Shêjzat

(Le Pleiadi)



Numër Përkujtimuer
kushtue
Prof. ERNEST KOLIQIT

shêjzat

(LE PLEIADI)

E PËRKOHËSHME KULTURORE, SHOQNORE E ARTISTIKE

RIVISTA CULTURALE, SOCIALE ED ARTISTICA

✯

Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit

Numero commemorativo dedicato al Prof. Ernesto Koliqi

✯

Drejtuer Përgjegjës/Direttore Responsabile

MATILDE MANCINELLI

Redaktor/Redattore

MARCO KOLIQI

Redaktor për pjesën gjermanishte/Redattore per la parte tedesca

PETER BARTL

Këshilli i Kryesís/Consiglio di Presidenza

MARTIN CAMAJ, GERHARD GRIMM, † KARL GURAKUQI, CLAUS HAEBLER, HANS JOACHIM KISSLING, † ERNESTO KOLIQI, LUIGI MARLEKAJ, † ROSOLINO PETROTTA, † ALOIS SCHMAUS, GEORG STADTMÜLLER, GIUSEPPE VALENTINI

Selija e Redaksís dhe e Administratës

Sede della Redazione e Amministrazione

PIAZZA DELLA BALDUINA, 59

00136 ROMA

✯

Dorëshkrimet, dhe në qoftë se s'botohen, nuk kthehen

I manoscritti, anche se non pubblicati, non si restituiscono

Pronar/Proprietario

ERNEST KOLIQI

shêjzat

(LE PLEIADI)

1978

Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit
Numero commemorativo dedicato al Prof. Ernesto Koliqi

PËRMBAJTJA
Sommario

Faqe
Pag.

Martin Camaj
Nji humbje e randë 7

P. V.
Jeta dhe veprat e Koliqit 14

P. Giuseppe Valentini
Ernesto - Specchio d'umano transito 19

Ernest Koliqi
Kuvendime me Vangjelín 26

Italo C. Fortino
Ernest Koliqi e Arbëreshët e Italisë 29

Matilde Mancinelli
Ricordo di Ernesto Koliqi 33

Gennaro Cassiani
Ritratto di Koliqi 34

Rexhep Krasniqi
Ernest Koliqi dhe zhvillimi letrar në Kosovë 36

Ettore Paratore
Ricordo di Ernesto Koliqi 43

James Torrens, S.J.
The poet is a shrine for his language 48

1

Faqe
Pag.

ANGELA CIRRINCIONE
Vajtim a Ernest Koliqi 52

SALVATORE PETROTTA
Kujtim i prof. Kolikjit 55

Msgr. dr. JOSEPH J. OROSHI
Nji pishtar i letërsisë e i kulturës shqiptare fiket 57

EMANUELE GIORDANO
Koliqi dhe unë (Koliqi ed io) 65

The memory of professor Ernest Koliqi honored at the University of Santa Clara, California 73

Dom PRENK NDREVASHAJ
Elegjí mbi Ernest Koliqin 87

HANS-JOACHIM KISSLING
Il romanziere tedesco Karl May e gli Albanesi 89

TAHIR KOLGJINI
Profesor Ernest Koliqi 94

NIJAZI SULÇOGLU
U shue Hylli shqiptar n'Italí 102

LEO MAGNINO
Lo studio dei problemi etnici e delle minoranze 106

HAMDI H. ORUÇI
« Vatra » dhe prof. Ernest Koliqi 112

ERNEST KOLIQI
Lutja e Dëshprueme 120

PETER BARTL
Die Këlmendi Zur Geschichte eines nordalbanischen Bergstammes . . . 123

FRANCESCO BONASERA
Una carta manoscritta dell'Albania conservata nella raccolta marsiliana della Biblioteca Universitaria di Bologna 140

ANTON LOGORECI
Ernest Koliqi 142

ANESTI ANDREA
Poetit Ernest Koliqi 145

MARCELLO DURANTE
A quale lingua si ricollega l'albanese? 147

EMILIO TAVOLARO
Ricordo di Ernest Koliqi 151

Faqe
Pag.

Shefki Miraku
Me Ernest Koliqin në miqësi 153

Spiro Muka
15 Kallënduer: një datë e hidhur 156

P. B. D.
Letra e nji Dashamiri 158

Nermin Falaschi
Un altro « immortale » albanese: Ernest Koliqi 160

Basilio Blaiotta
In memoria di Ernesto Koliqi 164

Miftar Spahija
Me rastin e vdekjes s Ernest Koliqit 167

John Sinishta
« The awakening of *arbëresh* cultural heritage in America » - « Koliqi's uncompleted educational endeavor » 171

Edvige Pesce Gorini
Ricordo di Ernesto Koliqi 173

Miku i Tij Letrar
Kujtimit të Hilushit 174

Vincenzo Chiodi
Ricordo di Ernesto Koliqi 178

Halim Begeja
Kultura dhe politika e Koliqit 179

Ernest Koliqi
La famiglia Simini 184

Dr. Christine Körner
Der Beitrag der Exilbläter « Ora e Shqipnisë » und « Bashkimi Kombëtar » zur Verbreitung des Gedankens der nationalen Einheit 188

Ndoc Vulaj
Gjâmë e vaj mbí vorr të prof. Ernest Koliqit 193

Vittore Pisani
Su albanese *shoh* 196

Angelo Fabi
Le raccolte di novellistica italo-albanese promosse da Ernesto Koliqi . . 198

Ago Agaj
I lumtur në jetë, i lumtur në vdekje 202

Gjon Sinishta
Vdekja e Babës 204

Faqe
Pag.

Giovanni Cava
Ricordo impressionistico del prof. Koliqi 205

Giosafat Frascino
Unë, profesor Koliqi dhe e përkohëshmja *Shêjzat* 207

Adolfo Plachy
Ernesto Koliqi 214

Lec Shllaku
Profesori u nda nesh! 216

Vasil D. Alarupi
Gega prej Rugove 223

Gordon M Messing
La tragedia di Norbert Jokl 226

Angela Minicucci
Ricordo di Stella Romano Minicucci e Scritti di Cesare Minicucci riguardanti gli studi albanesi 228

Anesti Andrea
« The Symphony of Eagles » by Ernest Koliqi 233

Nga shtypshkroja tue qortue shtypâjt e *Shêjzavet* 237

Prenk Gruda
Prof. E. Koliqi mësues i ndritshëm e dashtnuer i gjuhës amtare 240

Franco Schirò
Monsignor Paolo Schirò (1866-1941) 243

Peter Bartl
A Ernest Koliqi per il 70° genetliaco 247

Arben Kosova
Akrostihi i im kushtue Atij që e meriton 249

Antonello F. M. Biagini
La lotta per l'indipendenza albanese nei rapporti degli addetti militari italiani (1911-1912) 251

Italo C. Fortino
Ernesto Koliqi e gli *Arbëreshë* 262

Ymer Doda
Për shum mot festat 266

Adem Hodo
Në përkujtim të profesor Ernest Koliqit 268

Klaus Lange
Das Weltbild des Naim Frashëri 272

M. C.
Hasan Kaleshi (1922-1976) 281

Faqe
Pag.

AGOSTINO GIORDANO
Come un testamento 284

UJK MALI
Antiteza letrare 288

KOSOVË REXHA-BALA
Bardhë e zi rreth Drinit 293

ROBERT SCHWANKE
Gedanken über Nation und Staat der Albaner 298

KOLEC PIKOLINI
Letër nji Mikut 304

P. V.
Synopsis of the life and works of the Poet professor Ernest Koliqi . . . 306
Nota bibliografica - Scritti critici sul Koliqi e la sua opera 312


M. C.
Vorrimi i prof. Ernest Koliqit 316

Kronikë kulturore 320

Tezë doktorati mbi Koliqin (V.) - Mbrëmjet shqiptare (DM-Ko) - Mbramje letrare shqiptare në New York (T.H.) - Monsinjor Fortino çon nji meshë për Koliqin - Meshë përshpirtje për Koliqin - Përkujtohet prof. Koliqi - Këshilli i Fakultetit përkujton prof. Koliqin - Nji vizuer: Ernest Koliqi (SHEFKI MIRAKU) - Përkujtimi i Ernest Koliqi-t në New York në përvjetorin e parë të vdekjes - Ekspozita e pikturave të Lin Delisë në Gjermani (MARTIN CAMAJ) - Dr. Rexhep Krasniqi nderohet nga Bashkësia e New York-ut (hho) - Veprimtarija patriotike e heshtun e Adem Dushit (T.) - Anesti Andrea - Të rij Shqiptarë Universitarë n'Amerikë (hho) - Kisha e ré Katholike Shqiptare « Zoja e Papërlyeme - Pajtore e Shqiptarvet » (LULA LUCAJ) - Aperte le attività annuali del Circolo « Besa-Fede » - Le stirpi degli Albanesi d'Italia nella cronaca di Tocco 1375-1422 - Viaggio tra gli albanesi della Jugoslavia - Albania: Nascita d'una cultura nazionale (MIRCEA POPESCU) - Dr. Ernest Koliqi - La scomparsa di Ernesto Koliqi (ETTORE PARATORE) - È morto Ernest Koliqi (ELEUTERIO FORTINO) - Prof. Ernest Koliqi - Ricordo di Ernesto Koliqi (MIRCEA POPESCU) - Ernest Koliqi (PETER BARTL) - Cultura regionale - Varg librash letrarë « Biblioteka Shqipe » - LIBRA TË LEXUEM - Në përkujtim të dr. Nos Qirjakut (M. CAMAJ) - P. dr. Paulin Margjokaj ndrroi jetë (V.) - Vdiq Kapiten Xhevdet Skënderaj (P.) - Vdekja e Gjok Dragushës (V.) - Zhdukja e Sabri Domit (V.) - Zoja Lucia Shkreli ndrroi jetë (P.) - Halim Begeja (hho) - Ida Koka ndrroi jetë (P.) - Ndrroi jetë Gjeneral Zef Serreqi (P.) - Ndrroi jetë Miria Elena Vuksanaj Ndrevashaj (P.) - Zhdukja tragjike e Luftarit të Lirís, Gjon Gjinaj (Z.) - Pal Bib Mirakaj ndrroi jetë (V.).

Ky numër u pregatit për shtyp nën kujdesin e PETER BARTL, MARTIN CAMAJ, ZEF V. NEKAJ, HAMDI H. ORUÇI, GJON SINISHTA e PETRO VUÇANI.

Registrato il 26-7-1957 al n. 5898 del Registro del Tribunale di Roma



Prof. Ernest Koliqi (1903-1975)

Nji humbje e randë

nga **MARTIN CAMAJ**

E randë dhe e vështirë asht edhe për mue barra që po më bie të shkruej për këtë humbje shi në këtë vend ku Ernest Koliqi shtjelloi për tetëmbëdhetë vjet tema gjithfarësh shoqnore, frymëdhanëse të artit dhe përtrijse të kulturës shqiptare. Kjo peshë lehtësohet kur me bindje thom : zemra s'e mban, por as arsyeja s'duron të flasim për vdekje : vetja e Koliqit e paisun me vlera të nalta njerëzore, si poet e dijetar, i gjithanshëm, i hapun kah jeta me krahë gjiganti, gjallnon ; vepra e Tij e madhe flet gjithnji, si bazë komplekse e nji testamenti shpirtnor, fillue në vjetet tridhetë dhe e pandërpreme deri në ditët e fundit.

Koliqi si gjithë njerëzit e zgjedhun dhe në nji pikpamje i dashunuem prej fatit, i vetëdishëm i vlerës së vet, nuk frikësohej nga vdekja. Ai fliste te e vona për këtë shkëputje vetëm kur ankohej se « për shkak të kohës » po i mbetet pa sosë kjo ose ajo vepër. Do të më mbesë edhe i pashlyeshëm kujtimi se si profesor Koliqi shprehej mbi ardhmëninë madhshtore të popullit shqiptar, sepse besonte ngulshëm në cilësitë pozitive dhe të jashtzakonshme të shqiptarit. Kishte edhe besim se breznitë e ardhshme do t'ia njihnin, ndoshta ma tepër se bashkëkohorët, thelbin e koncepcioneve të Tij. Për të mbrojtë tezën e zhvillimit të lumnueshëm të Shqipnisë e të vlerave fisnike sidomos para ma të rijve binte arsyetime të shumta, shfaqë aty këtu edhe në faqet e kësaj reviste në këto vjett e fundit. Fliste kështu me gjuhën po të atij besimi të njerëzve të Rilindjes që Ai kishte njoftë personalisht. Këndej rridhte dhe entuziazmi i asaj periudhe heroike dhe dëshira për ta pa qenjen e vet dhe krejt jetën e çdo shqiptari në funkcion të çeshtjes nacionale.

Për Koliqin vetmohimi për çeshtje, ndjenja e përgjegjësisë, për të punue e jetue si Rilindas ishte e natyrshme dhe e vetvetishme. Ky qëndrim jetësor la ravë të qarta dhe në krijimtarinë letrare të Koliqit, së pari si krijues dhe mandej dhe si gjurmues i letërsisë shqipe. Në veprën e Koliqit u përjetësuen dhe kthesat e rrymave letrare sepse Ai qe i hapët gjithnji kah frymzime të reja, por tema thelbësore mbetet deri në fund çeshtja e eksistencës së kombit, « mbetja gjallë » ose « gjallnesa ». Ndërrojnë gjinitë letrare te Koliqi por kjo përmbajtje mbizotnon ; dinte të përdoronte pendën e vet të

mprefte në shkrime me karakter polemik pa ngurrim se po bahej « i padashun », kur ia merrte mendja se ishte në interes të çeshtjes.

Në të ardhmen do të shkruhet shumë mbi veprën e Koliqit, do të shkruhet gjithsesi, por kjo karakteristikë themelore e veprës së gjithanshme të Tij nuk do të injorohet. Por nga ana tjetër për mungesë dokumentacioni kam frigë se do të bjerë në pjesën ma të madhe nën hijen e kohës roli i Koliqit si zadhanës i kulturës dhe pajës shpirtnore shqiptare ndër të huej, sidomos në këto tridhetë vjett e fundit. Mund të dalë ndokush e të thotë se edhe kjo veprimtari do të përçohet në të ardhmen nëpërmjet dokumentacionit në faqet e revistës *Shêjzat* dhe ndër sa e sa shkrime kryesisht italisht dhe në gjuhë tjera të hueja.

Pjesën ma të madhe Koliqi e kaloi në dhén e huej, në nji anë gjithnji në kontakt me botën shqiptare e sidomos arbëreshe, dhe në tjetrën si profesor universiteti e shkrimtar në dialog të përhershëm me rrethe intelektuale të ndryshme të botës perëndimore. Vetë persona e Koliqit ndër këto rrethe, si njeri shoqnie dhe kuvendtar brilant qiste poshtë me të parën çdo paragjykim të gabuem e dizinformues mbi Shqipninë. Njifte fill e për pe historinë shekullore të thashethanave kundër shqiptarëve ndër të huej: denigrimet naive të shundliteraturës kundër nesh i praponte me humor tipik shkodran e tjerat ma të rafinueme i vente mbarë në peshojcën e gjykimit të shëndoshë dhe i hidhte poshtë me argumenta, tue lanë të spikasin formulime të përsosuna prej gojtari, në mbroje të gjithë shqiptarëvet, pa dallim. Fliste ashtu sepse vetë ma së pari ishte i mbushun mendje mbi vërtetësinë e këtyne pohimeve. Këtu due të them se, jo vetëm me pendë, por edhe me gojë i shërbeu çeshtjes, shi aty ku ndreqjet e të dhanavet të gabueme mbi Shqipninë gjeshin jehonë që me siguri do të transmetohet pandërpremje nëpërmjet kuvendeve e shkrimeve të atyne ndigjuesve edhe mbas zhdukjes së Tij.

Me këtë shqyrtim due dhe unë të vi te pohimi që ndigjohet prej shumkuj se zhdukja e Koliqit paraqet humbje të randë për kulturën shqiptare në përgjithësi dhe vë në rrezik shqimjen e lëvizjes kulturale shqiptare në Perëndim, pikrisht mbas dhetë vjetvet nga vdekja e Fan Nolit në Amerikë.

Në saje të zotësive organizative e punës së palodhshme të Ernest Koliqit u ngjall ndër arbëreshë e shqiptarë në Perëndim nji lëvizje kulturale, tue u nisë ma parë nga Instituti i Studimeve shqiptare të Universitetit të Romës, gjithnji në bashkëpunim me qendrat tjera albanologjike universitare, dhe ma vonë nëpërmjet revistës *Shêjzat*. *Shêjzat* shërbyen si tribunë dhe dritare informimi mbi aktivitetet shkencore albanologjike në botë. Ato regjistruen në kronikën e tyne edhe ngjarje shoqnore që në të ardhmen do të vlejnë sadopak si dokumentacion historik e kultural për nji periudhë rreth njizetvjeçare. *Shêjzat* nën drejtimin e Koliqit vijuen, tue iu përshtatë kohës dhe vendit, traditën kulturale të Rilindjes dhe sidomos të revistave të periudhës mes dy luftavet në Shqipni. Në këtë vend duhet sqarue edhe nji herë qëndrimi

ynë në përgjithësi kundrejt zhvillimit të kulturës shqiptare aty ku jeton trupi kryesor i këtij populli : jemi gëzue dhe gëzohemi që janë ba qendra studimesh shqiptare Tirana e në kohët e fundit edhe Prishtina ; por nga ana tjetër nuk asht e thanun se duhet dëshirue shuemja e vatrave kulturale tona, me nji tradicion të vjetër, jashta këtyne qendravet.

Ky problem ka për të ra në pleqnim të shumëve, sidomos mbas vdekjes së Koliqit. Shqiptarët e shpërndamë nëpër botën perëndimore, në vend të parë ata të Amerikës dhe arbëreshët me nji traditë të shkëlqyeshme, jam i sigurtë se do t'i përgjegjen si këtu e ma parë detyrës dhe nevojës për të ruejtë e paisë me elementa të rij trashigimin kultural të etënvet në kushtet e veta spicifike. Të gjithë e dimë se nuk asht kjo nji gja e lehtë. Përvojë e kronikë e këtyne përpjekjeve dhe vështirësive janë posaçe shumë artikuj hymës në *Shêjzat*, dalë nga penda e Ernest Koliqit, si *Malli i atdheut e librat* (krh. Vjeti VII, fq. 73) etj.

Këshilli redaktues i revistës *Shêjzat*, i përkrahun nga ata ma të afërmit e profesor Koliqit *dr. Mark Koliqi* dhe *dr. Petro Vuçani* e ndjeu për detyrë të kujdeseshin për pregatitjen e këtij numeri të fundit. Shumica e bashkëpunëtorëve i përgjigjën thirjes tue dhanë kontributin e tyne, dikush me syzime të çmueshme shkencore, dikush me shkrime që flasin me gojën e zemrës për Ernest Koliqin : të gjithë i falnderojmë për këtë bashkëpunim kaq të gjatë që banë pa shpërblime dhe honorare, por thjesht për idealizëm dhe në emën të miqsisë.

Problem mbi probleme, tue fillue prej numrit të parë të *Shêjzavet* u paraqit gjithnji financimi i shtypit. Edhe ky vëllim i bashëm po del në dritë me ndihmesat e shqiptarëve, shumica punëtorë krahu : bashkë me të Ndiemin kemi çmue në kulm gjithmonë përkrahjen e pajtimtarëvet tanë! Për t'u thanë *Faleminderit* na duket pak, ma shumë asht t'u thomi : të gjithë me nji pikë djersë, bashkë me Shpirtdhanësin e kësaj lëvizje kulturale në të cilën barti barrën kryesore, mund ta mbajnë veten bashkëndërtues në këtë vepër.

Shpërblim për ne të gjithë asht vetëm siguria që kjo vepër e lidhun ngusht me emnin e Koliqit nuk do të bjerë në harresë.



Instituti i Studimeve Shqiptare, Tiranë 1942

All'Istituto di Studi Albanesi, Tirana 1942

(*Nga e majta*/dalla sinistra): Vangjel Koça, Aleksandër Xhuvani, Anton Paluca, Át Anton Harapi, Xhevat Korça, Mustafa Merlika Kruja, Ernest Koliqi, Dhimiter Beratti, Át Giuseppe Valentini, Karl Gurakuqi, Ekrem Vlora, Nicola Lo Russo Attoma e Dom Lazer Shantoja

Me pikllim njoftojmë se u nda kësо jete, papritmas, mbas pak vjetësh të humbjes së bashkëshortes fort të dashtun, VANGJELIJA,

ERNEST KOLIQI

Të tronditun e me idhnim të pamasë lajmojnë i biri MARCO, e bija ELISABETTA me dhandrrin CARLO, Nipat GABRIELE, LUDOVICA e GIANMARCO, Vëllazënt e Motra e ngashrueme, i kunati PETRO VUÇANI, si dhe mbarë farefisi se ceremonija e vorrimit mbahet të shtunën me 18 kallnuer në orën 11 në Kishën e Shën Piut X në Piazza della Balduina.

Romë, 15 kallnuer 1975.

Ha raggiunto in Cielo la Sua adorata VANGJELIJA

ERNESTO KOLIQI

Lo annunciano storditi dal dolore i figli MARCO ed ELISABETTA, il genero CARLO, i nipotini GABRIELE, LUDOVICA e GIANMARCO, i fratelli e le sorelle vicini e lontani, il cognato PETRO VUÇANI, i parenti tutti.

Partecipano le fedeli MARIA BELLU e MARIA FANTILLI.

Le esequie avranno luogo sabato 18 gennaio alle ore 11 nella Chiesa di San Pio X in Piazza della Balduina.

Roma, 15 gennaio 1975

Il Consiglio Direttivo del B.K.I. partecipa con profondo cordoglio la scomparsa del suo valido Componente

PROFESSOR

ERNESTO KOLIQI

Ordinario dell'Università di Roma

Il Rettore e le Autorità Accademiche dell'UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI ROMA partecipano, con profondo dolore, la morte avvenuta in Roma, il 15 gennaio 1975 dell'Illustre

PROFESSOR

ERNESTO KOLIQI

già Ordinario di Lingua e Letteratura Albanese della Facoltà di Lettere e Filosofia

I funerali avranno luogo il 18 gennaio 1975, alle ore 11 nella Chiesa Pio X in Piazza della Balduina.

L'ISTITUTO DI STUDI ALBANESI dell'Università degli Studi di Roma partecipa con immenso dolore la grande perdita del suo fondatore e illuminato Direttore

PROFESSOR

ERNESTO KOLIQI

GIUSEPPE GRADILONE partecipa con profondo cordoglio l'improvvisa scomparsa del suo indimenticabile Maestro

PROFESSOR

ERNESTO KOLIQI

ricordandone le rare qualità di uomo e di studioso.

ISMAIL e ODINEA con profonda tristezza rimpiangono l'amico

ERNESTO KOLIQI

— ZEF e MARIA SEREGGI
— LUCIA PRENNUSHI e famiglia
— GASPER e LAURA SEREGGI
— TON e CESARINA KOKA
— ANTON NELLA e NICO PRENNUSHI
— LIN e LUCIA SHKRELI
— MARTIN e ERIKA CAMAJ
— HIL TOPALLI

con commosso affetto piangono la perdita del carissimo amico

PROFESSOR

ERNESTO KOLIQI

FLAVIO NARDUZZI profondamente addolorato partecipa al dolore dei familiari per la scomparsa del caro cugino

PROF.

ERNESTO KOLIQI

SILVIA e PEPPINO ZORZOLI partecipano al dolore dei familiari per la scomparsa del carissimo amico

ERNESTO

FALNDERIM

MARCO KOLIQI falnderon n'êmën të së motrës ELISABETTA dhe të gjithë familjes të tanë ata që me kunora, letra e telegrame na shprehën përdhimtimet për humbjen e atit, të vëllaut e të kunatit fort të dashtun

ERNEST KOLIQI

Falnderoj me zemër të gjithë ata të afërt tonë që na u gjeten pranë në këto dit të trishtueshme e moren pjesë në salikime, posaçe miq e dashamirë që erdhen prej së largu, si nga USA, Turqija, Belgjika, Franca, Gjermanija e Suedija, Siqilija e Kalabrija, si edhe Ministrín e Arsimit, Rektorin e Universitetin e Romës, përfaqsít e komuniteteve fetare e të partive politike në mërgim.

Romë, 22 kallnduer 1975.

Jeta dhe veprat e Koliqit

nga P. V.

1903. *Lindi në Shkodër me 20 màj. Qysh në fmini u dallue për lexim e shkrim.*

1918. *E dërguen n'Itali me studjue. Bashkë me studenta tjerë themeloi në Bergamo të përjavëshmen studenteske* Noi, giovani (*«Na, të rijt»*), *ku botoi vjerrshat e para n'italisht.*

1921. *Ktheu në Shqipni e u vû me zell me xânë gjuhën shqipe. E shtyni në veprimtari letrare patrioti Luigj Gurakuqi, e në këtë kohë lidhë miqsi me të rijt e atëhershëm të Shkodrës, si Kolë Thaçi, Shuk e Karl Gurakuqi, Loro Ashiku, Dom Lazër Shantoja, Kolë e Lin Kamsi.*

Fiton konkursin e Ministris s'Arsimit për nji hymën kombëtar të propozuem prej Këshillit Ministruer. Juria ishte e përbâme nga: P. Gjergj Fishta, Fan S. Noli, Midëhat Frashëri e Luigj Gurakuqi.

1923. *Sëbashku me P. Anton Harapin e Nush Topallin themelon fletoren* Ora e Malevet. *Kjo fletore pat nji sukses të madh, jo vetëm në fushën politike, por edhe n'atë letrare të kohës. Këtu bâni hapat e para në lâmin letrar, nën drejtimin e Luigj Gurakuqit e të Fishtës.*

1924. *Hyni me bâ pjesë në Shoqnin* Bashkimi, *krijue nga Avni Rustêmi. Në këtë vjet qe i detyruem me u largue prej Atdheut e u shtrengue me ndêjtë pesë vjet në mërgim në Jugosllavi. Këtu mësoi gjuhën e vendit e filloi me lexue autorët mâ të mëdhej serbo-kroat.*

Gjithmonë i nxitun e i këshilluem nga Luigj Gurakuqi, shkroi e botoi poemthin dramatik Kushtrimi i Skanderbeut *me përmbajtje patriotike. Pikërisht kjo vepër i dha shpresa të mëdha për të hymë përgjithmonë në botën e letrave shqipe.*

1928. *Boton në Zara vëllimin e novelave* Hija e Maleve, *ku paraqiten jo vetëm ngjarje të jetës malsore, por edhe qytetare, tue u bazue përhera në frymën e* Kanûnit të Lek Dukagjinit.

1929. *Kthehet në Shqipni me vëllimin e novelave. Suksesi i këtij libri e pagëzoi si* krijuesin e novelës shqipe.

1930-33. *I kushtohet për disa vjet arsimit dhe e ushtron si mësues në Vlonë e Shkodër.*

1932. *Del në dritë vëllimi i parë i përkthimeve të bukura* Poetët e Mëdhej t'Italís, *me poezi nga Dante, Petrarka, Ariosto e Tasso, tue u shoqnue me nji parathanje të Át Gjergj Fishtës. Përkthimet qenë pritë mâ se mirë si prej lexuesve, ashtu edhe nga kritika.*

1933. *Boton librin e vjerrshave* Gjurmat e Stinve, *ku paraqiten në nji frymë krejt të ré skenat e jetës shkodrane.*

1934. *Bashkëpunon në të përkohëshmen* Illyria, *e përjavëshme kulturore, qysh nga fillimi. Në vjetin 1935 boton poemthin në prozë* Quattuor.

1935. *Del libri i dytë i novelave:* Tregtár Flamujsh, *në të cilin jeta shkodrane âsht paraqitë edhe mâ me hollsi psikologjike. Në këto novela spikatet mâ së miri mendimi i ri i autorit.*

1936. *Boton vëllimin e dytë të antologjis* Poetët e Mëdhej t'Italís, *me poezi nga Parini, Monti, Foscolo e Manzoni.*

Do të dilte edhe vëllimi i tretë, por për arësyena të ndryshme nuk u botue. Veçse shum poezi e fragmente të Leopardi-t, Carducci-t, Pascoli-t e D'Annunzio-s duelën në dritë në të përkohëshme e fletore të kohës e në vëllimin Manuale di lingua albanese *të P. Fulvio Cordignano-s. Vëllimin e dytë e paraqiti albanologu, mjeshtri i Tij, prof. Carlo Tagliavini, e kritikën e pat bâ Dom Ndré Mjedja në të përkohëshmen* Leka. *Përkthen edhe lirika prej Diego Valeri-t, Enrico Grassi-t, Emil Verhaeren e Charles Baudelaire.*

1937. *Kreu studimet universitare në Padova me tezën:* Epica popolare albanese (« *Epika popullore shqiptare* »), *tezë doktorate që kje vleftësue shum nga albanologët Norbert Jokl, Maximilian Lambertz e nga nji numër i madh studjuesash të famshëm t'albanologjis.*

1939. *Emnohet Ministër i Arsimit. Përnjiherí mblodhi në Ministri gadi krejt studjuesat e shkrimtarët mâ të spikatun e filloi botimin e librave për shkollat e mesme e fillore. Botimi i këtyne teksteve ka qenë nji kryevepër që s'âsht përsëritë mâ. Mjafton me theksue dyvëllimshin* Shkrimtarët Shqiptarë, *vëllimet* Bota Shqiptare, Rreze Drite e Te Praku i Jetës *e sidomos vazhdimi i mbledhjes së folklorit me botimin e blênvet* Visaret e Kombit *që deri atëhere kishin dalë në dritë vetëm tre vëllime e me ardhjen e Koliqit në Dikasterin e Arsimit mbrrijti deri në XIV vëllime, tue mbetë edhe sot e kësaj dite monumenti mâ me randësí për studimin e folklorit shqiptar.*

Po në këtë vjet emnohet titullar i Kathedrës së Gjuhës e Letrësis Shqipe n'Universitetin e Romës. Mâ përpara pat qênë si i ngarkuem i kësaj dege në Universitetin e Padova-s.

Themelon të përkohëshmen Shkëndija *që, mbrenda pak kohe, bâhet votra e shkrimtarvet, tue njoftë lexuesit me nji numër të madh letrarësh të rij të talentuem të çdo krahine.*

1940. *Organizon në Tiranë nji Kongres të Studimeve Shqiptare, ku morën pjesë, përveç shqiptarvet, albanologët botnor të famshëm, si prof. Carlo Tagliavini, Antonio Baldacci, Francesco Ercole, Angelo Leotti, Gaetano Petrotta etj. etj. Nga ky kongres lindi* Instituti i Studimeve Shqiptare *me qendër në Tiranë. Këtu fillon botimi i vëllimeve të mëdhá* Studime e Tekste, *ku bashkëpunuen linguista, jurista e folklorista si P. Zef Valentini, P. Bernardin Palaj e Ernesto Cozzi.*

1941-42. *Gjatë këtij vjeti shkolluer, si Titullar i Arsimit, dërgon në Kosovë rreth dyqind mësues e mësuese. Me këtë rast u hapën nji numur bajagi i mirë shkollash fillore në shum vende e disa shkolla të mesme e u dha nji numur i shênjueshëm bursash.* « ...ma në fund, erdhi çasti historik i hapjes së *Shkollës së parë*

të plotë të mesme në gjuhën shqipe, që u realizue me 12 Dhjetor 1941». *E këto shkolla* «u banë baza me randësi për zhvillimin e përparimin e gjanë dhe të shumanëshëm të arësimit dhe të kulturës shqiptare në Jugosllavinë e sotëshme» (Rexhep Krasniqi *në* Shêjzat *Vj. XVIII, nr. 1-10, faqe 8-11*).

1942. *Martohet me arsimtaren* Vangjelija Vuçani. *Prej saj i linden dý fëmij:* Marco (*Marku*) *dhe* Elisabetta.

Largohet nga Ministrija e Arsimit dhe emnohet Kryetar'i Institutit të Studimeve Shqiptare për me muejtë kështu me vijue veprën e ndërmarrun nga Kongresi. Bashkëpunon edhe me Mustafa Merlika Krujën, Karl Gurakuqin, Asdrenin, Ali Asllanin, Lasgush Poradecin, Anton Logorecin, Ismet Toton etj.

1947. *Nis me shkrue në fletoren* L'Albanie Libre *që posa ka fillue me dalë. Nga botimet e tij të shpeshta në këtë fletore, po përmendim* Kângën e Kapedan Markut, *kângë epike për vdekjen e Kapidan Markut, ku nalton trimnin e këtij Fatosi, që rá dëshmor në vjetin 1946 tue luftue për lirin e Atdheut e shpëtimin e krejt zakoneve t'ona fisnike; e më 1953 fillon me botue shkrimet për historin e letrësis* Dý shkollat shkodrane (*Shkolla e Jezuitve dhe Shkolla e Françeskajve*).

1957. *Me dekret të Presidentit të Republikës s'Italis, datë 2 shtatuer 1957, Kathedra e Gjuhës e Letrësis Shqipe e Universitetit të Romës, për meritë të Koliqit, nderohet tue u bâ* Institut i Studimeve Shqiptare.

Boton në Firenze vëllimin Poesia popolare albanese (*Poezija popullore shqiptare - me tekste përball shqip e përkthime italisht*).

Themelon të përkohëshmen Shêjzat (*Le Pleiadi*), *nji ndër monumentet mâ të pazavendësueshëm të letrësis shqipe. Në çdo numër të rivistës gjindet nji shkrim i Tij. Mjafton të shfletësohet kolekcjoni i 18 vjetve të së përkohëshmes për të njoftë figurën e Koliqit e idêt e Tija.*

1959. *Boton vëllimin* Kangjelet e Rilindjes (*«I canti della Rinascita»*), *me përkthimin italisht, ku i nxitë Arbreshët me ruejtë gjuhën e zakonet e të kenë besim në pavdeksin e fisit.*

1960. *Del në dritë romani* Shija e bukës së mbrûme, *ku ndihet dashunija e të mërguemit për token e vet, për dëshirën e madhe me pá Atdheun e që nuk mundet dot, sepse nji bishë e egër e mizore e ka shtrëngue në duert e veta.*

Boton në revisten Quaderni dannunziani, *fasc. XVIII-XIX, studimin* Gabriele D'Annunzio e gli Albanesi.

1961. *Përkthen italisht e boton me shënime në* Shêjzat *poemthin e Ali Asllanit* Darsma Shqiptare.

Boton vëllimin Rapsodi e rapsodie delle Alpi Albanesi, *ku flitet për trimnin e burrnin shqiptare.*

1962. *Përkthen italisht e me shënime shkoqitëse nga* Lahuta e Malcís *së Fishtës Kangën e XXVI:* Koha e Ré.

1963. *Boton* Antologia della lirica albanese (*«Antologjija e lirikës shqipe»*), *volum ku për të parën herë paraqiten në nji gjuhë europjane përkthimet e lirikat mâ të mira t'autorvet shqiptarë të vjetër e të rij, e këtu duhen theksue veçanisht ata të Kosovës për popullarizimin e tyne n'Europë.*

Rishtypë Shtatë Pasqyrat e Narçizit (*që i kishte botue së pari në fletoren* Gazeta Shqiptare *të Bari-t me 1936*) *ku paraqiten shtatë copa proze poetike që përshkruejnë gjendjen shpirtnore të shkrimtarit.*

1965. *Del në dritë* Albania, *nji monografi italisht, botue në* Enciclopedia dei popoli d'Europa, *Milano. Âsht hera e parë që nji enciklopedi paraqet objektivisht e me kjartësi nji pasqyrë të gjanë mbi Shqipnin si në pikpamjen gjeografike, ashtu edhe letrare e historike. Janë 160 faqe shtypi me plot fotografina krahinash e skâjesh, kostumesh e personalitetesh.*

1969. *¼ mâj: i vdes Bashkëshortja, krahu i djathtë në çdo veprimtari të Tij. Zhdukja e Saj i shkaktoi nji mungesë të pazavendësueshme e, ndoshta, shpejtoi edhe humbjen e Tij.*

1970. *Riboton poemthin* Symfonija e Shqipeve *(që e kishte botue herën e parë po në fletoren* Gazeta Shqiptare *të Bari-t me 1936). Vepërza ka për argument naltësimin e kohës së kalueme të fisit t'onë. E përktheu anglisht, me 1972, shkrimtari i ri* Anesti Andrea.

1971. *Përkthen italisht nga* Lahuta e Malcís *epizodin e* Marash Ucit *(Kângët: XII-XIII-XIV e XV) me nji hymje e shënime shkoqitëse.*

1972. *Del në dritë vëllimi* Saggi di Letteratura Albanese, *Firenze. Âsht nji përmbledhje e mirë shkrimesh e konferencash përpunne gjatë disa vjetve.*

1973. *Vazhdon me e përkthye italisht e me e pajisë me shënime* Lahutën e Malcís: *këtë rradhë epizodin* Oso Kuka *(Kângët: II-III-IV-V).*

1975. *Vdiq papritmas në Romë, në banesën e vet, me 15 Kallënduer e u varros po në këtë qytet me datën 18. Po në Romë prehen prindët e Tij dhe Bashkëshortja e Vet. Në ceremonin e asaj dite kishin ardhë Personalitete të ndryshëm, Kolegë, Shqiptarë, Arbreshë, Miq t'ardhun nga SH.B.A., nga Turqija, Suedija, Gjermanija Prendimore, Franca, Belgjika e shum vende t'Italis. —*

* * *

Nuk duhet harrue se me 1967 nisi botimin e seris Studi Albanesi *(«Studime Shqipe») e deri më sot, gjithmonë nën drejtimin e Koliqit, janë botue në pjesën* Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia *(«Traditat popullore të Shqiptarve t'Italis») tre vëllime, e në pjesën* Studi e Testi *(«Studime e Tekste») gjashtë vëllime të tjerë.*

Veprat e Tij janë përkthye gjermanisht, italisht, anglisht, arabisht, greqisht.

Bashkëpunon e shkruen në rivistat e fletoret mâ me randësi Hylli i Drites, Leka, Gazeta Shqipëtare, Illyria, Përpjekja Shqiptare, Minerva, Besa, Koha e Jonë, Jeta Katholike, Lajmtari i të Merguemit, *etj.*

Shkurtimisht ky âsht jetëshkrimi i Koliqit të Madh, e po dishrojmë me theksue këtu fjalët e nji tjetri të Madhi, prof. Karl Gurakuqit, *që disa kohë mâ parë pat shkrue:* «Nuk janë shum shkrimtarët t'onë, emni i të cilvet të njifet aq mirë në shtresat letrare shqipe sá ai i Koliqit; të pakët janë atá, prodhimet e të cilvet të kenë marrë aq hapët në çdo kând të Shqipnís, sá ato qi ai i ká falë letërsís. Janë katërdhetë vjetë qi paprèmas e shofim emnin e tij në çfaqje kulturore gjithëfarësh, në botime nepër fletore e revista të ndryshme, disá prej të cilavet themelue dhe mbajtë prej tij vetë, në botime veprash qi janë të paracaktueme të zânë nji vend të dukshëm, dashtas a padashtas, në historín e letravet t'ona» (Shêjzat, *Vj. VII, 1963, nr. 5-8, faqe 163*).

Medajë arit të Shoqnis «Dante Alighieri»
(Medaglia d'oro della Società «Dante Alighieri»)

Ylli i Artë për Meritë të Shkollës
(Stella d'oro al Merito della Scuola)

Akademik ordinar i Akademis Tiberine
(Accademico Ordinario della Accademia Tiberina)

Akademik Nderi i Akademis Teatine të Kietit për Shkencat
(Accademico d'Onore della Accademia Teatina delle Scienze di Chieti)

Antar i Akademis s'Abrucit për Shkencat e Artet
(Membro dell'Accademia degli Abruzzi per le Scienze e le Arti)

Antar efektiv i Akademis së Mesdheut
(Membro effettivo della Accademia del Mediterraneo)

Antar Nderi i Qendrës Ndërkombtare për Studimet Shqiptare të Palermo-s
(Membro Onorario del Centro Internazionale degli Studi Albanesi di Palermo)

È uscito il volume:

ANTONIO BELLUSCI

MATERIALE E DOKUMENTE KULTURAVE ANALFABETE
MATERIALI E DOCUMENTI DI CULTURE ANALFABETE

Vol. I

ARGALIA
ndër tekstet origjinale arbëreshe

ossia

IL TELAIO
nei testi originali arbëreshë

Kërkime etnografike ndër arbëreshët
të Kalabrisë, të Basilikatës e të Greqisë

Ricerca etnografica tra gli albanesi
di Calabria, di Basilicata e di Grecia

Cosenza 1977 *Lire* 7.500

Il libro di pp. 160 con alcune figure e tavole si può ordinare presso l'Autore:

Papàs Antonio Bellusci
Parroco di: 87030 Falconara Albanese (CS)

Ernesto
Specchio d'umano transito

di P. GIUSEPPE VALENTINI

Di fronte a un vivo non si osa — se si ha coscienza — dire quel che si pensa di lui esser la verità; perché è di passaggio e non si vuole prevenire il giudizio né guastar l'avvenire.

Di fronte a un morto non si usa — se si ha giusto umano rispetto e riverenza del Giudice Iddio — dire il nostro giudizio men che elogiativo; *kjoftë për athërë,* si suol dire, quel che è stato è stato, mettiamoci sopra la pietra tombale con un'epigrafe che non sia dissonante da quella clemenza di Dio che vorremmo anche per noi, né difforme da quella giustizia che elimina il male cancellandolo ed esalta il bene valorizzandone ogni briciola.

E mira prei së hollit e e keqja prei së trashit, diceva il vecchio proverbio; e se l'intendiamo nel senso che il male si disfà quanto è troppo e il bene quand'è troppo poco, è discutibile come tutti i proverbi; ma se l'intendiamo come un canone relativo al valore dei giudizi, se crediamo che *ká Zot,* c'è Dio, un giudizio è errato quando dice troppo male e quando dice troppo bene.

E a questa misura deve attenersi ognuno, sia l'avversario, sia l'amico.

Sono stato amico di Ernesto per quarantadue anni. Certo con quella fedeltà all'amicizia che Egli aveva dal suo essere albanese e che io avevo appreso in Albania.

Un'amicizia all'albanese, intesa non solo come l'amicizia-ospitalità, o come amicizia — *ndore* — protezione, che non guardano ai meriti delle persone ma agli impegni presi fra loro, per quel dovere di salvaguardia dell'alto interesse comunitario della sicurezza e della solidarietà. Ma anche con quella forma privata e personale che nasce nella collaborazione dal riconoscimento della mutua complementarità, e si nutre quindi nella giusta stima vicendevole, pure rimanendo ciascuno nel suo polo a servire la sua specifica funzione irrinunciabile nell'interesse comune ai due e all'intera Società.

Le nostre posizioni erano diverse. Io ero il prete, filosofo quindi e teologo; Egli era il laico e il letterato, l'artista quindi. Io lo guardavo dall'alto della mia cattedra filosofale, con comprensione, e da quella teologale con condiscendenza; Egli, da buon cattolico scutarino, rispettava la mia cattedra, ma faceva quel che era il compito suo e la sua ispirazione.

Io desideravo che Egli divenisse filosofo e teologo, e quindi poeta; Egli era nato poeta e quindi sentiva che la sua via era all'inverso: dalla poesia ai valori umani attraverso i quali intravediamo il Vero e il Divino.

Anche storicamente le nostre vie erano convergenti partendo da opposti punti di partenza. Ernesto era nato a Scutari, in una città e in una casa che

erano focolari di albanicità: ne partì quattro volte, e tre vi ritornò perché sempre legato a quel cordone ombelicale, riportandovi però delle acquisizioni preziose: con esse Egli mirava costantemente non a sopprimere od obliterare i valori morali della sua gente, che sentiva esteticamente, e quindi con tutto se stesso, ma a rivelarli con la finezza della penetrazione acquisita alle grandi scuole e correnti estetiche, e a dare ad essi una voce che li facesse conoscere, debitamente apprezzare e utilmente accettare nel comune e vario « tesoro di bellezze diverse » ma armoniche che fanno dell'umanità il ritratto in mosaico del volto di Dio; non una veste accattata e disadatta ma una voce sua originaria armonizzata con le altre. Quindi la sua ricerca di fondo di tutti i valori sostanziali dell'albanicità, sempre accoppiata con la ricerca della forma più duttile.

Io venivo e ritornavo da fuori, dapprima, lo confesso, con una specie di intenzione « colonialistica », non di imporre un potere oppressivo, ma di donare una superiore cultura; dapprima sorpreso, poi stupefatto nell'incontro con un'« altra » civiltà; poi ancora affascinato dai suoi reconditi aspetti, che erano altrettante idee-forze per un vivere civile veramente tale, fatto di mutuo rispetto e sociale solidarietà fino a un inverosimile eroismo; e finalmente travolto e acquisito a quella mentalità quasi più che se ci fossi nato. Fino al punto di volermi camuffare da albanese, adottando pedantemente le forme stilistiche e idiomattiche dello stile albanese popolare, e quelle retoriche della tradizione letteraria scutarina. Né potevo far diversamente: nella mia situazione di *jabanxhí* pellegrino ammesso all'ospitalità albanese, mio primo dovere era quello di rispettare; non che ci sia riuscito sempre, sopraffatto ogni tanto dalle mie velleità letterarie e culturali della scuola classica italiana, che mi faceva ambire di dir in albanese di cose in cui l'albanese non si fosse prima cimentato.

Come si vede, da partenze diverse mossi, e per vie diverse movendo, ci incontravamo concordi.

Ma c'era paradossalmente di più.

Io partivo da un ambiente e una mentalità saldamente e fervidamente cattolica, conservatrice, integrista: precisamente da quella italiana e puntualmente veneta, che dissociava risolutamente l'amor della patria italiana dall'ossequio a una politica imperante, « patriottarda » come dicevamo allora, laicistica e antipapale: l'Italia per me stava nelle sue glorie di santità e di arte e di letteratura e di scienza cristiana, non in un suo fatuo prestigio politico; in un suo primato morale, non in una sua bandiera sventolata in aria o nelle sue baionette. Quando mi venne rimproverato di non essere buon italiano perché svolgevo il mio insegnamento in albanese e non in italiano, risposi che mi sembrava più onore per un italiano saper fare omaggio alla cultura albanese e riuscire a servirla, che non volerla sostituire con la cultura italiana o asservirla ad essa.

Ernesto veniva invece da una formazione familiare, certo cattolica, ma non senza una tinta leggermente liberale; con un concetto del patriottismo tipico delle guerre d'Indipendenza; nei suoi studi nell'Italia di Carducci e di D'Annunzio se ne era appropriato il linguaggio, ma sempre sostituendo in cuore — e appena poté — negli scritti Italia con Albania. Le sue prime opere edite, nate subito al suo ritorno in patria, furono quella con cui vinse il concorso per un inno nazionale, e il *Kushtrimi i Skanderbegut,* ispirate totalmente a un

patriottismo indipendentista, e pertanto politico. Sta il fatto che la lingua patria in lui non era dimenticata né disusata, come invece ho visto in quasi tutti i miei alunni che avessero passata la fanciullenzza all'estero, pur essendo di famiglie di caldi sentimenti patriottici. Di più, la lunga assenza, in ambiente la cui concezione di vita era di gran lunga diversa da quella del suo paese, dandogli una distanza nel mirare lo spettacolo della società albanese, glielo deve aver reso più sorprendente: la sua collaborazione nell'*Ora e Maleve* con quei frati francescani che vivevano e battagliavano con la regola di San Francesco in cuore e il *Kanun* nella testa e nel braccio, la scuola di quel patriota di profonda concezione che fu il suo maestro politico Luigj Gurakuqi, lo avviarono irrevocabilmente all'azione politica sì, ma sempre e sempre più intesa alla conservazione ed elevazione di tutti quei valori spirituali che danno la più autentica personalità e nobiltà allo spirito albanese, più che non alle effimere situazioni e ai meno essenziali interessi in cui battaglia e s'adopera la politica pratica della giornata.

Ancora ci trovammo d'accordo, sia quando Egli pubblicava nel mio *Leka* le sue liriche così intense di entusiasmo e di sollecitudine per le maschie e sane virtù della Montagna e per la loro conservazione.

D'accordo, senza accordarci, quando, avvenuto l'attentato di Zogu contro quei sacri focolari di elevazione spirituale della Nazione che erano le Scuole private e specialmente quelle cattoliche, Ernesto si ritirò in Italia a studiare, e noi del *Leka* passammo a una opposizione non clamorosa ma non tacita né senza pericoli, contro gli arbitri del Regime.

E venne il momento critico della rottura definitiva e improrogabile col zoghismo.

Non si trattava più solo, oramai, di dissidi regionali o culturali o religiosi; in fin dei conti anche i regimi, come le nazioni, sono sanabili. La situazione geopolitica europea era in movimento; da vicino, in uno sconvolgimento generale, che cosa avrebbero fatto i vicini? Certo le loro conclamate mire erano espansionistiche; da lontano c'era il nazismo che straripava e che offriva prove della sua indole in Cecoslovacchia e in Austria. Notisi bene: il pericolo non era solo un pericolo d'invasione di forze e di poteri ma di culture estranee e spinte a sostituirsi. Né le forze d'Albania da sole erano tali da poter garantire una difesa, come si poté veder poi, quando la liberazione d'Albania non poté avvenire senza l'intervento della Russia per mano della Jugoslavia, con la connivenza dell'Inghilterra e dell'America, non senza la perdita della Kossova e dell'anima stessa della concezione di vita essenziale delle sue tradizioni nazionali.

Ernesto fu con Mustafa Kruja e con D. Lazer Shantoja, tra quelli che videro l'unico scampo nel ricorso all'Italia, di cui non previdero né la caduta né la disillusione che avrebbe dato.

Quando io ne ebbi notizia, spettatore già del dramma dell'*Opozita* e della rivolta del Dukagjini e del putsch di Kavaja, confesso che la credetti non più di una velleità; comunque non spettava a me, italiano, cattolico e religioso di professione, albanese di cuore, di politica non più esperto dell'uomo della strada, esprimere un parere conforme o difforme da quello che il grosso della vecchia *Opozita* aveva adottato.

Ernesto, con Mustafa, con D. Lazzaro, con Shefqet Verlaci, con Gjoni i Marka Gjonit, con Kolë Bibë Mirakaj, furono presto disillusi e amareggiati quando da parte italiana si mutarono le carte in tavola e si diede al nuovo regime una impostazione non già di commonwealth, come era stato concordato, ma di « impero ». Ma il dado tratto rimaneva fisso sulla tavola e chi poteva ritrarlo?

Fu così che si fece di necessità virtù: loro terranno il potere, noi tenteremo di manovrarlo o almeno indirizzarlo sempre a bene dell'Albania; in questo senso, son persuaso, ebbero l'appoggio o la collaborazione del P. Fishta, di Terenc Toçi (che in altri tempi non aveva esitato ad opporsi anche con le armi a un'errata politica italiana), del P. Bernardin Palaj, di Xhevat Korça, di Dhimiter Beratti, di Aleksander Xhuvani, di Xhafer Ypi, e di altri che poi passarono all'aperta resistenza. Anch'io mi accodai.

Difatti non ci fu da parte italiana un programma di snazionalizzazione ma solo una certa repressione delle tendenze libertarie e una incomposta spinta a importare moduli italiani nel governo, capitali e mano d'opera italiana nell'industria e nella economia, e cultura italiana nelle scuole invece di altre culture occidentali. Ma Shefqet Verlaci, Ernesto, Mustafa e compagni vigilavano, e non senza successo nell'essenziale, a che l'intromissione italiana nel governo restasse arginata; a difendere l'economia albanese dalle velleità sconsiderate degli imprenditori e operatori economici italiani vigilava la Luogotenenza con a capo Jacomoni; Ernesto vigilava, dal suo Ministero dell'Istruzione, poi dall'Istituto di Studi Albanesi e dalla Presidenza della Camera, non dico a salvataggio, ma a fiorimento della cultura albanese. Noi tutti eravamo sempre sulla breccia a dar consigli, a far rimostranze, a prendere per il loro lato debole i potentati italiani per indurli al servizio della Causa albanese.

Il fatto fu, che con la sconsigliata e impreparata guerra italo-greca, coraggiosamente, apertamente e concordemente deprecata dalla Reale Luogotenenza e dal Governo albanese, molte sventure senza frutto si accumularono sull'Albania meridionale; ma la stessa guerra nell'altro suo risvolto, quello del fronte jugoslavo, ebbe esito fulmineo e si concluse con l'unione all'Albania della Kossova, sogno dell'irredentismo albanese.

Ernesto vi collaborò animando e pagando di persona insieme con Kolë Bibë Mirakaj, con Bottai, col colonnello Palandri delle Guardie di Finanza, organizzando le bande delle tribù albanesi montanare.

Ma, soprattutto, dell'unione della Kossova ne fece una cosa seria istituendovi e facendovi fiorire un'ampia e fitta rete di scuole albanesi ove prima non ne esisteva una. Anche oggi la Kossova lo ricorda con riconoscenza, e se ne vedono i frutti nel tigoglio della cultura albanese nella regione, retrocessa alla Jugoslavia nel 1945, auspice la Russia.

In questo almeno, Ernesto con gli amici avevano visto bene, ed Ernesto, sostenuto da Jacomoni anche con sussidi del suo, aveva ben provvisto.

Ma l'opera sua non fu certo limitata a questo. Come Ministro dell'Istruzione, Egli dette in due anni un impulso prima mai visto alla compilazione e pubblicazione di testi scolastici, specialmente per le scuole secondarie, che prima

erano in ogni settore costrette a servirsi o di testi in lingue straniere o di dettati frettolosi.

Se tutta la vita di Ernesto fu — tra un esilio e un ritorno e l'altro — uno « specchio d'umano transito », lo fu più evidentemente il suo periodo di permanenza al « potere »: due anni al Ministero dell'Istruzione, meno di due alla Presidenza dell'Istituto di Studi Albanesi, men di mezz'anno alla Presidenza della Camera.

Eppure gli bastò, non dico per imprimere un'orma incancellabile ma sterile, bensì per seminare una messe che continua a produrre.

Prima di lui il Ministero dell'Istruzione, anche col suo primo titolare che fu un Luigj Gurakuqi, anche con altri, come il poeta Hilë Mosi e come l'erudito Mirash Ivanaj, non poté essere che un organo amministrativo; con lui, pure funzionando come mai da organo di oculata amministrazione, divenne organo propulsore di tutta la cultura nazionale, focolare anche per le iniziative culturali private.

Sua iniziativa geniale fu l'istituzione del prestigioso ufficio degli « Ispettori Superiori », che non si occupavano tanto di ispezionare occasionalmente l'andamento dell'attività scolastica, quanto di individuare settori della cultura nazionale da coltivare e sviluppare, e uomini capaci di farlo, e metterli all'opera. Vi lavorarono in permanenza, come in un'ardente fucina, uomini quali Aleksander Xhuvani, Karl Gurakuqi, Namik Ressuli filologi, Ndoc Vasija commediografo, poeta e giornalista satirico, e altri competenti in altre discipline di cui purtroppo oramai mi sfugge il ricordo; e collaboratori esterni numerosi e competenti, albanesi e italo-albanesi.

Ne uscì, oltre la ricca serie dei testi scolastici, la coppia delle due classiche collane, *Shkrimtarët Shqiptarë* (una specie di ampia galleria di tutte le figure di rilievo della letteratura albanese di tutte le epoche e di tutti i paesi, colonie all'estero comprese, con la bio-bibliografia di ciascuno e con proporzionati saggi delle loro opere), e *Visaret e Kombit* (una specie di illustrazione ampia e accurata della cultura e civiltà tipica albanese in tutti i suoi settori). Oltre a questi, varie opere a parte dei migliori scrittori albanesi.

Né fu trascurato l'acquisto di manoscritti pregiati da conservare e pubblicare: ricordo qui l'insegna poema scanderbeghiano di Cosma Serembe, che fu preparato per la stampa, e il prezioso Dizionario di termini rari di Don Nikollë Gazulli, che vide a tempo la luce.

Idea e in gran parte opera di Ernesto in quel periodo fu la fondazione del Reale Istituto di Studi Albanesi, una vera e propria accademia in cui si accoglievano e adunavano i migliori studiosi, letterati, albanologi albanesi ed esteri. Primo Presidente ne fu Mustafa Kruja, a cui successe Ernesto stesso, apportandovi l'istituzione di commissioni settoriali che sedevano alternativamente a consulta tutti i giorni della settimana, e l'inizio della formazione d'una biblioteca e d'un museo etnografico.

Una delle commissioni lavorava alla traduzione in italiano delle migliori rapsodie eroiche albanesi con l'intento di farne conoscere all'estero i tesori più preziosi. L'altra, in vista della necessaria formazione d'un lessico culturale albanese, capace di ovviare all'invasione di imprestiti deformatori, formava e

conduceva quasi a termine uno schedario ragionato di prefissi e suffissi tipici di cui la lingua albanese si serve assai agilmente e decorosamente per la formazione di neologismi; lo schedario, con poche aggiunte e precisazioni, fu più tardi pubblicato da A. Xhuvani ed Eqrem Çabej, membri già della detta commissione.

Era progettata inoltre la pubblicazione di opere importanti come il monumentale Dizionario albanese di Mustafa Kruja (di cui era già iniziata a Roma la composizione in monotype), e di altre opere ancora. Inoltre la pubblicazione periodica di *Studi e Testi,* in molteplice serie di varie discipline albanologiche, di cui poterono uscire in grande formato un numero ponderoso per le discipline giuridiche e uno per quelle archeologiche.

L'Istituto venne poi, dal nuovo regime, trasformato in « Istituto delle Scienze », forse per accentuare la volontà di togliere l'esclusiva alle discipline umanistiche che più direttamente servono l'albanicità, e favorire le scienze naturali e tecniche più apprezzate dalla mentalità materialista dialettica. Divenne poi Accademia delle Scienze.

La sua produzione del tempo di Ernesto resta tuttavia nonché innegabile, fondamentale.

Si pensi che in quel suo periodo, periodo di presuntuoso prestigio italiano, l'introduzione dell'insegnamento dell'italiano nelle scuole elementari albanesi venne impedito proprio ad opera esclusiva di Ernesto l'italofilo; si pensi che in tutta la storia della cultura albanese non si ricorda un periodo di tale purismo linguistico, né prima né poi; e ciò ad opera del suo Ministero e del suo Istituto; basta consultare, non dico i testi scolastici e quelli ufficiali, legislativi o amministrativi, ma anche la stessa stampa quotidiana.

Transito o passaggio fu per Ernesto quel periodo, per quanto fecondo, nella sua brevità.

Ma passaggio anche da una funzione a un'altra. La sua prima età fu una stagione di produzione personale, sia pure di stimolo a riforma e rinnovazione, e quindi tutt'altro che asociale.

La seconda stagione, iniziata a Tirana e al Ministero, e proseguita sino alla morte, fu prevalentemente quella di promotore e animatore e sostenitore d'ogni seria iniziativa culturale albanese.

Naturalmente, quando fu al potere, col prestigio della carica e coi mezzi che questa gli consentiva. Ma già da allora cominciava la sua stagione, non più di ministro o di presidente, ma direi quasi, di anfitrione cordiale e di buon gusto; « borghese » si disse di lui; ben detto, ma non nel senso della grettezza, della mancanza di ideali e di intraprendenza, bensì in quello della tendenza alla nobilitazione, alla elevazione; e anche in quello della porta aperta e della mensa imbandita e della stretta di mano che è un incoraggiamento e una ferma promessa da galantuomo, avallata da un impegno personale indefesso al servizio degli amici e della Causa; diciamo anche da un certo piglio di sicurezza di sé che consacra il capo nato, che può contare sugli altri e su cui gli altri possono contare. Borghese alla scutarina, di estrazione mercantile e quindi largamente agiata e aperta, ma sempre rinsanguata di sangue montanaro e sempre in vivo contatto con la gente eroica della Montagna.

Pubblicista da sempre, naturalmente, come tutti noi allora, senza compenso, fu in grado nel 1940, di farsi editore d'una Rivista, *Shkëndija,* dove offriva alla voce della gioventù quel portavoce che egli presso altri a suo tempo aveva trovato. Fu cosa breve, un transito anche questo, memorabile però per coloro che ne usufruirono.

Ma poi, appena riassestatosi nella sua cattedra di Roma, rieccolo all'impresa con *Shêjzat* (Le Pleiadi). Programmatico il titolo. Certo vi echeggiava l'inobliabile eco dei primi suoi fervori estetici letterari quando insieme si ispirava alla letteratura francese con quella italiana. Ma con una ben maggiore fattività e consapevolezza di scopi: non voleva essere un Ernesto solitario cantore che facesse sentire la sua voce, e tanto meno che volesse cantare per sé: la Rivista doveva essere una Pleiade dei migliori scrittori albanesi e albanologi; non era nemmeno un'arma di battaglia, ma come la costellazione di cui prendeva il nome, una luce per indicare vie non fallaci.

Unico lavoro della vita di Ernesto che non sia stato un passaggio meteorico, per quanto esemplare, bensì un costante lungo costruire e ricostruire: una ventina d'annate, quante forse non ne ha raggiunte nessun'altra rivista culturale albanese.

E ciò quasi solo con i mezzi personali di Ernesto, non altri dal suo stipendio di professore universitario.

Quando oramai questo non poteva più, in clima di crisi economica, bastare a tanto peso, ed Ernesto dolente stava per darsi vinto, la sua vita cessò.

Forse non cesserà la doppia collana degli *Studi e Testi* del suo Istituto Universitario in cui con animo grande aveva ripreso, specialmente per la cultura italo-albanese, iniziative affini a quelle dell'Istituto di Tirana.

Oltre ad essere stata la sua vita una serie di trapassi, segna e dovrà emblematicamente additare il transito da un'antica a una moderna Albania; non attraverso la morte dell'Albania autentica per sostituirle un'Albania esotica e artificiale, ma attraverso un'evoluzione dei suoi antichi genuini valori, liberati da incrostazioni parassitarie e indirizzati sulla stessa linea a mete sempre più elevate; non tanto con una orgogliosa affermazione di razzismo o d'una sognata potenza politica, ma con una realizzazione delle virtù più sane che resero la Nazione sempre ammirevole, combattiva ed eroica per *trimní,* ma non a vuoto, bensì a servizio di nobili ideali di onore e onestà — *nderë* e *burrní;* non ferma, nel resto, entro i limiti d'un primitivismo pittoresco, ma aperta a tutte le migliori richieste del bene comune morale e materiale; pronta, come sempre fu, a sacrificare gli interessi materiali a quelli spirituali.

Molti eravamo a condividere questi suoi ideali e, per ciò, a contare su di lui come sul più pronto e valido appoggio per ogni esigenza e per ogni buona iniziativa; molti che guardavano a lui come ispiratore e animatore di vita e attività culturale autentica albanese, e ora sentiamo desolante il vuoto che ci lascia il suo transito.

Riusciranno altri ad assicurare ancora un portavoce alle voci dell'autentica cultura albanese rifugiatasi in esilio? O ne segnerà la morte di Ernesto il passaggio ai silenzi della Storia?

Kuvendime me Vangjelín

nga **ERNEST KOLIQI**

Vangjelís

Pak dit mâ përpara
me të dyja duert
t'a kapshem fytyrën
e nga goja e jote
thithëshem unë mushtin
e dashunís s'ate
së freskët
si gjak qershijash
rî me voesë mëngjesi.
O kupë langjesh shortore
qi zêmrën përherë
m'a mbajte të njomë
si lulishtë n'agim.
Papritë
rreziku t'âsht beditë
e parakohe
t'u shterr në trup
vesku i rinís,
por jo ambëlsija
qi ka burimin
në hír rinuer të shpirtit
e qi edhe mishit t'and të vuejtun
i ep âmë lulesh prilli.
O kupë e mbushun sot
me musht e me lot
ku flîja
e prillëve tueja të njoma
âsht shëndrrue për mue
n'âmbëlsín mâ të madhe
qi qet nji jetë e shtrydhun
nga gishtat e lum
të nji dashunije
shtue pa masë
nga dhimba e vuejtja.

Romë, 22-I-1969

Prof. Koliqi me të Shoqen në Venedik (1942) e në Romë (1943)





Prof. Koliqi con la moglie a Venezia (1942) ed a Roma (1943)

Vangjos

Po pse papritmas, Vangjo, meje u shkoqe
Me kurm prilluer n'dhé t'zí tue shkue m'u trete?
Pse vetëm m'lae n'travajë e váj t'ksaj jete,
pse kur m'a fort m'u dojshe pran' m'u hoqe?

Gjithkund buzqeshun plot kuptim m'u gjete,
si burrnesh' n'dit' e bardha e t'zymta m'ndoqe,
ti e âmbël edh'e fort' pa kurrkund shoqe,
n'kujdes gjithmon' për t'tjerë e kurr për vete.

Uroj qi muzgu i em t'ket mbrâmje t'shkurta
mbasi me nisjen t'ande krejt u zhgulen
andjet qi jeta deri djè m'pat endë.

Pa Tý t'mjerueme janë edhe të ngurta
shtiqet qi për n'vorrez' vetare ulen.[1]
Veçse shpresa me t'pa prap m'gzon në shpirt mbrendë.[2]

Romë, 13-V-1969

* * *

Kjo banesë âsht e jotja : na në tê jemi si miq të pritun, sepse në çdo skâj, në çdo anë, gjithëkund mbesin shejet e kujdesit dashunuer qi u kushtove orendive e e mbarshtrove. Kur shetis në balkue e shikoj vullâjt e luleve, mendoj me therje në zêmër duert e tueja të pastra qi mbollen drandofillet e jeseminat e lulemullagat tashti të luluem në ket stinë prendvere, ato duer qi i përkitsha po me at të prekun të butë me të cilin lëmojshin faqet e mija në t'imta mërzije e idhnije.[3]

28-5-1969.

* * *

[1] Shtiqet vetare drejt vorrezes q'ulen.

[2] Veç m'gzon shpresa me t'pá qi ruej n'shpirt mbrendë.

[3] Këto poezí e shenime të prof. Koliqit kushtue Bashkëshortes, mendohen me u mbledhun e me u rendumun për me i botue në nji vëllim të veçantë. Nuk mund të caktohet nji kohë tue qenë se dorëshkrimet e dokumentat janë të shumtë e duhet kohë me i vû në rregull.

Ernest Koliqi e Arbëreshët e Italisë

nga ITALO C. FORTINO

Arbëreshët e njohin si *profesori* që mbësonte gjuhën shqipe në Universitetin e Romës, ku shumë të rinj nga katundet arbëreshë të Kalabrisë, të Siqelisë dhe të Molisit, që studiojin në Romë, vejin e e gjëjin sa t'e njihin, dhe shumica, sa të gjegjin lecionat që ai mbante te Instituti i Studimeve Shqiptare. Këta të rinj arbëreshë, pas laures, kur ktheheshin në katundet e tyre rrëfejin për *Profesorin* i cili i kish mbësuar si flitet në Shqipëri, si ka qenë dhe si është situata kulturore dhe letrare në këtë komb të posaçëm, që pati një histori e cila në pjesën më të madhe është edhe historia e arbëreshëvet të Italisë. Me të vërtet për shumicën e këtyre studenteve ka qenë një moment i veçant takimi me Koliqin, sepse ky qe Burri që i zbuloi historinë e tyre, që i ndihu të mirrin vetdijë të qenies së tyre, Njeriu që i hapu sytë sa të ruajnë të kaluarën dhe të ardhmjen me objektivitet dhe me një pikëpamje historikisht më e vërtet. Ky takim ka qenë shumë i frytshëm. Këta të rinj vleftësuam idetë, mësimin, njohuritë e këtij Burri të pasur me përvojë jo vetëm kulturore por edhe politike e shoqërore. Mësimi i Ernest Koliqit, në realitet, nuk kufizohej në leciona akademike të ftofta të profesorit të Universitetit; mësimi i Tij thellohej në njerëzimin. Ai sillte një fjalë që ish e mbështetur në një përvojë të gjatë, në përvojën e Burrit që kish njohur mirë cila ish dhe cila është jeta e shqiptarëve autentikë, jeta e atyre që Ai njohu mirë kur i ri i takonte ndë malet e Malësisë ose të Dukagjinit. Këta të rinj që i vanë pas lecionavet gjatë vitevet të mësimit në Universitet, dal ngadalë zbuluan fshehtësitë e jetës së Tij dhe fshehtësitë e jetës së tyre.

Me një fjalë ata vunë re gjithmonë më shumë se duke njohur mirë kulturën, letërsinë dhe gjuhën shqipe, jo vetëm afroheshin shpirtërisht jetës së Tij por mirrin vetdijë për prejardhjen e njëjtë.

Duhet t'e njohim pa dyshim se duke sjellë përpara një punë që nuk i përkiste vetëm mësimit të Universitetit, por që prekte jetën e arbëreshëvet, prejardhjen e tyre, të kaluarën dhe situatën e tyre të sotme, Ai, me fjalën e Tij, zgjoi vetëdijën e arbëreshëvet, i dha fuqi, vuri në dukje se arbëreshët nuk vdiqën, por se kanë një fuqi të mbrëndëshme që nuk mund të shuhet. Eshtë bukur, këtu, të kujtojmë fjalët që Ai shkroi për arbëreshët duke i kushtuar poemthin

Kangjelet e Rilindjes në vitin 1959. Ai thotë: « *Këtë poemth, endun me fletë dafine arbnore të rîmuna në lot t'idhëta malli, auktori ia kushton Arbreshve t'Italís, të cilët, tue u qindrue besnikë, për pêsë shekuj në dhé të huej gjuhës e dokeve të të Parvet, dishmojnë shkëlqimisht para botës mbarë se shpresa në fate të bardha t'Atdheut, qi ushqejnë Bijt e Shqipes, nuk shuhet në váj të mërgimeve por kapërcen, prorë e gjallë gjallnuese, zezonat e Kohës edhe vezullon e përjetëshme mbi prak t'agimeve të reja* ». Punës së Profesorit u përgjegj mjaft shpejt vepra e arbëreshëvet.

Disa vitë më vonë fuqitë kulturore të arbëreshëvet të Kalabrisë mblidhëshin rreth revistës *Zgjimi* e jipin fill një jete së re të pasur me shpresë në një ardhmje më të mirë, kur gjithë arbëreshët do të vetëdijë për situatën e tyre jetësore dhe kulturore, kur do të mbësojnë në shkollat më mirë dialektin arbëresh dhe gjuhën shqipe, kur do të kenë më mundësi për të zhvilluar një kulturë më të shëndoshtë.

Ata të rinj që vazhduan rrugën e mësimit të Tij dhe studiuan historinë, letërsinë dhe kulturën arbëreshe dhe shqiptare, u kanë diplomuar në gjuhën dhe letërsinë shqipe. Disa nga këta, ndën drejtimin e Tji, shkuan ndë katundet arbëreshë të Kalabrisë sa të mblidhin lëndë të letërsisë gojore, kështu që Instituti i Studimeve Shqiptare mbërrijti të botojë katër vëllime me prralla, fjalë të urta dhe gojdhëna. U shtua edhe interesim për shkrimtarët arbëreshë. Vepra kryesore e më të madhit poet arbëresh në letërsinë shqipe, *Jeronim De Rada*, për të parën herë qe e studiuar si duhet. Z. Gradilone, adsistent i Profesorit, pregatiti botimin kritik. Drejtimi i E. Koliqit qe i domosdoshëm për të hapur rrugën shumë studiuesve arbëreshë që interesohen dhe japin një kontribut të vlerfshëm kulturës dhe letërsisë shqipe.

Pas revistës *Zgjimi* edhe disa tjera të përkohëshme filluan të botoheshin. Edhe këto sualltin përpara problematikën arbëreshe që ka si qëllim vleftësimin e kulturës arbëreshe duke krijuar një kuadër profesorësh të pregatitur që mund japin mësimin e dialektit arbëresh dhe të gjuhës shqipe, në shkollat e katundevet arbëreshë të Italisë kur qeveria krahinore do të bindet të lejojë mësimin e gjuhës shqipe në katundet ku flitet kjo gjuhë.

Këtu kujtojmë punën e vlefshëm të revistave *Zëri i Arbëreshëvet*, *Zjarri*, *Katundi ynë* etj. Duhet të pohomi se gjithë këto revista muarrtin fill nga e përkohëshmja e themelluar nga E. Koliqi *Shêjzat*, ku kanë botuar shkrimet e para shumë arbëreshë e ku u paraqitën problemet më të mëdhenj të botës arbëreshe.

Lëvizja kulturore arbëreshe të këtij shekulli është e mbështetur në veprën dhe në punën e E. Koliqit. Ish si Njeri që siall përpara fjamurin, i përcjellur nga një murrë njerëzish që kanë të njëjtat probleme dhe që nisen për të njëjtin qëllim. Edhe poetët arbëreshë të sotshëm, si Vorea Ujko, Lluka Perrone, Xhiosafat Frashino etj. u lenë në këtë lëvizje kulturore dhe kanë dhënë dhe japin një kontribut

të naltë krijimtarisë letrare arbëreshe. Është e nevojshme të thomi një fjalë edhe për organizatat kulturore që u sajuan në këtë kohë: shoqata *AIADI* mbledh msuesit arbëreshë dhe vepron të vëhet mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e katundevet ku flitet arbërishtja. Kujtojmë edhe kursin që ka organizuar kjo shoqatë në Guardia Piemontese për mësuesit arbëreshë në vitin 1965; bashkimi *UCIA*, përfaqëson të gjithë katundet arbëreshë dhe mbron kulturën duke studiuar edhe zhvillimin; tjetra shoqatë *ACIA* bashkëpunon për të njëjtat qëllime. Në vitet e fundit kanë qenë bërë shumë përpjekje për zgjimin e ndërgjegjes së popullit arbëresh e mund të thomi se një pjesë të madhe i vete E. Koliqit, i Cili shumë herë shkoi në mes të Arbëreshëvet të cilëvet i solli një fjalë të sigurtë që tingëllon si një fjalë udhëheqësi ndaj së cilës u kthien shumë arbëreshë që nuk harruan prejardhjen e tyre dhe që kanë besë në vlerën e kulturës së tyre. Mësimi i Tij si një kondër vaji u shprish në të gjithë katundet arbëreshë. Kur Ai pregatiste studentët në Universitetin e Romës kish përpara sysh të ardhmjen, atë që ata të rinj mund të bëjnë një herë që ktheheshin në katundet e tyre. Kështu se edhe mësimi shihej nga një tjetër pikëpamje, bëhej mision, njerëzohej. Prof. Koliqi ishi i bindur se çdo student që pregatisej mirë, që mirëkuptonte rolin e vet dhe problemin jetësor të pakicës etnike gjuhësore arbëreshe mund të ish si një kope gruri që vëhet ndënë dhé e me kohë bëhet një kalli. Fjala e Tij dhe mësimi i Tij janë të gjalla në shumë të rinj që me kohë shpresojmë se do të lënë një gjurmë në realitetin e botës arbëreshe.

Përfundonj duke paraqitur takimin e parë të Profesorit me arbëreshët e Kalabrisë. Ish e treta ditë e Pashkëvet e Ai gjëndej në Frasnitë, një katund arbëresh të krahinës së Kosenxës. Në këtë katund të martën e Pashkëvet kremtohet *rallja*. Vashëza e trima ecin katundit e katundit duke kënduar e duke luar. Ai kish dalë nga shtëpia e një miku, ku ish mysafir, e vej udhës e udhës i vetëm, kur gjegji një këngë që i dukej kënga e valles së Shkodrës.

Kështu Koliqi e përshkruan këtë takim:

« Tuba vashash si mbretnesha
stolis' shtatin n'zoga t'ndritëshme
tue i thânun kângëve
m'u beditne me hap kcimi.
. . .
M'shtîne njomet midis tyne
bukurisht tu'i shndrruemun hapat
. . .
Ecshin t'lumet vallatare
tue këndue kâng't e motshme.
— Mirë se erdhe n'truell t'Frasnitës
vllau ynë i zgjedhuni:
i patrandun ktu besimi

në rilindje t'Arbënit
qindroi gjat' pes'shekujve:
ngjalli n'të shpresat e shueme:
midis nesh n'haré valvitu
vetmitar si flamuri
nalt shtjellue n'nji curr t'lulzueshëm
në lirin e èrnave —

Lule prej dritoreve
mbi né âmbël rèsheshin ».

Arbëreshët nuk mund t'e harrojnë kurrë këtë Burrë që u interesua shumë për ata. Në mërgim si ata, larg nga shtëpia ku u kish lerë, ku kish kaluar vitet e para bashkë me prindërit dhe me vëllezërit, Ai shpirtërisht ka qenë shumë afër arbëreshëvet, pse Ai kish përshtipjen se i njëjti fat kish përcjellur arbëreshët në Itali para 500 vjetësh dhe Atë në shekullin XX.

... Lexohet me ândje prodhimi i Koliqit, âsht tërhjekës, të bân për vete si nji fllad prendveruer, si nji puhí vetore, e lehtë dhe e âmbël; ká gjânsí frymzimi, thellësí mendimi, lehtësí pende qi âsht cilsí e krijimtarvet fatlumtun. Mendimet i rrjedhin njêni mbas tjetrit gjithmonë të lidhuna, dhe fjala nuk i shkrepë kurr për t'i shprehë këto në mënyrë të bukur e të zgjedhun. E kemi ndigjue shpesh tue folë para publikut në rasa të ndryshme, në qarqe letrare e në rrethe miqsore. Fjalimet e konferencat e tija, me mbrendí kulturore, me larmí argumentesh, do t'a shtojshin vargun e botimevet në mënyrë të dukshme. Mjerisht shumicën e tyne e ká mbajtë pá ndonji përgatitje paraprake, pá marrë ndonji shenim, kështu që as ai vetë nuk do t'ishte sot në gjendje t'i përmblidhte. Kështu thuej edhè për artikujt e panumër të shpërndamë ndër fletore dhe revista; po të përmblidheshin, do të sajojshin edhè këta vëllime të tâna. Me rândësí do t'ishte edhè botimi i epistolarit, të cilin ai e ruen me zilí, pse prej tij mund të nxirej lândë e mjaftë dhe e sigurtë për të përpilue sidomos historín e mërgatës shqiptare me të gjitha përpjekjet për bashkim punimi, memorandumet, bisedimet, vendimet, mendimet e njênit e të tjetrit.

KARL GURAKUQI

(*Ernest Koliqi* në *Shêjzat*, VII, 1963, nr. 5-8 faqe 162-172).

Ricordo di Ernesto Koliqi

di MATILDE MANCINELLI

Con Ernesto Koliqi scompare una nobile figura di animatore, un autentico gentiluomo squisitamente buono e comprensivo, che aveva saputo riunire intorno a Sé numerosi e sinceri amici attratti dalle Sue elevate doti di cuore, dalla Sua umanità, dalla Sua vivida intelligenza e dalla Sua profonda cultura: mi sentivo e mi sento onorata di aver appartenuto e di appartenere alla schiera dei Suoi estimatori i quali non potranno dimenticare il Suo esempio di rettitudine, di altruismo e di incrollabile fede.

Per quasi vent'anni, attraverso questa gloriosa Rivista, alla quale Ernesto Koliqi volle che anch'io partecipassi con il mio nome, sono stati illustrati i più significativi aspetti della storia, della cultura e delle tradizioni di un popolo che Egli ci ha insegnato a rispettare e ad amare.

Ora Ernesto Koliqi non è più fisicamente presente fra noi, ma sentiamo ancora la Sua parola suadente, ricordiamo la pacatezza e la bonaria arguzia delle Sue osservazioni, la gentilezza dei Suoi modi.

È morto un sapiente, un illustre Uomo d'onore: lo piangiamo con profondo cordoglio e lo ricorderemo con affetto, venerandone la memoria.

... Ma colui che finalmente porterà la musa scutarina fuori delle severe mura dei conventi e dei collegi per vivificarla e ringiovanirla con la sua fresca vena poetica è Ernest Koliqi *(n. 1903), attualmente ordinario di lingua e letteratura albanese presso l'Università di Roma*

... Notevole è stato il suo contributo allo sviluppo della cultura albanese come pubblicista ed editore di giornali e riviste Dopo il breve periodo di collaborazione in Ora e maleve *(Il genio delle montagne, 1923), il Koliqi intuendo il graduale isolamento della letteratura cattolica scutarina era dovuto, oltre che al laicismo diffuso nel resto dell'Albania, anche al consolidamento dello stato unitario albanese, fondò a Tirana nel 1936, con altri collaboratori, il periodico* Illyria, *di cui fu redattore e nel 1940 la rivista* Shkëndija *(La scintilla). Con gli eventi bellici si chiuse il primo periodo della sua attività letteraria, ma il secondo, forse il più fecondo della sua attività creatrice, lo vede in esilio a Roma, dove egli dirige da più di un decennio la rivista* Shêjzat *(Le Pleiadi). E questo periodo può essere considerato forse il suo migliore. Specialmente nella prosa — citiamo fra le tante* Shtatë pasqyrat e Narçizit *(I sette specchi di Narciso) e* Shija e bukës së mbrûme *(Il sapore del pane lievitato, 1969) — egli ha donato alla letteratura albanese alcune delle pagine più belle per afflato poetico e per originalità, dimostrando di avere una mirabile capacità nel piegare la parola e l'espressione a suo piacimento. Egli, che per nascita è il meno orientale degli scrittori albanesi, nella prosa abbaglia con i suoi arabeschi e i suoi indugi quasi calligrafici, trasportando il lettore in un mondo di favole e di sogni. Il destino ha voluto purtroppo fare di Koliqi l'epigono di quell'aureo periodo della letteratura scutarina, ora bruscamente troncato in Albania.*

Ma egli imperterrito, sorretto da volontà e ideali incrollabili, continua la sua battaglia e i suoi sforzi per mantenere viva quella tradizione.

NAMIK RESSULI, *Storia della letteratura albanese,* pp. 133-134 in « Letteratura universale »: *Storia delle letterature del Sud-Est Europeo,* Fratelli Fabbri Editore, Milano 1970.

Ritratto di Koliqi

di GENNARO CASSIANI

La personalità di Ernesto Koliqi si rifletteva nella sua fisionomia. Due occhi pensosi e irrequieti illuminavano un volto che spesso nascondeva una sofferenza e sul quale guizzava un sorriso che ne prendeva tutti i muscoli fino a rimpicciolirne gli occhi.

La sua voce calda aveva una melodiosa serenità, in cui l'ironia nascondeva talvolta una amarezza che, pur essa come tutti i suoi sentimenti — fosse la commozione o la nostalgia o il rimpianto — si nascondeva dietro un velo di dolcezza che ghermiva e conquistava.

Carattere gagliardo, di perfetta struttura umana come un capolavoro di arte, lottatore formidabile, uomo politico di vastissimi orizzonti, letterato eminente, artista del pensiero e orafo della parola, o che si esprimesse nel natale idioma albanese o che lo facesse nella lingua italiana della quale era padrone come pochi.

Egli aveva l'anima di un fanciullo, l'anima semplice e buona di chi fa nella vita legge suprema il dovere da compiere senza riserve e senza dubbiezze, così che la sua figura grandeggiava davanti a chi sapeva intenderne la formidabile struttura dello spirito e dell'intelletto.

Stendhal lo avrebbe detto un produttore di energia.

Oh intime lunghe conversazioni nel chiuso del mio studio in Roma, nella quiete ombrosa della mia casetta di campagna in Calabria, in una trattoria di Trastevere o nella sua casa romana di Piazza Ungheria o della Balduina! Egli mi svelava i misteri fascinosi del mondo orientale, mi accompagnava per mano lungo l'erta della montagna albanese e mi diceva delle leggi raccolte dal *Codice della Montagna,* particolare e misterioso, facendomi penetrare così in un mondo che per me aveva del fiabesco. E per intanto egli mi metteva a nudo l'anima sua, che non consentiva ripieghi subdoli o viltà nascoste.

Così forse si può comprendere come una particella del mio spirito sia finita con lui.

Ma io debbo sottrarmi alla dolce e triste malia di pensare Ernesto Koliqi per me e debbo sforzarmi di pensarlo per tutti.

Basterà che ricordi i rappresentanti degli esuli albanesi venuti da ogni dove per rendere omaggio alla sua salma: erano venuti dall'America, dalla Francia, dal Belgio, dalla Turchia, dalla Svezia, dalla Germania Occidentale. E poi era tutta in Roma l'anima italo-albanese: veniva dagli smeraldi del piano,

coperti dai pampini verdi delle vigne e dalle foglie d'argento degli ulivi. Era qui tutta devotamente raccolta l'anima della nostra gente con la melanconica melodia delle sue canzoni, con la carezza ardente dei suoi affetti. Era qui l'anima italo-albanese, celebrante nel nome del fortissimo la sua propria fortezza. Per essa Ernesto Koliqi non era soltanto un simbolo, ma un mito. Dietro la salma c'era il labaro della Università di Roma dove Koliqi per tanti anni aveva insegnato lingua e letteratura albanese e attorno uomini di cultura, eminenti nelle scienze e nelle arti.

Amleto si domandava se la grande figura di un uomo possa sopravvivere sei mesi, ma noi speriamo che il nome di Ernesto Koliqi si sottragga alla sorte comune dell'oblio.

Rimangono e sfidano il tempo le sue liriche come quelle raccolte ne *Le orme delle stagioni,* le sue opere narrative come *L'ombra dei monti,* la collezione di questa rivista nella quale non si sa se ammirare di più la genialità della iniziativa o il contenuto che tutta la ispira.

Sognava la sua Albania, dove fu anche Ministro della Pubblica Istruzione, e lo struggeva il ricordo di Scutari dove era nato e dove era la sua casa paterna.

La morte ha piantato la croce sul suo cammino quando non era possibile che le spoglie mortali potessero riposare nel luogo che più gli fu caro.

Ma le stelle che dai campi sterminati del cielo vegliano le spoglie del gran morto, serrate in una tomba del Cimitero di Prima Porta, sono le stesse che brillano pie e tremule sul cimitero di Scutari!

In Ernest Koliqi è possibile ravvisare in linee più decise un nuovo stadio della letteratura albanese. Egli è l'assertore della giusta evoluzione. Per lui ogni divenire deve attuarsi col lievito dello spirito etnico: lievito che mentre consente l'impasto delle forme con la materia trattata, fissa d'altra parte in ogni creazione, fantastica o razionale, i caratteri dell'albanesità.

Nella sua poesia, come nella sua prosa, s'avverte dunque il respiro delle Alpi Albanesi e una elegante modernità occidentale, l'ampia eco degli aedi dei suoi monti e la melodia delle forme culte. E son questi i motivi per cui la posizione spirituale ed artistica del Koliqi è destinata ad esercitare sensibili influenze sia sui desiderosi di radicali innovazioni sia sui retrivi di forme nuove e di nuova poesia.

GIUSEPPE SCHIRÒ

(*Storia della letteratura albanese,* Nuova Accademia Editrice, Milano 1959, pp. 239-245).

Ernest Koliqi dhe zhvillimi letrar në Kosovë

nga **REXHEP KRASNIQI**

Parathanje

Në nji mbramje të muejit Kallnuer 1975, në qetësinë harmonike të shpisë së vet në Romën e amëshueshme, ndrroi jetë Ernest Koliqi në paqë me Zotin, me veten, me rrethin familjar dhe miqët dhe dashamirët e tij të shumët. Por, në thellësinë e shpirtit, ai u nda prej kësaj bote me nji brengë të pashërueme, me andrren e parealizueme, me pa edhe njiherë Atdheun, me pa edhe njiherë Shkodren, qytetin e vet të lindjes dhe të fminisë që ai e ka dashunue dhe adhurue me nji intensitet të flakët.

Do të jenë të tjerë që do të merren me jeten e vepren e Ernest Koliqit si poet, shkrimtar, shkollar i gjuhës dhe letërsisë shqipe, ashtu dhe me rolin e tij që ka luejt në sheshin arësimuer dhe të politikës shqiptare. Do të jenë të tjerë që do të shquejnë pasunimin që i ka sjellë ai fjalorit të shqipes me përpunimin e fjalëve dhe të terminologjisë së re, tue u mbështetë kryesisht në thesarin e pashtjerrëshëm të gjuhës së Malsisë veriore, gja që e ndihmuen atë në shkrimet e veta me trajtue me mjeshtri thema të ndërlikueme të mendjes dhe të shpirtit me qartësi dhe thjeshtësi supreme.

Si mjeshter i rrëfimeve të shkurta, në novelat të përpunueme gati me nji stil të prozës poetike dhe me përmbajtje të jetës tradisionale të gjindes së krahinës së vet të Shkodres, ai ka trajtue anët e bukra, virtutet e nalta njerëzore, të karakterit, të burrnisë, të besës, të mikpritjes shqiptare. Poashtu, ka spikat anët e damëshme, sidomos paraqitjet e hakmarrjes që me shekuj kanë trazue randë jeten dhe kanë shtrydhë rritjen e familjeve tona.

Tue fillue që nga vjeti 1920, Ernest Koliqi, me shkrimet e veta ka influencue breza të njimbasnjishëme të rinisë shkollore shqiptare. Dhe po nga ky vjet, ai ka qenë i shënuem nga rrethanat e kohës, të marrë pjesë aktive në hapat e para të fminisë të jetës shtetnore shqiptare. Megjithqë e randueme nga pesha e së kaluemes historike e mbrapambetësisë dhe e vorfnisë dhe me nji popullësi prej ma se 90% analfabetësh, elita e udhëheqjes së atëherëshme, bani përpjekje të forta me adaptue format e jetës demokratike prendimore. Ndermarrje këto të lavdueshme, por që ma në fund, krijuen nji krizë tronditëse të mbrendëshme. Kundërshtimet e eksagjerueme midis grupeve që përfaqësojshin shtresen e udhëheqjes së traditës dhe atë

të elitës së shkollueme, poashtu probleme tjera komplekse, shpërthyen haptas në kryengritjen e vjetit 1924, që detyruen Koliqin të largohet nga Atdheu dhe të jetojë për disa vjet si mergimtar në vende të hueja. Mirëpo, midis gjithë këtyne tallazeve që do t'a ndjekëshin atë deri në fund të jetës, Koliqi vazhdoi punën e vet krijuese me nji vullnet të hekurt. Letërsija, poezija, gjuha dhe kultura arbnore, u banë pjesë dominuese të jetës dhe të fatit të tij në ket botë, u banë krah fluturues që e ndihmuen atë me qëndrue shpirtnisht në majet e Parnazit midis ngjarjeve tronditëse përreth tij.

Koliqi dhe kultura shqiptare në Kosovë

Qëllimi i këti shkrimi asht të shquej vetëm nji aspekt të vepres së Koliqit, të analizoi përmbledhëtas interesimin e gjallë që ai ka diftue përherë për atë pjesë të popullësisë shqiptare që pat fatin tragjik të mbesin nën Jugosllavi jashtë krijesës shtetnore shqiptare. Ky interesim që, siduket, ka rrjedhë edhe nga admirimi dhe frymzimet që ai ka pasë nga arti i naltë poetik dhe forca epike e kangës kreshnike të Kosovës që ai e ka naltësue si *folklori ma i ngjyrëshëm i gjindes që flasin shqip.*

Në përjudhën e parë të veprimtarisë politike, Ernest Koliqi, që kishte nji pregatitje të përsosun të shkollës klasike, dhe dallohej në shej për talent letrar në shtypin e atëherëshëm të Shkodres, menjiherë kishte tërhjekë vrejtjen e Luigj Gurakuqit, personalitetit politik ma të shquem që kishte Shkodra dhe që njifej mbrenda dhe jashtë Shqipnisë për përpjekjet shumëvjetore në krijimin dhe fuqizimin e shtetit shqiptar. Gurakuqi, njeriu i politikës, arësimtar, i versuem edhe në çashtje të letrave, banonte në Rrugen Gurakuqi, në mahallen e qujtun Gjuhadol, në afërsi me shpinë e Shan Koliqit, atit të poetit tonë. Në këtë mënyrë, njoftja dhe miqësija e lidhun midis tyne, ishte fare e natyrëshme.

Duhet të ketë qenë Gurakuqi, i cili kishte njoftuni të gjana mbi çashtjet shqiptare, ashtu dhe mbi fatin e Kosovës së robnueme dhe njifte personalisht Bajram Currin, Hasan Prishtinën, Isa Buletinin, etj., msuesi i parë që i ka dhanë Ernestit të ri informatat përkatëse. Mbiktë, po ai duhet të ketë ndërmjetësue pranë Shan Koliqit për t'ia dhanë nji shpi që kishte në Rrugën Gurakuqi, familjes së Bajram Currit që kishte gjetë strehim në Shkodër, mbas zaptimit të dytë të Kosovës nga Serbët, në vjetin 1918.

Shkruesi i këtyne radhëvet që bante pjesë në familjen e Bajram Currit, e mbanë mirë mend Gurakuqin si burrë të pashëm me mustaqe terhjekëse dhe shumë sympatik, që herë mbas here, vizitonte dhe rrinte me orë rrjeshtë në bisedime me Bajram Currin, Hysni Currin, etj. në banesën e afërme me të veten.

Si mbas thanjeve të Koliqit, Gurakuqi kishte njohuni të mjaftueshme edhe për kangët kreshnike të trevës kosovare, dhe kur ai në raste bisedimesh të shtrueme, deklamonte përmendësh pjesë të kangës

së famëshme të Miletit, që banë fjalë për dergimin e taborreve turke nën Xhavit Pashën me nënshtrue njiherë ma tepër nji lëvizje kryengritëse kosovare, « sytë e Luigjit shëndritëshin prej emocionit dhe entuziazmit ». Edhe në ket fushë duket se, Gurakuqi ka qenë ai që i ka hapë poetit tonë nji kopsht të rí plotë me lule të poezisë popullore shqiptare, dhe kështu, ka kontribue për thellimin e intereses së Koliqit për popullësinë e Kosovës.

Gjatë mergimit të parë të Koliqit në Itali dhe në Bosnje të Jugosllavisë, ai ka pasë vazhdimisht kontakte me mergimtarë udhëheqës të asaj kohe dhe me kosovarë, midis tyne, me Hasan Prishtinën, Dervish Mitrovicën, Niman Ferizin, që banojshin në Zara, ashtu edhe me veteranin e arësimit të Kosovës, Ibrahim Femiun, që atëherë banonte në Banjaluka afër Sarajevës.

Mbas faljes nga qeveria mbretnore dhe këthimit në Atdhe, ai u emnue profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në liceun shtetnuer të Shkodrës, ku studjuen shumë të rijë kosovarë me bursa shtetnore, disa prej të cilëvet vjet ma vonë, u shquen në fushën e letrave shqipe në Kosovën e sotme. Koliqi, në nji artikull në *Shêjzat* 1957, kështu i përshkruen ndjenjat e kënaqësisë së tij për ket gja : « Tue e shfletuemun — *Shkëndijat e para*, — antologjinë e botueme në Prishtinë, 1956, nji rresht t'auktorëve aty përmbledhë, më kumbuen në vesh disa emna të njohun të cilët më përtrinë në kujtim nji ndër përiudha ma të lume të jetës, atë kur msojshëm shqip në lice shtetnuer të Shkodrës. Kështu qi, s'parit erdha tue përpi ato shkrime jo me sy kritiku letrar, por me andjen e hollë të atij qi shef në nji lulnaje të lulueme, vullaj të rij ku ai vetë dikur derdhi do djersë edhe hodhi nji grusht farë ... kallzoj të drejtën qi n'at libër gjeta nji balcëm ngushëllimesh shpërblyese. Bane të mirën në det dhe e gjan në krypë, thot nji fjalë e motëshme. E kjo lloj krype, kur gjindet papritmas, i jep shije të veçanët jetës ».

Nji rol me randësi kombëtare ka luejt Ernest Koliqi në kohën kur ai ishte Kryetar i Dikasterit të Ministrisë së Arësimit. Siç dihet, mbas shkatrrimit të Jugosllavisë mbretnore në fazën e parë të luftës së dytë botnore në vjetin 1941, u realizue bashkëjetesa e përkohëshme e pjesës kryesore të popullatës shqiptare të atij shteti me shqipëtarët e shtetit shqiptar. Gjatë sundimit 20 vjeçar jugosllav, qeverija e Belgradit sistematikisht kishte lanë mbas dore edukimin shkolluer të shtetasve të vet shqiptarë, dhe mbiktë, u a kishte mohue atyne çfardo të drejte që kishte të bante me kombësinë shqiptare, ashtu edhe mësimin e gjuhës shqipe.

Kështu, Ministria e Arësimit u gjet para nji situate të prapambetësisë së pabesueshme të asaj popullate me nji përqindje të analfabetizmit që kalonte numrin 90, dhe si rrjedhje të kësaj politike nefaste, me nji mungesë të ndieshme të njerëzve në profesione intelektuale.

Posa lejuen rrethanet e kohës, Ministri Koliqi, përsonalisht drejtoi organizimin e shkollës shqipe në të gjitha krahinat e Kosmetit,



Prof. Franz Babinger e prof. Koliqi

të Tetovës, të Dibrës së Madhe, të krahinave bregdetare me qytetin Ulqin, vende këto që ishin shënjue nën mvarësinë e qeverisë shqiptare të asaj kohe. Në fillim, në veren e vjetit 1941, u përgaditë nji kurs shkolluer që kishte për qellim me ia njoftue rinisë shqiptare të krahinave në fjalë, për të parën herë, elementet themelore të mësimit të gjuhës shqipe, dhe kështu, me përgaditë sheshin për vazhdimin në rregull të vjetit shkolluer 1941-42.

Mbas studimit të nji plani të përpikët dhe përpjekjeve me gjetë përsonelin drejtuesë, administrativ dhe mësimuer, që për arsye të shuma ndeshen në probleme të vështira për t'u kalue, ma në fund, Ministria dërgoi nja 200 mësuesë, mësuese, inspektorë, drejtorë, etj., të cilët në bashkpunim me autoritetet shqiptare të vendit, për atë kohë mujtën me hapë nji sasi të konsiderueshme shkollash fillore, në qytete dhe disa katunde të mëdhaja, të krahinave të shënueme ma sipër. Përveç organizimit të arësimit filluer, Ministrija hapi nji gjimnaz të plotë tetëvjeçar në Prishtinë bashkë me nji Internat për nja 200 studentë me bursa shtetnore, ashtu dhe tri shkolla të mesme Katërvjeçare në Prizren, Gjakovë, Pejë, nji shkollë të ushtrimit bujqësor në Tetovë, dhe nji shkollë të zanatit për qylyma në Prishtinë. Për të gjitha këto shkolla u vunë në dispozicion mjete financiare dhe mësimore në naltësi të bollshme, ndërsa mësimit të gjuhës shqipe iu dha randësia ma e madhe.

Siç dihet, organizimi i shkollës shqipe në krahinat shqiptare të Jugosllavisë që vazhdoi të funksionoi prej vjetit 1941 deri 1944, ka pasë nji randësi të posaçme për zhvillimin e matejshëm, përparimet në rreze ma të gjanë dhe të shumëanëshme të arësimit dhe të kulturës shqiptare në Jugosllavinë e sotëshme.

Në mërgim të dytë

Vjetë ma vonë mbas ngjarjeve tragjike që suellën Atdheun shqiptar nën sundimin e njej shoqnije, ku siç thotë poeti i ynë në nji artikull në *Shêjzat* (1957) « ... vetëm zani zyrtar aty ndëgjohet tue kumbue mësa që shprehja e lirë e ideve e e ndiesive pengohet nga sistemi diktatorial i qeverimit », e shofim Koliqin në aktivitet të plotë politik, letrar e shoqnuer në Romë. Por, si në të kaluemen, fusha e vertetë e punës së tij përqëndrohet në lamën e ditunisë së gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Me përpjekje të palodhëshme ai mujti të bind qeverinë demokratike italjane që të krijohet Instituti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Romës, nji vepër madhështore kjo për kombësinë shqiptare, mbasi ky institut bahet nji ndër qendrat kryesore të studimeve albanologjike në Evropë. Dijetarë arbresh, shqiptarë, italianë, gjermanë, austriakë, kroatë, etj. të njoftun në këtë lamije vepruen aty, ndërsa nji varg të rijësh dhe të rejash arbëreshë, italianë, shqiptarë, i pasunuen njoftunit e tyne, dhe njikohësisht, hapën horizonte të reja për përparimin e matejshëm të ditunive arbënore.

Në të njejten kohë me ket veprimtari, Koliqi, fillon botimin e së Përkohëshmes *Shêjzat* (1957), e cila pandërpremje vazhdoj të botohet deri në vdekjen e tij. Në nji kohë, kur mbarë prodhimet letrare, gjuhësore, historike, etj., në Atdhe gjinden nën diktatin ideopolitik të regjimit Stalinist, botimi i kësaj së Përkohëshme ka pasë nji randësi të posaçme për studimet serioze të lira shqiptare në botë. Edhe gjatë kësaj përjudhe ai ka ndjekë me interesë ngjarjet që kishin të bajnë me popullësinë shqiptare në Jugosllavi, dhe natyrisht gjaja që tërhjekë vrejtjen ma të madhe të tij, ishte zhvillimi i letrave dhe kulturës shqiptare.

Siç dihet, vetëm mbas largimit të A. Rankovic-it, 1966, i cili për ma se 20 vjet kishte ushtrue nji regjim terrori, shembëllues me at të kohës së Jugosllavisë mbretnore, përkundrejt shtetasëvet të kombësisë shqiptare, filluen këta të fitojnë disa të drejta kombëtare dhe njerëzore si mbas Kushtetutës së Shtetit Federal.

Në këtë mënyrë u-lehtësue, deri diku, presioni i randë që ushtrohej kundër shtresës intelektuale shqiptare dhe komunikimit të sajë me qarqet e njejta të shtetit shqiptar dhe botës së jashtëme që interesohej për dituni shqiptare.

E Përkohëshmja *Shêjzat* që në fillim të botimit u-ba nji burim me randësi për zhvillimin letrar dhe kultural të Kosovës. Aty, herë mbas here, u-botuen recensione të veprave në shej në prozë, poezi dhe shkenca, ndër të cilat shfaqej dhe gëzim për përparimet madhështore që ishin ba në këtë fushë. Prof. Koliqi, si autoriteti kryesuer i Shkollës klasike gjuhësore shkodrane-kosovare, në të cilën që nga shekulli 16-të janë botue veprat kryesore shqipe, siduket, kishte vue shpresa të mëdha në ruejtjen e kësaj tradite nga letërsija e re në Kosovë. Këtë shpresë e shofim sidomos në artikullin e tij *Bota Arbnore* (*Shêjzat*, numër 1-2, 1966) ku trajtohen qëndrat kryesore të kulturës shqiptare në botë. Për shqiptarët e Kosmetit, midis tjerash, shkruhet: « Prova ma e bindëshme që rrajët e shqiptarizmit (thrasim *shqiptarizëm* përmbledhjen e vlerave të njimendëta shqiptare të çdo lloji) nuk thahen por jesin mugulluese e të pjellëshme për jetë të jetës, na e japin Shqiptarët në Jugosllavi. Befas ndër ta ndodhi nji zgjim menduer qi krejt na çmeritë. Populli i Kosovës, titan i shtrënguem të mprojë me armë trashigimin stërgjyshuer ethnik tue lanë padeshtas mbas dore këndim e shkrim në gjuhë amtare, mbas së dytës luftë të përbotëshme, dijti e mujti në pak vjet me u naltësue në kulturë dhe me krijue nji letrësi e cila bëgatë më frymë të gjanë të veten e me njomësi e thellësi ndjenjash njerzore Parnazin arbnuer. Ligjirimi kosovar i palivruet, me at kumbim të madhnueshëm qi jehon në kangë kreshnike, lulzoi, mbrenda njizet vjetëve, tue u hollue e tue u zbutue e shkriftue (s'adoucir), *pa humbë cilsit e fuqis natyrore e undyren autoktone të frazeologjis në mbrumjet ma të guximshëme t'artit shprehës* ». Rrezikun që ai intuitivisht e ka ndi se mund t'i kërcnohet këti zhvillimi të natyrëshëm letërsisë shqiptare në Kosovë gja që ndodhi vjet ma vonë me marrëveshtjen për unifikim

të gjuhës letrare midis Tiranës dhe Prishtinës, Koliqi po në këtë artikull e nënvizon kështu : « Rreziku, mbas sotit, edhe këtu qindron në nji të rrëfatun në drejtime qendër-ikse (*centrifuges*) të këti mugullimi letrar, plot piptha e triskuj të mahnitëshëm, qi t'a shtyn padeshtas me kërkue langjet jetësore ushqyese jashta humusit aborigjen të përbashkët arbnuer ».

Megjithë përpjekjet e Tiranës dhe të Prishtinës me vue në heshtje veprat e Koliqit dhe të shkrimtarëve tjerë të së kaluemes dhe të sotëm për shkaqe ideo-politike, fuqija krijuese, bukurija e gjuhës dhe e stilit, fryma e lirë gjallënuese e prozës dhe e poezisë së tyne, nuk mund të mbetëshin për gjithnji në errësinë. Rinija shkollore kosovare, dhe të shpresojmë edhe ajo në Shqipni, heret ase vonë, do të gjente rastin të shijojnë pjesë të kësaj letërsije. Njaty nga fundi i 1960-tës, siduket, kanë mujtë të lexojnë edhe ndoj numër të *Shêjzat*ve. Frymzimet që kanë pasë qarqe të studentave universitarë që merren me letërsi dhe kulturë në Belgrad, Prishtinë, etj. mund të shifen në letrat që i kanë dergue poetit tonë në Romë. Këtu po sjellim disa rrjeshta të letrave në fjalë : « Por le t'ju merzis pak me nji bisedë qi flet për mitin e artit koliqjan qi ka fillue të përhapet këtu ndër ne. Por po i hyjë nji pune qi s'asht për mue, mbasi me tregue ndikesen qi ka ba te dashamirët e fjalës bukur — *Zana e Fundme*, *Prroni i Çepit*, *Kërcimtarja e Dukagjinit*, *Thanë Gjaku*, *Prrallë Romantike*, *Auto-da-feja*, *Shën Gjergji*, — s'asht punë aspak e lehtë. Por dishka po ju tham, dishka qi asht e vertetë dhe e thjeshtë e qi s'lyp argumentime : *Shkrimet e jueja janë tue frymzue deri në mrekullim zemrat e reja kosovare*, e njerzit vrapojnë mbas fjalës s'uej pse aty ndeshin Përëndeshën tonë — Shqipen, të pastër, të njomë e virgjine porsi *Primavera* e Boticelli-t ». Në nji letër tjetër, midis tjerash thuhet : « Kemi pasë edhe shumë takime na të rijtë kosovarë, e doemos tema dominuese e atyne bisedimeve vinte e bahej arti i juej qi pranohej pa reservë si *ma i përsosuni në letrat shqipe*. Intelektualët e rijë të Kosovës Ju përshendesin e Ju adhurojnë, mrekullohen me bukurinë e fjalës s'Uej e frymzohen soje ».

Puna e Ernest Koliqit si profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, si shkrimtar dhe poet prolifik, si gazetar e polemist politik, si konferencier dhe orator, si përfaqësues i përsosun i qytetnimit prendimuer, si njeri i shkueshëm i shoqënisë, i kanë fitue ati nji popularitet dhe emen midis shqiptarëvet dhe të huejëvet si rrallë ndoj shqiptari në kohën tonë. Nga ana tjetër, ai ka qenë vazhdimisht i luftuem nga qarqe të intelektualëvet të së majtës, nga kundërshtarë dhe kritikë në sheshin letrar-gjuhësuer, dhe kryesisht, për qëndrimin e tij politik të bashkëpunimit me regjimin e mbështetun nga fashizmi italian në Shqipni.

Mirëpo, ky asht fati i shumë personaliteteve të mëdhaja në vendin tonë dhe në botë, por randsija e jetës dhe e veprave të Ernest Koliqit do të vazhdojnë me pasë impaktin ma të thellë në zhvillimin e matejshëm të letërsisë dhe të kulturës së lirë arbnore.

Ricordo di Ernesto Koliqi

di ETTORE PARATORE

Non è compito mio, perché non ne ho la competenza, soffermarmi sul valore fondamentale e insostituibile dell'opera che Ernesto Koliqi svolse per incrementare la conoscenza della civiltà del suo popolo, specie sotto il profilo delle tradizioni popolari, e per impiantarne una prima sistemazione critica. Basta ricordare al riguardo quello che è ormai di dominio pubblico nel mondo della cultura: che egli, trovatosi per le vicende della sua vita a rivivere profondamente e anche drammaticamente il destino di tanti suoi connazionali, di rifugiarsi cioè nell'ospitale Italia, ma con gli occhi e il cuore sempre rivolti all'aspra propaggine schipetara sull'Adriatico, ebbe il genio e la forza di concludere fattivamente quella che fino allora era stata la non inutile ma pur sempre dolorosa dicotomia della tradizione nazionale albanese: da un lato la resurrezione che gli esuli in Italia, gli *arbreshë*, avevano tenuto in incubazione per secoli fino alla grande esplosione di Girolamo De Rada e alla conseguente opera di spiriti come Giuseppe Schirò, dall'altro la progressiva acclimatazione nella terra d'origine delle esigenze culturali poste dagli emigrati in Italia, il moto d'autocomprensione che l'acquistata indipendenza aveva favorito ma che aveva grandeggiato tuttora più che altro nell'opera dei poeti, da Frashëri a Fishta. Grande animatore in patria della conoscenza delle più remote tradizioni della sua terra, il Koliqi, costretto all'esilio, aveva naturalmente ricollegato l'opera già svolta in Albania con quella esistente nelle tradizioni dell'immigrazione albanese nelle nostre provincie, che sin dal De Rada aveva scrupolosamente affiancato le indagini linguistiche e storiche allo slancio della poesia.

Anche il destino che l'aveva fatto nascere a Scutari sembrava predisporlo a questo compito decisivo. Era stata proprio la sua città il centro di permanenza e di vitalità della fiaccola della coscienza nazionale anche nei secoli bui dell'oppressione ottomana; e l'opera di padre Leonardo De Martino, svoltasi proprio a Scutari, aveva rappresentato il provvidenziale collegamento fra questo inestinguibile focolaio di vitalità autoctona e la plurisecolare e multiforme attività degli albanesi trapiantati in Italia. Né si può sottacere il fatto che, prima e dopo il conseguimento dell'indipendenza, Scutari, nell'instancabile resistenza alle brame annessionistiche del Montenegro e in genere degli slavi del sud, era stata veramente considerata la città santa della nazione. I caratteri di questa formazione sono stati oggi acutamente individuati da Giuseppe Gra-

dilone nel capitolo intitolato *L'opera letteraria e culturale di Ernesto Koliqi* contenuto nel volume *Altri studi di letteratura albanese* (Bulzoni, Roma 1974). Ma il Gradilone non ha potuto fare a meno di porre in primo piano quello che in tale formazione aveva rapporto con la più profonda sentimentalità e si è espresso sempre in questa chiave, come opera di poesia.

Questo è appunto ciò che ci sentiamo più autorizzati a sottolineare, in rapporto con le nostre possibilità e con la conoscenza personale che abbiamo avuto la ventura di stringere con Ernesto Koliqi. Anche a non conoscer nulla dell'opera sua che ne fa uno dei vertici della moderna letteratura albanese (egli è per es. il creatore della prosa lirica della sua lingua) e che palesa la sgomentante pluralità delle sue geniali attitudini, si poteva intuire quale tesoro di umane esperienze si celasse in quell'individualità pur così quadrata e vigorosa come egli appariva fisicamente a chi lo contemplasse. Quando la sua stessa instancabile attività ci fornì nel 1963 l'*Antologia della lirica albanese* in cui nella versione italiana egli ci fece conoscere il meglio della poesia della sua terra, compiendo all'inverso quello che egli aveva già saputo fare per la conoscenza della nostra poesia traducendola in lingua albanese, noi dalle due liriche sue che con pudica sobrietà egli aveva inserite nel volume riuscimmo a cogliere più intimamente quella che nella sua formazione spirituale era stata la profondità dell'influsso della città natia:

I tuoi notturni gelsomini, o patria,
profumano d'acuta nostalgia
le ore del mio esilio.
Lontana sei, ma i volti
della tua numerosa aspra bellezza
fiammeggiano specchiati nel profondo
cielo dell'anima,
da rugiade di duolo illimpidito.
Intatta porto in me l'azzurra pace
dei mattini che incrina l'argentina
voce delle campane
ed il mistico invito
dei minareti aerei
che l'alba ingiglia.
Porto con me
la purpurea delizia degli estivi
meriggi scutarini
nei cortili recinti d'alte mura
ove dalla calura
s'imperlano di lievi gocce rosee
le gole delle giovinette assise
al rezzo sotto il moro
mentre a tratti risuona,
gaio e sonoro nunzio di frescura,
del secchio il cozzo che dal buio fondo
del pozzo sale a sgocciolar sul marmo

del puteale veneto.
Porto con me l'incanto
trepido e l'oro delle lente sere
che la bocca del vento, —
calato d'improvviso giù dai monti, —
rende inquiete
mormorando le antiche
nenie segrete
che vivono nel canto delle fonti
alpestri e nell'anelito tonante
della foresta ov'hanno lor dimore
le Madri millenarie della stirpe
e i Genii, fabbri delle nuove gesta.

Questa ombrosa, struggente sensibilità a tutto quello che è la santità della tradizione (voce che specialmente per un albanese autentico ha una vera e propria imponenza sacrale) finiva per manifestarsi con una forza intima proporzionale alla serietà del travaglio con cui era rivissuta e alla rigorosa e schiva semplicità con cui si estrinsecava. Un classicista come il sottoscritto, custode anche lui di valori tradizionali sentiti come fondamentali e perciò tanto più gelosamente rivendicati in questo triste periodo di contestazioni e di denigrazioni, non poteva non avvertire subito in lui un fratello spirituale della più pura essenza. E negli anni in cui ebbi la fortuna di istituire con lui rapporti di collaborazione, di veder sorgere spunti di comuni interessi, ci fu facile trovare un terreno d'intesa nell'ambito dei fondamentali caratteri che strutturavano le nostre attività culturali. La naturale preminenza della sua sensibilità per la tradizione popolare della sua terra, quella che informa i tre primi capitoli dei suoi *Saggi di letteratura albanese,* doveva naturalmente incontrarsi con le mie predilezioni per lo studio della sussistenza delle grandi figure della letteratura latina nelle tradizioni popolari italiche, specialmente con le mie indagini sulla sussistenza e la configurazione della personalità di Ovidio fra le genti d'Abruzzo. Di qui i memorabili incontri fra noi nel quadro della sua fondamentale attività di divulgatore delle leggende popolari albanesi specie nella diaspora molisana, calabra e sicula, entro le linee delle indagini di cui a tutti noi recava magistrale esempio il compianto Paolo Toschi. La sua commossa opera di rivendicazione del grande italo-albanese cui si deve la definitiva rinascita dello spirito nazionale, Girolamo De Rada, mi fece ricordare che in gioventù m'ero avvicinato all'opera di quel grande, grazie al volume che su lui aveva scritto un amico la cui memoria resterà sempre per me una delle maggiori forze di elevazione spirituale: Vittorio Gualtieri. E l'interesse suscitato in me per lettere inedite del De Rada di cui ero venuto a conoscenza in occasione di alcune discussioni di quelle tesi di laurea che erano una delle prove più luminose dell'attività didattica del Koliqi e alle quali egli volle darmi l'onore di intervenire come correlatore, mi offrirono il destro di compiere l'insano atto temerario di scrivere per la rivista *Shêjzat* da lui fondata un articolo sui motivi umani affioranti dall'inedito epistolario deradiano. Volle poi il caso che ci in-

contrassimo anche nelle simpatie per alcune maggiori figure della nostra letteratura contemporanea: nei già citati *Saggi* v'è un capitolo intitolato *Gabriele D'Annunzio e gli Albanesi,* che è il primo e definitivo bilancio degli influssi del Pescarese sulla poesia albanese contemporanea. Il sottoscritto, che fra le tante sue infedeltà al compito di filologo classico può vantare o deplorare (a seconda dei punti di vista) anche la sua tenacia di cultore del D'Annunzio, non poteva non gettarsi avidamente su quelle pagine, cui dette ampia pubblicità nella rivista abruzzese *Oggi e domani.*

C'erano tutti i motivi per sentirsi spiritualmente vicino a una personalità di tanta imponenza e suggestione. In me agli inizi sussisteva sempre un senso di stupore e di timidezza nel vedermi trattato alla pari da un uomo capace di essere la massima autorità nell'ambito dei suoi studi e insieme un grandissimo poeta, da un uomo che oltre a questi meriti eccezionali poteva vantare un glorioso passato anche nell'attività politica che aveva fatto di lui il massimo rappresentante e il più geniale animatore della consapevolezza culturale della nazione albanese. Ciò che a poco a poco vinse le mie trepide renitenze e m'indusse a sentirmi fratello, e sia pure fratello minore, di quella insigne personalità fu proprio la sua *humanitas,* che un cultore di studi latini doveva scoprire e coltivare con gioia, quella dote così preziosa e pur così rara anche in studiosi di eccezionale valore, che m'ero abituato a sentir vibrare in lui non solo nella sua opera poetica ma in tutta la sua quotidiana estrinsecazione, che mi appariva quindi il supporto delle sue manifestazioni espressive più alte. Eravamo giunti entrambi a quella fase della vita in cui l'attività svolta può essere già vista sotto forma di consuntivo, e può permetterci di giudicare a che scopo siamo nati e può quindi darci, nell'attesa della morte, la forza di continuare il nostro lavoro come assidua riaffermazione degli ideali per i quali siamo vissuti. Questo m'insegnavano giorno per giorno il suo sorriso, la sua bontà, la sua instancabile dedizione al suo lavoro ed alle sue idealità tanto più ardentemente coltivate quanto più apparentemente compromesse dalla nequizia dei tempi. E come preparazione all'estremo trapasso inteso come coronamento di un'esistenza nobilmente impiegata, ancora una volta la sua poesia mi forniva un documento perfettamente consono all'esperienza che la sua persona mi suggeriva quotidianamente. Era la lirica che nella sua versione reca il titolo *Estrema visione:*

Bianca Visitatrice,
che d'improvviso con silente passo
appari sopra l'erbe vespertine,
non mi sgomenta il perentorio dito
fermo nel cenno del fatale invito:
accoglierò sereno
la leggera carezza
delle tue mani d'ombra
quando con un frullar di trepide ali
queste pàlpebre, stanche
di luce sempre effusa sul dolore,
mi chiuderai con un materno gesto:

mi sembrerà di risentir sul volto
il delicato tocco
d'una rama dei boschi, delle dita
vegetali dei boschi d'Albania,
dita di fresche foglie
asperse di rugiada,
le lagrime del nostro cielo, aulenti,
sudor segreto della nostra terra,
unico refrigerio
al divorante ardore
che mi consuma questa argilla umana,
dove rivive e soffre
la cenere degli avi:
ti seguirò spedito,
tacita condottiera,
sopra il sentiero aereo che conduce
al limitare cerulo
della Gran Luce che tu ci riveli:
pago se, prima di varcar le astrali
alte frontiere e sciogliermi
da questa umana argilla che m'inceppa,
mi mostrerai lontano
nei cieli, fra la bruma
dei miei terrestri dì vòlti al tramonto,
le montagne natali
alfine circonfuse da un fiammante
vel di libere aurore.

Quando perciò ci folgorò la notizia della sua morte, pur nel dolore mi sembrò che si fosse compiuto un rito di sublimazione; e mi parve ch'esso contenesse una promessa e un invito anche per la mia oscura e modesta vicenda terrena, l'estremo dono che quella superiore personalità offriva ai *minus habentes* che avevano avuto la fortuna di incontrare e intendere il suo esempio luminoso.

The poet is a shrine for his language[1]

by **JAMES TORRENS, S. J.**

The poetry of Ernest Koliqi will, alas, have to remain a tantalizing mystery, a locked treasure, for those who do not understand his native language. As the poet Paul Valery has said, "A true poet is strictly untranslatable. He is never profoundly, intimately, and completely understood but by his own people: he is inseparable from the speech of his nation". Still a non-Albanian reader can catch glimpses and clues of greatness, reading Koliqi's work in translation. And he can rejoice that Koliqi has enabled the Albanian language to reach its full potential, to express fully the spirit of the people who speak it, in his poems. For the poems of any great poet are a sort of shrine for his language.

The evidence of Ernest Koliqi's industry on behalf of Albanian poetry is indeed astonishing. His volume *Antologia della Lirica Albanese,*[2] an anthology of Albanian lyric poems which he translated into Italian, shows him to have been perfectly bilingual. The translations in this long series have every conceivable poetic rhyme-scheme and form which are no doubt dictated by his originals— and show his great versatility in Italian and great care. They are indeed beautiful poems in their own right. These translations, and so many others published over the years in his literary journal *Shêjzat* (le Pleiade), are tributes to the whole poetic tradition of his country, which was carrying itself out in him.

This attachment to the Albanian tradition shows itself particularly in *The Symphony of Eagles,* his epic account of the bravery and trials of the Albanian people, past (as Illyrian tribes men) and present. Students of poetry have long known that Yugoslavia is a privileged home of the age-old oral epic. Koliqi has shown them, both through his doctoral thesis *The Albanian Popular Epic* (later published) and through *The Symphony of Eagles*[3] that Albania is no less. Koliqi's epic has a number of high points, but perhaps no moment is more thrilling than that which marks the end of a generation of wandering by the Illyrian tribes and their discovery of what is to become their permanent home.

[1] *Father James Torrens, S J., poet and author himself, met Prof. Koliqi in 1973. An admirer of Prof Koliqi's work, Fr. Torrens has already translated some of his poems from Italian into English*

[2] E. Koliqi, Antologia della Lirica Albanese, *Milano 1963.*

[3] E. Koliqi, The Symphony of Eagles (*translated by* Anesti Andrea), *Rome 1972.*

Behold O Lord the weary tribe,
climbing that craggy mountain,
draped all white beneath dark clouds.
Sluggish their pace, withered their limbs,
still they advance over rocks and cliffs,
wondering how long they need roam the earth.
But lo! A miracle! Perched on a peak
Bardhylli, Hylli's bold nephew, lets out a cry:

"Fields, unending fields, and ah, the sea!"
Now people rush to where Bardhylli stands,
as amid purple clouds of eve a soaring eagle
bids Hylli wellcome.

Thus spoke the elated leader to his people:
"Noble Illyrians, this hour heralds the prophecy's fulfillment,
for now, at last, we walk upon the land
that the gods did promise us.
Behold these forests with wondrous trees,

these fields of green embraced by mountains,
these shady bowers, these crystal brooks;
here we shall build our homes and temples
and from this earth, in patient toil, let us now reap
seasons of joy".

Ernest Koliqi's love of his native country expressed itself in countless lyric poems as well, poignant and full of vivid personal memory. His "Desperate Prayer" expresses, as well as the words of any exiled writer I know of, the pain of seeing his country, at a distance, subject to bitter suffering, and the struggle to avoid despairing of its future. The "Desperate Prayer" is both a sharp, piercing cry and a prayer.

Other poems of Koliqi are more tranquil, marked with the gentle touches of home that appear also in his stories (for example "The Garden") and in his novels. One poem may perhaps be taken to stand for the rest in this regard, a poem which implies the peaceful assurance of a religious faith and expresses, as well, great nostalgia. The poem is entitled "Final Vision". It is here translated from Koliqi's Italian text. This poem may, for many obvious reasons, be allowed to stand as our final word on Ernest Koliqi's poetry.

White Visitant,
who suddenly with silent step
appear upon the evening grass,
your finger with its fateful beckoning,
imperative, does not alarm me.
I will receive serenely
the slight fondling
of your shadow hands

when you close up these eyelids,
tired of the light they shed on sorrow,
with a maternal touch:
I will seem to feel upon my face
the soft brushing
of a forest branch, fingers
of your woods, Albania,
fingers of fresh leaves
sprinkled with dew,
the tears of our delightful sky
and secret moisture from our earth,
alone tempering
the fervors that consume
this human clay of mine,
where ashes of my fathers
live and suffer once again:
I will follow you at once,
my wordless guide,
over the air's long path
that leads us to the threshold
of that one Great Light whom you reveal:
enough for me, before I cross
the high frontiers and free myself
from this encumbrance of human clay
if you but show me
far, far off, amid the mist
of earthly days moving towards sunset,
my native mountains
now at last encircled
with a flaming veil of free dawns.

Gjindja qi kanë për gjuhë amtare shqipen e — ku mâ shum ku mâ pak — frymzohen nga shpirti i zakoneve arbnore, sot ndahet në trí pjesë: banorët e shtetit shqiptar, vllezënt në Jugosllaví dhe bashkatdhetarët e diasporës.

N'idealin t'onë, qi kurr s'ká për t'u shkimun, këto trí degë përbâjnë nji tanësí gangullore, cilido të jét zhvillimi shoqnuer i veçantë i tyne.

... Diasporës, n'atmosferën liríplote të Prendimit, i përket kunorzimi i punës mendore qi kryhet në rrethana shtypëse në dy pjesët tjera të Shqipnís ideale. Shkrimtarët e lirë të mergimit duhet nëpër sita të lira të nxjerrin majen e ndiesíve dhe të mendimeve që linden në zêmrat e në trût e vllazënve të ngatrruem në gjalma pengueşe.

ERNEST KOLIQI, *Bota e ré shqiptare*

(*Shêjzat,* II, 1958, 5-6, faqe 145-146)









Prof. Ernest Koliqi në rrethin familjar
Prof. Koliqi nell'intimità familiare

"Vajtim" a Ernest Koliqi

di ANGELA CIRRINCIONE

Albanesi dispersi in ogni dove,
in Albania, in Calabria, in Sicilia,
in America e in tutta l'Europa,
cantate il vajtim *con me a Koliqi.*
Combattente zelante ed ostinato
lottò per tutta quanta la sua vita.
La sua penna fu l'arma preferita!
Colpiva l'odio con l'amore avito
per la besa[1] *degli avi e la* burrnija,[2]
di cui fa parte urtija *e* trimnija.
Le sue opere oggi son vessilli
che testimoniano tutti i suoi assilli.
Or se qualcuno dei compatrioti
non ha tanto con lui simpatizzato
e d'uno o d'altro fallo l'ha accusato,
ricordi che nessuno è senza sbaglio.
Dai suoi scritti appare molto chiaro
l'amore grande per la patria sua.
Un giorno all'anno Lui commemorava,
era l'Indipendenza d'Albania,
che festeggiava il ventotto novembre,
volando ad hoc di solito in Sicilia,
per respirare l'aria d'Albania
Se qualcuno di voi non conoscesse
tutti i dolci alveari che ha prodotti,
tutti i fiumi di versi che ha versati
in molte annate della Shêjzat *sua,*
or si decida a coglier da vicino

[1] *besa* = promessa, parola data, fede giurata. Spiegazioni in italiano date dallo stesso Koliqi in *Studime e Tekste Juridike I*, pp. 15-17.

[2] *burrnija*: nella concezione virile della vita, due virtù fondamentali troviamo fuse nella *burrnija*: la *urtija* che è l'equilibrio mentale, il sapersi comportare con prudenza, con garbo e misura nei rapporti tra uomo e uomo, e la *trimnija,* il coraggio, il valore ben distinto dalla temerità.

la grande eredità da lui lasciata,
per apprezzare almeno ora da morta
quella virtù che viva avea spregiata.
Qui ci vorrebbe un Fishta o uno Shantoja,
un Palaj, un De Rada, uno Schirò,
per piangere potere degnamente
tutte le lacrime che Lui si meritò.
Ma questi Grandi lo hanno accolto già
nel grande cerchio, nel cerchio dei poeti,
rendendo grazie a Lui dell'operato
per il comune Ideale tanto amato.
Io non so dirvi se con versi o canti,
se con parole o modi sconosciuti
a questo nostro mondo di mortali,
ma certo con la musica sublime,
che giungere non può all'orecchio umano,
poiché l'artista buon, più o meno pio,
è una stupenda espression di Dio.

* * *

Scutari, piange con me!

Scutari, devo darti brutta nuova:
quell'Usignolo, che tu generasti
nei primi anni del secolo in corso
e matrignescamente dirottasti
a vivere da esule in Italia,
non canta più!

Se conoscessi la ricca eredità
di tutti i versi in cui ti ha immortalata,
di tutti i sogni che per te ha sognati,
delle lacrime amare che ha ingoiate,
un lungo vajtim [1] *tu canteresti*
sopra di Lui.

Tu non lo sai come mitigava
la nostalgia che di te lo tormentava.
Ogni volta che Lui desiderava
di vedere un lembo del tuo cielo,
di toccare le sponde del tuo Lago,
Lago di Scutari,

[1] *vajtim*: canto funebre, generalmente cantato da donne.

di respirare un po' della tua aria,
l'odoroso profumo dei tuoi fiori,
ora andava in Calabria, ora in Sicilia
fra gli eredi di Giorgio Castriota.
Lì Lui sentiva l'aria d'Albania,
sognando da poeta,

felice di parlare quel linguaggio
che come Fishta[2] *l'Esule sentiva*
così soave,

"come soave è il sonno d'un fanciullo,
come la luce che dà nuova speme,
nuova speme,

come letizia che non tiene ascoso
nessun senso di male e di malizia.

Sentiva dolce,
come una lieve brezza in primavera
che sfiora i fiori con bacio gentile.

Sentiva sonoro,
come il canto sonoro d'un uccello
che gorgheggia fra il verde dell'aprile.

E rimbombante,
a volte lo sentiva rimbombante
come il tuono d'un fulmine saettante".

Ma la speranza di posare infine
le morte membra sue nel grembo tuo
morì con Lui nella città di Pietro.
E come l'amore grande per la Patria,
nell'esule, ramingo ed emigrato,
si sente e si acuisce sempre più,
così l'amore di Ernest Koliqi fu.

[2] Gli attribuiti dati alla lingua albanese sono quelli di Gjergj Fishta nella sua poesia *Gjuha Shqipe*.

Kujtim i Prof. Kolikjit

nga SALVATORE PETROTTA

Me vdekjen e prof. Kolikjit, me të vërtetë e pa priturë për neve, shuhet një nga Shpirtrat më të mëdhenjë — o se më i madhi — të tërë botës letrare Shkjipëtare.

Ngë isht punë jimia të shkruanj glatë e gjerë por edhe dy fialëtë vetme më duhet t'i shprehë për Burrin çë në Shkjipëri ashtu si edhe jashta i kushtoi tërë jetën madherisë t'Atdheut.

Kush I rroi afër — te gjella dhe te puna — mënd kuptonjë *Kë* kemi humbur, veçnarisht sot çë, te bota e tërë, jetohet ndër një klimë pa besim.

Ai, prof. Kolikji, përfakjësoi për neve një fialim të gjallë, një pikëkjëndrim të gjëravet te të çilat duhet të besojëm, një kontakt me të vërtetë me gjellën e përditëshme.

Nani Burri ngë isht më dhe kjo isht e kekja e vërtetë çë na kjëndron neve, Shkjipëtarë dhe Arbreshë, neve të çilëve na kjëndron — si ngushëllim për një gjellë e humburë — kujtimi i Tij çë te mendja e jonë dhe te zëmbra jonë do të ruajëm si atë i njëi Miku dhe i njëi Vllau çë na ka lënë si trashgjim dëtyrën të mos humbjëm dashurinë për letërsinë Shkjipëtare e çila isht njëkohësisht dashuria për Shkjipërinë tek e çila Ai ngë pati më fatin të kthehej.

... Por duhet me zotnue mirë të dyja gjûhet e mâ teper perkthyesi me pase shkndin poetike në vedi: si âsht rasa me thânë per z. Koliqin t'onë, i cilli, posë se ká ne vedi shkndin poetike, zotnon edhè mâ se miri gjûhen shqype e italishte, sikur diftojnë veprat qi dër m'sod ká botue.

Prandej megjith arsye mund të thohet, se âsht pernjimend nji fat i bardhe per literatyren t'onë kombtare, qi ky letrar i ri, i pajisun me të gjitha cilsit e lypuna per nji perkthyes të mirë, i a ká hî perkthimit të copavet të zgjedhuna prej veprave të katër klasikvet mâ të parë t'Italis; pse kshtû komi i jonë ká me pasë nji idé mjaft të kjartë e të pershtatun mbi naltsin e ktyne kolosvet të literatyres botnore. Perkthimet klasike thamë se janë fort të vshtira edhè nder gjûhë të mdhá europjane, të zhvillueme gjatë qinda e qinda vjetsh; shka nuk kan me kênë per gjûhë shqype, e cilla, si gjûhë letrare, të thuesh, ka lé dje? Por gjûha e paster, vjerrsha kumuese e skjyrtimi i kthellté i z. Ernest Koliqit mbi shpirtin e noten karakteristike të secilles nder kto vepra, posë se po na bâjnë me shijue bukurí klasike dér m'sod krejt të reja per komin shqyptar, u rrfejnë nji heri të huejve, se gjûha shqype ká aq pasuni fjalësh e âsht e ardhshme e plot gjallni e jetë, sa me mûjte me u perkthye në të klasikët e ç'do komi e ç'do kohe.

I lumtë, pra, z. Ernestit! — por me shart, qi të vijojë vepren kaq marë të fillueme.

Át Gjergj Fishta o.f.m.

(në Ernest Koliqi, *Poetët e Mëdhej t'Italis*, me nji parathânje nga Át Gjergj Fishta, *Vëllim i Parë*, faqe VII-XIV).



Prof. Koliqi me zojushën Matilde Mancinelli, Drejtoresha e « Shêjzavet » dhe me të Shoqen

Dalla sinistra: la sig.na Matilde Mancinelli, Direttrice di *Shêjzat,* il prof. Koliqi e la consorte, sig.ra Vangjelija

Nji pishtar i letërsisë e i kulturës shqiptare fiket

nga Msgr. Dr. JOSEPH J. OROSHI

Nji nder fatëkeqësitë gati të pergjithta âsht se nierzit e mdhaj bâhen aq të nevojshëm në rangun e tyne të përditëshem, saqë dalin vonë në pushim, e nuk arrinë m'e shfrytësue plotësisht përvojën e tyne të gjatë, me krijime të reja, ose edhe per t'u dhanë dorën e fundit prodhimevet që ata i dhanë nierzimit.

Shum herë ndigjova nga shqiptarët e Boston-it se Imzot Fan Noli nuk mendonte me vdekë! ... pse donte me vijue punën e tij intelektuale per t'u lanë sa mâ shum breznivet t'ardhëshme. Këte të vertetë e shprehë mâ së mirit edhe proverbi popullor: *Nuk më lanë punët me vdekë!* Nji german më thonte per Kanqelarin Adenauer: *Sa të largohet nga Kanqelleria, ai vdes.* Këta ngjanë sidomos me nierzit krijimtarë, si në shkencë si n'arte të bukura. Ata e perfillin rangun e tyne jo vetem si nji detyrë per t'u krye, por mâ teper si nji vokacjon per t'i kushtue jetën. Per ta nuk ka matëshmení, as shmangie flijimesh, çfaredo qofshin. Poeti lirik romak thonte per materialistat: *Parja siellë unë pares.* Anasjellëtas âsht per shkencëtarët e artistat: puna u shton unë e punës perherë e mâ teper. Të kallun në psyhen e tyne per të gjinikue ata çka në menden e tyne âsht sajue, sendergjue e shestue per të miren e nierzimit, naltësohen n'atmosferat e universalevet, të pamatëshmenisë së kohës e hapsinës, tue harrue deri ligështinë e natyrës nierzore, së cilës Krijuesi, në setcilin individ, i ka vû nji cak.

Nder këso rrethanash e gjet vdekja papritmas *profesor Ernest Koliqin*, Ordinar i Universitetit të Romës per Letrësinë Shqipe per mâ se tridhetëpesë vjet.

Shêji i sëmundjes hajneshë të zemrës i pat trakllue te dera tash do vjet mâ para. Megjithatê, teksa pat dalë në pushim, ai i qe përveshë punës prodhimtare edhe mâ me zell e shpejtësi se para. Si kemi marrë vesht nga miqët, ai punoi atë ditë ç'nga ora shtatë të mëngjesit e deri n'ora pesë të mbramjes që do t'ishte e mbramja per tê. E ndiente vetin të kënaqun se tash, i shkëputun nga punët e Universitetit, mund t'i a kushtonte krejtë kohën prodhimit letrár. Dihet se ishte tue pregatitë *Antologjinë e Letërsisë Shqipe* (me shkrimtarë të mdhaj e të vogjël), dhe « Memoirs » e veta. Në mes të kësaj nisme sa të dobishme, aq të nevojshme, vdekja e pamëshri-

rëshme i a ngrini dorën tue shterngue penden puntore. Keso çasesh mirë na kujtojnë elegjitë vajtimore të malcorevet tona në vdekjen e rapsodit të vendit:

Lahuta të pret me i rá
Por gishtat t'u kanë thá!

Nuk besohet se gjindet sot gjallë nji si ai, me përvojë e njoftuní aq të thellë e të gjithanëshme të shkrimtarëvet shqiptarë, që të ndermarrë nji nisme sa të guximshme aq edhe të vështirë, përpilimin e *Antologjisë Letrare Shqiptare*, me art e paanësi, sidomos në konditat e sotshme, si do të delte nga penda e tij.

Nga vjeti 1955 deri në 1961 paçë fatin të studjoshe n'Universitetin Shtetnor të Romës. Këtu paçë rasën ta njifshem mâ s'afermi të ndiemin Profesor. E paçë jo vetem Profesorin e Letërsisë Shqipe, por edhe drejtor të studjimevet. Njoftunija, dashtnija e depertimi me zotësí i shkrimtarëvet të ndryshem, edhe i dytunorëvet, e sidomos depertimi i filozofisë së kangëvet epike shqiptare, në të cilat ai shquente nji « ethos » autokthon të njij çivilizimit jetik Iliro-Shqiptar, e mbante audjencën e dendun shtang, dhe u jepte të huejvet me kuptue se edhe Populli Shqiptar e ka dhanë nimesën e vet në brumbosjen e çivilizimevet të ndryshme Mesdhetare.

E njimend edhe specializimi i tij, në doktorimin e Letrësisë, ka qenë mbi *Kangët Epike Shqiptare*. Pat mbajtë miq personal rapsodët mâ të njoftunit e malevet, si Gjergj Pllumbin e Shalës, Prendush Gegen e Pukës etj., e nder meshtarë ma së forti Pater Bernardin Palaj, françeskan, permbledhës e hulumtues i madh i *Visaret e Kombit*.

Klasa e tij n'Universitet gjindej gjithmonë e dendun, jo vetem me studenta të rregullt, por edhe me intelektual tjerë, sidomos Arbreshë, që dishrojshin të kishin njoftuní mbi letersinë shqipe. Persa u perket Arbreshëvet mandej, u bâ udhëheqës per dashtninë e ringjalljen e gjuhës shqipe nder të gjitha ato koloní. Me anën e studentavet Arbreshë, sikurse me hulumtimet e veta direkte, mblodh krejtë folklorin e traditat popullore jetike nder fshatet arbreshe. Landa mâ e zgjedhuna e ketyne materjalevet qe përpunue shkencëtarisht, nen drejtimin e tij, nder theza laurimit në Letrësinë Shqipe, n'Universitetin e Romës. Imzot Fan Noli i pat dhanë miratimin mâ të madhin kësaj punë, pse thonte: *Kurr nuk është bër një punë e tillë ndër Arbreshë*.

Pjesë mâ të zgjedhuna të këtyne punimevet universitare qenë botue, gjatë tetëmbëdhetë vjetëvet, në revistën zâmadhe të letrësisë dhe të kulturës shqiptare, *Shêjzat*, themelue e drejtue me zotësi e mbajtë gjithmonë në livel epror gjuhësijet, sikurse me flijime të mdhaja si ekonomike, ashtû të punës së panderpreme intelektuale të profesor Ernest Koliqit. Kjo revistë jo vetem që gëzoi miratimin e pjesës mâ të njoftun t'intelektualëvet shqiptarë në diasporë e të minoritetevet shqiptare, sidomos në Kosovë, por edhe nga jashtë

Vâllajt e Shêjzavet, u përhapën si në Gjermani, Amerikë, Angli e shum universitete botnore. Per mâ teper rreth saj u mblodhen penda nder mâ të mirat e diasporës shqiptare, sikurse disa penda auktorësh të huej me jehonë nderkombtare, sidomos albanologë e historjanë gjerman. Me nji fjalë revista *Shêjzat* qe bâ epiqendra e Letrësisë e Kulturës Shqiptare, e në të njêjtën kohë shkollë e Letrësisë Shqiptare të stilit të naltë per rininë në diasporë dhe, me kufizimet e njoftuna, nder minoritarë.

Vetem breznitë e ardhëshme kanë per ta gjykue pa-anësí e kanë per t'i dhanë çmimin e merituesheëm kësaj reviste zâmadhe. Kurdo, në kohën e ardhëshme ata kanë per të bâ kërkesa e hulumtime letrare e kulturore kanë per të gjetë se, në krahasim me botimet tjera, në krejtë periudhën ç'nga vjeti 1939 e deri në mbylljen e saj, me vdekjen e krijuesit të saj, me 15 kallnduer 1975, nuk kanë per të gjetë mbrenda kësaj periudhe, botime tjera me përmbajtje letrare shqipe, vijueshmenisht artistike të stilit të naltë, si *Shêjzat*, as botim tjeter çfaredo, të papërziem si kjo revistë në demagogjinë e merzitëshme politike të këtynë tridhetë vjetëvet të fundit. E pra, siç dihet, krijuesi dhe drejtuesi i saj, nuk ka qenë apolitik. Por këtu ai dijti të përmbahej i tillë. Lirija në krijueshmení, dhe universaliteti i artit per të miren e gjinisë nierzore, janë ligjë të pakapërcyeshme per artistin e vertetë.

Me vend e pat zgjedhë prof. Karl Gurakuqi, dritë pastë, titullin e librit komentues me rasën e dhetëvjetorit të parë të revistës *Nepër vullâjt e Shêjzavet* të cilin e botoi në Romë në 1969. Titulli vetë e përshkruen përmbajtjen e kopshtit (landës) së *Shêjzavet*. Jo kopshtë ferrash pasjonesh nierzore, por vullâj të njoma e të freskëta që tue u rritë, lulëzojnë, dhe në verën e lirisë japin frytet e bukura e të shishëme per të miren e nierzimit.

Pregatitja dhe prodhimet letrare

Prof. Ernest Koliqi lindi në Shkodrë me 20 maj, 1903, nga nji familje e njoftun tregtare e këtij qytetit historik Illir-Shqiptar.

Si mbaroi filloret në Kolegjën Saverjane të Jezuitëvet në Shkodrë, i ati, Shan Koliqi e dergoi n'Italinë e Veriut per shkollat e mesme.

Prodhimet e veta poetike në gjuhen italishte i filloi ç'nga rinija. Me 1919 këthen në Shqipni, në Shkodrë, ku Imzot Luigj Bumçi e Luigj Gurakuqi, tue njoftë në prirje letrare artistike, e nxisin të jepej mbas studjimevet të gjuhës e të veprimtarisë letrare shqipe.

Me 1923, së bashkut me miqt e tij shkodranë, Nush Topallin e Pater Anton Harapin, themeloi fletoren *Ora e Malevе*, organ politik i grupit liberal-demokrat, që drejtohej nga Luigj Gurakuqi. Si Gurakuqi si, mâ vonë, Át Gjergj Fishta e Dom Ndre Mjedja, u bânë udhëheqësat mâ të ngushtit të tij per t'i dhanë hove të reja e përvojë në letersinë shqipe. Megjithatê, Koliqi qe i pari shkrimtar shkodranë

i kohës së vet që dashtas u largue nga shkodranishtja pak teper e theksueme nder shkrimtarët të tjerë të deri atëherëshëm. Gjuha e tij ishte mâ e pergjithtë, prandej mâ e pasun, stili aristokrat, periudhat të skalituna me adjektiva ngjyrëdhanës, i jepshin gjallnim e valavitje gjuhës e stilit të tij artistik.

Në 1924 *Ora e Malcve* i besoi kryeredaksinë e asaj fletorje. Po në këtë vjetë e thrret Gurakuqi në Tiranë si sekretar privat, dhe pak mâ vonë bahet sekretar i Ministrisë së Mbrendshme, nen Kolonel Rexhep Shalën.

Ngjarjet e vjetit 1925 e shtyejnë të kërkojë strehim në Jugosllavi, ku pat rasë të thellohej në poezinë e pasun popullore jugosllave.

Me 1928 Koliqin e gjejmë në Bari t'Italisë, në mes të grupit të mërguemvet shqiptarë Sotir Peci, Bahri Omari, Kost Paftali, Sheh Karbunara e, mâ vonë, në bashkëpunim per veprimtari të shqipes, me Mustafa Krujën në Zara.

Të paren veper e botoi Koliqi në Tiranë, në vjetin 1924. Me pseudonymin *Borizani* botoi shum poezina në *Lirija Kombëtare* të Gjenevës, drejtue nga dr. Omer Nishani.

Por vepra që e paraqiti shkrimtar dorës së parë të shqipes qe vëllimi i novelavet *Hija e Malcve* botue me 1929 në Zara. Shkruesit të këtyne rreshtavet i kujtohet mirë leximi i parë i këtij librit. Në të shihej qartë se jo vetem nji pendë mjeshtrore e ré kishte lindë në Shkodrë, por me të, dhe nji stil i rí që bânte gjuhen mâ të lehtë, mâ t'ambël, mâ lakuese, të pasun e tërhjekëse, n'afërsi me gjuhët e mdhaja botnore, shvillue me shekuj para sonës, per shprehjen e artit.

Po në këte vjetë ai këthehet në Shqipni, ku mëson letersinë shqipe, mâ para në shkollen tregtare të Vlonës e, mâ vonë, në Liceun Shtetnor të Shkodrës. Shum nga nxânësit e tij u bânë shkrimtarë të vlefshëm të shqipes e t'arsimit shqiptar, si në Shqipni, si edhe per nji kohë të shkurtë por të vlefshme, në Kosovë.

Me 1933 dha dorëheqje nga arsimi per të shkue n'Universitetin e Padovës, n'Itali per të vazhdue studjimet.

Me 1936 u emnue Lektor i Shqipes pranë atij Universitetit, per Kathedren e Albanologjisë që drejtohej nga glotologu i famëshëm, Carlo Tagliavini.

Me 1937, u doktorue, tue mprojtë thezën : *Epika Popullore Shqipe*. Po në këte kohë u themelue në Romë, n'Universitetin Shtetnor Selija e Albanologjisë. Me 1939 qe emnue Ordinár i kësaj Selije, ku qendroi deri sa doli në pensjon, me perjashtim të njij periudhet të shkurtë. E njimend, nga vjeti 1939 deri në fund të vjetit 1941 ai drejtoi Ministrinë e Arsimit në Shqipni. Megjithse koha dhe rrethanat ishin ato që njifen, nen nji okupim, asgjâmangut prof. Koliqi dijti t'i shfrytësonte të dyja. Nen Ministrinë e Arsimit t'atëherëshme u botuen tekste shkollor shqipe e libra, mâ teper se ç'nga vjeti 1912 e deri n'atë kohë.

Por merita mâ e madhja e këtij dikasterit t'Arsimit ka qenë hapja e shkollavet shqipe per të parën herë, nder krahinat e ndry-

shme kosovare. Kosovarët vetë e pohojnë se kjo nisme, e fillimit të shkollës shqipe në Kosovë, nuk mund të quhet as nji rilindje, pse çka nuk ka eksistue kurr, nuk rilindë, por nji lindje e vertetë historike per nji populllësi prej mâ se nji milion frymësh, përbâ prej analfabetësh, mâ se 90%. « Nuk kishte nji mësues, profesor, gjygjtar, avokat, doktor medicine, me nji fjalë nuk kishte asnji person prej kombësisë shqiptare në profesjon intelektual » na thotë dr. Rexhep Krasniqi në nji artikull në nr. e fundit të *Shêjzaret*, ku përshkruenë mjerimin e terrësinavet të Mes Jetës ku i kishin lanë regjimet monarkike jugosllave t'atyne kohëvet. Ky qe vetë dishmitar i asaj gjendje, derisa qe ngarkue nga vetë Ministri, prof. Koliqi, Komisar i Ministrisë per Internatin e Prishtinës, që do të bâhej çerdhja e arsimtarëvet e arsimtarevet të mâ vonëshme.

Prap po i a lamë fjalën dr. Krasniqit nga i njajti artikull: « Para se të nisej në krye të detyrës (per Kosovë) Z. Krasniqi pat nji bashkfjalim të gjatë me prof. Koliqin, i cili, nder tjera udhëzime, shquejti tri pika me randësi të posaçme: 1) Ministrija e Arsimit ven bujarisht në dispozicjon mjete financjare dhe material të ndryshëm për ekuipazhimin e shkollës dhe t'Internatit, si dhe per ushqim e veshëmathje të studentavet bursista; 2) Mësimi i gjuhës shqipe do të kishte prioritet mbi të gjitha landët e tjera, mundësisht me nga dy orë të përditëshme per të gjitha klasat, dhe po per këte qellim ai porositi që: 3) Studentat e kësaj shkolle nuk do të kishin nevojë të marrin pjesë n'organizimin e rinisë fashiste, siç ishte gjendja në Shqipninë e vjeter » (*Shêjzat*, XVIII, 1974 Nr. 1-10, fq. 10). Bursistat e Internatit ishin dyqind, të gjith me bursa qeveritare, dhe drejtohej nga prof. Vasil Andoni.

Në dritën e sotëshme, besoj se gjithkush e kupton randësinë e kësaj nisme historike.

Per mâ teper, po gjatë asaj kohe, themeloi, bashkë me Mustafa Krujën dhe prof. Át Zef Valentini, *Institutin e Studjimevet Shqiptare* në Tiranë, i cili përmblodh në gjinin e vet shkrimtarët e poetët mâ të njoftunit në botën Shqiptare.

Mâ vonë ai e la Ministrinë e Arsimit e kohën e punën i a kushtoi krejtësisht këtij Institutit.

Mbarimi i luftës së Dytë Botnore rishtas e gjenë prof. Koliqin tue dhanë mësime në Romë, si titullar i Kathedres s'Albanologjisë n'Universitetin Shtetnor të këtij kryeqytetit.

Me 1957, me dekret të Kryetarit të Republikës Italjane, *Kathedra e Shqipes* pranë atij Universitetit, per njohje prestizhit, u naltue n'*Institut Studjimesh Shqiptare*.

Botimet mâ të njoftunat të Koliqit në Letërsí janë: nji vëllim vjerrshash me titull *Gjurmat e Stinvet* (1934); nji vëllim novelash: *Tregtar Flamujsh* (1935).

Porse aktiviteti i tij letrar gjindet sidomos nder të përkohëshme të ndryshme, si në *Hylli i Dritës*, *Leka*, *Minerva*, *Illyrija* — që drej-

tohej nga Asim Jakova, — *Gazeta Shqiptare, Ora e Malevet* etj.; Studjime Letrare mbi dy Kolegjat shkodrane, të Jezuitëvet e të Françeskajvet, Mbi poetët Simbolista të Flandrës, Mbi Reflekset Lindore në Letërsinë Shqipe; Mbi Artin Krijimtar të Rapsodvet të Malevet të Veriut të Shqipnisë.

Nder këto vjetët e fundit botoi romanxin *Shija e bukës së mbrûme* sikurse vëllimet me nji varg poemthash në prozë: *Pasqyra e Narçizit* e *Kangjelat e Rilindjes* në poezí, *Symfonija e Shqiperet* perkthye anglisht nga *dr. Anesti Andrea*. Koliqi shkroi shum edhe në gjuhen italishte, tue përdorë edhe në këte gjuhë gjithnji thematikë shqiptare, per t'u bâ të njoftun të huejvet shpirtin e karakteristikat e shqiptarit.

Nder këto vepra spikasin: *Epica Popolare Albanese* (1937); *Poesia Popolare Albanese* (1957); *Antologia della Lirica Albanese* (1963). Menjiherë mbas botimit autori i a dhuroi të nenshkruemit kopjen me këto fjalë: « Të Përndertit ... kët perpjekje me u a paraqitë bukurisht të huejvet ânat mâ njerzore të fisit arbnuer, me dashuní, vëllaznim e nderim i a dërgon. E. K. » (*d. v.*).

Ky vëllim 320 faqesh, qe komentue, në stil e terma eprorë, si nimesë Civilizimit Mesdhetar, në nji artikull dy shtyllash në *Giornale d'Italia* (shkurt 4-5, 1964), shkrue nga nji nder klasicistat mâ të mdhajt e Europës, *Ettore Paratore*, autor e Ordinar i Letersisë Latine n'Universitetin Shtetnor të Romës. Ky pat zgjedhë e botue n'atë artikull pjesën e njij poezie origjinale të ndiemit autor, nji nder mâ të bukurat e tija, me titull *Estrema Visione* (Vegimi i Mbram). Në këte poezi lirike autori përshndet per të mbramen herë vorret e të parëvet e Atdheun, i sigurtë se nuk do ta shifte mâ per së gjallit, si ngjau:

Quando con un frullar di trepide ali
queste palpebre, stanche
di luce sempre effusa sul dolore,
mi chiuderai con un materno gesto:
mi sembrerà di risentir sul volto
il delicato tocco
d'una rama dei boschi, delle dita
vegetali dei boschi d'Albania,
dita di fresche foglie
asperse di rugiada,
le lagrime del nostro cielo, aulenti
sudor segreto della nostra terra,
unico refrigerio
al divorante ardore
che mi consuma questa argilla umana,
dove rivive e soffre
la cenere degli avi:
ti seguirò spedito,

tacita condottiera,
sopra il sentiero aereo che conduce
al limitare ceruleo
della Gran Luce che tu ci riveli;
pago se, prima di varcar le astrali
alte frontiere e sciogliermi
da questa umana argilla che m'inceppa
mi mostrerai lontano
nei cieli, fra la bruma
dei miei terrestri dì' vòlti al tramonto,
le montagne natali
alfine circonfuse da un fiammante
vel di libere aurore.

Përkthime

Prof. Koliqi zên mandej nji vend kryesisht me randësi si përkëthyesi mâ kompetent që patëm, nga italishtja e frengishtja në shqip, sikurse nga shqipja n'italishtën. Qe i pari që përballoi përkthimin e poetëvet të mdhaj, si Dante Alighieri, Petrarca, Ariosto Tasso, Foscolo, Carducci, Pascoli, D'Annunzio, Baudlaire, Maeterlinck, Verhaeren etj.

Per çdo shkrimtar krijimtar, si Koliqi, âsht mâ vështirë me sjellë në nji shqipe të kulluet e artistike të këtillë poet, se me krijue nji veper origjinale.

Ndoshta fort pak shkrimtarëvet shqiptarë u heci fati si prof. Koliqit, që të kishte si karrierë jetësore, mâ teper në diasporë, arsimin e naltë të Letravet Shqipe. Kjo ka qenë nji fatlumsi per atê, sikurse per Letersinë Shqipe. Në dritën e sotëshme, e, nëse sot e kur veprat e shkrimet e tija do të mblidhen e të botohen në tanësi, prof. Koliqi pa dyshim mbetet shkrimtari orgjinal mâ i madhi i periudhës së tij, mbrenda e jashtë Shqipnijet.

Me qinda nxânsa Arbreshë, shqiptarë e italjanë kanë ndjekë mësimet e tija n'Universitetin e Romës, dhe, si u tha mâ nalt, shum prej sish janë doktorue, tue rrahë thematike Albanologjijet. Mâ se katerdhetë theza laurimit pasunojnë me landë letrare, historike e gjuhësore arkivat e Institutit të Studjimevet Shqiptare, që ai themeloi dhe drejtoi me aq zotësi pranë Universitetit të Romës. Në këte mënyrë prof. Koliqi i ka pregatitë nji brezni të re, jashta Atdheut, Letërsisë Shqipe.

Besojmë se, sot per sot, kurrkuj nuk i bjen barra mâ e randë se Institutit të Albanologjisë n'Universitetin e Romës dhe Qendres Nderkombëtare të Studimevet Shqiptare të Palermos per botimin në tanësi të vepravet e të dorëshkrimevet letrare të prof. Koliqit. Do t'i bâjshin sherbimin mâ të madhin letërsisë e kulturës shqiptare në diasporë, dhe do t'ishte nderimi e monumenti mâ i madhi që do t'i bâjshin përkujtimit të Tij.

Prof. Koliqi qe i pari që hapi periudhën e prozës artistike të letërsisë shqipe, në të cilën zên vend mbi nominativat, adjektivi me fuqinë kromatike të piktorit, gërshetue me jehonat e ambla të muzikantit. Gjuha e tij âsht zhurmuese si prrojet e lumejt shkallmuesa; âsht si currili i kronit të kaltert e të pamêshëm që në verën rreshkuese me puhinë freskuese, grishë shtektarin me u flladitë, dhe dashtë e padashtë, me pí në tê.

Per Mikun e katerdhetë vjetëvet dhe viganin e Letravet Shqipe, mund të thomi çka la shkrue per veti poeti latin, Horaci: *Non omnis moriar.*

Mars 10, 1975

... Koliqi nuk ka pasë nevojë as e ka kapë artistin e shkrimtarin për fyti, ashtu si bâhet sod, me i thânë: Këndo për mue, o të thera! *Krejt përkundrazi Koliqi themeloi* Institutin e Studimeve Shqiptare, *qi u-bâ baza e universitetit t'ardhëshem, dërgoi kuadrat dhe pregatiti mësues nga Shqipnija e nga Kosova, e përngut, për te plotsue nevojat arsimore të krahinavet shqiptare te bashkueme me Atdhén ... A thue kanë qenë në burg, p.sh.* Sterjo Spasse *e* Nonda Bulka *o* Andrea Varfi *sepse nuk dërguen artikuj në* Shkëndín *e Koliqit! E m'ane tjeter, le t'a marrim, p.sh.* Lazer Siliqin, *i cili ankohet aq shum në mbledhjen e shkrimtarvet e te pyesim për tê: A e pat shterngue Koliqi te shkruente ne revistën e tij? Apo nuk mund të hante bukë pa shkrue? ... Po le te marrim edhe nji shembull tjetër tipik: vjershën* Stuhija *të* Filip Ndocës ... *A thue se pat kuptue Koliqi vjershën e vjershat e tjera te tija? A nuk kishte mujte me e ndalue, me e burgue? ... Krejt përkundrazi, në* Shkëndín *e Koliqit janë trajtue probleme akademike në formen mâ të lire. Fj. vjen,* prof. Namik Ressulin *e shofim se ka shkrue artikuj te gjatë me nga 15 faqe tue arsyetue pa kurrfarë ndruejtjeje e ngurrimi thezën e dialektit Toskë për t'u pranue si dialekt zyrtár, ashtu si bânte ndonji gjuhtár gege per dialektin e tij.*

Kapë kah ta kapish del ne shesh si drita e diellit se periudhën e heshtjes a të pushimit te vërtete letrár prodhues të Koliqit gjatë luftës e karakterizon përkujdesi dhe përhapja e arsimit kombtar veçanisht ne Shqipnín Ethnike. E, kur shofim se Universiteti i Prishtinës, *sod me tete fakultete do të matet me atê te Tiranes ne nji kohë të shkurtë, e se n'atê universitet ka mjaft arsimtár t'emnuem nga Koliqi gjatë luftës me sherbye në Kosovë po për gjuhën shqipe, vetem kjo duhet t'a qetsojë zemrën e Koliqit dhe t'a bâje me jetue mâ gjatë për të mbarën e letravet shqipe. Të pandërgjegjëshmit dhe të papërgjegjeshmit qi nga Tirana lëshojnë lot krokodili për Koliq e Kosovarë le të shukasin e ta ulin kryet përpara atij qi bán përgjegjësi kombtare në momente kritike.*

KOSOVARI

(*Shêjzat*, VII, 1963, nr. 5-6-7-8, *Mâj-Gusht*, faqe 235-241).

Koliqi dhe unë
(Koliqi ed io)

di Papàs EMANUELE GIORDANO

L'improvvisa morte del prof. Koliqi mi ha colpito profondamente, come del resto ha colpito tutti gli *Arbëreshë* d'Italia e del mondo, e forse anche quelli della Repubblica Popolare d'Albania.

Una Stella è scomparsa dal cielo d'Albania. In Italia, circondato dall'affetto della nutrita diaspora albanese, Egli si sentiva come nella Sua Patria. Attorno a quello splendido Luminare, noi *Arbëreshë* ci stringevamo tutti, per trovare conforto e fiducia vicendevole, quando con trepidazione si temeva dei futuri destini della nostra Patria d'origine e di noi Albanesi d'Italia.

Egli è stato, dal dopoguerra fino agli ultimi giorni della Sua vita, il Promotore di moltissime iniziative degli *Arbëreshë* in campo Albanologico, ed ha contribuito sostanzialmente al risveglio generale del quasi assopito sentimento albanese negli animi di molti *Arbëreshë*. Attorno alla sua gigantesca figura vertevano anche gli animi affranti di quasi tutti gli Albanesi dell'ultima Diaspora. Egli per loro era amico e fratello, li consigliava e assisteva con ogni sorta di aiuti. Perciò molti già disperano, dopo il crollo della Colonna centrale che sosteneva l'edificio culturale degli Albanesi e degli *Arbëreshë* dispersi nel mondo, prevedendo tempi difficili ed oscuri.

Gli *Arbëreshë* però sono dell'avviso che, con la Sua morte, si è soltanto concluso un ciclo, dei più gloriosi, della loro storia e cultura, ma un altro ciclo si aprirà. Essi sapranno riprendersi, anzi sapranno alimentare con maggior fervore il risveglio di cui si sono resi ormai coscienti, per raggiungere sempre nuovi e gloriosi traguardi. I cinque secoli della nostra permanenza in Italia ne sono la prova. Come, infatti, il De Rada seppe stimolare ed entusiasmare, in vita, i suoi contemporanei, e, dopo la Sua morte, influenzare profondamente le generazioni successive, così anche il grande Spirito di Ernest Koliqi saprà, anche dopo la Sua morte, stimolare, ispirare e guidare gli *Arbëreshë* attraverso le Sue opere ed il Suo raro esempio di abnegazione e di totale dedizione alla causa dell'ALBANESITÀ.

* * *

In questo numero speciale di *Shêjzat,* dedicato interamente alla figura e all'opera del prof. Koliqi, sarà certamente trattata nei minimi dettagli la Sua biografia; si scriverà della Sua vasta produzione letteraria; della Sua attività come Direttore dell'Istituto di Studi Albanesi e come Docente di Lingua e

Letteratura Albanese; si parlerà della Sua quasi ventennale Direzione di *Shêjzat;* del Suo impegno politico; delle Sue relazioni con i profughi Albanesi; infine si parlerà anche delle Sue relazioni con gli *Arbëreshë* d'Italia e dell'amore entusiastico che nutriva per loro.

Volendo anch'io esprimerGli la deferenza e l'amicizia che a Lui mi legava, mi soffermerò a considerare il Suo profondo attaccamento per gli *Arbëreshë* di Frascineto e di Ejanina nonché i miei personali rapporti con Lui.

Ebbi la fortuna di conoscerLo per la prima volta nel 1954, in casa di Papàs Giuseppe Ferrari, a quel tempo parroco di Frascineto, di cui il prof. Koliqi era ospite. Da allora la nostra amicizia andò vieppiù cementandosi, attraverso un intenso e cordiale rapporto epistolare e ancor più in occasione delle sue periodiche visite in Calabria. Le sue mete preferite erano generalmente Frascineto ed Ejanina, dove contava molti amici, e le Terme di Spezzano Albanese, dove riceveva degli amici *Arbëreshë,* fra cui lo spezzanese *On. Gennaro Cassiani,* Deputato al Parlamento Italiano fin dalla Prima Legislatura.

Fu in tali occasioni che composi per Lui la seguente poesia, intitolandola *Mirësevjen.* La lessi durante il pranzo che il Papàs Ferrari aveva offerto al Koliqi ed ai Suoi familiari:

Zakon të paharruarshëm ke, o Koliq,
të vish ndë prill e ndë vjesht ndë Kalabri;
mëndaj dhe sivjet Tyj të ra buniq [1]
e u zbrite këtu pe shëndet e limondi.
S'harrove bijtë e zojën bulareshë,
po i solle të njihnin këta katunde arbëreshë.

Më parë ti shkove e pive ujë Spixanë
e u prëjte te një e këndshme ftohtësi;
atjè u pé me të ndriçmin zot Kasjanë
e xure edhe si këndon ai gjonkallí! [2]
Pëstaj erdhe ndë të njohurën FRASNITË [3]
kuj papàs Sepa i bëri dhe i bën dritë.[4]

Frasnita ësht katund plotë kollocidhe,
me gurë e shurë nga ana saj më e gjera; [5]
ka ujra të ftohët, gorica e kulumbidhe,
me vreshtazit ç'burojnë t'ëmbla vera:[6]
këtu ke, o Ernest, shumë miq, si zot Sollanin [7]
e, të prasmin ndër ata, më ké mua, Jordanin!

[1] Buona sorte.

[2] *L'assiuolo* uccello notturno che canta in aprile-maggio, quando si forma la spiga del grano, e a settembre, quando si forma quella del granoturco.

[3] *Frascineto* è nota perché patria di illustri albanologi: *Domenico* e *Michele Bellusci, V. Dorsa, Bernardo Bilotta.*

[4] *Giuseppe Ferrari* da vari anni è professore di Lingua e Letteratura Albanese presso l'Università di Bari, su interessamento del prof. Koliqi.

[5] Oggi quelle rocce calcaree costituiscono la materia prima di uno dei più grandi e moderni cementifici d'Europa.

[6] Frascineto è noto anche per il pregiatissimo *Vino Pollino.*

[7] *Papàs Francesco Solano,* albanologo e autore di una grammatica albanese.

Ngushëllohu pra, o Bular, se ti s'je i vetë:
Shqipëria ësht e madhe si kjo botë;
se gjaku ynë i shprishur kudò thërret,
e lotët gjaku, thonë, se i mbleth Ynzot!
Ti gëzohmu poka, o Vëlla, mos u helmò,
me pendë e fjalë të luftosh ti mos harrò!

Kujtò dhe, i ndershmi zoti profesor,
se populli shqiptar ësht i amëshuar:
shkon koha e tanishme limonor
e Perëndia dërgon herën bekuar!
Ti gëzohmu poka, o Vëlla, mos u helmò,
me pendë e fjalë të punosh ti mos harrò!

O Zonjë e hjeshme e mikut tonë Koliq,
ndihmoje tek e rëndmja punë e tij,
levroji zën, çë lufton për liq
e të shërbenjë me zën ti m'e shtyj!
E juve, Bijtë e tij, vëllezrit e mi,
ju uroj t'i bëni nderë së buk'rës SHQIPËRI!

Frasnitë, 18 vjesht 1956

Con questa poesia intendevo non solo dare il benvenuto al prof. Koliqi ed ai Suoi familiari, ma anche sollevare il Suo sconfortato animo di profugo-esiliato.[8]

Ai due villaggi *arbëreshë* di Frascineto e di Ejanina il prof. Koliqi era legato sentimentalmente, non solo per gli amici che vi contava e per gli abitanti, ma anche per lo stesso caratteristico paesaggio collinare-montano che Gli ricordava la Sua Scutari. Nella catena del Pollino, che sovrasta a nord i due paesi, Egli ravvisava le montagne della Sua Albania, di cui aveva cantato le bellezze, la storia e la vita dei suoi eroici Malisori.[9]

Fra gli abitanti di Frascineto ed Ejanina riscontrava la tipica mentalità albanese, lo stesso culto dell'ospitalità. Questi, in verità, Lo circondarono sempre delle loro più premurose attenzioni, manifestandoGli la loro ammirazione e solidarietà. Ma ciò che più Lo affascinava di Frascineto ed Ejanina erano le *vallje* (le ridde), formate dalla più bella gioventù femminile e dalla più gagliarda gioventù maschile locale. Le ragazze vestite nel tradizionale costume albanese Gli sembravano *Regine;* il canto delle patrie rapsodie Lo estasiava.[10]

E qui vorrei esprimere una personale opinione, che risponde a verità. È vero che tutti gli italo-albanesi hanno caratteristiche comuni, derivando essi da un'unica stirpe, tuttavia il prof. Koliqi pare che abbia « scoperto » gli *Arbëreshë* per la prima volta a Frascineto ed Ejanina; gli abitanti di questi due paesetti rappresentavano per Lui tutti gli « autentici *Arbëreshë d'Italia* ». A questi ultimi

[8] E. Koliqi, *Kangjelet e Rilindjes*, Roma, Ed. *Shêjzat*, 1959; canto I, pag. 10-11; canto III, pp. 24-25.
[9] E. Koliqi, *op. cit*, canto V.
[10] E. Koliqi, *op. cit.*, canto V, pp. 32-33.

il Koliqi dedica il poemetto *Kangjelet e Rilindjes* (I Canti della Rinascita); ne fu ispirato a Frascineto.[11]

Nel canto V e VI parla apertamente di Frascineto e nel canto IV vi allude fra le righe:

Errando alla ventura ...
dopo dieci anni di logorante andare [12]
giunsi in un ceruleo vespero
a una fonte dal limpido getto.
Limpide linfe la fonte versava [13]
e accanto le stava una giovane dagli occhi limpidi
eretta come un arboscello
bianca e rosata come raggio d'aurora,
con un sorriso mite sul labbro
ma in fronte con uno sfavillio d'orgoglio,
che la indicava chiaramente
ramo d'oro di nobili radici.
Riempiendo d'acqua la giara (vucën),
la Dea parea delle fonti.[14]
— Sia lieto incontro il nostro, lieta fanciulla.
— Lieta sia la tua venuta qui, signore eletto.
— Avresti per me un sorso d'acqua?
— Quanta te ne brama il cuore.
Fece coppa la giovinetta delle rosee palme
e m'offrì da bere nel cavo delle mani.
Ed ecco, m'avvinse un potere d'incantesimo.
Al primo sorso che bevetti
sapore di conosciute sorgenti
sentii tosto in bocca.
Alte linfe dei fonti d'Albania,
in quel sapore la vostra freschezza il cuore riconobbe; [15]
al secondo sorso
cadde un velo dai miei occhi
e ravvisai nel volto della giovane

[11] E. Koliqi, *op. cit.*, canto V, pp. 32-33, vv. 1 e segg.

[12] E. Koliqi, *op. cit.*, canto IV, pp. 26-27, vv. 1-4. Siamo nell'anno 1954, decimo del suo esilio in Italia, ed il primo in cui ebbe contatto con gli *Arbëreshë* di Frascineto ed Ejanina.

[13] Sarà stata certamente una delle sorgenti d'acqua di cui è ricca la periferia dei due paesi. Note sono le gelide sorgenti del fiume Ejano, a sud di Ejanina; come anche le sorgenti del Clavaro e di Campomale. A conferma di ciò, posso confessare che molte volte il prof. Koliqi gradì recarvisi in nostra compagnia, nei pomeriggi estivi.

[14] Quella giovane, reale o ideale, doveva pur sempre essere una di quelle fiere fanciulle delle ridde di Frascineto ed Ejanina. Cfr. c. V pp. 32-33. Nel 1954 c'era ancora l'uso di andare ad attingere acqua con l'asino ed il barile al fianco.

[15] La generosità della giovane colpisce l'interlocutore come un incantesimo e ravvisa in quell'acqua il sapore delle conosciute sorgenti d'Albania: la sorbiva dal cavo delle mani di una *Arbëreshe!*

le fattezze altere e soavi
che hanno madri e sorelle da noi ...
Al terzo sorso un'istintiva domanda mi uscì di bocca:
— Di quale lignaggio discendi, fanciulla avventurata?
— Di nascita sono *Arbëreshe.*
— Ed io *Schipetaro,* nobile sorella! [16]

In quella fonte, su cui s'inchinava ...
per cinquecento anni, uomini e donne,
esuli dai lidi d'Albania
avevano rinfrescato gli occhi ...
Cosicché nel fluire dei secoli
l'acqua di quella fonte acquistò il sapore
delle acque che scaturiscono dal seno dei nostri monti.[17]
Suonò l'invito nell'antico idioma:
— Vieni, sangue nostro disperso
a riposare nella casa di mio padre.[18]
E con passo pieno di dignità,
sostenendo sul nudo braccio la giara (vucën),
mi prese con sé verso il villaggio.
Il comun sangue in fronte le splendeva,
la lingua comune sulle labbra le fioriva,
mentre ella mi guidava per i vespertini sentieri,
astro lucente dell'ospitalità,
avresti detto una Nausica albanese.[19]

Ho già detto all'inizio che il Koliqi è stato il promotore di moltissime iniziative degli *Arbëreshë* d'Italia nel campo culturale. Fra quest'ultimi annovero anche la mia persona. Infatti, anche se è vero che già molti anni prima del 1954 nutrivo l'idea di compilare un Dizionario *Arbëresh,* è pur vero che fu il prof. Koliqi nel 1956 a farmi decidere. E mentre io propendevo per una sua

[16] Il poeta, trovandosi in paese *arbëresh,* era quasi certo che quella giovane fosse albanese: nell'esprimersi in italiano, la pronuncia caratteristica svelava al poeta l'origine etnica della giovane. Nel dubbio le rivolge la domanda ed ottiene una conferma. Quanta nobile ed orgogliosa fierezza in ambedue nel proclamare l'Albanesità: *arbëreshe - schipetaro!*

[17] Se dopo 500 anni gli *Arbëreshe,* e quei di Frascineto in particolare, considerano l'Italia come una seconda Patria, perché quivi riposano le ossa dei loro padri di varie generazioni, anche le fonti e le terre sono però diventate albanesi, perché usate ed abitate da gente di stirpe albanese. A ragion quindi gli *Arbëreshe* si definiscono *italo-albanesi* hanno nel cuore Italia ed Albania.

[18] L'ospitalità è sacra per gli *Arbëreshë,* ma quella giovane non avrebbe mai rivolto l'invito ad un forestiero. Lo rivolse all'albanese perché riconosceva in lui un *fratello di sangue,* come lui la riconobbe *sorella.* Cfr. i termini: *Vëllamja* e *Motërma.*

Ancor oggi, più di sessant'anni dopo la sua morte, Karl May (1842-1912), autore di numerosi romanzi d'avventure, è uno degli scrittori più popolari dello spazio linguistico tedesco. La cifra delle edizioni delle sue opere può cimentarsi con quella delle edizioni della Bibbia, la comunità dei suoi lettori e lettrici rinchiude quasi tutte le classi d'età e tutti i ceti sociali, oltracciò un museo e l'esistenza di una « Società Karl May » fanno testimonianza della popolarità di questo scrittore, per non parlare delle traduzioni in parte autorizzate, in parte non autorizzate che hanno divulgato l'opera di Karl May anche al di là delle frontiere tedesche. Non è però soltanto il contenuto dei romanzi d'avventure di Karl May ad avvincere i lettori e le lettrici, anche il personaggio dello scrittore emana un certo fascino, malgrado o forse anche a causa della sua vita enigmatica e, per lo meno per alcuni periodi, poco chiara.

Qui però non è il luogo di pronunziarci su i segreti della vita di Karl May né d'immischiarci nelle controversie concernenti il valore etico e pedagogico dei libri di questo Sassone. Quel che c'interessa in quest'articolo è l'esaminare l'immagine degli Albanesi, disegnata da Karl May nelle sue opere « classiche ». È però consigliabile premettere che i teatri dei suoi romanzi d'avventure Karl May non li conosceva che da seconda mano, cioè da descrizioni di viaggi, traduzioni di opere orientali, carte geografiche, dizionari ecc. Non è che dopo la pubblicazione dei suoi romanzi d'avventure che gli fu dato vedere personalmente i paesi delle inesauribili azioni dei suoi eroi, nel caso nostro parti dell'Impero Ottomano. Lo spazio albanese non l'ha mai visto né sapeva le lingue parlate in oriente e nei paesi balcanici. Karl May ama però intercalare nei dialoghi dei suoi eroi frasi e formule alloglotte che in parte riproduce da dizionari e guide linguistiche, in parte però compila dilettantescamente da solo, provocando involontariamente l'ilarità dei conoscitori, tanto più che più di una volta aveva sbagliato riga o preso per traduzione di un termine una definizione più o meno prolissa (che gli dà luogo a riflessioni sulla mentalità orientale). Nei volumi « orientali » — i volumi « americani » non stanno alla discussione — l'eroe principale appare sotto il nome pseudo-arabo *Kara ben Nemsi* e Karl May, servendosi nei più casi della prima persona, s'identifica con lui, come anche nei volumi « americani » dove s'identifica coll'eroe principale *Old Shatterhand*. Il che gli procacciò il biasimo dei suoi avversari che non volevano concedergli quello che si concede ad ogni poeta, la libertà poetica che rinchiude anche il diritto di servirsi della prima persona.

Parrà forse strano che abbiamo scelto un argomento preso da una fonte appartenente agli strati inferiori della letteratura. Fa però d'uopo tenersi presente che i romanzi d'avventure di Karl May in gran parte sono responsabili dell'immagine che intere generazioni tedesche (e anche non-tedesche) si sono fatte e si fanno ancor oggi dei paesi dove si svolge l'azione dei romanzi d'avventure di Karl May, nel caso nostro dell'oriente e dei paesi balcanici. Specialmente la gioventù, infiammabile, credula e quindi facilmente seducibile, è sempre disposta a prendere per oro colato tutto quanto le danno ad intendere la letteratura del genere, il film, la televisione ecc., il che *mutatis mutandis* è vero anche per i romanzi d'avventure di Karl May. Fortunatamente però l'influenza esercitata da Karl May sulla gioventù e sugli altri lettori e lettrici non era mai negativa, contrariamente a quella dei romanzi gialli e dei films gialli in tutto il mondo, per cui per es. la critica cattolica l'ha in grande stima quale propugnatore dell'etica cristiana.

In generale Karl May distribuisce i suoi eroi e i suoi mascalzoni imparzialmente tra le varie nazioni con i cui rappresentanti l'azione dei suoi romanzi d'avventure ha a che fare. Nientedimeno non è privo di giudizi globali e generalizzazioni di casi isolati, il che però si manifesta più nei volumi « americani » che nei volumi « orientali ». Nei volumi « americani » dove l'elemento tedesco recita una parte essenziale, i « westmen » e coloni tedeschi sono sempre buoni, nobili e non di rado Sassoni, e quando un « westman » americano è buono, ha sempre sangue tedesco nelle vene, contrariamente ai « westmen » americani che in maggioranza sono mascalzoni. Quest'attegiamento non è spiegabile che con riguardo al retroscena storico: il sogno di una nazione tedesca unita da un lato, la politica sterminatrice degli Americani contro gli Indios e lo schiavismo degli Stati meridionali dall'altro lato. Per cui *Old Shatterhand,* l'eroe principale dei volumi « americani » è giurato « abolizionista » e grande amico dei pellirossa. Nei volumi « orientali », per lo meno in quei « classici », l'elemento tedesco passa in seconda linea, a primeggiare è l'invincibile *Kara ben Nemsi,* quasi l'unico tedesco tra i protagonisti. Tra i rappresentanti delle nazioni dell'Europa centrale e occidentale spiccano gli Inglesi con alcuni lords ricchissimi, generosi, magnanimi, valentissimi e sempre in cerca di avventure, ma molto ghiribizzosi, i cui capricci più di una volta provocano situazioni delicatissime, ma anche comiche. Le altre nazioni dell'Europa centrale e occidentale non sono rappresentate che sporadicamente e poco tipicamente.

Quanto alle nazioni orientali e balcaniche, Karl May nutrisce sentimenti molto differenziati, influenzati probabilmente dalle fonti da lui sfruttate. Particolarmente gli è odioso il tipo del « Levantino » in generale, e quest'antipatia lo scrittore la sfoga sugli Armeni e sui i Greci. Tra i mascalzoni principali dei volumi « orientali » figurano alcuni Armeni che oltracciò hanno abbracciato l'islam, e circa i Greci Karl May ha l'ardire di affermare che ovunque in oriente è commessa una mariuoleria, un Greco ha le mani in pasta. A più profondo esame però si vede che questi giudizi globali e quindi infondati concernono un certo tipo che naturalmente si trova in tutti i paesi del mondo: l'affarista internazionale, tipo che necessariamente forma un gruppo difficilmente definibile, ma contrastante considerevolmente col grosso della popolazione dei paesi del Vicino Oriente. Tra le grandi nazioni maomettane Karl May preferisce gli

Arabi, particolarmente i Beduini, cui attesta un'onesta sincerità, anche se un po' ruvida, mentre, come dice, la servilità dei Persiani lo disgustava. Nientedimeno è un Persiano a recitare una parte simpatica nel terzo volume « orientale ». Quanto ai Turchi, il giudizio di Karl May è determinato dalle condizioni dell'Impero Ottomano del tempo: lo scrittore deplora gli abusi nell'amministrazione, nella giurisdizione ecc., senza però mostrarsi ostile alla nazione turca stessa. Talvolta i Turchi della letteratura barocca sembrano aver fatto da padrino all'immagine turca di Karl May. La sua simpatia per le minorità dell'Impero Ottomano costringe lo scrittore a parteggiare per Curdi, Iesidi e qualche minorità cristiana contro azioni turche che però interpreta come eccessi effettuati contro la volontà e all'insaputa del Sultano da funzionari locali.

Tra le minorità favorite di Karl May spiccano gli Albanesi. È lo spazio albanese a formare il teatro dei due ultimi volumi « orientali » classici (*Durch das Land der Skipetaren e Der Schut*). Il termine *Albanese* (in tedesco: *Albaner*) non appare che di rado, Karl May preferisce i termini *Skipetar* e *Arnaut* (dal turco *Arnavut*). Nell'uso dei due termini mostra però certe inconseguenze. Lo scrittore non ignora che si tratta dello stesso popolo, sembra anche conoscere le due tribù principali, i Gheghi e i Toschi, perché in un passo parla del dialetto ghego della lingua albanese. Dei Mirditi dice che si considerano come *Arnauti liberi* (*freie Arnauten*), dal che è desumibile che il termine *Arnauten* (*Arnauti*) nel vocabolario di Karl May formi il concetto superiore per tutto il popolo albanese. Perché però differenzia in altri paesi gli *Arnauti* dagli *Skipetari?*

A mio avviso queste inconseguenze non si spiegano esclusivamente colla terminologia delle relative fonti consultate dallo scrittore. Siccome lo scrittore chiama *Arnauti* di preferenza la truppa ben nota che in tutto l'Impero Ottomano faceva certe funzioni poliziesche o parapoliziesche che, dà nell'occhio la circostanza che per questi *Arnauti* non si serva mai del termine *Skipetar* che lo scrittore riserva unicamente agli indigeni dello spazio albanese. Oltre a ciò tutto quanto dice circa questi *Arnauti* dalle funzioni poliziesche, forma un contrasto insormontabile con tutto quanto dice circa gli *Skipetari.* Come si sa, non è menomamente inaudito che un termine etnico passi nella categoria dei termini di mestiere, il che succede nei casi in cui un mestiere è esercitato prevalentemente da un gruppo etnico determinato. Ancora oggi la guardia papale la cui pittoresca divisa storica desta l'attenzione di tutti i visitatori della Eterna Città, si chiama *Guardia Svizzera,* benché in essa prestino servizio anche Italiani. In tedesco *Schweizer* (Svizzero) è il termine per il mungitore particolarmente nelle malghe alpine ed il Tedesco si serve di questo termine senza rendersi conto che originariamente si tratta di un termine etnico. In francese *Suisse* (Svizzero) è il *sagrestano* anche se non è di origine svizzera.

È presumibile che nell'Impero Ottomano il termine *Arnavut* si sia sviluppato in maniera analoga, cioè che il termine *Arnavut,* in principio usato *a potiori* per la sopranominata truppa poliziesca o parapoliziesca, sia passato nella categoria dei termini di mestiere, oramai significando tutti i membri di questa truppa senza riguardo alla provenienza etnica. Il che vuol dire che tutto quanto Karl May dice circa questi *Arnauti,* non è menomamente caratteristico per gli Albanesi in generale, ma solamente per la truppa in questione. Anche qui però lo scrittore manca di conseguenza. Ora questi *Arnauti* appaiono come

soldatesca rozza, brutale, litigiosa e perfida, ora sono descritti come una guardia da operetta. L'Aga degli Arnauti di Amadiya, città nelle montagne curde, per non citarne che un esempio preso dal secondo volume « orientale » classico, è un rodomonte in fondo inoffensivo, anzi bonario, e oltracciò un marito di stoppa, e gli *Arnauti* da lui capitanati sono tipi assolutamente innocui e ridicoli. In altri passi dei romanzi d'avventure di Karl May però gli *Arnauti* sono una masnada indisciplinata che, sia per sete di vendetta, sia per rapacità, non si arretra nemmeno dinanzi all'idea di svaligiare ed assassinare i viaggiatori stranieri affidatigli alla loro protezione. È dunque consigliabile lasciar da parte questi *Arnauti* che, come speriamo di aver mostrato, non contribuiscono niente di essenziale all'immagine degli Albanesi come appare nell'opera di Karl May.

Nelle opere di Karl May lo Skipetaro è l'Albanese per eccellenza e tra gli Skipetari spiccano i Mirditi. Senza dubbio l'immagine degli Albanesi, cioè degli Skipetari, come appare nei due ultimi volumi « orientali » classici, è determinata, per lo meno in gran parte, dall'ambiente di cui lo scrittore aveva bisogno per avvincere il lettore. Il suo giudizio è assolutamente positivo, per cui Karl May non poté decidersi di assegnare il ruolo del mascalzone principale ad uno Skipetaro. Probabilmente per questa ragione lo assegna, in maniera poco convincente, ad un Persiano sciita domiciliato a Rugova. Gli Skipetari appartenenti alla confraternita segreta dello *Schut* — l'annientamento della quale, effettuato da Kara ben Nemsi e i suoi compagni di viaggio, forma il contenuto dei sei volumi « orientali » classici — non sono criminali nel senso dello *Schut* e degli Armeni islamizzati, ma uomini di un popolo libero che cerca di conservarsi la libertà (per cui lo *Schut* camuffa la sua organizzazione da confraternita politica, cioè ribelle, ma non disonorevole). Qui Karl May tocca il problema del rapporto tra lo Stato preposto e gli interessi di un popolo vivente nella mentalità di schiatta. Più s'indebolisce l'autorità governativa, e più si manifesta la mentalità di schiatta, la schiatta essendo considerata come l'unità più alta nei rapporti organizzatori tra il genere umano. Il che è vero particolarmente per popoli non sottomessi che incompletamente ad uno Stato preposto. Questi popoli vivono secondo le proprie loro leggi che, come si capisce, nei più casi non sono conformi a quelle dello Stato preposto, causa di varie difficoltà e anche di quel che lo Stato preposto qualifica per delitto, il relativo popolo però per suo diritto.

Probabilmente per creare un certo contrasto, Karl May mette a confronto i due fuorilegge albanesi *Alagi* al Mirdita *Haydar*. Gli *Alagi* sono masnadieri rozzi e senza scrupoli, uomini esclusi dalla propria loro società, che non credono che nella forza delle loro armi. Servono allo *Schut* soltanto per il profitto. Ma anche da queste due figure negative traspare qualche elemento delle virtù albanesi. Malgrado la loro rozzezza mostrano una sorte di bonarietà, non uccidono che in combattimento e parlano dei loro colpi di mano quasi sportivamente, sono provetti e bravi lottatori che sanno benone maneggiare tanto il fucile quanto la scure. Il Mirdita Haydar però personifica tutta la cavalleria dello Skipetaro. Nell'intimo del suo cuore non ha niente contro il suo antagonista Kara ben Nemsi, anzi, lo ammira perché vede in lui, senza rendersene conto, il proprio suo ritratto se anche ingentilito. Insidia alla vita di Kara ben Nemsi non per motivi ignobili, ma perché lo costringe il codice d'onore del suo popolo

e della sua famiglia. Kara ben Nemsi ha ucciso il di lui fratello, quindi è a lui che questo codice d'onore impone il dovere della vendetta. Ma Kara ben Nemsi non ha ucciso il fratello di Haydar con premeditazione — come Old Shatterhand, anche Kara ben Nemsi non uccide che in casi dell'estrema necessità — anzi, neanche per legittima difesa. Il fratello aveva trovato la morte per la propria sua imprudenza. Haydar vuol uccidere Kara ben Nemsi, però non proditoriamente, ma in lotta aperta. Kara ben Nemsi lo vince con l'astuzia e gli ridà la libertà, benché per Haydar il dovere della vendetta continui. Quando Kara ben Nemsi gli spiega le circostanze della morte del fratello, Haydar comincia ad ondeggiare tra il dovere della vendetta e il sentimento della gratitudine, perché Kara ben Nemsi avrebbe potuto ucciderlo invece di ridargli la libertà. Finisce per sospendere la vendetta praticamente in eterno, consegnando la sua scure a Kara ben Nemsi. Quando la confraternita dello Schut idea un nuovo attentato contro Kara ben Nemsi e la di lui comitiva, Haydar rifiuta di collaborarci e resta completamente neutrale. L'atteggiamento di Haydar è assolutamente cavalleresco e rispecchia la mentalità degli Skipetari. Lo stesso atteggiamento cavalleresco si vede nel dragomanno albanese di Sir David Lindsay. Fatto prigioniero, assieme al lord inglese, dallo Schut, il dragomanno potrebbe salvarsi, mettendosi dalla parte del più forte, ma non lo fa perché per lui sarebbe disonorante rompere un contratto. Nella figura del Mirdita Haydar si concentra tutta l'immagine che Karl May si è fatto del popolo skipetaro, immagine di un popolo arcaico con tutti i lati forti e deboli di un tale. Su un piano più moderno, anche il dragomanno albanese, tipo urbano, ha conservato alcuni elementi arcaici. Il profondo rispetto della vecchiaia e dei vincoli di sangue, il codice d'ospitalità ed altri elementi positivi formano il contrappeso all'inesorabilità del ius talionis (vendetta), e tutto ciò indipendentemente della rispettiva religione. Ci sono tra questi distintivi però elementi che Karl May attribuiscse erroneamente all'islam — per lui il Mirdita Haydar è Maomettano, benché al suo tempo i Mirditi in maggioranza siano stati cristiani — per es. il *ius talionis*, ma in realtà si tratta di un elemento arcaico che quasi tutti i popoli arcaici hanno in comune.

Sommariamente si può dire che i sentimenti di Karl May verso gli Albanesi soon amichevoli al che forse ha contribuito — indipendentemente dalle fonti da lui sfruttate — la misteriosità che avvolge tutti i popoli arcaici e al cui fascino particolarmente il Tedesco si abbandona con tanta intensità.

LETTURE: *I romanzi di viaggio «orientali»* di KARL MAY, H. WOLLSCHLÄGER, KARL MAY, in *Selbstzeugnissen und Bilddokumenten* (Reinbeck 1965). K. B. (inswanger) in *Lexikon der islamischen Welt II* (Stuttgart 1974) (= Urban-Taschenbücher 200/2) pp. 158-159.

Zogjt e Shqipes, do t'a kujtojnë me mirënjoftje

Profesor Ernest Koliqi

nga TAHIR KOLGJINI

Me datë 16-1-1975, telefoni i em 275038, m'epte nji lajm pikllues me nji fjali trishtuese: « *Mbrâmë me 15-1-1975 vdiq Ernesti!* ... ».

U trondita në shpirtë. Nuk më besohej, ky lajm i kobshëm. Si vdes, nji njeri i bâshëm dhe i fortë si Ernest Koliqi? Si shêmbet, nji pyrg i madh kaq shpejt e pá paralajmim?

Njeriu, aty për aty, nuk e beson se vdes aj, të cillin e don, e çmon dhe e adhuron. Në fillim nuk e beson; por, mbas disá minutash, dorzohet. Shtërngohet me iu shtrue të vërtetës s'idhtë. Pranon se, ligja e natyrës, shtrinë për toke çdo krijesë e çdo vigâ. Për veç Zotit, tjetër kush, i përherëshëm nuk ka vazhdue.

Edhe unë, mbassi nuk pata rrugë tjetër, iu dorzova kësaj gjâme. Dhe m'u dasht me i honepsun pasojat e kësaj ndodhine.

Profesor Ernest Koliqi, mjerisht, ishte damë prej nesh.

* * *

Po. Profesor Ernest Koliqi, qé damë prej nesh; por, vetëm fizikisht. Vleftën e vet morale, nji zâ të mirë, nji ushtimë të kanëshëme, na e kishte lânun si nji kujtim t'âmbël né të gjallëve.

Mësimdhanësat t'onë, moti, tue dashtë me na rritun me nji përgatitje sakrifikimi, na këshillojshin: « *Trí kategorína, nuk vdesin. Nuk vdes:*

1) *aj, qi lên mbas vehtes trashigimtarë të dênjë e të dobishëm për rrethin e vet dhe për shoqnín njerzore;*

2) *aj, qi ndërton dhe i lên polemit vepra të dobishëme si shkollë, spital, imaret, urë, ujësjellje, krue e tjera kësodore; dhe*

3) *aj, qi i lên kombit të vet — e njerzís — vepra kulture e letërsíje dhe tjera, nga të cillat përfitojnë brezat e ardhëshëm.*

Këta, nuk vdesin; por, janë të jetueshëm gjithnji ».

Prá, Ernest Koliqi, âsht njâni prej këtyne tre vetëve, qi nuk vdes kurr. Aj, tue fillue prej moshës së njomë djaloshare e deri në mâ të mbramen frymë, përpunimet e veta kulturore e letrare ia para-

qiti botës shqiptare vandakë vandakë. Proza të bulmueme e të pasuna. Poezína t'âmbëla e mahnitëse. Shkrime të bukura mbi doket dhe zakonet e mira burrënore të racës s'onë. Përshkrime tërhjekëse mbi folklorin dhe bukurín e vendit. Përmbledhje proverbash. Anekdota, tregime ngjarjesh, mahína të hijeshëme, shenime zbavitjesh, zbukurime vallesh e llojë llojë përpunimesh. Qoftë drejt për s'drejti në gjuhën e nânës, qoftë me rrugë përkëthimi, të gjitha i thuri me nji mjeshtrí të posaçme, qi ia pat lakmí, kushdo. E, të gjitha këto, ia shtroi përpara botës shqiptare si pemë e mundimit të vet për popullin t'onë, të cillin e dashti aq fort sá nuk kursei asgjâ për tê.

Në këtë mënyrë i shërbei gjuhës; i shërbei shqipes; prá, i shërbei përgjithësisht kombit t'onë.

Nji herë, në bisedim e sipër, i pata thânun se, latinishtja dhe shqipja, janë motra me njâna tjetrën; e, prandej, e kanë gabim disá, qi nji shumicë fjalësh të shqipes i pranojnë se kanë ardhun nga latinishtja ...

M'u përgjegj: « *Motra janë; por, latinishtja, âsht rritun si nusja në qytet e shqipja, âsht rritun si nusja në katund. Prandej, iu takon shkrimtarëve të zellëshëm me e përpunue shqipen sá të munden ...* ».

Jo veç letërsís; por, i shërbei dhe historís së saj. Ishte aj, qi në *Shêjzat* e veta — me ndihmën dhe të bashkëpuntorëve të vet — ia bâni të njoftun botës se kush ishte Buzuku, Bogdani, Bardhi, De Rada, Naimi, Fishta, Asdreni, Çajupi e tjerë shkrimtarë e letrarë të vjetër dhe Shpend Bardhi, Konica, Noli, Vlora e tjerë letrarë të kohës s'onë.

Profesor Koliqi, në pikëpamje shprehjesh, kishte besim mâ tepër në Fishtën, në Shpend Bardhin dhe në Karl Gurakuqin, paçin dritë. Shpesh herë, kur folshim për Shpend Bardhin, thonte: « *Kushdo qi mund të ketë letra prej Mustafës, duhet t'i rueje këto, mbassi nji ditë mund të botohen* ».

S'kam dyshim se, mbi këtë argument, dmth. mbi veprimtarín e Ernest Koliqit në lâmën kulturore e letrare, ka me shkrue mâ gjânë e gjatë, ndonji zotní prej kolegëve ...

* * *

Profesor Koliqi, pat çmue të gjithë shkrimtarët. Dhe në mënyrë të veçantë pat inkurajue ata, qi ishin mâ të gjallë. Këtyne iu pat dhânun nji rândësí të posaçme dhe pat pranue me kënaqsí bashkëpunimin e tyne. Aj, pat tregue kujdes të madh me vûmë në dukje, veçanisht, penat e forta të Kosovës, të cillat, kishin fillue me ngállue në kopështin e njomë të shqipes porsi lalelule me ngjyra të kanëshëme e të ndryshëme. Lexonte veprat posá të botueme të tyne dhe i shqyrtonte. I reklamonte këto dhe autorët e tyne me gëzimin mâ të madh. Thuejse, për sá i përket gjuhës, nuk i mungojshin marrëdhânjet me disá pena shqiptare në Jugosllaví.

Atëherë, kur u shkatrrue Jugosllavíja në dhetë ditt e para të Prillit 1941, profesor Koliqi, ishte Ministri i Arsimit. Ishin ditt mâ t'âmbëla të jetës së vet; sepse, ishte realizue ândrra e tij e shenjtë, qi i kishte stredítun e frymzue në mbrendín e vet nji Shqipní të Vërtetë, me qênë se vëllazënt shqiptarë, ishin bashkue tok nën nji atmosferë të njêjtë. Ishte realizue nji ideal, të cillin e kishte ushqyem qysh në moshë të ré.

Në këtë kohë, Koliqi, pa pritun aspak, i kushtoi nji kujdes të jashtëzakonshëm çashtjes arsimore. Nuk mund të lêhej mbas dore, nji rasë e volitshëme. Prandej, urdhnoi mobilizim n'arsimtarët, të cillët, si misionarë, i përcolli në vendet e lirueme. S'ka gjâ, pse këta, figurojshin në kuadrat e shkollave të Shqipnís. Si këndej, si andej, shërbimi, i kushtohej arsimit shqiptár. Aj, qi duhej me gëzue shpejt e shpejt kënaqsín e arsimit, ishte elementi shqiptár i këtyne vendeve, element, të cillit i ishte mohue dhe abetari i vet nga ana e Jugosllavís Mbretnore.

Jo vetëm ushtría e luftës; por, edhe ushtría arsimtare e Shqipnís, duhej t'i shlironte vendet e veta thjeshtë shqiptare. Prá, Koliqi, përveç kësaj ushtríje, pakëputmas, dergoi në këto vende shqiptarë profesora, inspektora, organizatora, kamjona me libra, orendí shkollore dhe ndihma në të holla. I përvoli krahët si nji gigânt dhe siguroi krijimin e shkollës shqipe në vendet shqiptare si mâ sipër; shkollë, ecilla, për fat të bardhë, vazhdon regullisht edhe sod, tue shkue përpara.

Për këtë shkak, Koliqi, si duket, shkrimtarët shqiptarë në Jugosllaví i ka quejtun si pinjoj, qi në fillim i kanë pasë hapun syt në kohën e vet. Prandej, me plot arsye, duhet t'i njifet e drejta e mburrjes. Edhe sod, në mërgatën shqiptare jetojnë arsimtarë pleq e gjymëspleq prej atyne, qi Ernest Koliqi, i ka pasë ngarkue me ofiqe arsimtarësh. I njoh personalisht dhe me emën. Këta vullnetarë të pá lodhëshëm, jam i bindun se, kujtimin mâ t'âmbël të jetës së tyne, do t'a ruejnë në lidhje me këtë perjodë shërbimi. Për t'a, âsht nji dekoratë e çmueshëme morale, qi kanë të drejtë me e mbajtun me krenarí.

Kjo perjodë, ka qênë ajo mâ e âmbëla edhe për Ernest Koliqin.

Besoj, lexuesat e mij, nuk kanë me m'a kursyem lejen e tyne, në qoftë se, kam me shenue këtu nji ngjarje, ecilla, përkitas me këtë kohë, për mue ka qenë sá e lume aq edhe e rrezikshëme:

Aty kah medisi i Prillit 1941, lash Bashkín e Kuksit dhe shkova si kryetar' i Bashkís në Prizren. Fillova me shqiptarizue veprimet administrative e tjera të Bashkís. Në Prizren dhe në rrethet e tija, janë grumbullue arsimtarët shqiptarë. Medis tyne ndodhet dhe Fadil Hoxha. Ky, âsht mâ i shkathtë dhe mâ i zjarrtë se të tânë tjerët. Fillojnë mësimet dhe shfaqjet teatrale me vrullë. Tridhetegjashtë arsimtarë prej këtij grupi, nuk kanë kuadro, mbassi Tirana, nuk ka parapamë në buxhet ndonji shumë për me përballue pagesa të tilla. Kishin ramë ngusht financiarisht. Në buxhetin e Bashkís kemi

nji kapitull: *Ndihmë për arsimtarë*. Këshilli i Bashkís, plotsisht d'akord. Mârrim vendim dhe arsimtarëve, qi s'kishin kuadro, iu paguejmë rrogat nga arka e Bashkís. Mirëpo, enè nuk ishte bâmë aneksimi i këtyne vendeve. E, prandej, na shqiptarët, ndërsá këto vende i cillësojshim *vende të lirueme*, ushtrija, i cillësonte *vende t'okupueme* dhe ngulmonte qi të këndoje vetëm gjeli i saj. Në Prizren ishte divizioni « Firenze » nên komandën e gjeneralit Alberto da Ponte.

Më vjen në Bashkí, major Germani, këshilltár administrativ i komandës dhe kritikon pagimin e rrogave t'arsimtarëve. I shpjegoj çashtjen se, arsimtarët, janë në shërbimin e popullit dhe se âsht populli, aj, qi iu vete në ndihmë nepërmjet të Bashkís. Atëhere, aj, kërkon qi dhe arsimtarëve serbë t'iu paguhen rrogat. I përgjegjem se, ata duhet t'i pagueje Belgradi, mbassi i ka parashikue në buxhet. Majori, shton se, flet n'emën të komandës ushtarake. Edhe unë, shtoj se, folij n'emën të popullit ...

Erdhëm kosas me komandën. Raportuem, të dý palët, njâna tjetrën ...

Mâ në fund, gjenerali komandant, u tërhoq në dispozicion të komandës së forcave t'armatosuna në Tiranë; dhe unë, mbas njij kohe, mora urdhën për me lanun Prizrenin, tue shkue në Kukës.

Atëhere, ishte koha me punue për elementin shqiptár, edhe tue përballue rrezige ..., mbassi ushtrija, kishte në dorë gurin dhe arrën ...

Këtë ndodhinë e tregova vetëm për të dëshmue mbi përpjekjet e Koliqit.

* * *

Profesor Koliqi, kishte nji mendmbajtje shum të fortë. I radhonte ngjarjet, kur donte, edhe me imtësínat e tyne. Kur e shifte se, ndigjuesat, e shijojshin bisedën e tij, shpesh herë, e shoqnonte me buzëqeshje. Ishte me gazmend. Në mes të bisedimit, ndonji herë, bânte edhe ndonji mahí të bukur. Prandej, ndigjuesat, nuk ngopeshin me e ndigjue Koliqin. Aj, simbas shoqnís, regullonte sjelljet e veta. Me plakun folte si plak dhe me të riun folte si i rí. Të shumtën e herës, kur shoqnija, ishte e përshtatshëme, e fillonte vetë kângën, ose shoqnohej me tjerë.

Koliqi, pá dallim feje, partíje, ose krahíne dhe pá kondita e pat vûmë vehten në dispozicion të çdo shqiptari. Kur ndokush, i drejtohej për ndonji nevojë, ose për zgjidhjen e ndonjij çashtjeje të ngatrrueme, me nji herë, ia ngarkonte vehtes detyrën e përkrahjes. Vraponte me taksi, ose me ndonji auto të ndonjij tjetri, për të ndërmjetsue pranë kompetentave qi të zgjidhet níja. Jo veç për nderë; por, e quejte edhe për detyrë me i ndihmue kuejdo. Aj, nuk pritte ndonji interesë prej ndihmave, qi bânte; por, shpenzonte edhe nga xhepi.

Nga pikëpamje e bujaris, ishte i plotë, Koliqi. Vetë aj personalisht dhe familja e tij patriarkale, ka pasun mârrëdhânje — jo veç

me qytetarët e Shkodrës; por, edhe — me malsína larg e afër qytetit I ndiemi Bajram Curri, kur paska pasë qênë në Shkodër, të shumtër e kohës e paska pasë kalue në shtëpín e Koliqve. Natyrisht, aty ku ka pasë qendrue Curri, edhe okoli i malsorëve, ka pasë qenë i madh. Aty hyjshin e delshin krenë, parësí, bajraktarë e voglim. Rraheshin llojë llojë problemesh. Aty kishte kuvend burrash. Ndiqej radha e fjalës dhe pranohej arsyeja. Si ç'ishte zakoni ndër shqiptarë të vjetër. N'anë tjetër, sikurse merret vesht nga shkrimet e tija, Koliqi, edhe vetë, paska pasë shetitun në disá krahina të maleve.

Sigurisht, shfaqjet fisnike të popullsís malsore, do të kenë lânun gjurma në mbrendín e Koliqit. Por, ka dhe mâ. Kangët kreshnike të *Lahutës së Malcís*, të cillat i kishte vargjazitun Fishta me nji mjeshtrí të pa shoqe, tue përmbledhun në mënyrë mrekulluese shprehjet burrënore të malsínave të veriut, s'ka dyshim, Ernest Koliqin e kishin ndikue deri në palcë. Këtê e pohon edhe vetë në përkëthimin e njij pjese të *Lahutës* me emnin *Il Liuto delle Montagne*. Profesori, përkëthimin e vet, ia kushton Fishtës tekstualisht :

A
Padre Giorgio Fishta, —
che m'insegnò ad amare
l'Albania e le sue tradizioni, —
nel centenario della sua
nascita (1871-1971)
con inestinguibile
ammirazione di discepolo.

Si pasojë e këtyne ndikesave, profesor Koliqi, kishte bashkue dhe brumzue vetínat e qytetarit me ato të malsorit. Dhe pikërisht për këtë arsye, në poezín e vet rapsodike, mâ tepër jehojshin shprehjet fisnike të maleve t'ona.

* * *

I ndiemi, në vjetin 1955, pat ardhun në Stamboll si përfaqsues i refugjatëve internacional n'Italí. Muer pjesë në nji mbledhje t'I.R.O.-s, qi vazhdoi për shum dit në nji nga sallat e Universitetit të Stambollit. Merrshim pjesë si ndigjuesa, unë, Shemseddin Vendresha dhe i ndiemi Qazim Neki. Tue përfitue nga ajo rasë, Koliqin, na të tre, e shoqnuem për të shetitun Stambollin dhe për të shijue peshkun e vendit. Mbeti i habitun në bukurinat natyrale të Stambollit. Gryka, suka, maje, burime, det'i qetë, ujna të mirë, ishuj, Bosphor, Corne d'ore e tjera e tjera.

Nji ditë, patëm shkue në *Büyükada*, dmth. n'Ishullin e Madh. Ky ishull, âsht njâni dhe mâ i madhi prej katër ishujve të bukur të Stambollit, qi, dikuër, quheshin *Le Isole dei Principi*. Zûmë nji vend për të pimë nga nji kafe. Këtu kemi përpara pamjet e mreku-

llueshëme të tre ishujve tjerë. Profesori, ka hymë si në mendim. Unë, filloj me i dhânun shpalitje mbi panoramat, qi enden palë palë para syvet t'onë. Aj, më thotë:

«*Tahir i dashtun, lejom nji herë qi t'i tres këto, qi kam paa deri këtu e, mbasandej, po nisim në tjerat*».

Profesori, paska pasun ndërmend me shkrue nji roman, në të cillin do të përshkruejte edhe Stambollin. Prandej, paska pasë përqendrue kujdesin e vet për t'i qindisun në mendmbajtje ato, qi i patëm pamë mâ përpara.

Koliqi, në vjett e fundit, pat mbledhun shum dokumenta dhe pat sajue planin për të shkrue kujtimet e veta të mbështetuna në këta dokumenta për sá iu përket ngjarjeve politike në jetën t'onë kombëtare. Sigurisht, këto kujtime, patën me i lëshue nji dritë historís s'onë, mbassi deri tash, historianit i janë paraqitun pikëpamje të ndryshëme dhe nga prizma, qi ndryshojnë prej njâna tjetrës.

Mirëpo, mjerisht, nuk i mjaftoi, jeta.

Njeriu, sajon e Zoti, ndihmon ...

* * *

Profesor Koliqi, e mbajti të ndezunë flakën e shqiptarís, gjatë kohës së mërgimit, për të tânë shqiptarët, qi ndodhen në botën demokratike të lirë. Aj, i dha diklavë njij përpunimi kultural në dobí të kombit. Me autoritetin e tij të shquem si nji profesor e letrár dhe me simpathín e madhe, qi gëzonte, rrëmbei zêmrat e shum profesorave n'Universitetet Romë, Milano, Bari, Palermo, München e tjera. Gëzoi mirëpritjen e klerit dhe të Kolegjit Italo-Shqiptár. Gëzoi, në këtë mënyrë, dhe simpathín e pjesës intelektuale t'arbëreshëve e, sidomos, të Qendrës Internacionale për Studimet Shqiptare në Palermë.

Si përfundim i këtyne marrëdhânjeve të sinqerta, u zhvilluen mbledhje kulturore; u kremtuen festa shqiptare e lokale; u bânë kongrese; u botuen libra të ndryshëm dhe revista e, kështu, filloi nji ditë e ré në fushën e njoftuninave të ndryshëme shqiptare. U mbajt nji kontakt i përzemërtë edhe me *Vatrën* e me shqiptarë tjerë në Shtetet e Bashkueme t'Amerikës.

Mbi të gjitha, ishte revista *Shêjzat* e profesor Ernest Koliqit, ajo, qi shkëlqei rresht tetëmbëdhetë vjet me artikujt e sajë letrarë, historikë, shoqnorë e, përgjithësisht, me nji përmbajtje të zgjedhun, me nji stil të pastër e me nji frymë dashunore shqiptare. Me fjalë tjera, *Shêjzat*, ishin faqja e bardhë e profesor Koliqit, e bashkëpuntorëve të tijë dhe e nacionalistave shqiptarë në mërgim.

Ishte autoriteti dhe zotsija organizative e profesor Koliqit, qi e pat gatue këtë brumë kaq të madh.

Sod, Ernest Koliqi, pushoi. Pushoi me nderë e me burrëní, tue e mbyllun defterin e llogarís. Na, dëshrojmë qi vendin e tij t'a zâne, dikush. Na digjet zêmra, n'âsht se ndonji shqiptár tjetër, nuk do të mbërrije me ia zânun vendin. Po due me e sjellun fjalën edhe për disá smirëzez, qi Koliqin e quejshin si nji pengesë në përparimin e tyne dhe mrrolshin turinin, kur Ai, përmendej. Qé prá. Aj, nuk âsht mâ. Sheshin e kanë të lirë. Le t'i grahin dhe le t'a zavendsojnë !...

Koliqi, e vazhdoi jetën e vet, si hâna me kunorë. Hânë ishte vetë. Dhe kunorën e përbajshin, ata, qi e kishin rrethue. Ata, qi i dhanë bashkëpunimin e tyne pá ndonji kursim.

I përjetëshëm qoftë, kujtimi i Yt, Ernest ...

Istanbul, me 25 shkurt 1975

... Duket veç se Enverit keshe po i ardhka keq qi edhe prof. Koliqi nuk qenka ndalë në Shqipni me e përlavdue me shkendin e tij poetike!

Le të lejohet këtu me u-bâ nji krahasim gjithënji i thjeshtë ndërmjet veprimtaris s'Enverit si kryetar shteti e të prof. Ernest Koliqit si Minister Arsimi gjatë pushtimit fashist, mbasi fatkeqsisht edhe Koliqit i a solli puna t'urrehej e të çmohej përnjiheri.

Pikë së pari rrethanat nuk kanë si krahasohen, por, në qoftë se Koliqi piu nji gotë nga rakija *e Fashizmit t'Italis, ai i hudhi gotës* voj ullini shqiptar *qi të mos dehej, kurse Enveri e çoi brrylin me cermën* Komuniste *për dy dekada me nji* Të jam falur me dhjetë! *Kruja dhe Koliqi dhanë shum nga sedra e tyne, por u shpërblyen me bashkimin e tokave amnore shqiptare jashtë kufijvet t'Atdheut me Atdheun Nanë — çka padyshim âsht mâ tepër se nji* sedër personale; *kurse Enveri me shokë bânë kryekëput të kundërtën: për ambicjen personale, jo vetem qi falën tokat shqiptare jugosllavëvet, por edhe vranë vllaznit e tyne pa pikë mëshire tue dërgue gjeneralat Peçi e Marku në Kosovë e Mal të Zi e Maqedoni e tue bâ kështu turpin e pashembullt në historin t'onë kombtare. Koliqi e ka shfrytzue fashizmin, kurse komunizmi e ka shfrytzue Hoxhen me kompani dhe e ka bâ me këcye si karkalec prej Beligradi në Moskë e mandej në Kinë ...*

KOSOVARI

(*Shêjzat*, VII, 1963, nr. 5-6-7-8, *Mâj-Gusht* 1963, faqe 235-241).



Shêjtnija e Tij Papa Pauli i VI pret n'audjencë të veçantë Këshillin e Redaksís së Popujvet t'Europës t'udhëhequn nga comm. prof. Luciano Di Bona

S. S. Paolo VI riceve in udienza il Consiglio di Redazione dell'Enciclopedia dei Popoli d'Europa

U shue Hylli shqiptar n'Italí

Me rastin e vdekjes së të dashunit prof. dr. Ernest Koliqit

nga NIJAZI SULÇOGLU

Ernesti dhe Kosovarët

Ernesti me zêmër deshti,
Kosovarët këtu n'mërgim;
Ndihmoi me sa muejti,
I shtrengoi me përqafim.

Revisten e vet dergoi,
Kosovarëve pa ndërpré;
I dha shpresë e i nxitoi,
Të punojnë për Mëmëdhé.

Ernesti kishte kuptue,
Tragjedin e tyne n'Kosovë;
Për këtë rrinte tu' ndihmue,
T'kujtojnë me mall at' trovë.

Shkrimet e tyne botonte,
N'faqet e shêjta t'Shêjzave;
Shpesh herë edhe shkruente,
Ishte derman i zêmrave.

Kosovarët mirë dijnë,
Se si Ernesti tjetër s'kâ;
Me vjet do të psheretijnë,
Atê që nuk kthehet mâ.

Humbje e rand për Kosovarë,
Këtu në të ziun mërgim;
Si Ernesti, Burr Shqiptarë,
Rradhë gjinden n'Atdheun tim.

Në mes Arbëreshvet

Qysh atë ditë që doli,
Këtu në mërgim të shkretë;
Rrethë vehtes i përmblodhi,
Arbëreshët e vërtetë.

Arbëreshët njerz të rrallë,
Me vyrtyte shum të nalta;
U afruen shkallë-shkallë,
Me biseda shum të mjalta.

Arbëreshët përqafuen,
Atê me shum mall e zjarrë;
Për rrethë tij u tubuen,
Filizat t'njoma Shqiptáre.

Ernesti e hapi zêmrën,
U kapën dorë për dorë;
Çashtjen Shqiptare perflakën,
Nepër salla n'korridorë.

Ernesti me Arbëreshët,
Ishte bâ kushëri e Vllá;
Gjithëku ndante mendimet,
Prej tyne kurr nuk gjindesh ndâ.

Vetëm vdekja, morti i zí,
E ndau prej Arbëreshvet;
Oh! çdo t'qan nâna Shqipëri,
Birin e vet me Shqiptaret.

Në mbledhje gjuhësore

Ndër konferenca Shqiptare,
Që bâheshin shpesh n'Itali;
Apo n'tjera ndërkombtare,
N'Evropë, Amerikë, n'Azí:

Nepër këto kur ftoheshte,
Flitte me plotë admirim;
Gjuha Shqipe naltsoheshte,
Nga goja e tij pa frigim.

Ai Shqipnin shum e donte,
Shqipen e mbante mbi çdo gjâ;
Ndër mbledhje kur lavdëronte,
Ndinte vehten t'knaqun sa s'kâ.

Mandej Kosovën, Çamërin,
Këto dy Bija t'Shqipërís;
Deri n'qiell nxjerrte zanin,
Kur thurrte kangën e Lirís.

Gjuhen Shqipe admironte,
Afër saj s'bânte krahasim;
Atê mbi çdo gjâ e çmonte,
Gjatë gjithë jetes n'mergim.

Frymën e fundit kur e dhâ,
Fjalë Shqipe ishin q'shqiptoj;
Atdhén dhe njiherë m'e pâ,
Shkodrën loce e deshiroj.

Përkthimet e arta

Sot bota jonë letrare,
Me Ernestin tanë mburret,
Si Shqiptare-Kosovare,
Kanë shperthy' kufijt, muret ...

Letersin tonë Shqiptare,
Deri më djé kurrkush s'njifte;
Nga lama jonë letrare,
Bota jashtme kurrgjâ s'dinte.

Mirpo sot, koha ka ndrrue,
Me n'krye pinjojt t'Shqipërís:

Bota rrin tue shfletue,
Pendat tona të letërsis.

Me mund t'vet që ka bâ,
Ernesti në krye qendron;
Ai me vjet punoj pa prâ,
Deshti që bota t'admiroj:

Të njofë se kush jemi ná,
Kombi mâ i lasht në Ballkan;
Sot anmiqt na kanë ndá,
Kanë gjymtu' token Ilirjan.

Kumti i zí

Para këtij lajmit të zí,
Nja pêse dite përpara;
Kisha marrë nji urim t'rí,
Shkruem me shkronja t'arta.

Vallë, theme, n'ato dité,
A ishte smuet Ernesti?
Nenshkrimin e kishte çitë,
Sa bukur vetë poeti!

Mandej erdhe lajmi i zí,
Për vdekje t'tij te kobëshme;
Si lumi më shkoj vaji,
Nder faqe të perlotëshme.

Eni, Zana, bashkë t'qajmë,
Poetin e madh t'Shqipërís;

Pa Ty, né, si do të bâjmë,
O Bilbili i Arbërís?

E deshtin shum Kosovarët,
Me ma'll e me plot admirim;
Pa dallim gjithë Shqiptarët,
Në Shqipëri e në mërgim.

Natë e dité punove,
Për Atdhé t'shêjtë Shqipëri;
Kur nga goja nuk e lshove,
Kosovën bashk me Çamëri.

Krahe t'kishin Arbëreshët,
Ty në mergim, n'Itali;
Puna jote nuk harrohet,
N'Kosovë e në Shqipëri.

Plote tetëmbëdhetë vjet,
Shêjzat mrekulli drejtove;
Tash, me kê do të vazhdohet,
Revista që themelove?

Mbas teje, gjithë punuem,
S'bashku në Botën e Lirë;
Atdhén kurr nuk e larguem,
Nga mendja jonë e dlirë.

Punove hiç pa lodhëshëm,
Ishe për t'u admirue;
Fryti yt i gjithëanshëm,
Na bânë me u krenue.

Kjo humbje madhe, vigane,
Tronditi thell' mergimtarët;
Qajnë zêmrat Ilirjane,
Pa dallim t'gjithë Shqiptarët.

Mbas Ernestit

Prap ditët po na kalojnë,
Në heshtje edhe pa gëzim;
Pa Ty orët zor na shkojnë,
Plot pezme e me hidhërim.

Në gjinin tonë Shqiptarë,
Nji shprazti t'madhe ke lanë;
Në botë çdo mergimtarë,
Ofshajnë kudo që t'jenë.

Si Ernestin, nana Shqiptare,
Veshtirë mâ ka me na lé;
Aj kish zêmrën flamurtare,
Ish dishepull për Mëmëdhé.

Për jetë ka me jehue,
Ernest, zâni, emni i Yt;
Filizat kanë me këndue,
Zêmrat në vaj tue i mbyt.

Në dymujorin e vdekjes

Qé, dy muej u bâ,
Qysh prej nesh je ndâ:
Nga gjini Shqipërís,
Kosovë-Çamërís.

Kudo zemrat Shqiptare,
N'Atdhé e n'botë mbarë;
Me lot n'sy lotojmë,
Hidhrueshëm vajtojmë.

Sa mirë kur qé gjallë,
Ishe Shqiptarë n'ballë;
Dit'e natë punove,
Për Atdhé u mundove.

Dhe shkollat e para,
Q'ishin hapa t'mbara;
Kush çeli n'Kosovë,
Përhapi n'atë trovë:

Rrezet e ditunís,
Liris e mirësís;
Kur n'Kosovë s'dinte,
Kush Shqip të mësonte.

E mbas asaj kohës,
Filizat t'Kosovës;
Ndoqën udhën e mbarë,
T'pishtarit Shqiptarë.

Nga terri mitunís,
Hypen n'shkalla t'ditunís;
U banë t'larduem,
Njerz të kulturuem.

T'gjitha këto kem hua,
Njeriut t'madh lua;
Q'punoj përherë per né,
Për Kosovë e Atdhé

Dhe kur erdhë n'mërgim,
Nuk ndejti në ngujim;
Por, gjithënji punoi;
Gjuhën Shqipe zgjanoi.

Shêjzat *i themeloi,*
Tetëmbdhetë vjet drejtoi:
Me nderë e zjarre,
Plot ndjenja atdhetare.

Ai t'rijt i donte,
N'çdo mënyrë i ndihmonte:
Shpresat e Atdheut,
Nipat e Skenderbeut.

Mbas Teje nuk dihet,
Se a dot' botohet,
Mâ revista Shêjzat,
Q'na gëzonte zêmrat.

Anmiku dot' gëzohet,
Q'mâ s'dotë botohet:
Revista Shqiptare,
Dashme margaritare.

Na, mergata Shqiptare,
Rinija Kosovare;
Çdo gjâ dotë bâjmë,
Anmiqt t'gzuem t'mos lajmë.

Rrugën tande t'shtrejtë,
Për Atdhé të shêjtë;
Qysh na udhëzove
Dhe na edukove:

Pa ndâ dot' punojmë,
Atdhén dot' admirojmë;
Deri t'vazhdon kjo jetë,
Në mërgim të shkretë.

Nga ti zêmër marrim,
N'ndihmë kërkend s'thrrasim;
Rruga na âsht mbushë,
Plot me lule ndër fushë.

Këto lule q'po çelin,
Aromën s'e mëshefin;
Shqiptarët e vertetë,
Kanë mbjedhë n'ket jetë.

Mbjedhsin e kerkojmë,
Q'n'dhâ shije t'shijojmë;
T'shohim me sy vetë,
Sa shtrejtë âsht kjo jetë.

Mërgata Shqiptare,
Kulluetja Kosovare;
Me vjet' edhe vjetë,
T'qajmë Ty për jetë.

Nga zêmra s'dote nxjerrim,
Emnin Tand dot' përmendim;
Shqiptarin e vertetë,
Admirojmë për jetë.

N'filiza Kosovarë,
Në Atdhé Shqiptarë,
Fama Jote dot' rrnon,
Deri sa jeta t'vazhdon.

Lo studio dei problemi etnici e delle minoranze

di LEO MAGNINO

« Dato che il diritto come esigenza universale di civiltà debba esistere — scriveva più di un secolo fa Pasquale Stanislao Mancini — dovrà esistere non solo per gli uomini, ma anche per le Nazioni, che formano l'unità primitiva, la *monade* della grande famiglia umana. Da ciò ne deriva quale fondamento del diritto internazionale, il principio della nazionalità, ossia di quel complesso di elementi naturali e sociali, che sono la razza, la lingua, le costumanze, le leggi, la storia e la religione, e dell'unico elemento morale che è la coscienza della nazionalità, cioè il sentimento che le nazioni acquistano da se medesime e che le rendono capaci di costituirsi al di dentro e di manifestarsi al di fuori ».

In definitiva dunque una Nazione è, per il Mancini, una società naturale di uomini conformati a comunanza di vita e di coscienza civile da unità di territorio, di costumi e di lingua.

Ne consegue pertanto che ogni Nazione ha il diritto sacro e inviolabile all'esercizio della propria libertà finché si mantenga innocuo alla libertà egualmente legittima delle altre Nazioni. E perciò il diritto di nazionalità non è che la stessa libertà dell'individuo estesa al comune sviluppo dell'aggregato organico degli individui che formano la Nazione. Questi diritti che derivano spontaneamente e necessariamente dal fatto della nazionalità, senza che l'artificio d'alcun patto politico ne sia la efficiente causa, hanno poi una doppia maniera essenziale di manifestazione: la libera costituzione interna della Nazione, la sua indipendenza verso le altre Nazioni.

Ora proprio in questo diritto del libero ed armonico sviluppo delle nazionalità risiede, secondo il Mancini, la radice e il fondamento vero e primo di tutti gli altri diritti fra le genti, anzi il loro naturale compendio.

Gli oppositori di Pasquale Stanislao Mancini ebbero a ribattere che questa dottrina propugnava l'egoismo particolare e l'isolamento delle Nazioni. Si presumeva insomma che la *Scuola* del Mancini rappresentasse non già la nazionalità vera e propria, ma la sua degenerazione, ossia qualcosa come ciò che fu poi il nazionalismo imperialista o, con parola più appropriata, lo sciovinismo.

Al contrario, la dottrina del Mancini, con la rivendicazione e la tutela dei diritti di tutte le Nazioni, mira proprio al fine supremo dell'armonia tra le Nazioni: basti dire che il Mancini alla formula di Kant relativa al diritto interno (« coesistenza ed accordo della libertà di tutti gli uomini ») fece corrispondere in ordine al diritto internazionale la dottrina della « coesistenza e l'accordo delle nazionalità libere di tutti i popoli ».

Ne deriva la necessità dello studio dei problemi etnici e delle nazionalità per potere meglio individuare la consistenza stessa dei vari Stati che compongono il mondo abitato e per poter meglio individuare la esistenza dei vari gruppi etnici e delle minoranze che vivono nell'ambito di ciascuno Stato, tenendo ben presente che la vita stessa del gruppo etnico è ciò che completa realmente l'individuo e gli conferisce una propria personalità.

Lo studio dei problemi etnici può assumere diversi aspetti: i principali sono quelli di ordine prettamente scientifico o etnografico, quelli di ordine sociale e infine quelli di ordine politico. Dall'attento esame degli elementi costitutivi dei differenti complessi etnici si possono determinare le caratteristiche psicologiche, razziali e sociali che contraddistinguono ciascun popolo, in una parola attraverso l'« etnia » si può studiare la composizione stessa dei singoli Stati.

Inoltre, attraverso un più approfondito esame dei singoli problemi etnici, e in particolare di quelli dell'Europa centro-orientale, e dalla conseguente soluzione dei dissensi etnici che fino ad oggi hanno reso assai difficile la pacifica convivenza delle varie popolazioni stanziate in Europa come in Africa, o in Asia e negli altri continenti, si può trovare la *chiave* per risolvere pacificamente e in modo definitivo, anche dal punto di vista politico, il problema della convivenza dei popoli.

Non dobbiamo dimenticare che a partire dallo scorso secolo alla radice di tutte le guerre che si sono succedute con ritmo impressionante in Europa e oggi imperversano in altri Continenti, troviamo sempre la insoluta questione delle nazionalità e delle minoranze, intimamente connessa a quella dei problemi etnici e da questa determinata.

La storia della protezione di quelle persone che, sebbene suddite dello Stato in cui abitano, sono di razza, di lingua o di religione differenti da quelle della maggioranza degli altri sudditi del Paese, si confonde con la storia stessa dell'umanità, nei suoi sforzi incessanti per raggiungere quelle libertà che, confusamente intravviste e in parte anche ottenute nei secoli precedenti, sono state solennemente proclamate per la prima volta nella « Dichiarazione dei Diritti dell'Uomo e dei Cittadini » durante la Rivoluzione Francese e, più tardi, riaffermate dalla « Dichiarazione dei Diritti dell'Uomo » adottata dall'Assemblea delle Nazioni Unite il 10 dicembre 1948.

Dapprima le minoranze furono protette soltanto da norme interne dello Stato, poi ottennero più sicure garanzie e lo Stato assunse anche impegni internazionali a loro favore.

Le persone di razza, di lingua o di religione differenti da quelle dello Stato in cui si recavano ad abitare, godettero fin dall'antichità una certa protezione che, misticizzata, divenne un obbligo sacro presso taluni popoli e si credette financo che la stessa Divinità proteggesse gli stranieri.

Questa protezione di carattere interno, affidata all'arbitrio dello Stato ospite, si trasformò, col volgere del tempo, anche in una protezione di carattere pubblico, quando i Sovrani ottomani permisero agli stranieri che venivano nelle loro terre di servirsi delle proprie leggi: queste concessioni divennero poi le cosiddette « capitolazioni » straniere, le quali, sorte dapprima per la benevo-

lenza dei Sovrani orientali, vennero poi richieste come diritto dagli Stati occidentali.

Genova, Amalfi, Pisa, Venezia ottenevano « capitolazioni » a favore dei loro sudditi dagli Imperatori d'Oriente e dai Sultani turchi, prima ancora che Francesco I ottenesse nel 1535 la prima « capitolazione » di carattere generale e internazionale.

La protezione delle minoranze religiose è affermata dai documenti sulla tolleranza religiosa e il Trattato di Westfalia del 1648 conferma gli accordi registrati da tutti i Trattati precedenti, relativi ai Regolamenti delle diverse religioni della *Riforma*.

Nei principali accordi e trattati stipulati nel sec. XIX si afferma però per la prima volta con carattere generale la protezione delle minoranze religiose e si stabiliscono i primi principî anche sulla protezione delle minoranze di lingua e di razza. Così nel Congresso di Vienna l'art. 1 dell'Atto finale del 9 giugno 1815 garantiva ai Polacchi sudditi dell'Impero russo, dell'Impero austro-ungarico e della Prussia una rappresentanza vera e propria e istituzioni nazionali: l'Inghilterra e la Francia a più riprese intervennero perché tali norme fossero osservate presso l'Imperatore di Russia.

Nella Conferenza di Londra del 1830 nasce una consuetudine che, ripresa negli ulteriori congressi internazionali, è stata poi adottata per la risoluzione del problema delle minoranze dopo la prima guerra mondiale alla Conferenza della Pace di Parigi. La Francia chiese allora alla Grecia, all'atto della sua costituzione, garanzie precise per i cattolici e la Grecia si impegnò ad accordare i diritti politici a tutti i suoi sudditi, senza distinzione alcuna in riguardo alla loro religione.

Gli Stati occidentali vengono così a condizionare il riconoscimento di Stati di nuova formazione ad alcune premesse, tra cui quella di assumere precisi impegni per le minoranze etniche stabilite nei territori che vengono a far parte del nuovo Stato.

Nel Congresso di Berlino del 1878 questi principî vengono nuovamente affermati ed essi saranno poi largamente elaborati nella Conferenza della Pace, che stabilisce che qualsiasi Stato voglia entrare a far parte della grande famiglia europea, allo stesso livello degli altri Stati, deve riconoscere quei principî che sono alla base dell'organizzazione sociale di tutti gli Stati d'Europa.

Il riconoscimento della sistemazione delle minoranze è solennemente sancito nel Trattato di Versailles negli art. 86 e 93, i quali stabiliscono che la Cecoslovacchia e la Polonia si impegnano ad accettare le disposizioni che le Potenze alleate e associate giudicheranno necessarie per proteggere in quegli Stati gli interessi degli abitanti che differiscono dalla maggioranza della popolazione per razza, lingua o religione.

Il Trattato tra le Potenze Alleate e la Polonia, stipulato in pari data con il Trattato di Versailles nel 1919, assume una particolare importanza, perché contiene quei principî che sono il fondamento di tutti i Trattati conclusi in seguito tra le grandi Potenze alleate e associate e i nuovi Stati, e che vanno sotto il nome di « trattati per le minoranze ».

Fissate alcune garanzie per le minoranze, prima considerate individualmente e poi da un punto di vista più largo, ispirandosi al principio di mantenere vivo l'elemento distintivo delle minoranze stesse e assicurate poi queste garanzie da una disposizione di indole costituzionale e un'altra di indole internazionale, si è avuto uno schema di trattato-tipo, che con le variazioni a seconda delle diverse condizioni etnografiche e geografiche dei singoli Stati, è stato adotttao anche sotto forma di dichiarazione, ovunque si presentasse la questione delle minoranze.

Bisogna dire però che i riconoscimenti validi egli li ha avuti. I due grandi poeti dell'epoca, Fishta e Mjedja, così lontani da lui nella concezione letteraria, gli concessero la loro stima e il loro affetto ...

... Più interessante ancora, quello che egli fece da ministro della Pubblica Istruzione per l'apertura delle scuole albanesi nella Kossova dove vi è tuttora giudicato uno degli avvenimenti storici più importanti e più decisivi per l'albanismo kossovaro.

ANTONINO GUZZETTA, *Ernesto Koliqi, un poeta sociale,* fascicolo primo, in *Introduzione,* pp. 5-14, *Centro Internazionale di Studi Albanesi,* Palermo, n. 15, Tipografia Missioni Estere, Milano 1968.

Kujtimit të Hilushit

nga **MIKU I TIJ LETRAR**

Me folë rreth vleftave estetike asht vështirë. Si mund t'u rrijnë përkundruell mendimet tona, që janë të kufizueme rrebtsisht prej kufijve ideologjikë, kulturalë a egocentrikë, vleftave që synojnë të jenë të përjetshme? Me nji fjalë, kritika ndaj artit rrin në relacion si çasti me amshimin.

Ndonjiherë paraqiten momente të volitshme historike kur kritika mbushet me ideale, largpamsi, zemërgjansi e fisniki dhe, e endun sish, fjala e saj fiton dishka nga e përjetshmja. Por a mund të thuhet sot, për kohën tonë, se ofron rasë të tillë? Të zhytun në detin e absurdit e të ligsisë, të dhunës e të profitit, qenja e individit shtërngohet të struket, të mbyllet në vetvete — jo në kullën e fildishtë, ku me e gjetë të lumen! po në kullën e ankthit, të frigës së pandërpreme, në kullën e Kafkës, mbrenda mureve të së cilës endemi si bishë e trembun për egzistencën tonë biologjike — i vetmi kujdes që na mbetet mbas dështimit tragjik të egzistencës shoqnore.

Si me folë për *Hilushin* sot kritika shqiptare kur nji pjesë e saj vuen prej paragjykimeve qesharake (se politika asht veprimtarija kryesore njerzore, vet mbretnesha që mban nën kambë të gjitha veprimtaritë tjera — artin, moralin, shkencën), ose kur pjesa tjetër e saj asht gjithashtu e njianshme tue vuejtë prej mallit për tokën e lanë a kur nji pjesë tjetër, e tronditun me vdekjen e Tij, me humbjen e mikut të shtrejt, flet me zemër pezull, me fjalë të përlotuna?

Megjithate, pa marrë parasysh taborret e përmenduna, mund t'i përmbledhim karakteristikat kryesore të veprimtarisë letrare-kulturore të *Hilushit* në nji si repetitorijum të historisë sonë letrare:

Pa ua vu veshin rrethanave ekstreme shoqnore, në të cilat i ra për hise me jetue, me nji konsekvencë e kontinuitet të rrallë, ndërtoi nji aspekt të tanë, të randsishëm, jo vetëm kundrimi po edhe krijimi të kulturës sonë.

Në letërsi krijoi stilin e posaçëm — *koliqjan* t'a quejmë tashma pa ngurrim — i cili në epiko-lirikën e Tij asht nji shartim i klasikës greke me freskinë e kohës, kur asht *lirik* ngjan me shushuritjen e luleve të bardha pranverore, mbushun përplot me vesë e dritë. Kur asht *polemik*, përshkohet me qetsinë atnore që s'turbullohet me lajthitjet e fëmijve të vegjël.

Dhe përderisa Fishta na mëson e na përgatit të përvetsojmë fatin tragjik-heroik, të pajtohemi me te, me ndjenjen e therorzimit si domosdoshmëni të çastit historik, *Hilushi* na pajton me të bukurën, dhe sado që tragjika historike, nacionale e sociale s'ka se si mos të dominojë në veprën e Tij, ajo paraqitet në nji tabllo t'argjantë, plot me ornamente mrekulluese. Në përgjithsi, vepra e *Hilushit* mund të cilsohet si *ornament i jetës* — si ornament, jo në kuptimin e sekondaritetit, po si nji përpjekje e zbukurimit të jetës, fisnikimit të saj.

Në punimet kritike-letrare, *Hilushi* përpiqet të pajtojë traditën me të tashmen tue pikatun e tue theksue me të drejt nji vazhdimsi veprimi. Ajo vazhdimsi egziston dhe Ai don të na bajë të vetdijshëm për këtë gja. Kur shkruejmë se *egziston* — kemi parasysh veprat e Kadaresë, Camajt e të R. Kelmendit me shokë të pakë e jo epigonat tjerë, që veprojnë të shtyem prej komplekseve vetanake a interesit politik e ideologjik. Dhuna si raport karakteristik fatkeq i kohës, na ka lanë me behane : deri edhe në botën e artit përpiqemi të hyjmë me anë të saj.

Gjuha e Tij asht kapitull në vete. E lindun nga të ndeshunit ndërmjet shkollës simboliste, prirjes e dashunisë dhe mallit të Tij për te, e përdorun me mjeshtri, e zgjedhun dhe e pastër, ajo mbetet modeli i gegnishtes letrare.

Hilushi asht shembulli ma fatlum në letërsinë tonë në të cilin *etika* dhe *estetika* përfaqsohen në mënyrë të barabartë. Me qenë vetëm *estet* në shkrimet kushtue vendit dhe kohës sonë, do të thotë me qenë jehonë e zbehtë e ndikimeve të shkollave të ndryshme letrare *l'art pour l'artiste*. Me qenë vetëm *etik* (ose kryesisht etik) në shkrime, do të thotë se ke qëllim të mirë, por jo edhe mundsi të formojsh emën në letërsi. Me qenë *estet* dhe *etik* ... por i tillë ka qenë vetëm *Hilushi*.

Prap mbi artin. Sado që krahasimet çalojnë, megjithate artin mund t'a marrim si nji pasqyrë mbi të cilën kohnat përkulen që të njofin fytyrën e vet, të shofin synimet, dëshirat e veta. Dhe tue qenë se kohnat s'janë identike ndërmjet veti, arti kështu ruen vitalitetin dhe aktualitetin e vet.

Mbi artin e Hilushit. Shka kërkojmë sot ne prej tij? Të rraskapitun nga pesha e historisë, të randuem prej dyshimit e zhgënjesës, të mneruem prej shfaqjeve të panumërta të së mbrapshtës, para së gjithash prej *Hilushit* kërkojmë të na sigurojë se a ka kuptim egzistenca jonë kombtare, a kemi tipare kurajuese që e përcaktojnë qenjen tonë si komb.

Në nji poezi të *Gjurmave të Stinve* Hilushi shkruen :

> « ... *mjaftoi vetvetes, gjêj mâ t'madhën ande*
> *n' kângën kumbore qi mbi buz' t'lulzon* ».

Tue u nisë prej përvojës se çdo ideal kolektiv mund të jetë i shpërdorun e i dyshimt, Poeti këshillon formimin e nji ekuilibri vetanak, në të cilin duhet të gjindet forca dhe vullneti për veprim.

« Kur kombi bje n'humbnerë,
kur vuen polêmi i mjerë
kur shkelen doke e lterë
kur enden kombet varg
Ai nuk âsht larg ... » (Ai kthen)

« Por ... hynit ... s'duen qi t'm'shkojë n'vend dishiri
dy herë e mâ me dekë për ty, Atdhé! » (Th. Gërmënji)

Me këto citate po e dëshmoj gabimin e pafalshëm, të cilit kritika s'mund t'i shmanget : tansitë plot jetë t'i shndërrojë në copa të pashpirta. Mendoj se vepra e *Hilushit* s'mund të citohet dhe spjegohet e analizohet me vështirësi. Ajo mbetet nji gjallesë estetike që s'duron çansim dhe kufij racionalë. Kohë mbas kohe mundemi vetëm të hetojmë në te përgjegjjen që na duhet. Pikrisht nga ky aspekt deshta të ilustroj me ato pak vargje se arti i *Hilushit* ngushllon, jep zemër, forcon besimin. Për me qenë ky funksjon ende mâ i ditës, duhet të kujtojmë edhe përvojën e pasun jetsore të Tij, nji përvojë që ngërthen në vete ekstremitete ma tepër se të ashpra. Ekstremitetet e tilla mund të ndikojnë shum keq në personalitetin e njeriut, sa edhe të humbet besimi në jetë, në mundsinë për komunikim. Gjeniu njifet shi në këto rasa, tue mos e humbë torruanë, besimin dhe forcën e veprimit.

Për momentin e tanishëm shoqnor, *Hilushi* [1] gjithashtu mbetet shembull i rrallë : po heshtim me decenje para artit të Tij, tue diftue kështu papjekuninë tonë kulturore dhe papërgjegjsinë historike.

Por, kur të shfryhemi prej mllefeve politike e prej gjakimeve ideologjike — në qoftë se e don fati e deri atëherë mbesim njerz me sedër, me dinjitet — po them, atëherë patjetër do t'i kthehemi *Zanës së Hilushit*, e cila do të na përqafojë me mallë tue përshpëritë me ngashrim : « Unë kam pritë me nji durim që ka qenë ma torturues se akti i krijimit, por ... po ju fali gabimin ! »

Por, nëse Zana e Tij na e fal gabimin, a mund t'i a falim ne vetvetes? Po dyshoj në legjendën mbi Kthimin e djalit plangprishës ...

Fror, 1975

[1] *Hilushi* ose *Hilush Vilza* ishin pseudonime që përdorte Koliqi.



Prof. Koliqi me proff. Giuseppe Schirò e Mircea Popescu
Prof. Koliqi con i Colleghi Schirò e Popescu



Graz: *Koliqi me prof. Krist Malokin dhe me prof. Martin Camaj*
Koliqi con i proff. Maloki e Camaj

Ricordo di Ernesto Koliqi

di VINCENZO CHIODI

Quando Emilio Tavolaro, con voce che tradiva la commozione, mi comunicò che Ernest Koliqi era morto, nel profondo sconforto per il triste evento pensai che se i figli perdevano il Padre, il mondo *arbresh* perdeva l'animatore di tutte le più nobili iniziative tese a far risorgere l'amore e l'interesse per le tradizioni e la cultura albanese sopite colla scomparsa dei primi grandi assertori.

Resta la Sua memoria e la Sua ponderosa opera di letterato, poeta, esegeta e critico profondo, come punto di approdo per chi conserva e nutre amore per le tradizioni e la cultura albanese.

Egli veniva spesso da noi colla passione del profugo che approda in lido amico. E ci parlava della sua Patria sfortunata, del suo mondo letterario, delle sue ricerche, dei suoi propositi. Noi stavamo ad ascoltarlo rapiti dalla profondità del suo ingegno, della sua cultura, del suo amore per tutto ciò che sa di albanesità.

Ora Egli non c'è più; ma rimarrà vivo in noi che lo stimammo e lo amammo, il ricordo e la riconoscenza.

... Posá u dridh kah lindja brezi i qiellit dhe agimi i çeli mbi tê syt vezullorë, të tre poetënt dolën s'bashku. Në mâ të parin vend, ku daheshin udhat kryq, u ndalen e shpallen me zâ të bashkuem:

— Besojmë në Shqipní dhe në vërtytet e mshefta qi ruen gjaku illyro-thrak i bijve të saj.

Besojmë në misjonin e naltë qi Perendija, si çdo kombit në botë, i shênjoi edhe kombit të vogël shqiptar, mot e sot e në vallen e shekujve të palindun.

Besojmë në vëllaznimin e madh të Shqiptarvet qi tue u forcue ka me i falun fisit t'onë agime mâ të drejta.

Besojmë në punën e Shqiptarvet të vëllaznuem e në lumnín qi ká për t'i sjellë kombit parmenda e bulkut, veli i detarit, penda e dijetarit, kullma e farkatarit, buza e poetit, spata e druvarit, mësimi i fetarit, kur këto të këvizin e të kumbojnë tue veprue n'emnat e ngjitun e të pandám të Perendís e të Shqipnís.

Besojmë në fisnikín e gojdhânave stërgjyshore dhe në lulzimin e rí të këtyne ndër breznina qi ecin prej territ kah drita.

Besojmë në Flàmur t'onë dhe në frytin e vuejtjeve qi për Tê u bajten, në dobín e gjakut qi për Tê u derdh.

Besojmë në drejtësín vëllaznore qi Flàmuri i Shqipnís ka me sugurue and'e kand n'at tokë ku na përkundi në djep kanga e nji nâne arbnore dhe në gjí të së cilës shpresojmë me u dhânë pushim këtyne eshtnave të lodhun.

ERNEST KOLIQI, *Symfonija e Shqipevet*

Kultura dhe politika e Koliqit

nga **HALIM BEGEJA**

Dëshira me shqyptue dy fjalë mbi arkivol të Koliqit

Ernest i pazavendësueshëm!

I gjunjëzuem përpara arkivolit Tand do t'i thojsha këto fjalë, që dalin nga zemra e eme, tepër e prekun për humbjen Tande të kobëshme për mbarë popullin Shqiptar sot dhe për të gjitha generatat e ardhëshme të saja.

Fatkeqësisht e humba veshkjen që më dha vllau Jusuf dhe kështu iu shtruesh edhe njiherë maqinës për të kullue gjakun. E kjo duhet kalue dy tri herë në javë, ndryshe jeta e eme nuk mund të vazhdoi.

Bash dy ditë përpara se Ti të na lejsh si jetima nëpër rrugët e diasporës shqiptare, po shetisnja në vetmín t'eme, e përpara shtëpís i thash vehtes: « Ah, sa fatkeq paskam qenë që do të shtërngohem me kalue jetën t'eme mbrenda murëve të New York-ut » dhe, menjiherë, m'erdhi në mende si vetëtimë dhe thash: « Po sikur të më vdesi ndonji mik apo shok i largët, si do i bahet halli tashti, që nuk kam me pasë mundësí me i shkue pranë arkivolit dhe me i dhanë përshëndetjen e fundit? »

Menjiherë sikur të folësha me vet Perëndín që po pregatiste, si duket, marrjen Tande nëpër qiellnat e amshueshme, më shkoi mendja dhe goja tek emni i Yt! Në nji çast të shpejt e shkunda vehten e thash: « A mos të hiku mendja, more Halim? » E ndërrova me inat at mendim dhe e harrova at andërr me sy të çelun. Mirëpo jo!, sepse si ndonji rrufé rá në trunin t'em, mbas dy ditëve kur më telefonuen e më lajmuen se Ti, Ernest, e dhé frymën e fundit n'orën 20,15' me 15 janar 1975, ditë fatkeqe për të gjithë né. Pra, paralajmimi kish qenë hyjnuer!

Ernest! *Në paqe pushofsh!*

Dy fjalë për Ernest Koliqin

Prof. Ernest Koliqi kje nji nga shërbestarët e pakët të denjë të popullit shqiptar. Shërbestar i kombit, i flakët, i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i intelektualizmës shqiptare e i popullit shqiptar qysh në rinín e Tij.

Shkolla klasike e Jezuitve pregatiti nji Koliq të kalibrit të naltë intelektual dhe nji djalë të denjë nga çdo pikpamje. Jetën e Tij, ditë e natë, e vuni, pa kondita, në shërbim të së mirës së përgjithëshme. Vdiq duke derdhë djersë e mundim të papërshkrueshëm për nderimin e mprojtjen e racës shqiptare. Patriot i drejtë dhe i ndershëm, që kish për parim : *Le të rrnojë Shqypnija edhe pa mue.*

Prof. Ernest Koliqi kje nji mjeshtër i rrallë për të mbjellë farën e kulturës në popullin Shqiptar e si i tillë, qysh ka kohë, kje deklarue si i vetmi *dritëndriçues dhe dritëdhanës kulture*, jo vetëm për racën t'onë, por edhe për racat e tjera të botës, e sidomos për ata që patën fatin të ndjekin shkrimet e Tija në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera.

Koliqi ka qenë e do të mbetet nji gjigant i leteraturës shqipe. Do të duhen, ndoshta dhetra e dhetra vjetësh për me zavendësue boshllëkun që Ai ka lanë. Ishte nji enciklopedist i kalibrit të Sami Frashërit. Me dashuninë dhe madhështinë e Tij, na pruni në gjinin t'onë Vlleznit Arbreshë me të cilët sot jemi afër siç duhet të kishim qenë në kohën e Skënderbeut.

Koliqi hapi dhe përkrahu shkollat shqipe në Kosovë e sot prej këtyne shkollave shofim se kanë dalë e vijojnë me dalë të rij të cilvet u shijojmë me kënaqësi shkrimet e frytet e duhuna.

Në fushën politike të këtij mërgimi fatkeq, kje nji ndërtues, lutës dhe puntuer i zellshëm për bashkimin kombëtar antikomunist.

Të përshkruejsh Koliqin si shkrimtar do të duheshin volume të vazhdueshme m'e paraqitë; padyshim historjani i nesërm i gjuhës e letërsís shqipe do t'a ketë parasysh. Sot na mjafton të thomi se shkrimet e Koliqit komentohen e studjohen nëpër kathedrat e universiteteve të shum vendeve. E, pra, nderim mâ të madh a ka për racën shqiptare që i dhuroi popullit Shqiptar nji pjellë, të nderueme edhe nga bota e huej?

Me prekursorët e Rilindjes Kombëtare Koliqi dallohet dhe zen vendin e parë si frymëzues i pazavendësueshëm i mbjelljes së farës së kulturës. Si patriot i padiskutueshëm, më mjafton të përmendi :

A) *Dr. Rexhep Krasniqi*, n'artikullin botue në *Shêjzat* (nr. 1-10, Vj. XVIII, faqe 7-11) shkruen : Kur u emnuesh Drejtuer i Shkollës Shqipe në Prishtinë, prof. Koliqi (Ministër i Arsimit n'at kohë), *ndër të tjera udhëzime, shquejti tri pika me randësi të posaçme: 1) Ministria e Arësimit ven bujarisht në dispozicion mjete financiare dhe material të ndryshëm për ekuipazhimin e shkollës dhe të Internatit, sidhe për ushqim e veshëmbathje të studentave bursistë; 2) Mësimi i gjuhës shqipe do të kishte prioritetin mbi të gjitha landët e tjera, mundësisht, me nga dy orë të përditëshme për të gjitha klasat, dhe po për ket qellim ai porositi që 3) Studentat e kësaj shkolle nuk do të kishin nevojë të marrin pjesë në organizmin e rinisë fashiste, siç ishte gjendja në Shqipninë e vjetër* ».

B) *Conte Galeazzo Ciano*, ish minisër i Punvet të Jashtme t'Italís në ditarin e tij *Diario 1939-1943*, Volume I : 1939-1940, Riz-

zoli Editore, Milano 1963, në faqen 150, shkruen : « *Ricevo Koliqi, col quale parliamo del problema cossovaro e della Ciamuria. Redigerà un pro-memoria programma. Dò queste istruzioni per l'azione che dovremo svolgere in tre tempi successivi: 1) azione di propaganda generica a base culturale e religiosa; 2) organizzazione pubblica sulle stesse basi; 3) organizzazione militare clandestina per il momento in cui la ineritabile crisi jugoslava verrà a prodursi* ». Ky pohim vërteton dashunín e Koliqit për Kombin Shqiptar dhe dalin të kjarta provat se Ai ishte nji puntuer i vemendëshëm për realizimin e kufijve natyrorë të Shqipnis Ethnike.

Me fjalë të tjera, nga çdo pikpamje që t'a kapish jetën e Koliqit, të del përpara, jo vetëm si gjenjal i kulturës, por edhe si patriot i shkëlqyeshëm. Sa herë që të tjerë, ndër bisedime i nepshin adjektiva për me vû në pah veprimtarín e Tij, Ai, edhe pse i meritonte, prap me mirësinë njerzore mundohesh që ata adjektiva meritash t'i nepeshin Rinisë shqiptare sepse *vetëm Rinija shqiptare* — thoshte — *do të jetë ajo që do t'a mbajë të gjallë racën shqiptare.* E në fakt për ketë Riní vazhdoi punën derisa dha shpirtin.

Ata që e kanë njoftë për së afërmi e dijnë fare mirë se sa i pajisun ishte me zakonet burrnore të fisit shqiptar dhe, n'anën tjetër, në jetën e përditëshme e gjejshe duke buzëqesh e bâ shaka në çdo tryezë që shtronte në shtëpí të Tij apo ndër miqt e shumtë që kishte.

E quej detyrë të shfaq me gjith zemër, sa shum shkurtimisht shfaqa, për Ernest Koliqin, i Cili, i vetmi ndër të gjithë né dijti me ndejtë luftëtar efektiv dhe inteligjent për kontra komunizmit terrorist që zotnon Atdheun.

Qysh u-afruem dhe shkuem drejtë bashkëfjalimeve për bashkim?

Kjo pyetje i përket nji fazës historike të këtij mërgimi fatkeq, mbasi lidhet me emnin e të ndiemit Mit-hat Frashërit. Do t'a zhvilloj shkurtimisht tue qenë se njiherë tjetër do të merrem gjanësisht me këtë argument.

Jemi në Prandverën e vjetit 1945, në Romë, ku ndodhen shum ballista. Në këtë kohë të ndiemit *Mit-hat Frashëri* dhe *Ali Klissura* ndodhen të internuem në kampin e Ternit sepse kështu e gjykuen aleatët t'onë Anglo-Amerikanë.

Kishim marrë sigurime se së shpejti Mit-hat Frashëri do të lirohesh. Parashikimet t'ona, pa përjashtim t'asnjenit, ishin se shum shpejt Shqipnija e zaptueme nga komunistat do të lirohesh. Pra, ishte rasti i nji marrëveshtjeje të përgjithëshme.

Nga ana e *Organizatës Balli Kombtar* u ngarkuen për këtë marrëveshtje të ndiemit z.z. *Koço Muka* e *Kadri Cakrani* si edhe *z. Eqrem Peshkëpia.* Këta Zotnij u muerrën vesht me të ndiemit z. *Shefqet Vërlaci, Kapedan Gjon Markagjoni* dhe me *Ernest Koliqin.* (Shtiejmë në paranthezë : *Bloku Kombtar Indipendent*, jo vetëm që nuk

ishte formue, por *ndoshta* as që do t'ishte formue, nëse né Ballistat do të kishim qenë largpamës).

Komisjoni i *Ballit* na pruni këtë marrëveshtje:

Na që cillsohemi bashkëpuntorë me fashizmin jemi gati t'i lejmë në dorë Mit-hat Frashërit të formoi nji Komitet Kombëtar, si të dojë Ai, dhe se po e liruem Shqipnin nga komunizmi, jemi gati t'i shtrohemi nji gjyqjit të Drejtësisë. Aty le të na akuzoi kush të dojë se edhe na kemi akuzat t'ona.

Ku kishte marrëveshtje mâ të mirë për *Organizatën e Ballit Kombëtar?* Për këtë arsye posa buçiti lajmi që Mit-hat Frashëri arrijti i lirë në Romë, *Dr. Ismail Vërlaci* e *z. Ismail Sefa*, me shpenzimet e tyne, shtruen nji darkë për të gjithë profugët që ndodheshin në këtë qytet. Në haré e sipër u hangër darka dhe në mesin e duertrokitjeve, i ndiemi Mit-hat Frashëri mori fjalën. Në mes të tjerave tha tekstualisht: *Partija e ime është Shqipëria.* Të gjithë njerzija u-çuen në kambë dhe me duertrokitje të nxehta dhe të papushueme, shoqërojshin fjalën e Mit-hat Beut, të Cilin dishrojshin me e çue në triumf si nji heró kombtar.

I ndiemi *dr. Xhelal Mitrovica*, i përgjigjet Mit-hat Frashërit duke e përgëzue dhe duke përgëzue të gjithë né që «kemi fatin të kemi nji Mit-hat Frashër si prijs të kombit». Mbas këtyne dy fjalimeve njerzija caktoi nji komisjon për të marrë listën emnore të komitetit që Mit-hati do t'a përpilonte.

Kur mbaroi darka që ngrofi me shpresë krejt Shqiptarët, kanë arrijtë në Romë, t'ardhun nga kampi i Santa Maria di Leuca këta zotnij: *Dom Zef Shestani, Zef Pali, Qazim Prodani, Vasil Andoni, Lec Kurti, Nexhat Peshkëpia, dr. Jani Dilo.* Këta Zotnij u takuen me Mit-hat Frashërin. Se çfarë banë apo qysh e banë, fakti kje ky: *Mit-hat Frashëri refuzoi t'i nepte listën e Komitetit Kombëtar Komisjonit të caktuem; dr. Xhelal Mitrovica, Qazim Çakërri e dr. Halim Begeja.* Ndodhi që në sallën e hotelit të rrugës Veneto, në Romë, u-zhvillue nji shamatë e ashpër. Sidoqoftë, fjalët e Koliqit me shokë mue më ngelën të rrenjosuna në tru e u binda se ishin vetëm për të mirën kombëtare. Prandej e quejta për nder, jo vetëm t'afrohem me njerzit e sotëm të *Blokut Kombtar Indipendent*, por edhe të bahem mik me 'ta.

Bashkfjalime drejt bashkimit

I ndiemi prof. Ernest Koliqi dhe unë u-bashkuem, u-fjalosëm, u-miqësuem dhe punuem për bashkim. Ambicja e jonë ishte me i a mbërrimë bashkimit; egoizma e jonë ishte si me e afrue dhe me e realizue mirëgjendjen e Shqipnis dhe të popullit shqiptar. Né nuk i biseduem të kaluemet për me fajësue ose me shfajësue; né u përqendruem vetëm drejtë t'ardhëshmes. Në këtë drejtim i harxhuem

orët, ditët dhe muejt me i dhanë mundësinë të gjithëve për me përqendrue veprimet, sakrificat, zotësit mendore dhe fizike në nji kazan të përbashkët: *në kazanin e mbrojtjes të nderit dhe t'emnit të Shqipnis.*

Nuk ka gojë të thotë se profesor Koliqi nuk iu shtrue punës, nuk mbajti ligjërata, nuk shkroi artikuj, nuk udhëtoi për me bamë bashkimin e shqiptarvet. Me qindra janë konferencat e Tija akademike, me të cilat Ai dijti me nderue Atdheun dhe popullin Shqiptar. Prej vjetit 1945, tue u endun rrugëve të Romës, përgjatë gjithë këtyne vjetëve, e deri me 15 janar 1975, nuk prajti kurrë, nuk u lodhë tue i ramë kryq e tërthuer rrugave t'Europës, Afrikës, Azis dhe i rrallë kje fjalimi i Tij, si duket i fundit, në Firenze më Shtator me u bashkue për shlirimin e popullit shqiptar. Kush i mohon sakrificat e Tija tregon se nuk ka pjekuninë burrërore. Herën e fundit e bashkova Koliqin në Firenze dhe atje për bashkimin e fuqive të përbashkëta mendonte, punonte dhe predikonte. Nji nderim i veçantë dhe i rrallë kje fjalimi i Tij, si duket i fundit, në Firenze më Shtator 1974, në Kongresin e *Bashkimit Demokrat Shqiptar* [Shih vëllimin *Kuvendi i Parë në mërgim i Bashkimit Demokrat Shqiptar*, Firenze (Itali) me 6-7-8 shtator 1974, faqe 17-24]. N'ato mbramjeje fiorentine që ndejtëm deri kah orët e mëngjezit, tue kuvendue dhe tue qamun hallet e Atdheut dhe të të gjitha motrave dhe vllezënve t'onë, Ai nuk prante me shpresue se dikur *bashkimi do të bahet pse e do e mira e Shqipnis, e kërkon nderi i Shqiptarvet.* Sot me krye të përulun përpara kujtimit të këtij Miku të Madh dhe të vlefshëm I drejtohem edhe njiherë të gjithë politikanëve shqiptarë në mërgim, t'i harrojnë keqkuptimet, të mos ngatrrohen në moskuptime të kota, por të bashkohen. Ketë thirrje ia baj të gjithëve pse ajo âsht rruga me i shërbye Atdheut dhe popullit shqiptar.

Jehona e prof. Koliqit dhe e emja për bashkim do të gjejë ndëgjuesë dhe përkrahës që do të fugojnë drejtë atij bashkimi, që në fakt Koliqi me shokë filluen me e mbjellë atë farë qysh n'Aleksandri t'Egjyptit në 1949: *nepni Jul Cezarit çfarë âsht e Jul Cezarit.* Po të shkojmë me ketë princip profetik iu siguroj se seicili do të gjejë të vërtetën dhe Shqiptarët do të jenë si vllezën të pandamë.

La famiglia Simini

di **ERNEST KOLIQI**

Gennaro Simini, il patriota italiano esule, si spense a Scutari, che amò come seconda patria e dove fu amato dall'intera cittadinanza, proprio intorno agli anni in cui la Lega di Prizrend (1878) e il Congresso di Berlino imponevano in modo perentorio la questione albanese all'attenzione delle Potenze europee. Come già si è accennato, in Albania il movimento risorgimentale prendeva piede anche negli strati più opachi della popolazione. Il tramonto nel sangue dei pascialati semindipendenti dei Bushati nel Nord e di Ali Pascià Tepeleni nel Sud, la calata nel paese fino allora retto da maggiorenti nazionali di una torma di avidi funzionari ottomani ignari degli usi e costumi locali e della indole della stirpe, la lotta contro il *Tanzimat* (le riforme) avevano unito animi e volontà in una comune opposizione che sovente scoppiava in moti rivoltosi e una esasperata guerriglia. Erano, però, ancora manifestazioni d'insofferenza per le vessazioni degli emissari di Costantinopoli. Soltanto l'idea di una riscossa nazionale avrebbe conferito alla lotta un significato, facendo fiorire in un popolo diviso da differenze religiose, da incalliti regionalismi e pregiudizi di clan il sentimento della patria comune. Il miracolo avvenne attraverso le iniziative culturali che, specie fuori d'Albania, nelle comunità italo-albanesi, dei centri albanesi di Romania, di Bulgaria, d'Egitto, s'intensificarono e dettero agli Albanesi la coscienza dei loro diritti di nazione. Gennaro Simini, dopo aver servito con fervore la causa dell'unità d'Italia, ancora fremente nell'animo di passione patriottica, rivolse tutto l'ardore della sua generosa natura, imbevuta d'idee mazziniane e d'impulsi garibaldini, al riscatto della terra che gli aveva concesso ospitalità, che gli aveva dato una moglie eletta, dove viveva a suo agio nel ritmo di nobili tradizionali usanze a lui congeniali. Scutari, fra le altre città albanesi, godeva il privilegio di essere sede di numerosi consolati esteri. Una cerchia limitata di notabili, educata all'estero, frequentava le riunioni di quei rappresentanti diplomatici.

I funzionari turchi agivano in modo da mantenere vive, incrementandole il più possibile, le divisioni specie religiose: essi consideravano i musulmani gli ortodossi e i cattolici rispettivamente di nazionalità ottomana, greca o slava e latina. Chi, Albanese, aveva accesso ai ricevimenti di consolati, dove si parlava dei nuovi fermenti europei massime dopo il 1848 e dei sussulti nazionalistici che scuotevano le nazioni oppresse, difficilmente poteva diffonderle, ostacolato dal timore dell'oculata polizia turca e dalle barriere che si opponevano ai contatti

fra le varie comunità religiose. Invece il *dott Jasemini* (dicensi che sotto questo nome tutti conoscevano in città il *Simini*), accolto in ogni casa con fiducia e simpatia insieme all'assistenza sanitaria portava folate di idee e sentimenti liberali. La sua qualità di cittadino italiano e quella di genero del Console inglese gli permettevano franchezza di linguaggio. Tra lui che faceva circolare negli ambienti più chiusi le novità politiche, le notizie dei giornali, le informazioni sull'attività degli Albanesi all'estero dove ormai giornali, periodici, volumi di storia e opere letterarie in lingua albanese pubblicavano.

Il dottor Gennaro Simini si spense il 9 aprile 1880, quando attraverso la coraggiosa e illuminata opera della Lega di Prizrend l'Albania virtualmente era nata. Le aspirazioni vaghe e astratte si erano coagulate in una idea concreta e ora non rimaneva che raccogliere tutte le forze e convogliarle alla realizzazione di un progetto preciso di stato indipendente all'ombra del vessillo di Scanderbeg, cioè un'Albania dove tutti gli Albanesi senza distinzioni religiose e regionalistiche si sentissero fratelli.

Alla morte del padre, Giacinto aveva diciannove anni. Certamente ne condivideva il pensiero e i sentimenti. Era nato a Scutari nel 1861, di madre albanese. E con lui i legami con Scutari e l'Albania si strinsero maggiormente, poiché sposò in prime nozze *Giustina Kraja*, che morì giovanissima lasciandogli due figli: *Gennaro* e *Guglielmo;* e in seconde nozze *Maria Ndoja Lleshi*. Da questo matrimonio nacquero: nel 1899 *Ernesto*, l'Eroe di Tobruk, *Amelia*, deceduta ventiseienne nel 1930, *Gildo* nato nel 1905 e *Umberto* nato nel 1910.

Il movimento culturale albanese dal 1878 in poi s'ingrandì con ritmo vertiginoso: la letteratura si arricchì di opere pregevoli e allo scorcio del secolo XIX e all'inizio del XX apparvero i capolavori di *Naim Frashëri* (1846-1900) e di *Giorgio Fishta* (1871-1940). Giacinto, finito i suoi studi in Italia, tornò a Scutari, dove nel frattempo si erano aperte le Scuole Italiane. Egli fu uno dei primi insegnanti. Naturalmente non faceva che intrattenere i propri alunni albanesi sulla storia dell'Albania, sulla prestigiosa epopea di Scanderbeg, sui gloriosi tempi della libertà. Li incitava a lottare per l'indipendenza della patria. Molti rinomati cittadini di Scutari, distintisi per attività patriottica, ammettevano di essere stati educati all'amore della patria dalle appassionate esortazioni del Professor Simini. Egli pronosticava con giovanile entusiasmo la Grande Albania con i quattro *vilayets* di Scutari, Scoplie, Monastir e Giannina. A questa aspirazione (dettatagli nei precordi dal sangue albanese della seconda moglie, ch'era zia materna di Luigi Gurakuqi) dedicò accesi versi che meritano di essere pubblicati. Nel 1915, durante la breve occupazione montenegrina di Scutari, ospitò nella sua casa alcuni Kosovari aiutandoli poi a lasciare la città per luoghi più sicuri.

La famiglia Simini, tutta quanta, aveva messo radici in Albania e intendeva rimanervi. Anche i fratelli di Giacinto si erano sposati con donne del miglior ceto cittadino: *Attilio* con *Nusha Zorba* ed *Emilio* con *Angiolina Gjomarkaj*, sorella di Mark Kapitani. Gli avvenimenti costrinsero i Simini a lasciare l'adorata Scutari: prima per un breve periodo nel 1911-12 e 1913 durante la guerra italo-turca di Tripoli e poi definitivamente nel 1915, quan-

do sopravvenne l'occupazione austro-ungarica del Nord Albania nella prima guerra mondiale.

Il prof. Giacinto fu trasferito nelle Scuole Italiane del Cairo nel 1916 e vi rimase fino al 1927. Divenne amicissimo dei due poeti *Anton Zako Çajupi* e *Filip Shiroka*. Rimaneva nell'ambiente albanese.

In seguito tornò prima a Lecce, infine a Roma, dove si spense il 1° gennaio 1945.[1]

* * *

Kosova e mjerë

— Kosovë e mjer', Kosov' qysh jé?
— Me faqe krejt përmbys' për dhé!
— Po pse kjan'? Pse po gjimon?
— Lirín s'e kam qi ti po gzon!
E nuk jam vetëm në kët rrezik
Në t'randën thembër t'egrit anmik...
— Po bashk' me ty, m'kallzò, kush â
Qi s'gzon lirín sikurse na?
— Mâ t'mirat lule na i ka këputë
Europa rrole, e mbrapshta mrrutë!
Rrethe me male, plot ujna e fusha
Na kto kém pasun t'mira Zojusha:
Shkupin, Pezrendin, Pejen, Tetovën
E Mitrovicën, Gucîn, Gjakovën.

GIACINTO SIMINI

Febbraio 1914.

[1] Questa seconda parte fu già preparata dal prof. Koliqi prima della Sua scomparsa. La prima parte fu pubblicata nel n. 1-10, XVIII, 1974, pp. 47-55 di *Shêjzat*.

Errata-corrige: *Nel n. 1-10 (1974) di* Shêjzat, *a pag. 47 della metà del 16° rigo deve essere fatta la seguente sostituzione:*

... A sua volta Giacinto, uno dei figli di Gennaro Simini, si unisce in matrimonio prima con Giustina Kraja *e poi, rimasto vedovo, si riammoglia con* Maria Ndoja Lleshi *di Pashko e di Antonia (Nine) Dodmasej Preka (2). Questi matrimoni con figlie di notabili della città collocano la famiglia Simini nella più ristretta ed intima cerchia dell'ambiente scutarino. Anche se da Scutari si allontanarono nel 1911 perché espulsi dal governo turco in seguito alla guerra italo-turca e rientrati in Albania nel giugno 1913 dovettero definitivamente abbandonare la città per l'invasione austriaca nel dicembre 1915, rimasero spiritualmente legati a quella città. I Simini parlano l'albanese.*

Oh Flamúr !

Flamúr i rí
I kuq, i zí,
Sa i bukur jé!
Na ndez' Ti né
Për këtë Âmdhé!
Oh mos pushosh
T'u hjedh'! Na kjosh
Ti për gjith herë
Me nâm, me nderë.

Flamúr kjosh dritë
Për né për ditë!
Kush mos T'ndimoftë
Kurr gjall' mos kjoftë!

Me Ty prá kjoftë
Gjithkund, T'ndimoftë
E Të forcoftë
E ditë e natë
E lumja shpatë
T'Kastrjotit t'onë,
Porsi kumbonë
Tringlloft' ërherë
Si n'dimën, n'verë

Flamúr me nderë
Ti kjosh përherë!
Gjithkush Të do!
Flutrò! Flutrò!

E vrrit tue thânë:
Dueje njat Nânë,
Shqiptar; qindró
Kurr mos harró
Âmdhén, qi sot
Me t'mira â plot!
Për Tê mendó!
Për Tê vepró!
Për Tê luftó!

Flamúr, gjithmonë
Kjoòsh n'zêmër t'onë!
Ty anmiku T'drò!
Flutrò! Flutrò!

Oh Zot, n'këtë vend
Kurr mos na lên
Me hy kurrkend!
Këtë t'âmbël dhé
Na e ké fal' né,
O i Madhi Zot!
T'a mbushim plot
Pra na me t'mira
Jo me t'vishtira!

Flamúr, kjosh dritë
Për né për ditë!
Kush mos T'ndimoftë
Kurr gjall' mos kjoftë!

Vllazën T'qindrojmë!
Për Tê T'luftojmë!
Flamúr, flutrosh
Gjitmon'! Na kjosh
Shêj për lirí,
Për dashtuní,
Për këtë Âmdhé!
Gjithkush ndër né
Për Ty bân bé!

Flamúr, kjosh dritë
Për né për ditë
Kush mos T'ndimoftë
Kurr gjall' mos kjoftë!

GIACINTO SIMINI

Der Beitrag der Exibläter "Ora e Shqipnisë" und "Bashkimi Kombëtar" zur Verbreitung des Gedankens der nationalen Einheit

von Dr. CHRISTINE KÖRNER

Im selben Jahr, in dem Ahmet Zogu sich zum König Albaniens proklamieren ließ, begannen in Wien zwei albanische Zeitungen zu erscheinen, die den Kampf gegen Zogu auf ihr Panier geschrieben hatten.

»Ora e Shqipnisë« wurde erstmals am 10. Januar 1928, »Bashkimi Kombëtar« am 16. März desselben Jahres veröffentlicht. »Ora e Shqipnisë« war das »Organ i nji grupit politik independent refugjatësh«[1] und verstand sich als Nachfolgerin der Zeitung »Ora e Maleve« Shuk GURAKUQIs, deren Erscheinen mit der Machtübernahme ZOGUs im Dezember 1924 eingestellt worden war;[2] als Herausgeber, Eigentümer und Verleger des Blattes »Bashkimi Kombëtar« zeichnete Angjelin Suma.[3] Wien als »die Wiege des albanischen Patriotismus«[4] schien ihm der geeignete Ort für die Veröffentlichung eines albanischen Presseorgans. Suma war gleichzeitig Vorsitzender des »Komitee National-Vereinigung« (*Komiteti Bashkimi Kombëtar*), — eine bei den albani-

[1] Als Eigentümer, Herausgeber und Verleger der Zeitung wurde Dom Lazar Shantoja und als verantwortlicher Schriftleiter Dr. Friedrich Albrecht genannt. »Bashkimi Kombëtar« erwähnte in Nr 7 (Jg II) v. 23. April 1929, S. 3 Hasan Prishtina als Herausgeber von »Ora e Shqipnisë« neben L. Shantoja.

[2] Die oppositionelle Zeitung »Ora e Maleve« wurde in den Jahren 1923-1924 in Shkodra herausgegeben. Sie erschien erstmals am 15. April 1924. Verantwortlicher Leiter war anfänglich Shuk Gurakuqi, ab Nr 31 v. 26. 7. 1924 Luigj Mjeda, ab Nr 40 v. 27. 9. 1920 Kol M. Gjoni, ab Nr 45 v. 8. 11. 1924 Toma i Fr. Tomës. Das bei den Franziskanern gedruckte Blatt brachte Wissenswertes über Politik, Gesellschaft, Kultur, Literatur und Wirtschaft. Es erschien wöchentlich im Unfang von zwei, vier und sechs Seiten und im Format 30,6 × 46 cm.

[3] Beide Presseorgane, »Ora e Shqipnisë« und »Bashkimi Kombëtar«, befinden sich in der Wiener Nationalbibliothek, von »Bashkimi Kombëtar« sind dort jedoch nur die Nummern der ersten Veröffentlichungsperiode (16. März 1928 - 3. Juli 1929) vorhanden. Diese Zeitung wurde anfangs wöchentlich, ab Nr 7 v. 23. 4. 1929 zweimal monatlich herausgegeben. Als verantwortlicher Redakteur während der ersten Veröffentlichungsperiode zeichneten abwechselnd Karl Hawranek, Rudolf Lauterbach, Karl Rabsky und Hans Kaufmann. »Le Gérant« während der zweiten Veröffentlichungsperiode 1936/1937 (insgesamt 17 Nummern) war André Truffaut. Das Blatt hatte vier bis sechs Seiten Umfang und ein Format von 30,5 × 47,4 cm und 29,7 × 45,0 cm. Es kostete 20 Goldfrancs pro Jahr und 12 Goldfrancs für 6 Monate. Der Preis für ein Jahresabonnement von »Ora e Shqipnisë« betrug 5 fr. sv. für Albanien, 5 Schillinge für Österreich und 5 fr. sv. für außerhalb.

[4] Siehe »Bashkimi Kombëtar«. Wien. Jg I, Nr 1 v. 16. März 1928, S. 1 (Leitartikel: An Alle!).

schen Emigrantenorganisationen auch heute durchaus übliche Personalunion. Als Mitglieder dieses Komitees sind insbesondere noch Ali Klissura und Xhafer Bushati zu nennen.

Beide Zeitungen verstanden sich in erster Linie als politische Blätter: Neben dem »Kampf gegen das tyrannische Regime Ahmet Zogus« [5] war ihr Ziel vorrangig die Einigung des albanischen Volkes und besonders der Exilalbaner (dies vor allem zur Wiedererlangung der »nationalen Freiheit und Unabhängigkeit«, die man durch die Politik Zogus gefährdet beziehungsweise völlig untergraben sah). — »Ora e Shqipnisë« bekannte ganz klar: »Qellimi âsht qi populi lê të bashkohet në nji program e t'ecin për nji rrugë«.[6] Angjelin Suma begründete die Veröffentlichung seiner Zeitung, deren Name das Ziel — die »Nationalvereinigung« — bereits klar ausdrückte, so: »E vërteta është që nuk jemi gazetarë, por dëshira për t'i shërbyerë kombit t'onë, na shtyn t'a marrim këtë barrë kaqë të randë«.[7]

Um diesen »Dienst an der albanischen Nation« erfüllen zu können, ersuchte »Bashkimi Kombëtar« um die Unterstützung »aller Patrioter ohne Unterschied der Partei und politischen Tendenzen« und mahnte, »die Divergenzen über die sekundären Fragen beiseite zu lassen und alle unsere Kräfte für die hohe Pflicht zu vereinen: »das Vaterland aus der Gefahr zu retten«.[8] Trotz der politischen Uneinigkeit und verschiedenen Richtungen unter den albanischen Emigranten (»Bashkimi Kombëtar« sah vor allem drei Tendenzen: 1. die balkanische, 2. die — so gut wie verschwunden geglaubte — italophile und 3. die »subversiv bolschewistische« [9]) hielt die Zeitung an der Möglichkeit einer gemeinsamen Front aller Exilalbaner (und auch der Albaner im Mutterland) fest, da ihrer Meinung nach alle Albaner sich einig waren, daß das »verräterische und blutige Regime Ahmet Zogus« nicht länger geduldet werden könnte.

»Bashkimi Kombëtar« (wie auch »Ora e Shqipnisë«) sah durchaus realistisch, daß es den albanischen Emigranten ohne Hilfe von ausländischer Seite nicht möglich sein würde, erfolgreich die Regierung Zogus zu bekämpfen. Nach Ansicht des Blattes waren die Exilalbaner der ungeteilten Meinung »Që fuqit t'ona fjeshtë kombëtare pa përkrahjen — të pakën në fushën e politikës internacionale — e fuqive të huaja, nuk mjaftojnë për të shpëtuar atdhenë nga rreziku ku e futnë trathëtit e Zogut«.[10]

Aus diesem Grunde richtete man zur Unterstützung der albanischen Patrioten dringende Appelle an die Ausländer, das heißt an jeden, »dem das Schicksal unserer Heimat etwas bedeutet«, da dieses weitgehend auch das

[5] Siehe »Ora e Shqipnisë«. Wien. Jg I, Nr 2 v. 10. Februar 1928, S. 4.
[6] »Ora e Shqipnisë«. Wien. Jg I, Nr 1 v. 10. Januar 1928, S. 1.
[7] »Bashkimi Kombëtar«, ob. zit., S. 3 (Artikel: An die Leser).
[8] »Bashkimi Kombëtar«. Wien. Jg I, Nr 6 v. 13. April 1928, S. 3.
[9] »Bashkimi Kombëtar«. Wien. Jg II, Nr 7 v. 25. April 1929, S. 3.
[10] Ob. zit.; — nach Meinung von »Ora e Shqipnisë« lag in der »Erhellung der öffentlichen Meinung des Auslandes über die Frage Albaniens« sogar »das höchste Ziel« ihrer Mitstreiterin (s. »Ora e Shqipnisë«. Wien. Jg I, Nr 5 v. 24. März 1928, S. 4).

Schicksal Europas sei. In der Absicht, auch die Nichtalbaner anzusprechen und um ihre Gunst und ihr Verständnis zu werben, veröffentlichte man neben Artikeln in albanischer Sprache französische und in »Bashkimi Kombëtar« auch deutsche Beiträge. In deutscher Sprache erschienen meist sogar die Leitartikel von »Bashkimi Kombëtar«, die letzte Seite des Blattes war vor allem französisch geschriebenen Beiträgen vorbehalten.

Dieses Bemühen um Verständnis für albanische Probleme auch seitens der Nichtalbaner fand un findet man immer wieder in zahlreichen albanischen Exilpublikationen, die sich außer der Muttersprache häufig einer Reihe von Fremdsprachen bedien(t)en.

Wieweit »Ora e Shqipnisë« und »Bashkimi Kombëtar« die selbstgestellte Aufgabe, Ausländer für ihre Ziele zu interessieren und gar zu begeistern, unter den damaligen (politischen etc.) Gegebenheiten bewältigen konnten, ist im nachhinein schwer zu beurteilen. »Ora e Shqipnisë« behauptete zwar bereits in ihrer zweiten Nummer, sie würde »gjithkund me gëzim dhe entuzjazëm të madh« erwartet und berichtete von begeisterten Briefen albanischer Emigranten aus verschiedenen Orten als Antwort auf die erste Nummer der Zeitung; der Anspruch, im Namen des albanischen Volkes zu sprechen, den »Bashkimi Kombëtar« erhob: »Veçanërisht është një detyrë morale për ne, që pretendojmë para botës së huaj se vepërojmë e flasim n'emrin e popullit shqiptar [...],[11] war aber entschieden zu hoch. »Bashkimi Kombëtar« überschätzte sich hiermit jedoch nicht weniger als viele andere albanische Exilblätter, die sich ebenfalls als Vertreter der Meinung des albanischen Volkes ausgaben.[12] Daß diese Meinung überhaupt nicht existierte, es nur die Meinungen verschiedener Gruppen gab, wollte keine der Zeitungen wahrhaben. Keine dieser Gruppen, selbst wenn sie tatsächlich einen nicht unbedeutenden politischen Einfluß ausübte, konnte für sich beanspruchen, das albanische Volk wirklich zu repräsentieren.[13]

Das Verdienst von »Bashkimi Kombëtar« und »Ora e Shqipnisë« war es vor allem, daß sie immer wieder versuchten, die Notwendigkeit der nationalen Einigung bewußtzumachen. In langen Fortsetzungsartikeln führte »Bashkimi Kombëtar« ein »Bisedim mi programet e grupeve t'emigracionit shqiptar« und bemühte sich darin, neben den Verschiedenheiten der einzelnen albanischen Emigrantengruppen und -vereinigungen gerace die Gemeinsamkeiten aufzuzeigen und zur Einigung im Kampf gegen Zogu und für die nationale Unabhängigkeit, die man durch das Zogu-Regime ständig bedroht respektive völlig beseitigt sah, aufzurufen.

[11] »Bashkimi Kombëtar«. Wien. Jg II, Nr 7 v. 25. April 1929, S. 2.

[12] Siehe z. B. die Nachfolgerin der Zeitung »Shqipëria e Re«, die Broschüre »Zëri i Shqipërisë«, deren Herausgeber, die Mitglieder des »Komiteti Qendror i Shqipëtarve të Mergimit«, sich als »wahre Vertreter des albanischen Volkes sahen« (s. «Zëri i Shqipërisë«. Nr 2 v. 1. September 1935, S. 22).

[13] Weder das von Noli geführte Konare noch die Gruppe »të rijve«, die die Bewegung des »neoshqiptarizmi« ablöste und zu deren Vertretern auch Ernest Koliqi gehörte, oder gar die zersplitterten, sich aus wenigen Mitgliedern rekrutierenden kommunistischen Grüppchen der dreißiger Jahre waren dazu in der Lage.

Doch ungeachtet der Einsicht, daß der Kampf für die nationale Unabhängigkeit und Einheit und gegen die Regierung Ahmet Zogus *gemeinsam* geführt werden mußte, konnten »Bashkimi Kombëtar« und »Ora e Shqipnisë« es sich nicht versagen, gegen andere Emigrantengruppen und deren Presseorgane, etwa gegen Fan Nolis Blatt »Liria Kombëtare«, zu polemisieren. Wie viele der albanischen Exilblätter postulierten sie für sich und andere die Überwindung der Gespaltenheit der albanischen Emigranten, trugen aber andererseits mit ihrer Polemik vielleicht nicht wenig dazu bei, die Kluft zwischen den einzelnen Gruppen der Exilalbaner eher noch zu vergrößern.

Die Rufe von »Ora e Shqipnisë« und »Bashkimi Kombëtar« drangen verständlicherweise nicht nach Albanien selbst, da sie wie fast alle Exilblätter von einem Einfuhrverbot seitens der albanischen Regierung betroffen waren. Auch in anderen Ländern gab es Hindernisse für ihre Verbreitung, wie etwa in Jugoslawien, wo die Verteilung von »Ora e Shqipnisë« wegen ihrer Position gegenüber der Politik Belgrads durch ein Ministerdekret untersagt wurde.

»Ora e Shqipnisë« kämpfte nicht allzulange für die Einigung der albanischen Emigranten: Nachdem sie von Anfang an unregelmäßig in Abständen von cirka zwei bis vier Wochen herausgegeben wurde, erschien die letzte von nur acht Nummern am 6. Juli 1928. »Bashkimi Kombëtar« bemühte sich über einen längeren Zeitraum hinweg, in oben aufgezeigtem Sinne auf die Exilalbaner und das Ausland einzuwirken: Ihr Erscheinen wurde erst im Juli des folgenden Jahres eingestellt. Nach einer Pause von sieben Jahren begann R. Mitrovitza mit der Wiederveröffentlichung des Blattes in Paris. Weder der Name der Zeitung noch der des sie tragenden Komitees wurden geändert, was darauf hindeutet, daß das Hauptziel — die nationale Einigung — dasselbe geblieben war.[14]

Trotz ähnlicher Zielvorstellungen und einer Reihe von Übereinstimmungen war jedoch die Linie beider Zeitungen keineswegs identisch und differierten ihre Meinungen in wesentlichen Punkten:

Während »Ora e Shqipnisë« gegen die Politik Belgrads opponierte und sich aus diesem Grunde ein Verbreitungsverbot für Jugoslawien einhandelte, wollte »Bashkimi Kombëtar« bei der »zivilisierten Welt«, das heißt bei den Großmächten, dem Völkerbund, den Balkanstaaten und hier *vor allem Jugoslawien*, um Unterstützung im Kampf gegen Zogu nachsuchen.[15] Dafür war »Ora e Shqipnisë« mehr proitalienisch orientiert (eine etwas unrealistische beziehungsweise »schizophrene« Einstellung in Anbetracht der immer deutlicher werdenden Kooperation der italienischen mit der albanischen Regierung, der »Ora

[14] Aufgrund fehlender oder nicht einsehbarer Quellen mußte eine genauere Untersuchung des Inhaltes der Zeitung während der zweiten Veröffentlichungsperiode unterbleiben.

[15] »Bashkimi Kombëtar«. Wien. Jg II, Nr 9 v. 24. Mai 1929, S. 2.

e Shqipnisë« doch negativ gegenüberstand),[16] — die Haltung von »Bashkimi Kombëtar« gegenüber Italien war im Gegensatz dazu ziemlich ablehnend.

Von einer diesen Differenzen entsprigenden Polemik zwischen den beiden Blättern kann aber nicht die Rede sein, — bezüglich ihres Hauptanliegens waren sie sich völlig einig: des Strebens nach nationaler Unabhängigkeit und Einheit, das unangefochten immer im Mittelpunkt stand.

Kontributi i fletorevet emigrante « Ora e Shqipnisë » dhe « Bashkimi Kombëtar » për përhapjen e mendimit nacional

Këto dy gazeta filluan të dalin në Vjenë rreth fillimit të vitit 1928. Editorë ishin intelektualë, si Angjelin Suma, Lazër Shantoja, Rexhep Mitrovica etj. të cilët kishin lënë vendin e tyre pas ardhjes së Zogut në fuqi.

Të dy fletoret ndiqnin në përgjithësi një qellim të përbashkët që mund të përmblidhet në dy pika: a) *bashkimi i shqiptarëvet për përmbysjen e sundimit të Ahmet Zogut,* b) *sjellja e vëmendjes së të huajve nga çështja shqiptare, pa ndihmën e të cilëve gjendja në Shqipëri ish e pamundur të shndërrohet. Po për këtë gazetat në fjalë botonin artikuj jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjermanisht e frengjisht.*

Ora e Shqipnisë *doli prej datës 10 janar gjer më 6 korrik 1928, ndërsa* Bashkimi Kombëtar *vijoi të dalë gjer në korrik të 1929. Pas shtatë vjetësh heshtjeje* Bashkimi Kombëtar *del përsëri, në Paris, gjithsej 17 numra gjatë periudhës 1936/37 nën redakcionin e Rexhep Mitrovicës, duke u përmbajtur në vija të përgjithshme programit të mëparshëm, ashtu si e tregon dhe titulli që mban.*

[16] Andererseits war eine proitalienische Einstellung der albanischen Emigranten zu jener Zeit, das heißt gegen Ende der zwanziger Jahre, durchaus verständlich, da die Mehrheit der albanischen Patrioten, wie etwa Fan Noli, Gurakuqi, A. Klissura u. a. m., nach der gescheiterten Revolution von 1924 erst einmal nach Italien gegangen war.

Gjâmë e vaj mbí vorr

të prof. Ernest Koliqit

nga NDOC VULAJ

Majeve t'epra ku kishte banimin,
U dynd nji shqipe tuj shungullue;
Drejt Parnasit e muer fluturimin,
Doli k'so bote kaq t'turbullue.

Eh, ç'u l'shuene të gjith hyjt e qiellit
Kúr pán' se Shêjzat *mbeten pa prís!*
Vrap te hana n'per rreze të diellit:
Palè ç'u bâ Drita e lirís?

« Ka her' duket se 'i thirrje dertuese
E Vangjelís — pês' vjet n'vejní —
Andej donte, me m'nyra mikluese,
As m'e terhjekë, t'i bânte shoqní ...

« S'ka kujdes jo, aspak, Vangjelia
Se ç'kobin bâni largimi i Tij;
S'e ndíe t'keqen ajo se shoqnia
Lypin Ernestin e s'gjindet n'shpí ...! »

Zjarm bâ hana, plot huj, ziliqare:
Don hyjt e zgiedhun me i pas' pran' vedit,
Qi t'l'shojn' dritë mbí token shqiptare,
Edhe prej s'largut, prej perte' dedit.

A thue hana se Tý t'u shngarkue,
Moj Vangjelí? A thue aq merzitun
N'at'ânë ishe, qi k'shtû tue kerkue,
Per dit' iu sjellshe si m'e grabitun ...?

Oh, sa herë nder mend Ti iu solle,
Kúr mb'tavolinë Ai ulej t'punonte,
E nder duer tash e par' Ti iu pshtolle,
Kúr t'ngratit zêmra mall i gufonte!

Nji mall tjeter askurr s'iu largue:
Atdheu i bukur, poplli shqiptár,
Tridhet vjet, qe kaluen ... tuj lëngue,
Nder vuejtje t'randa si kau n'kulár.

E kujdesin e madh t'Bajram Currit
Gjithmonë e pate: t'njasaj Kosove.
Amanetin e mbram t'atij Burrit,
Per giuhen shqipe, mu n'vend ia çove.

Zêmra Jote, randue per së teprit,
Plasi papritmas, t'rrxoj para kohe!
Thuej dy fjal' tash andej Ti prej s'eprit,
Se k'ndej nga vorri ... s'je kah mund çohe!

Me kunoren e larit mbí krye,
Nalt nga Parnasi pak fjal' m'i urdhnue:
Folu shokve, qi krah't u ke thye,
Folu edhe robve se t'janë idhnue!

Dalngadalë, tue i marrë me t'mirë,
Bashkëpuntorve lutu me mall:
« E dij, shokë, se â punë e vështirë,
Deh, mbani Shêjzat! *Mbani prap gjallë! »*

Rreth e rrotull kah t'sjellesh m'u falë,
Nji gulf vjen fytin nye me Ta xânë;
Vaj e lott, si shqiptár, Ti me i ndalë,
Kúr lamtumiren t'nisish m'u dhanë.

Me at' goj t'ambel t'bylbylit kangtár,
Falu me gjak, miq e shoqní:
« Lamtumirë! » thuej kombit shqiptár,
Thuej: « Lamtumirë! » asaj Shqipní.

« Lamtumirë — thuej — Deshmor't e Liris!
U falem s'largut, prej vendi s'huej:
Q'nga Kosova der' n'dhé t'Çamëris,
Zjarr anembanë vlon gjaku i juej!

« Lamtumirë, moj Shkodra krenare!
Ti ké kên' drita dhe je pishtare;
Ti je Votra e Kulturës Shqiptare:
Kurr s'do t'perkulesh pa t'qitun fare!

« Si stuhija, sa shekuj mâ parë,
Njeni mbas tjetrit popujt barbarë,
Permbí tý e mbí kombin ton' mbarë
Rane, shkatrruen, gjithçka bân' zhár ...

« Si Abelin i vllau, ai smirzí!
Në hû e mbyti, si 'i kingj t'pafaj,
E shkul gjaku me hyj iu perzí:
Mbí tokë u bâ mâ i pari vaj.

« Tý t'pafaje, o e Ilirve mbar' çerdhja,
Do vllazen t'tjerë nuk duen me t'pá ...!
Oh, sa e madhe mbí tý kje gjakderdhja!
Dhunen e turpin s'del gjâ me i lá.

« Dhun' mbas dhune këcen mbí 'i tjeter,
E toka s'shêmbet ...! As s'çilet qielli!
Kúr këtë nuse e quejn' plakë t'vjeter,
Pse s'i mshef rrezet, o i bukri dielli!

« Gurra e kroje e lumej n'kateranë,
Tý si kreshnike t'fisit shqiptár,
Po t'kjajn' thekshem, se e shtypun shum randë
Nga kuqalashët, nga do trathtarë.

« Po t'dhunojn', por dikúr historia,
Ka m'u hakmarrë, tuj u dhan' grusht.
— O riní, o uzdaj', brohoria
E lumnís s'ardhme! Si flladi n'gusht

« I njall' bimët, gjallnojë e këthejë
Vllaznim e pagjë! Larg andej huni!
E bashkimi e hareja t'shperthejë.
— Oh, lum atdheu p'r atê qi ia pruni! »

T'mbramen fjalë tash thuejau, Koliq,
Njatyne nipave t'Herojt Kreshnik,
Per lirí edhe deri sa vdiq,
Fytafyta luftoi me anmik.

A s'jan' arka e thesarit të lashtë
Të fisit tonë trim e bujar?
T'kan' nderue, e si vllá të kan' dashtë:
Kurr s'e harrojnë atdhén e parë.

N'turmë t'Fishtes tashti e ke vendin,
Sikurse rrijnë shqipet mbí shkamba,
Fjal' nga 'i fjalë vijoni kuvendin,
Rrall aq'e nalt i shklet kuj kamba.

Ah, i mjeri un, zêmerpervlue
Per gur e dhé t'asaj Shqipnijë!
Sikúr t'mujshem nga dheu me ju zblue
Prap per tê jeten kishit m'e shkrijë ...

O, drit' shpírti u bâft' në Lumní!
Ju s'jeni t'vdekun, por mbí këtë dhé,
Si Hyj Drite per t'ardhmet brezní,
Flakë lirie per Tý, o Atdhé!

Su albanese *shoh*.

di VITTORE PISANI

« Io vedo » si dice in albanese *shoh* (ghego, colla solita variazione *h/f*, anche *shof*); « tu vedi, egli vede » *sheh* con *e* verosimilmente metafonetico (Pekmezi, *Gramm. der alb. Sprache*, p. 57); l'aoristo suona *pashë*, ghego *pash* e *paç;* il participio *parë*, ghego *pa*. Che il *pa-* dell'aoristo e del participio vada col sanscrito *páç-ya-ti* « vede » ecc., cioè con la forma senza *s-* « mobile » che riappare nel latino *spec-iō* ecc., è generalmente ammesso, pur se i particolari fonetici e morfologici restino alquanto oscuri. Qui vogliamo intrattenerci sulla formazione del tema del presente.

Che *shoh* contenga la stessa radice la quale riappare nel gotico *saihwan*, ted. *sehen* ecc. è evidente; se questa radice sia la stessa di **seq*^{u}- « seguire » nel lat. *sequitur*, sanscrito *sácate*, greco ἕπεται e cosí via e di **seq*^{u}- « dire » in lat. *in-seque*, gr. ἔννεπε ecc., o se qui abbiamo un caso di omonimia, è inutile discutere: si tratta di una possibilità semanticamente malcerta, e su di essa non è lecito basare i nostri ragionamenti.

Riuniamo piuttosto le forme contenenti un **seq*^{u}- « vedere » nelle varie lingue indeuropee. Esse sono:

gotico *saihwan* « vedere », aated. *sehan* ecc.;

medioirlandese *ar-secha* « he should see us » (Wh. Stokes, *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung*, XL, p. 249); ant. irland. *ro-sc* « sguardo, occhio » da **pro-sq*^{u}*-o-* (Pokorny, *Indogerm. etymol. Wörterbuch*, p. 898);

ittito *šakuuāi-* « vedere, guardare, osservare » con *šakuuant-* « visibile » (e *šakuua* nom. pl. « occhi », *šakui-* « occhio » > « fonte », che potrebbe rappresentare un incrocio della radice verbale coll'**oq*^{u}- continuato nel lat. *oculus*, armeno *akn*, greco ὄσσε ecc.).

A queste corrispondenze aggiungerei il latino *sciō*, col solito passaggio semantico da « vedere » a « sapere » (per es. in gr. οἶδα sanscrito *véda* gotico *wait* « so », perfetto di **ueid-* in *videō* ecc.), da **sq*^{u}*-iō*, presente in *-io-* con grado zero della radice (cfr. la mia *Glottologia indeuropea*, § 122) e con *qui* > *ki* per cui cfr. la mia *Grammatica latina*[4], p. 53 § 94 (*colliciae* i. e. *tēgulae* « grondaia »:

liquor, dēliciae laciō: laqueus, silicia « fieno greco »: *siliqua, līcium: ob-līquos*) e aggiungi *noegeum* cioè *noigiom* « asciugatoio, fazzoletto » da **noig^{u}-io- col *neig^{u}-* di gr. νίγω (**nig^{u}-iō*) νίψω *ecc.* (cfr. i miei *Testi latini arcaici e volgari* ad A 46, 19).

Una possibilità (da opporre a quella da me proposta in *Studi Germanici*, X/1, 1972, p. 43 s.) è che alla nostra radice appartenga il διοσκέω di Anacreonte fr. 3 D: Κλεύ βουλον δὲ διοσκέω, cfr. Esichio: διοσκεῖν διαβλέπειν συνεχῶς τὴν ὅρασιν μεταβάλλοντα nel cui οσκέω sono tentato di riconoscere una forma che raddoppiata, dunque **so-sq^{u}-*, in cui κ da *q^{u}* sarebbe ionismo come *in* κῶς = πῶς ecc.

Una forma raddoppiata credo di dover riconoscere anche nell'albanese *shoh;* già in *Paideia*, IX, 1954, p. 329 scrivevo, recensendo *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebiets* di W. Porzig: « ai confronti germanico-albanesi può aggiungersi alb. *shoh* "vedo" *sheh* "vedi, vede" da **sē-sq^{u}-* e **se-sq^{u}-* [ma sheh è piuttosto risultato di metafonia, v. sopra], forme raddoppiate di **seq^{u}-* in got. *saihwan* "veder" ». Da un punto di vista fonetico, mi pare che tutto sia in ordine. Quanto alla lunga di *ē* nella sillaba reduplicativa, lunga presupposta dall'*o* albanese, essa può rappresentare un allungamento intensivo.

Interessante mi pare che proprio nel senso di « vedere » una formazione raddoppiata abbiamo anche nel sanscrito *cáṣṭe* « vede » = avestico *čaštē* « insegna », III plur. *cákṣate* e *cákṣur*, radice *cakṣ-;* di solito questo *cakṣ-* viene ricollegato al *kāç-* di *kāçate*, intensivo *cākaçīti* (cfr. Mayrhofer, *Kurzgef. etymol. Wörterb. des Altindischen*, p. 381), che però significa « appare, splende » (ma per l'avestico il M., p. 204, segna *akasat* « scorgeva »). Foneticamente bisognerebbe pensare che **q^{u}e-q^{u}k-te* attraverso **ca-kṣ-ṭe* abbia dato *cáṣṭe* e di qui il *s* sia passato al plurale, pel quale ci aspetteremmo un **cakç-ate* o simili. A me pare molto più verosimile partire da **q^{u}e-q^{u}s*, cioè da una metatesi del **se-sq^{u}-* cui risale il nostro *shoh*, come per es. in lit. *kepù* « cuoccio » = slavo *pekq*, cfr. sanscr. *pácati* « cuoce » ecc., metatesi provocata da una spinta tabuistica.

Se quanto ho esposto qui sopra è giusto, *shoh* è un elemento indeuropeo antico conservatosi nell'albanese e ricollegante questo con il sanscrito, l'ittito, il germanico e possibilmente col greco; un elemento, per usare la mia terminologia, « protosanscrito », proveniente cioè da quel nucleo linguistico da cui si è formata l'unità indeuropea, cfr. per es. il mio libretto *Le lingue indeuropee*,[3] p. 114 ss. e soprattutto *Indogermanisch und Europa*, München 1974.

Le raccolte di novellistica italo-albanese promosse da Ernesto Koliqi

di ANGELO FABI

La pubblicazione di un *corpus* delle tradizioni popolari degli albanesi d'Italia è una delle più notevoli iniziative prese da Ernesto Koliqi nella sua operosa vita di studioso, una di quelle che più testimoniano la sua sensibilità culturale e capacità di realizzazione. Consapevole dell'azione disgregatrice e livellatrice che la nostra epoca, fatta di trasformazioni sociali e di rapidi scambi, opera sulla lingua e sui costumi del popolo, egli avvertì l'urgenza di una raccolta sistematica e scientificamente condotta del patrimonio tradizionale delle comunità italo-albanesi, un patrimonio — com'è ovvio — più di altri esposto a inquinamenti e dispersioni. Che le parlate degli italo-albanesi presentino aspetti originali e quindi notevolissimi dal punto di vista linguistico, è un fatto che Koliqi ben presto intuì, e altrettanto felicemente intuì che il potere di conservazione proprio delle aree linguistiche laterali — quali sono i dialetti vivi negli stanziamenti albanesi d'Italia rispetto alla lingua della madrepatria — si esercita parallelamente anche nel campo dei costumi e dell'espressività tradizionale: dai canti d'amore alle favole, dalle ninne-nanne agli indovinelli, dai proverbi agli sfoghi satirici e al lamento funebre. Che è come dire un materiale prezioso non solo per gli specialisti di albanologia, ma per ogni studioso di folklore. Koliqi aveva incominciato la raccolta dai testi narrativi, e i risultati raggiunti dall'impresa, anche se purtroppo incompiuta, non hanno deluso le aspettative, come dimostrano i tre importantissimi volumi di *Novellistica italo-albanese* pubblicati, col contributo finanziario del CNR, dall'Istituto di studi albanesi dell'Università di Roma.

La raccolta procedeva secondo un piano ben determinato, scandagliando gruppi di località geograficamente prossime tra loro. Il primo volume comprende le narrazioni degli stanziamenti albanesi che si trovano in Calabria alle falde del Pollino (Frascineto, Eianina, Civita, Plataci, Castroregio, Farneta); il lavoro di raccolta fu eseguito dal dott. Luca Perrone. Il secondo volume è comprensivo del materiale narrativo tratto da sei colonie situate più a sud, anch'esse vicine tra loro: Santa Sofia d'Epiro, San Demetrio Corone, Macchia Albanese, San Cosmo Albanese, Vaccarizzo Albanese, San Giorgio Albanese. Il terzo raccoglie i racconti di Greci, in provincia di Avellino, e di Barile, in provincia di Potenza; è dovuto alle cure del prof. Martin Camaj, che alla parlata albanese di Greci aveva già dedicato uno studio improntato alla più rigorosa metodologia glottologica. Un quarto volume, che il prof. Koliqi aveva

disposto per la pubblicazione poco prima della sua scomparsa, comprende la novellistica d'una serie di località italo-albanesi prossime a Catanzaro, e cioè San Nicola dell'Alto, Carfizzi, Pallagorio, Marcedusa, Andali, Vena di Maida, Zangarona. Come ben si vede, andavano infittendosi le tessere e tra breve sarebbe apparso nella sua interezza l'ampio mosaico della narrativa *arbreshë*.

Ogni racconto orale fu rilevato da soggetti di sicura origine albanese, dei quali non si mancò di annotare età, professione, livello d'istruzione; e si prese nota della data in cui avvenne la trascrizione del testo. Trascrizione fedelissima, che ne garantisce l'attendibilità. Ogni testo è stato tradotto letteralmente in italiano, con lo scopo evidente di renderlo leggibile a una vasta cerchia di lettori, che pur ignorando l'albanese possono trovarvi i più disparati motivi d'interesse.

È ben noto ai folkloristi che l'area di diffusione dei racconti popolari di solito è assai vasta, e che uno stesso racconto può trovarsi presso popolazioni diversissime per stirpe e per cultura. L'uniformità sostanziale e strutturale dei racconti popolari di tradizione ha da tempo imposto agli studiosi l'esigenza di classificarli, e a tal fine già da alcuni decenni la scuola finnica ha elaborato un indice dei « tipi narrativi », noto internazionalmente come indice Aarne-Thompson, il quale rappresenta un valido strumento atto a classificare un racconto popolare nel suo complesso. A questo indice è stato raffrontato tutto il materiale narrativo italo-albanese già raccolto, e s'è constatato che la maggioranza dei racconti vi aderisce perfettamente: una conferma, se pure abbisognasse, che essi non sono il frutto di creazione estemporanea e personale del narratore, ma scaturiscono dalla memoria collettiva di una gente. Naturalmente anche presso queste comunità i temi favolistici possono aver subito incroci, tagli, aggiunte, e presentarsi quindi in varianti più o meno lontane dal « tipo » originario, o considerato tale. E appunto nel risultato di un libero gioco di tendenze conservative e di spinte innovatrici va ricercata l'originalità di un racconto, vanno ravvisati i tratti etnici caratteristici. È dunque chiaro che il nuovo, più che nella vicenda in se stessa, sta nell'accenno a una consuetudine locale, a un dato storico o geografico ben definito. Ciò che subito colpisce è il gran numero di « racconti di animali », evidente espressione di una cultura contadina; e sono tutti raccontini sapidi, graziosi anche nelle movenze stilistiche, nati da una osservazione diretta e partecipante. Si potrebbe anche fare un rilievo sistematico della frequenza di questo o quel racconto; e per questa via si noterebbe, ad esempio, quanto sia diffusa la filastrocca (n. 2023 dei « tipi » Aarne-Thompson) della gatta che s'imbelletta e si mette poi alla finestra perché vuole trovare marito: passano tanti animali che si presentano ciascuno col proprio verso caratteristico, ma lei li scarta tutti e sceglie il topo, che poi viene regolarmente mangiato. Le fiabe propriamente dette, quelle, per intenderci, che hanno a protagonisti fanciulle e giovani fatati, maghi e orchi, principesse e briganti, matrigne perfide ed eroi dalla forza prodigiosa, sebbene attingano a una tematica pressoché universale, pure mostrano in tanti passaggi le tracce di una creatività autonoma e gli adattamenti determinatisi nel clima storico e culturale del paese ospitante. Andrebbe eseguito tutto un lavoro accurato di comparazione fra il patrimonio narrativo degli albanesi d'Italia e quello

della loro terra d'origine; assai notevoli restano le seguenti osservazioni fatte in proposito dallo stesso Koliqi: « Entrando a far parte dello sterminato e babilonico impero ottomano, estendentesi su tre continenti, gli Albanesi d'Albania ricevettero apporti che penetrarono nel vivo del loro spirito, massime nelle città del litorale. L'elemento fantastico della novellistica italo-albanese consiste nell'intervento di santi, dello stesso Gesù Cristo, di fate, di orchi, di monaci, di demoni, di briganti. In Albania invece le narrazioni pullulano di dervisci, pascià, geni, maghi, di stregoni negri, di *muftì* (vescovi maomettani), di *cadì* (giudici religiosi islamici), ecc. Soltanto nelle montagne d'Albania compare nella letteratura orale una viva mitologia pagana di antichissima origine arioeuropea: le *Zâna* (dee alpestri), le *Ore* (semidee che proteggono gli eroi nelle più temerarie imprese), la *Kulshedra* (l'idra dall sette teste), i *drangoj* (guerrieri sovrumani che difendono il paese dalla *Kulshedra* e dai nemici), la *Lubìa* (mostro malefico metà belva e metà rettile), *Nuset e detit* o *Këshetat* (le spose del mare o sirene), *Floçka* (la ninfa che vive nelle sorgenti o nel pozzo di casa), *viktorija* (il serpente che dimora nelle fondamenta della casa e s'identifica col destino della medesima), ecc. Nelle più antiche narrazioni italo-albanesi non si trova una specifica presenza dell'elemento fantastico orientale, se si prescinde da quelle generiche tracce di fiabe importate fin dalle più remote epoche dall'Oriente e comuni a tutto il patrimonio fiabesco europeo. Gli *Arbreshë* uscirono dalla patria con tutto il bagaglio della loro novellistica prima che il dominio turco spalancasse le porte dell'Albania ai pieni influssi orientali ».

Accanto alle narrazioni fantastiche, troviamo nella narrativa italo-albanese gli aneddoti più o meno scherzosi — racconti di mogli infedeli, di mariti prima traditi e poi fattisi furbi, di servi astuti e abilissimi, di compari che si fanno burle, ecc. — che sono l'umanissima testimonianza di un piccolo mondo di paese. Alcuni di questi non sono riportabili ad alcun modello, non raffrontabili con nessuno dei « tipi » noti: e sono quelli nei quali è dato di cogliere, più che in tutti gli altri, i lineamenti psicologici della gente che li ha prodotti; a titolo d'esempio ci piace qui riportare, nella versione italiana, il racconto dei due mietitori, italiano l'uno e albanese l'altro, che fu colto dalla voce di un narratore di Eianina:

Una volta c'era un italiano che veniva a mietere nella proprietà di alcuni albanesi. Ogni anno si vantava dicendo che in quel paese non c'era nessuno che lo superasse nel mietere.

Un anno gli albanesi si misero d'accordo e trovarono in paese un giovane forte, capace di superare il mietitore italiano.

Quando fu il tempo della mietitura, chiamarono il solito mietitore, il giovane paesano e altri. La mattina, nella fila, mentre stavano indossando il grembiule e infilando i ditali, il giovane albanese indossò il grembiule con la testa all'in giù e mise i ditali alla rovescia. L'italiano lo guardò e disse:

— Questo non sa proprio niente, come se venisse dal mondo della luna.

Il giovane ribatté:

— E tu sei nato istruito? Non hai anche tu cominciato coll'imparare?

Quando si mise a mietere, il giovane albanese afferrò la falce dalla parte della punta. L'italiano lo guardò e lo corresse:

— Devi tenere la falce per il manico e non per la punta!

— Tu sei nato istruito? Non hai anche tu imparato?

L'albanese, invece di tagliare lo stelo al di sotto della mano, lo tagliava al di sopra. L'italiano lo corresse ancora, ma poi perdette la pazienza e disse:

— Proprio vicino a me doveva mettersi costui che non sa mietere.

Spuntò il sole e fecero la prima colazione. Mangiando, quando l'orciolo che conteneva il vino arrivava al giovane albanese, non andava più avanti nel giro perché egli con un sorso lo vuotava. Dopo mangiato, l'albanese continuò a mietere sempre al suo solito modo, e, arrivata l'ora della seconda colazione, si prese la porzione migliore e si tracannò quasi tutto il vino. L'italiano diceva tra sé:

— Costui di mietere non è buono, ma, quanto al mangiare, e al bere, non c'è niente da dire!

E continuarono a mietere. Fattosi mezzogiorno e arrivata la padrona col desinare, l'albanese si comportò al suo solito. Ma dopo si riscaldò: con una sola falciata faceva mezzo covone e lo buttava in faccia all'italiano. Questo lo guarda e non osava più dire una sola parola.

Continuò così per un bel pezzo. Quando il mietitore italiano finalmente s'accorse che l'albanese sapeva veramente mietere e che lo stava addirittura coprendo di mezzi covoni, prese la falce, se la mise sulla spalla e, mogio mogio, se ne andò. E a mietere in quel paese albanese non tornò mai più.

Un racconto, questo, che dà la misura della fierezza orgogliosa degli *Arbreshë* e ben riflette la coscienza della loro individualità etnica.

Në këto kohët e fundit na ka pré thike zêmrat tona Shqiptare, vdekja e papritsheme e dragoit kombtar prof. dr. Ernest Koliqit. *Ernest Koliqi për tanë jetën e vet punoi per Kosovë e per Atdhén tone të dashtun, Shqipnín. Ai që përhapësi i parë i shkollave shqipe në Kosovë. Po të mos kishte qene Ai, sot në Kosovë, sikurse edhe në Çameri, ndoshta nuk mund të gjindesh asnji shkollë e hapun shqipe. Sikurse labat tonë që kanë mesue në gjuhen serbishte e arabishte, edhe na do të mesojshim, kundra vullnetit tonë, n'ato gjuhe. Ndoshta vehtes i kishim thanë në Kosovarët* Shqiptarë, *kishim folë* shqip, *por me shkrue s'besoj se kishim muejtë me shprehë dy fjalë në gjuhën tonë kaq të bukur amnore shqipe. Frytet e sotshëm intelektualë kosovarë, i jemi borxhli të Parve tonë, themeluesve, të dashunve pishtarë të Shqipnís Ernest Koliqit me shum shokë të tjerë. Dhe në këtë ditë zijë, në shenjë pikllimi, perulemi, me lot nder sy, perpara këtij Viganit të madh kombtar Shqiptar. Nder zêmrat tona kosovare, emni i Ernest Koliqit gjithmonë ka me qene i gjallë ndermjet të gjallve.*

NIJAZI SULÇOGLU

(*Koha e Jonë*, nr. 1-2-3, Vjeti XIV, janar-shkurt-mars 1975, faqe 50).

I lumtur në jetë, i lumtur në vdekje

nga AGO AGAJ

Në verën e vitit 1939, në Tiranë u hap fjala se Mati Logoreci ishte sëmurtur rëndë.

Vajta për t'e parë mikun e vjetër dhe e gjeta shtrirë në shtratin prej të cilit nuk u ngrijt më, por me mëndje të kthjellët dhe fjalët dhe idetë po ashtu.

Nuk e zgjati shumë muhabetin mbi sëmundjen e tij e vuajtjet e mija dhe erdhi në atë që kishte pasur merak e i kishte dedikuar gjithë jetën e tij të gjatë : *gjuhën shqipe.*

Më pyeti në se e dija seç i zhduk popujt dhe iu përgjegja me njëherë : luftrat e shumta, zija dhe sëmundjet epidemike të tmerrshme si lija, kolera etjera.

Tundi kryet me energji e më tha : « Ilirët dhe Thrakët u zhdukën vetëm se nuk kultivuan gjuhën e tyre, e lanë mbas dore, e përbuznë, e harruan dhe u asimiluan prej Sllavëve e tjerë popuj dashuronjës të gjuhëve të tyre ».

Pushoji një copë herë dhe filloji të deklamonte porosinë e mallkimin e Fishtës :

Pra Shqyptarë çdo fesë qi të jini
Gegë e Toskë, Malci e qyteta
Gjuhën tuej kurrë mos t'a lini
Mos t'a lini sa të jetë jeta
Po për te gjithmonë punoni

U prejt edhe njëherë plaku i admirueshëm sidomos për dedikimin e tij mblodhi ato të pakta fuqi që i kishin mbetur dhe me zë të fortë rifilloj :

Pra mallkue nj'ai bir Shqyptari
Qi këtë gjuhë të Perendis
Trashgim qi na la i pari
Trashgim s'ia len aj fëmis.
Edhe atij iu thaftë po goja
Qi e përbuz ket gjuhë hyjnore
Qi në gjuh t'huej, kur s'âsht nevoja
Flet e të vetën len mbas dore.

« Në këtë porosi e mallkim të Fishtës bashkohem edhe unë me gjithë zëmër këtu në këtë shtratin e vdekjes.

Pra iu lë amanet gjuhën shqipe ».

Ditë më vonë u poqa rastësisht me Ernestin, Ministër i Arësimit dhe i tregova seç porosi më kishte dhënë M. Logoreci dhe shtova : « Aji e dinte mirë që unë nuk jam as shkrimtar as gojtar por me gjithëatë nuk iu durua pa më porositur ».

Ernesti më tha se fara duhet hedhur se nga një herë bin atje ku nuk t'a merr mendja. Piqu me të dhe njëherë dhe i thuaj se edhe na jemi bijt e tij e të Fishtës dhe e kemi për zëmre gjuhën tonë. Do të bëjëm ç'të jet e mundur e pa u kurcyer.

Dhe ashtu bëri. Zhvilloj arësimin në Shqipëri, hodhi themelet në Kosovë e viset e tjera shqiptare që u bashkuan me mëmën gjer në 1944, jo vetëm por edhe në ato vënde që kishin mbetur jasht kufive tona si në Mitrovicë, Vuçitern e gjetkë. Dhe kur u nda nga Atdheu për gjithënjë Aji e vazhdoji këtë mision të shenjtë me anën e Kathedrës në Romë dhe shkrime e botime pa u çlodhur « gjer në buzë të varrit nuk iu nda ».

Vdekja e pa pritur e ndau nga ky veprim. E rrëmbeu si ujku qëngjin.

Në hidhërimin tonë nuk duhet të harrojëm se Aji qe fatbardhë në jetë e në vdekje. Shumë njerëz janë përpjekur me zell për një qëllim të lartë e të mirë por pak janë ata që patën fatin të shohën farën e mbjellë gjatë jetës përhera duke u rritur e përparuar. Ernesti e pati këtë fat.

Dardanët në Kosovë e Maqedhoni farën që mbolli Ky e kultivuan me zell të madh e zotësi të pashoqe dhe arrijtin në një shkallë arësimi e cila gëzon e krenon të gjitha zëmrat shqiptare kudo që janë dhe — natyrisht — atë të Ernestit ca më shumë. Poashtu lulëzoji edhe ndër Arbreshët e Italisë dhe sot edhe atje kemi një shumicë të doktoruar në gjuhën e literaturën tonë, ku më parë nuk kishte fare ose fare pak.

Se ç'do të thotë për bujkun, ç'gëzim i pa shoq është për të kur të mbjellat rriten, lartësohen, zbukurohen e zbukurojën përqarkjen e di unë që jam bujk e i lidhur me mish e shpirt me naturën. Edhe Aji ishte nga më të mirët që kemi pasur gjer më sot veçse Aji mbillte ushqim për shpirt e mëndje të kombit.

Kush ka patur një fat të tillin? Rrallë, shumë rrallë. Pra Aji qe me fat në jetë e me fat në vdekje.

Vdiq? Po, por vetëm trupi i Tij se mendimet e Tij të shfaqura në atë gjuhë të pashoqe, në gjuhën hyjnore, do të vazhdojën në jetë të jetëve të jetojën bashkë me emërin e Tij. Pra është i pavdekshëm.

Vdekja e Babës

nga GJON SINISHTA

Në nji dhomë të zbehtë nga flaka e qiravet
pásh me sytë e mendes,
gjind që u endëshin gjithnji në heshtime ...
me ftyra të mbrroluna e faculeta në duer,
që ndryshim pak kishin nga hijet e tyne.
E petkat e zeza i diftojshin gjithkuej
kobin që kurrkushi s'lakmon.

Në shtrojën e përjetëshme Baba ish shtri,
i veshun me stolina, si dikuer për festa,
dhe ftyra i shkelxente si çdo udhtarit,
kur kamba i shklet në prakun e pakthyeshëm.
E fmija e pa sherr, me 'i zâ të përkdhelët
nanat pa-prâ i pretshin:
— E përse, loke, gjyshi ende s'âsht zgjue?

Njerzimi vlonte si bleta kur lëshon
dhe në zemra të familjes tashma
shperthei nji vulkan i pashqimun,
që dnesët e deritashme i shndrroi në piskame,
të cilat me hor naltsoheshin kah qielli.
E drrasat lageshin nga shiu i syve
n'sa arkivoli delte për dere.

Rruga e kodrës të tanë leqe-leqe,
që nierzit i çonte te fshati qetësis,
shembllote per mue nji gjarpen të helmuem;
e jehona e kumbonës së vjetër,
që moti varej në dy qarra shekullore,
pikllonte çdo zemer, dhe njoftë e panjoftë,
me vedi sejcili shqiptonte: Dritë pastë!

Tashma Baba, në skaj të votrës s'amshueme,
pritëte buzëqeshun përshëndetjet e fundit;
e unë për së largu, me sy si buçila,
faqoren me ia njomë pamasë dëshrova,
por mjekrra e tij e ashpër, faqet e mija,
mjerisht kësaj rradhe nuk mi therri,
si prore në vogjli, kur ngrykë e merrshe.

Prishtinë me 19 nanduer 1956

Ricordo impressionistico del prof. Koliqi

di GIOVANNI CAVA

La notizia della morte del prof. Ernesto Koliqi si diffuse immediatamente la sera del 15 gennaio 1975 nella cerchia degli amici del centro italo-albanese di S. Demetrio Corone con la rapidità delle notizie tristi e dolorose, che recano stupore e commozione.

Il prof. Koliqi era una figura ben nota in S. Demetrio, non soltanto per la celebrità del nome, ma anche perché era solito trascorrervi ogni anno, da diversi anni, brevi periodi di vacanza, oltre alle sporadiche soste occasionali durante gli esami di abilitazione per l'insegnamento della lingua e letteratura albanese, che si svolgevano di solito a Cosenza, sotto la sua presidenza. Ospite ben accetto del compianto prof. Demetrio Mauro, anch'egli scomparso improvvisamente da più di un triennio, era sempre accolto con simpatia dalla calorosa cordialità dei comuni amici.

Quei brevi periodi di permanenza nell'amena tranquillità del paese gli offrivano l'occasione di rinfrancarsi in una serena distensione spirituale dalle severe fatiche universitarie e dallo stress cittadino, ma nello stesso tempo gli davano la possibilità di rinnovare gli incontri con gli amici, riprendere i contatti con il mondo italo-albanese, tenere qualche conferenza, promuovere dei convegni, animare seminari culturali.

Dismesso l'ermellino, pure conservando il fascino ed il prestigio del Maestro, che gli derivavano dalla varia e profonda dottrina, rivelava, nella pratica dell'amicizia, la schiettezza naturale del suo carattere generoso, affabile e gioviale, l'innata nobiltà dell'animo, la spontaneità del sentire. Portato qualche volta alla polemica, sempre si conteneva nei limiti di una razionale moderatezza, disposto piuttosto, per inclinazione naturale, a sentimenti di umana solidarietà e comprensione. Piacevole e vario nella conversazione, propenso istintivamente all'arguzia, se l'argomento gliene dava motivo, sapeva usare con senso di opportunità e con il garbo e la sobrietà del raffinato umorista la sapida barzelletta, per colorire meglio il suo discorso.

Non tenero ai facili trasformismi, geloso assertore della coerenza interiore della coscienza, si dimostrava intransigente nella difesa delle sue idealità; accettava, perciò, l'amarezza dell'esilio con la sofferta rassegnazione del credente. Tornava volentieri a S. Demetrio, quando ne aveva l'occasione, anche perché alcuni rioni del paese gli ricordavano intimamente i quartieri e le viuzze della vecchia Scutari.

In occasione del 150° anniversario della nascita del De Rada le sue visite furono più frequenti e più frequenti i contatti e gli amichevoli incontri per programmare il comune lavoro; in effetti, Egli fu il promotore e l'animatore

entusiasta delle diverse manifestazioni culturali, che si alternarono nei paesi italo-albanesi, dimostrando, con la sua meravigliosa capacità organizzativa, la ricchezza delle sue esperienze culturali e la pienezza d'amore per la poesia e la storia del mondo italo-albanese.

Altri si soffermeranno a trattare dell'opera critica e letteraria del Koliqi con specialistica competenza; noi abbiamo inteso soltanto, modestamente, rilevare una nota della sua umanità, che avvalorata dalla sua natura poetica, concorse a rendere feconda l'opera del Maestro, determinando un primato di questa sulla stessa produzione dottrinale. Per questo il suo ricordo è più vivo e la sua scomparsa più sentita e dolorosa.

... Fitim i madh për Kosovë kje hapja dhe funkcjonimi i shkollavet shqipe, të cilat qysh atëherë reprojnë e lulzojnë të kërthnesta dhe me nji rythëm të shpejtë dhe të pandalshëm i falin Kombit pijoner të rijë qi do të jenë garantija mâ e shëndoshë dhe uzdaja e s'ardhmes s'atdheut.

E merita kryesore e kësaj reprimtarije patriotike të qevcris shqiptare, pa dyshim, i përket Ministrit t'Arsimit t'asaj kohe, Profesor Ernest Koliqit *i cili, me rullnetin dhe me shpirtin e nji idealisti, nuk kurseu energjit e tij dhe mjetet shtetnore qi kishte në dispozicjon për t'a pajisë sa mâ mirë aparatin arsimuer në viset e lirueme me elementa të shëndoshë q'i dhanë hov'e gjalluí shkollës shqipe.*

E sod, për fatin e bardhë të Kombit, âsht formue atje nji riní dinamike ecila, në çdo fushë t'aktivitetit kombtar e shtetnuer, po pregatitet e po forcohet për t'a lumnue fatin e vendit në t'ardhëshmen.

Profesor Koliqi, q'edhe në dhé të mërgimit nuk e ka pushue interesimin dhe veprimtarín e frytëshme të tij për punët e Kosovës, ndjekë gjithnji me cenë e me zéll të madh zhvillimet dhe përparimet e shkollavet shqipe dhe të rinís shqiptare në Jugosllaví, për të cilat ka kujdes e lakmí të teprueme qi puna e frytëshme të mos ndalet, të mos ndërprehet.

... Më pëlqen me theksue këtu se njiherë kur i pata vojtë në zyrë për disa nevoja shkollore (me kërkue disa mësues dhe bursa për disa studenta) jo vetëm m'i plotsoj me njiherë këto kërkesa, por ishte entuzjast e i gatshëm më sherbye për çdo gjâ qi ishte në dobín e Kosovës ...

... Pra, me shum arsye Ernest Koliqi zên nji vend të naltë ndër zêmrat e dashamirvet të Kosovës e njiherit n'historín e përpjekjeve për naltësimin kulturuer të saj.

TAHIR ZAJMI, *Kontributi i Ernest Koliqit për Kosovën* në *Shêjzat*, VII, 1963, n. 5-8, faqe 221-222.


Unë, profesor Koliqi dhe e përkohëshmja « Shêjzat »

nga **GIOSAFAT FRASCINO**


Tek fshati im, që ëmër Firmoz (*Acquaformosa*) ka ëmër që i qëndroj të parën herë Monasterit të Shën Mëris që thuhej Shën Mëria e Shën Leucio dhe pas fshatit, kur një ditë, perëndesha të Bisinjanit, *Erina Kastriota-Sanseverino, mbesa të Janit, i biri* të Skanderbegut,[1] feudatare të Bragallës (*Altomonte*) si piu uj të mirë dhe të ftolt, tek kroj që sot thuhet « *kroj Batis* », me hare tha : « *haec est Acquaformosa* » në 29 të muajt gushtit kur është kremtimi Shën Janit, dita që ketij i pren krjet, dhe tek viti 1961, afër kishës që ka ëmërën e këtij Shëjti, një burrë, ndryshe nga njeriu që sot banon fshatet arbëreshë, për trupin të madh, si e kishin të partë Shqiptarë, për një zemërë fisnike, për një mendje të lartësuar, si mbjatu, nganjë mund kuptonj, ecnij vet vet, dhe ishë i ruajtur me çuditje nga gjithë. Në mest gjithëve, qe kush tha : « *Është një shqiptar; është profesor Koliqi* ». Ky nieri i hieshëmë qe i njohur, si mbjatu e njoha edhe unë pse gati pes vjet mënjehere, ketu u gjiegj fjala e tij shum e lartë, që edhe keshtu thoj : « Kalabria me male të lert, si Pulini dhe Mali Ashëpër (*Aspromonte*) ku u mbjodh më shum se ndër ndryshe vende "gjakut shprishur", i dukej e dyta Shqipëri ». Ahirna, kur na foli tek një odë të shtëpis njij miku, pas çë mbaroi fjalën e tij, unë thash timen, ndëmos se istorin të *Arbëreshëvet* të Italis pak e njihja. Kjo e njoha, si pas një vit, 1957, papas Selvaggi, shkrimtarë arbëreshë më dha abetarien e gjuhës shqipe, (Kungavi Monastirit) dhe keta dy livre : *Gjiella e Shëmëris Virgjër* të Varibobës e *Milosao* të De Radhës. Si këndova keta dy livre dhe ndryshe, shkruajta vjershe; ishë viti që u butua i *pari numër* i *Shêjzavet*.

Të dytën herë — dita Shën Janit 1961, — profesor Koliqi u gjënd Firmoz me timin mik të Ungres, Savoiardo, që i kishte dhën mikpritjen. Pata rasën ti fjsja dhe ti thoja se shkruaja poesi arbëreshë dhe një ndër këto, papas Selvaggi, ja kishë buthëtuar dhe e kishë gjetur

[1] Albero genealogico, qui unito.



Albero genealogico dei discendenti di Giorgio Castriota Scanderbeg (Tav. I)



Albero genealogico dei discendenti di Giorgio Castriota Scanderbeg (Tav. II)

pëlqyeshme; por nuk e butonij pse kishë të njih mirë shkrimet e autorit ndëse vlejn. Më tha ti dërgoja disa vjershe Romë dhe më dha drejtimin; me kohë ja dërgova.

Pas disa ditë më u përgjegj kështu, me një letër:

Università di Roma
Facoltà di Lettere e Filosofia
Istituto di Studi Albanesi

Roma, 17-10-1961

Caro amico,

ho ricevuto il manoscritto delle sue liriche e la ringrazio di cuore. Sto leggendole per farne una selezione adatta al pubblico di Shêjzat. *Già nel nostro giornale* Albanie Libre *(nella pagina letteraria) ho fatto stampare una sua graziosa ballata. Nel prossimo numero della rivista* Shêjzat *spero di poter far conoscere un certo numero delle sue poesie. Avrei bisogno di brevi cenni bio-bibliografici sul conto suo.*

Stiamo preparando per la fine di quest'anno un Numero Speciale di Shêjzat *in onore del Poeta Giorgio Fishta, di cui ricorre entro il 1961 il 90° anniversario della nascita. Egli, che è considerato il più grande poeta epico della gente d'Albania, è stato completamente radiato come se non fosse mai esistito dalla storia della letteratura edita nell'Albania rossa.*

Mi saluti i comuni amici e si abbia una cordiale stretta di mano dal suo

Ernesto Koliqi

Ndër aq vjet në rivistë *Shêjzat* keshtu më butoj të mitë shkrime:

Tek vjeti V-shtatuer-tetuer 1961 poesin *Katundi im.*

Tek vjeti VIII-mars-prill 1964, shkrimin nëpër *Legjenda* të Martin Camaj.

Tek vjeti VIII-korrik-tetuer 1964 poesin *Jeronim De Rada.*

Tek viti X-shtatuer-dhetuer 1966 shkrimin *Dhietërvjetori i rivistës* Shêjzat.

Ahirna, profesor Koliqi dhe profesor Camaj që nga Ai ishë i dashur mirë si një bir, më dërguan një letër dhe kështu më thojnë:

Shêjzat
(Le pleiadi)
E përkohëshme kulturore, shoqnore e artistike
Rivista culturale, sociale ed artistica

Roma, 2-9-1966
Piazza della Balduina, 59/7

I ndershmi e i dashuni Bashkëpuntuer Z. Jozafat Frascino,

Në fund të vjetit 1966 Shêjzat *mbushin dhetë vjet të jetës së tyne. Dolen për të mprojtë shêjtnimin e trashigimit t'onë stergjyshuer, jo me fanatizëm të verbët e verbues, por me mendesqueti e pjekunin gjikuese qi jep nji pregatitje kulturore moderne shpirt-ndritëse. Traditat t'ona të vjetra u përpoqem, tue i pertrî nepër frymë e dituni të kohës së sotshme, me i bâ mjet naltësimi e vellaznimi kombëtar e kuptimi ndërkombëtar. Qellimi i yne âsht qenë e âsht me hy në valle të përparimit njerzuer tue sjellë në strajcë të kulturës s'onë vetit mâ të pikatuna të kombesis shqiptare.*

Ju mirësisht na keni përsjellë me nxehtësin e sympathis s'Uej ç'prej ditve të para të kësaj përpjekje s'onë së vështirë e cila shpesh jo vetëm nuk qe e çmueme sa duhet, por nga nji herë dhe u keq-kuptue. Ju keni besue në punën t'onë e na keni nderue me bashkëpunimin e Juej. Tue u shprehë mirënjohjen t'onë mâ të thellë, U lutemi prandej me na dërgue ndonji shkrim t'Uejin për numrin e jashtazakonshëm

(i cili do të përfshije numrat 9-10-11-12 d.m.th. shtatuer-dhetuer 1966) qi do te dali kah fundi i ketij vjeti per te kremtue dhetëvjetorin e botimit te Shêjzavet.

Per arsye ngushtice vendi, U lutemi qi shkrimi mos te kaperceje ¼ faqe të dakti-loshkrueme e te na arrije ne redaksi jo mâ vone se me 15 tetuer te k.vj.

Me perzemersin mâ te çiltert, U dergojme te falat t'ona miqsore.

ERNEST KOLIQI
MARTIN ÇAMAJ

Tek vjeti 1968-XII-kallnduer-mars, më butoj keta vjershe: « *Vjij qenje për të verbër* » - « *Dy Firmoza të rea* ». - « *Ngë dij pse gjaku e tilq* » - « *Vreshta piak* ». « *Gjashtëdhetë vjetori i lindjes të gjellës ime është e qaset* ».

Në Italit pas e dyta luftë botërore e para revistë shqipe ose arbëreshë, pse kjo i hapu derën edhe shkrimtarëvet arbëreshë qe *Shêjzat* që pat lindjen si e varfër, si mund gjënden të parën herë gjithë rivistat, por mbjatu u ndryshua si shkuan pak vitra, me shkrimtarë shqipetarë, italishtë, tedesk dhe arbëreshë, të zgjedhur; kështu kjo revistë, të parën herë, dreq si një dhe me hithë, me gjëmba, me ferra, i shqepët, u gjënd mbjatu si një lulishte me të bukura lule, aq sa mbjatu si nënë i dha vetëhen ndrysheve rivistave, arbëreshë si *Zgjimi*, *Zjarri*, *Zëri Arbëreshëvet*, *Katundi ynë* që më butuan edhe poesi; kështu gjuha shqipe, përherë vështirë, si gjithë gjuhët e botës, si një ndallandyshe shkoj male dhe detra, dhe per çmimin të Koliqit që si gjithë shkrimëtarë famshëm, u gjënd me miqësi, si edhe me shum armiqësi, pse në botë njeriu buthtohet gënjeshtarë dhe qesharakë për atë që në shoqërit është i hieshëm.

Shkrimtari Lec Shllaku që tek rivista *Koha e jonë* më butoj disa poesi, nga Boulogne, në 20 korrik 1970, tek një letër, edhe kështu më thoj: « Tue pasë dhanë prova se nuk jemi *sektar* kam kerkue me bâ lidhje me Arbreshët të cilët më tërheqin shum dhe kam nji simpathi të veçantë. Mjerisht përveç të Ndierit Rosolin Petrotes, dhe tash vonë papas Bellusci, ju jeni i treti, nuk kam pasë mujtë me bâ bashkpunëtor të cilët do t'i shtojshin shum vleftën revistës s'onë. Nga ana tjeter nuk u a ve faj, prof. Koliqi ka qenë përherë pranë tyne dhe *Shêjzat* janë nji revistë me kuptimin e plotë të fjalës dhe me vlerë Internacjonale, prandej asnji akt gjelozije, përkundrazi na nderon të gjithëve, në diaspor që janë të gjakut t'onë të shprishur ».

Këngtari i Shkodrës që lindjen pat atje, dhe gjithë të Shqipëris, me shumë fuqi, durim dhe punë, zgjoj me vepratë e tij, që janë pa numër, Shqipetarë, Arbëreshë mos të harrojn gjuhën e tyrve që është vetëhea, dhe shpirti njeriut. Dhe në Kosmet (Jugosllaví) nuk harroj gjithë shqipëtarë, që banojn atje dhe keshtu edhe për piesin e tij, letërsia shqipe dhe gjuha pat përparimin me të vlier shkrimtarë e poetra si Enver Gjerqeku, Adem Gajtani, Ganimete Nura, Fahredin Gunga.

Ndër veprat e tij, numeroj disa si *Kushtrimi i Skanderbeut; Hija e Malere; Tregtar Flàmujsh; Poetët e mëdhej t'Italís; Gjurmat e Stinve; Antologjia të lirikës shqipe; Pasqyrat e Narçizit; Symfonija e Shqipere*, etj.

Ndër gjithë numërat të rivistës *Shêjzat* e para faqe përhëre kishte një shkrim të gjatë e të mirë të *Hilushit* (pseudonim të Koliqit) që si gjithë shkrimtarë të hieshëmë bëgatëtin letërsin e kombëvet te tyrve tue mbajtur zgjuar umanesmin, të të riun klasiçisim, klasiçisimin, illuminismin, romantiçisimin etj.

Si ndërroj jetë De Radha, Schirò, dhe ndryshe shkrimtarë të vleshëm si këta të dy, studhimet e albanologjis patën prapësin, dhe u zgjuan vet për çmimin e Koliqit që me vëllezëri hapu miqësin me shkrimtarë arbëreshë që gjithënjherje u gjëndëtin kështu edhe për pjesin e tij.

Dita që Koliqi mendoj të zgjonij letërsinë, gjuhën arbëreshë, që disa duan të thon se nuk qe kurrë, pse nuk njohtin poesit autorëvet si Serembe, Santori, Variboba, De Radha, Schirò dhe të ndrysheve shkrimtarë të vleshëm që qen dje dhe që jan sot, si pat fatbardësin të përpiq miq, pat edhe fatkeqësin pse ju gjëndëtin shum armiq paditur që thojn se gjuha arbëreshë kishë të harrohej pse *ni jemi italianë!?!*

Është Arbëreshi që me fjalin e urtë, kështu thot: « ndëse gjithë zogjt njihjn grurët, kurrë ndër fushat nuk korrej ».

I vogil, pesmdhiet vjet, u njoh mbjatu se ishë poet kur a Bergamo tek fletoria studhentëvet *Na të rijt* shkrimet e tij kishin mendime poetikë. Ndutu poesia e tij i qe shum e lartë pse nuk ndënj vet në Shkodrë ku pat lindjen, por njohu shum botë (Shqipëri, Itali, Mali, Zí, Boznia, etj.) dhe me zemërën e tij njohu për motive shoqërore dhe politikë më shum helme se gëzime.

Shkrimet e tij, mënjherë se të butonëshin tek rivista *Shkëndija*, *Albanie Libre*, *Shêjzat* që patën themelimin nga Ai, u butuan ndër ndryshe si *Ora e Malere*, *Hylli i Dritës*, *Leka*, etj.

U zbulua mbjatu ndër shkrimet se poesia e tij me shum arsim është shum e lartë, pse, pat lindjen poetë, qe i madh punëtor, drejtimin e pat nga më të famëshëm shkrimtarë si Luixhi Gurakuqi, Fishta dhe ndryshe. Për punën të lartë kulturorë të Koliqit, Akademia e vjetër e Shkencave (quajtur *Teatine* e qytetit të Chieti-t (Abruzzi) në vitit 1965 (1° qershor) e emëroj si *Anëtar nderi për merita letrare*; që *anëtar me nderë* t'Akademjes Abrucevet, prill 1966; *membrë ordinarë* të Akadhemjes Tiberinë (qershor 1966); *Konsilierë* të Akadhemies Medhiterranies (tetor 1968); *anëtar me nderë* të Çentrit Internasionalë Studhimeve Shqipeve të Palermit etj. Profesor Koliqi, poet i lirë, si ndërroj jetë, fëmija redaksis e *Shêjzavet* me idhërim dhe me zërën e saj shumë të lartë i thot gjithë botës shqiptar dhe arbëreshë se ëmëri tij do të qëndroj në letërsin shqipe ndër shkrimtarë i hieshëmë si De Radha, Frashëri dhe Fishta.

Vjersh

Këngëtari që nuk shihet më, por gjegjet:
kushtue Ernest Koliqit

Fati, këngëtarit madh shumë i lik qe,
pse, shpresa i iku se të kthehej n'atdhe,
pse, Ai, gjithnjiherje, jetë ndërroi
dhe kush e njih, i taraksur qëndroi.
Me burrëri këtu u buthtua Shqiptar,
që tek ki, sot, është më i madhi shkrimtar.
Edhe letërsinë arbëreshë Ai zgjoi,
dhe për këtë, Arbreshi shumë mirë e doi.
Ki i hieshëmë këngëtar, edhe shkrimtar,
me një zemërë fisnik nga gjithë qe i parë
pse, ajo, me Arbëresht, me Shqiptart qe e ndarë,
dhe ni, ata dhe keta, lan një të qarë.

... Ndër të gjitha veprat origjinale të prof. Koliqit, ajo qi i dha shkelqimin dhe dritën ma të madhe figurës së tij, asht revista *Shêjzat* (Le Pleiadi) të cillen aj e xen fillë me 1957. Ket revistë akademike kulturale prof. Koliqi e drejtoj për 19 vjet rresht tue pasë si bashkëpuntorë akademikët ma në za të Universiteteve të ndryshme t'Evropës. Gjatë kësaj kohe mjaft të gjatë *Shêjzat* u ba organi kultural shqiptar ma i njoftuni, jo vetëm në diasporën shqiptare, por edhe në mbarë botën e lirë prendimore, ndër qarqet kulturale t'Italisë, t'Austrisë e të Gjermanisë. Gjatë 10 vjetorit të parë të ksaj reviste, prof. Koliqi ka radhitë ma se 86 artikuj studimesh letrare e vepra poetike origjinale, përveç sá e sá shkrimesh të tjera të rastit dhe editorjale të çmueshme. Ket revistë aj e drejtoj me dignitetin ma të madh të nji akademiku shqiptar, dhe pena e tij e artë nuk pushoj krijimtarinë e sajë deri në momentin e fundit të jetës së tij.

Qendra Islame Shqiptare-Amerikane si dhe *Redaksija* e kësaj reviste fetare e kulturore i paraqet fmijve të tij, vllazënve si edhe mbarë far'e fisit, ngushllimet t'ona ma të thella për ket humbje kaq të randë.

F. D.

[*Perpjekja e Jone* (Our Effort), Vol. V, 12 november 1976, nr. 7-8, faqe 146-147-148].

Ernesto Koliqi

di ADOLFO PLACHY

Quanti conoscevano Ernesto Koliqi hanno accolto la notizia della sua scomparsa con immensa tristezza, perché non possono liberarsi dalla convinzione che con Koliqi finisce una epoca della grande fede nella cultura, nel messaggio spirituale. Con la sua vitalità, illuminata dall'intelletto, da una vera passione intellettuale, e dalla sensibilità altamente umana, Koliqi sembrava incarnare l'essenza di questi valori.

Incontravo regolarmente Koliqi durante le riunioni del Comitato Cattolico Docenti Universitari, organizzate dai dottissimi Padri Rosminiani nella loro sede accogliente presso la Porta Latina.

Koliqi si faceva notare per il suo spirito fine e ricco, a sfondo leggermente malinconico: *le désespoir calme,* si direbbe con Anatole France, ma mai ironicamente caustico. Rimanevamo in lunghi colloqui nelle pause ricreative tra le dotte conferenze ad alto livello, organizzate dai Padri Rosminiani. Quanto a me, cultore della filologia, mi attirava il mistero della lingua albanese con la sua ricchezza quasi provocante della materia fonetica, la quale seduceva alle ipotesi temerarie con le incursioni risalenti sino alla sfera indoeuropea molto antica — dunque una vera leccornia per un linguista!

Le impostazioni fondamentali di questo prezioso patrimonio linguistico attendono ancora ad essere ordinate, adoperando il metodo rigorosamente scientifico, e nessun altro che Koliqi sarebbe stato chiamato a titolo più giusto di farlo.

Koliqi, però, fu anche ed anzitutto scrittore e poeta e qui vale la parola del grande critico tedesco Gottfried Benn, il quale definisce il processo creativo come *ipertensione metaforica dell'essere* la quale travolge il poeta, interrompendo la riflessione fredda, prevalente presso uno studioso. Così Koliqi divenne scrittore di fama mondiale. La definizione di Benn vale anzitutto per i grandi rinnovatori del linguaggio e fra quelli apparteneva anche Koliqi.

Koliqi fu l'uomo di grande fede sviluppatasi nella cornice del retaggio glorioso dell'Italia umanistica e cattolica; Koliqi, cogliendo il fenomeno culturale con una bella formula sintetica, adoperava il termine di *luce filosofica e religiosa.* Data questa sua coscienza e date le svolte attuali poco incoraggianti della realtà culturale, gli ultimi anni della sua vita rappresentavano l'angoscia e la lotta interiore tra il pessimismo e la speranza.

Lasciamo agli altri, specialisti della materia, una valutazione adeguata del grande uomo ed artista, che fu Koliqi, accontentandoci di esprimere qui la certezza che la sua anima immortale ha trovato, come bene supremo, la soluzione definitiva delle più alte questioni le quali travagliavano il nostro Caro Amico nella sua vita terrena e che, attualmente, Egli è in possesso della più alta verità dell'essere umano.



Instituti i Studimevet Shqiptare n'Universitet të Romës: Kursistat e nji vjetit akademik
Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma: gli alunni di un anno accademico

Profesori u nda nesh!

nga LEC SHLLAKU

Lajmi i trishtueshëm i vdekjes së *profesor Ernest Koliqit*, si njeri i shkencës dhe i kulturës s'onë, kumboi thellë e rândë në mbarë Diasporen Shqiptare. Nga ana tjetër lajmi i zí erdhi befas, njashtu si vijnë mënxyrat, të gjallëve në këtë botë. Ushtima e kësajë humbje, të pazavendsueshme, prodhoi efektin e zhdukjes së nji personi të dashtun, të nji miku, të nji vllau a të nji prindi dhe, sidomos, t'atij që, për kulturen e thellë e të gjânë, përfaqësoi nji rradhë shkrimtarësh dhe poetësh të vêndit t'onë sá, botkuptimin e nji përjudhës së lumtun e cila, me humbjen e tij, u zhduk.

Âsht e vertetë, si thotë nji shprehje popullore se: « *jemi të gjithë birt e dekës* », dhe Profesori ka lá, kështu, nji detyrim ..., por institucjonet t'ona kulturore sá vetë konsolidimi i gjuhës dhe i leteraturës s'onë, kishin nevojë edhe për kujdesin dhe interesimin e tij, e ky fakt na trishton së tepërmi mbasi me humbjen e Profesorit, shtyllë e vertetë e nismeve dh'e lidhjevet me qendrat e ndryshme kulturore të diasporës, edhe po qe se nuk do të shkimen me vdekjen e Tij, jemi të bindun se ato do të mejnë në cilësí dhe gjallëní, dy virtyte që dalluen prof. Koliqin dhe i ruejti, edhe pse në moshën shtatëdhetëvjeçare, deri në fund.

Ajo, mandej, që na prekë thellë dhe dhimbëshem, âsht se me vdekjen e Koliqit, zhduket edhe i mbrami shkrimtár e poet shkodranë i cili, me nji rradhë poetësh dhe shkrimtarësh tjerë, qenë jo vetëm nderi i kulturës dhe i shkollës shkodrane, por edhe i tanë Shqipnisë.

Me gjithqë në Shkodër jetoi pak, jetën e qytetit të vet, të rretheve me malsina e pat njoftë thellë tue i kushtue nji kujdes të veçantë, për me i vue në pah dhe për t'i përjetësue ndër shkrime, novela e vargje, pse i konsideroi si yje të nji qytetnimi të vetëm dhe shum të meritueshëm të vêndit t'onë. Mbas aq mënxyre që u shkapet mbi qendren kulturore të qytetit të vet, Koliqit i qeshte ftyra sa herë që, tue gërmue ndër shkrimtár e poet të sotshëm, në Shqipní, ndeshte ndonji shkodranë: « *Shkodra ka tradita të shëndoshta kulture* — nenvizonte — *e sadoqë e kanë zhbi dhe e kanë shembë shkollën shkodrane, ja prap se prap dalin poet e dalin shkrimtár* », e tue shfletëzue faqet e nji libri a reviste, nxjerrë nga turra e vëllimeve që kishte përpara, mbi tavolinë, lexonte ndonji varg që mâ shum ia kishte prekë ndjeshmëninë e trillin poetik.

Habitej ndigjuesi kúr Profesori fliste, komentonte a çfaqte ndonji mendim a opinjon, nga rrjedhëshmenija e të folmes, pasunisë së shprehjeve, të skajeve, sinonimeve a të fjalëve të shkrime prej Tij, si e si që edhe në gjuhën shqipe të mund të çfaqeshin dhe të përjashtoheshin : « *mendimet mâ të naltat dhe ndjenjat ndër mâ të thellat* », ishte nji thesar dhe burim armonjoz i pashterrshëm : dije dhe humori, të cilave nuk u mungoi kurr theksi tipik i shkodranishtes.

Ndoshta lexuesi nuk âsht tue shijue, në këto rreshta, të dhana kulturore të Profesorit, të më fali, atë ia lamë kompetentave të vërtetë për të dhanë gjykime rreth aktivitetit kulturor dhe çka Ai përfaqësoi në lâmen e dijes, veç duhet mendue se jeta e nji personalitetit, të peshës së Koliqit, përbâhet edhe prej marrëdhanjevet të përditëshme, mbajtjes së nji korrispondence të rregullẗ miqësore me bashkatdhetar, të cilat përmbâjnë aspirata dhe ndjesina njilloj të randësishme, si nga ana tjetër pritja e përcjellja formojnë p'jesë të pandame të karakterit të personazhit i cili, mandej qe jashtzakonisht i qindrueshëm, gati kryeneçë, por përherë i dallueshëm, pse në të u pasqyruen tiparet e gjindës s'onë, si qe brumosë e ngjeshë ai i pleqvet t'onë : *urtí, durim* e *logjikë*. E për hirë të vertetës, nuk mbajë mend që Profesori të ketë shprehun nji mendim apo opinjon të bazuem në thashë e thana, të ketë përjashtue apriori mendimin e tjetrit, tepër i naltë shtati i tij, « *per le miserie umane* », thoshte, « *nuk kam dert, ajo që më rjen keq âsht se kerkohet me mbulue diellin me shoshë, me zvogëlue punën e mundin e tjetrit per me rue në pah të vetin, që mandej po t'u japim peshën e tyne të vërtetë, tue i ruejtun përmasat, janë sá nji kokërr ranë në dëtin e gjânë* ».

Shpesh, tue bisedue për ngjarje e njerz të së kaluemes, mbasi kishte shprehun mendimin e vet, ndigjonte me vemendje « kumonën » tjetër e jo fort rrallë, mbasi binte në dyshim dhe ndoshta bânte, me vedi, krahasimet e rastit, shtonte : « *nuk e kam dijtë, mirë që m'a the e m'a sqarove!* » Nga ana tjetër, Profesori kishte nji arkiv të pasun me dokumenta, të ndame në dosje, ku si mbas nji klasifikimi emnuer, pa vështirësí gjente dhe nxirrte letra, akte e tjera ksosh, me mbrendina shum interesante për historinë e Shqiptarve mâ në shêj dhe për vendin t'onë. Prá nuk kishte nevojë për sqarime, por i pranonte pse i pelqente biseda, shkëmbimi i mendimeve dhe shoqënija e atyne që nuk ia humbnin kohën me vogëlsina, pse çmonte njeriun aktiv, atë që interesohej vazhdimisht për çdo gjâ që kishte lidhje me gjuhën dhe vendin e shqiptarvet. Në këto rasa ishte tepër miqësuer dhe bujar në ftesa për darka e dreka. E duhet të pohoj se kam hangër shum herë në shtëpinë e Profesorit, bile edhe në fillim të muejit dhetuer, mbas kthimit nga Palermo-ja, të ftuem nga Qendra Ndërkombëtare për Studime Shqiptare, kam hangër drekën e fundit ...

Në këto raste, bisedimet vijojshin për pesë a gjashtë orë rresht ku, argomentat kalojshin nga nji themë në tjetrën, me preferencë rriheshin nismet dhe ndërmarrjet me karakter kulturor si : botimet në diasporë, hymja e albanologjisë ndër Institute dhe Universitete

të hueja, shpresa e nji zhvillimit të kënaqëshem të gjuhës shqipe ndër bashkësinat Arbreshe, apo bâheshin vlerësime mbi zhvillimin, tejet të konsiderueshëm, të gjuhës dhe kulturës shqipe në Kosovë, si për përhapjen e arsimit në Shqipní, a ndalesh, biseda për rreth *shtypit* në mergim, të cilit Profesori i çmonte qellimet e mira, kritikën ndërtuese dhe dialogun, por nuk ia aprovonte *stilin* denigrues dhe *kontestacjonin* sistematik: « *janë shkrime që nuk bâjnë mâ efektin që shpresojnë; kemi probleme tjera mâ me rândësí për të ndjekun; shqiptarët, mandej, sot kanë nevojë të pajtohen, të grumbullohen dhe të bashkpunojnë, në rast të kundërt mundi dhe shpenzimet hidhen në lum, perposë se i bâjmë nji shërbim të madh Tiranës* ».

Ndonjë mund të çuditet e të thotë: si është e mundur që shoku Mehmet të përlotet duke lexuar një novelë! *Por partia na ka edukuar dhe na mëson që ai të cilit i dridhet dora për të pushkatuar me dorën e tij një ose dhjetë kunderrevolucionarë njëherësh, nuk është humanist, por frikacak dhe oportunist;* ai që nuk hidhërohet kur i vdes

njeriu i tij i dashur apo shoku i afërt, s'ka ndjenja njerëzore, por antinjerëzore, është i pashpirt; *dhe ai që nuk emocionohet nga një vepër artistik që hymnëzon triumfin e vijës së partisë, është ose indiferent ose armik* » (*Mehmet Shehu*, Nga fjala e mbajtur në aktivin e partisë të rrethit të Tiranës më 13 nëntor 1973).

Për të plotësuar portretin e xhelatit humanist e artdashës na duket e përshtatshme vjersha e poetit *Faslli Haliti*, zëri i të cilit është mbytur nga Partia:

Njeriu me kobure

Ai pret të fryjë era
Jo që të xhvishen pemët
Jo që të shkunden gjethet e verdha
Por që t'i ngrihet cepi xhaketës
T'i duket pas brezit koburja.

Ai pret të vijë pranvera
Jo që të mbjellë e të korrë
Por që të xhveshë xhaketën
T'i duket pas brezit
Koburja.

(*Faslli Haliti, Nëntori* 4, 1972)

... Libri i parë i Koliqit qi më ra në dorë qe përmbledhja novelash Hija e Maleve... *Veçse do të rrefej qi unë, si glottolog, u kujdesova mâ tepër për pjesën e «trajtës» se sá për atê të «përmbajtjes» dhe ndjeva nji andje të vërtetë tue lexue at libër, sepse më dukej qi gjuha e Koliqit, aq hartistikisht e lëmueme, ishte mâ e bukur dh'e natyrëshme se ajo e prozatorve të tjerë të sotshëm. Më pëlqejshin në tê ai styl aq afër atij të letrësis së mrekullueshme popullore shqipe e disa fjalë shijeje arkaike qi m'ishin të njoftuna vetëm ndër fjalorët e* Bashkimit *a të* Jungg-*ut, ase ndër tekste të vjetra gegnishte të Bogdanit etj ... E qe aty shi n'at vëllimin e vogël të Cordignano-s qi lexova disa përkthime nga italishtja të Koliqit, si ajo* Përpara Shën Guido-*s së Carducci-t, edh'admirova mënyrën me të cilën auktori përkthente klasikët t'anë mâ të vishtirë, jo vetëm me siguri të përsosun, por me styl qi i përshtatej atij t'origjinalit ...*

Prof. Carlo Tagliavini

Ordinar i Glottologjís n'Universitetin e Padovës (në *Parathânje* të Vëllimit të Dytë: Ernest Koliqi, *Poetët e Mëdhej t'Italís*. faqe V-IX).

Bardhë e zi rreth Drinit

nga **KOSOVË REXHA-BALA**

Haxhi Zeka, burr i thatë e zeshkan, kryesonte kuvendin e këshillonte parín kosovare të veprojshin në pajtim me parimet e Komitetit Shqipëtar t'udhëhequn nga Sami Frashëri. Edhepse vetë nuk mbante armë, por mbante gjithënji vjerrë në krahun e majtë kur nuk binte shi nji çadër të zezë, thuese kishte ardhë nga Oksfordi i Anglis, parashtroi nevojën e armatimit të përgjithshëm të popullit për fitimin e ruejtjen e pamvarësis shqipëtare.

— Vëllazën! — me këte fjalë hapi Kuvendin Haxhi Zeka, ulun mbi gjûj përbáll paris shqipëtare të Kosovës, rreshtue rrast në xhami si në namaz, dhe vazhdoi mbas nji pushimi të shkurtë — mirë e dijmë të gjithë pse jemi tubue sot këtu. Po theksoj se nji rrezik i madh na ka rá mbi krye né shqipëtarëve, nji rrezik mâ i madh se çdo zerzele e çdo kolerë deri tash në botë, nji rrezik që mundet me na hupë farën si popull po nuk murëm masat e duhuna me mbrojtë vehten. Shpëtimi ynë âsht pamvarsija kombëtare, dalja më vehte si shtet shqipëtar. Shpesh e kemi bâ dert hallin tonë në tubimet e ndryshme të përgjithëshme e të veçanta, por deri sot nuk kemi marrë nji vendim të drejtë. Në tubimet e veçanta deri tash janë paraqitë pikpamje të ndryshme nga disa prijsa shqipëtarë aty-këtu. Sot duhen shoshitë të gjitha pikpamjet e ndryshme dhe me dorë në zêmër me pleqnue drejt për të mirën e mbarë shqipëtarëve, e jo vetëm për këte rrethinë apo krahinë, për këthough agallëk apo begllëk. Le të flasim me rend si âsht zakon në kuvende shqipëtare.

Tanë kohën foli me zâ të butë e bindës, thuese ishte tue mbajtë ders apo ligjeratë akademike. Ai i mbahej parimit të pleqnarëve — me bindë, e jo me trembë ndigjuesin.

— Vëllazën! — muer fjalën Aqif Pazari — shifni muhaxherët dhe pa fjalë lehtë mund të kuptoni se çka na pret nga Serbi e Malazezi. Turkut ia ka nxânë bishtin rrota e Miskovit e ia thotë valles simbas qefit të Carit. Qe, edhe gazeta zyrtare e vilajetit të Kosovës botohet turçe e serpçe. Pse nuk na njofin neve Shqipen? A mos davleti don të dalim dinit e mandej me na pranue të drejtën kombëtare? Edhe konsullin serb e kanë prue në Prishtinë, e nuk ka me vonue e në vend të valive kanë me ardhë vojvodët. I kemi besue Turkut, i kemi shërbye Sulltanit, por ai po na shet si berret në treg. Animirë, shitë për shitë, bile të na shesi te ndonji shpijanik, mbasi paska ra aq

ngusht, por po na shet te kasapët e Beligradit e të Cetinës. Mos Zot ma keq për né! — përfundoi i zêmruem.

— A mos je shitë te Franc Josifi, lum Aqifi? — ia priti fjalën Adem Zajmi.

— Nuk kemi ardhë këtu me u therë me fjalë as me da mejdan, se kemi ku vrahemi e pse vrahemi në kofshim trima shqipëtarë. Paj, Franci nuk na mohon kombësin e fén, kurse Nikolla dhe Obrenoviqi kanë me na humbë farën — u përgjegj Aqifi i përmbajtun burrnisht.

— Po të lypte Aqif Pazari me u shitë te knjazi e krali, nuk isha çuditë — ndërhyni Riza-beg Kryeziu i Gjakovës — se ai e din gjuhën e tyne, veçse lyp Adem Zajmi me u shitë te knjazi e krali, nuk ma ka rrokë mendja kurqyshë. Por ata Zajmin e mashtrojnë mâ lehtë se ai nuk i merr vesh pa pasë ndoj shka për turxhiman — foli Riza Kryeziu dhe kështu ia lau Zajmit hakun e Aqifit. Unë nuk jam për shitje — vazhdoi. Turku nuk na ka mbajtë krahin, theksoi — por nuk besoj se nuk na don, se mos me na dashtë kishte hjekë dorë prej nesh se moti janë kah e lusin edhe knjazi, edhe krali, edhe cari. Na duhet me ia kjajtë hallin Sulltanit e me lypë qeverisjen e vendit me njerzit tonë, beglerë e pashallarë të vendit, se kush mohon Sulltanin çon ujë në mulli të hasmit — përfundoi Riza-begu tue çue ujë në mulli të Turkut.

— Të lumtë goja, o Riza-beg! — ndërhyni Rifat-begu i Pejës. Si të tanë turqit, ashtu edhe na duhet të qindrojmë për dinë e për vatan.

Shum pjesëmarrës — agallarë, bejlerë, bajraktarë — dikush pse nuk dinte, e dikush pse nuk donte ndryshe, përkrahën mendimin turkofil të Riza-begut dhe të Rifat-begut. Katër ditë u tubuen dhe biseduen këta prijsa për ardhmënin e vendit. Edhe kur shpërndaheshin nëpër konaqe, ata nuk i prejshin fjalët, madje aty parashtroheshin mâ imtësisht faktet për padrejtësit e Turkut ndaj Shqipëtarëve.

Mësue me ndejtë qetë mbi shilte të butë, me u shtri e ândërrue në minder të veshun me mëndafsh, me çibuka sermi e me qelibar në buzë, të mbuluem me tym duhani tatlisert, disa e mohojshin njimendësin shqipëtare për të ruejtë rêndin e kalbun shoqnor, disa e kishin vështirë me pá, me kuptue, se kishte tjetër shtegdalje veç shpëtimit o humbjes me sulltanin, disa mendojshin se pa sulltanin, i cilli ishte tue hjekë shpirt, Shqipëtarët mbeteshin jetima, dhe, pa përkrahjen e ndonji bujari, ndonji kojshije shpirtbardhë, nuk kishin shpëtim. Të pakët ishin ata që mendojshin se do të mund të qëndrojshin më vehte si komb e si shtet po të bashkoheshin e po të mbështeteshin në forcat e veta tue përdorë armët me trimnin e njoftun malsore.

— Unë nuk kam mësue shkolla si disa prej jush e nuk dij me dhanë as imza — muer fjalën Isa Boletini — por dij nji mesele dhe po due me jua përmendë. — Veshet Nastradini me cukla si rrogtari i zotnis së keq e shkon në nji zijafet. Askush nuk i ban temena e në trapazan i japin me hângër do mbeturina të sofrës së mbrame. Shkon e veshet

Nastradini si zotni i randë dhe vjen të nesërmen në të njejtin zijafet. Të gjithë i bajnë temena, çohen në kambë e i bajnë vend në báll t'oxhakut, e ulin në krye të sofrës së parë si zotni të madh. Merr Nastradini me hângër dhe e rrasë edhe mângën e qyrkut në tepsin me mish e oriz e thotë me mend: « Merr, qyrk, se kjo âsht ndera e jote! » N'diçi, burra, né nuk na ban kush temena në mos e nderofshim vehten me armë si dikur Skenderbegu. Unë kam krye vetëm nji shkollë, shkollën e luftës, e kalemi jem janë armët. Në daç sulltani me vali e pashallarë, në daç cari me krala e knjaza, nuk çajnë kryet për né në mos u bafshim dritë te hûnda me flakë të barotit. Mirë âsht me pasë shkolla e libra shqipe, por ato na i qesin poshtë kush të dojë nëse nuk i mbrojmë me flakë të barotit. Pra, shpëtimi ynë âsht me ngjeshë armët i madh e i vogël, burra e grá në daçim mos me rá prej gojës së ujkut në gojë të arushës.

— Të lumtë goja, o Isë Boletini, se qâshtu flet shqiptari! — uroi Sadik Rama i Gjurgjevikut. Qe pesëqind vjet nën Turk jemi e Turkut hala s'dijmë me i dhânë haber. Ai si koftë — voftë. Na as e kemi prue, as mund e mbajmë — ai vetë âsht kah ikë iu ka sosë ujt. Sa sulltana e pashallarë, sa krala e knjaza shkojnë e vijnë, me nisë e me u bâ temena, bâhemi gërmuç e na del gunga. Unë nuk dij as turçe as nashke e zotni në truell tem të huejin nuk e duroj.

— Si po flasim këtu shqip, — muer fjalën Hafiz Mekuli nga Plava — dij me folë turçe e nashke e jam gati me u marr vesh në daç me sulltana e pashallarë, në daç me krala e knjaza, me më lanë rahat, zotni në truell temin e mos me më hypë mbi krye i hueji, se fjala e mbrame s'duhet thanë mâ së pari, por në mos daçin me pleqnue drejt, edhe unë merrem vesh me ta me grykë të pushkës si Isa e Sadiku e shum prej nesh. Edhe Sulltani e Cari dhe shum mbretní të vogla e të mëdhá së pari luftojnë me fjalë e mandej me pushkë dhe së mbrami prap merren vesh me fjalë. Pra, fjala i çelë dhe i mshelë rrugën plumbit të pushkës — përfundoi me urtí burri i pashëm e i këndueshëm plavian.

Ditën e katërtë, Rifat-begu me disa shokë, bejlerë si ai, kishte hartue nji rezolucion njimbëdhetë pikash. Kur Rifat-begu, me pelqimin e pushtetit turk në zyrën e bashkis ia paraqiti Haxhi Zekës propozimin, Haxhi Zeka u çudit qysh turkofilët kishin ndërmarrë nji gjâ të tillë kundër regullave të kuvendit.

— Për këte — u përgjegj ai me zêmrim të përmbajtun — Kuvendi duhet me zgjedhë nji këshill, i cili duhet të hartojë propozimin në bazë të pikpamjeve të shumicës e mandej Kuvendi vendosë për pranimin ose mospranimin ose për ndryshimin e rezolucionit.

— Çdokush ka të drejtë me bâ propozim, e Kuvendi vendos çka me pranue. Na do ta parashtrojmë këte e jemi të sigurtë se shumica, mos të gjithë përveç teje, do ta pranojnë. Ti edhe të tjerë si ti keni të drejtë me folë kundër, por mundi ka me ju shkue huq — ia preu Rifat-begu tue shkunde me zêmrim fletën e shkrueme me shkrola arabisht.

— Nuk dij a âsht kjo pjellë e mendjes së juej, apo hajmali e Sulltanit e dërgueme me kasnec prej Stambollit. Më vjen keq që edhe këte herë jeni kah e mashtroni popullin — u përgjegj i skuqun nga zêmrimi dhe duel prej zyrës me hapa të shpejtë. Kur e lutën të udhtonte me serem të bashkis nuk pranoi — Po heci me i shpî kâmbët.

Gjatë rrugës mendoi: « Duhet me u folë, me ua thye mendjen ». Derisa mbërrijti në Kuvend hartoi këthough fjalim me mend: « Vëllazën! Të nji gjaku jemi, por të nji mendje nuk jemi. Ndigjomëni me ve-mendje si ju ka hije si prîjsa e pleqnarë që jeni. Dikur kanë me ju rá ndërmend fjalët e mija, por ka me qênë vonë. Para njizetetre vjetve, në Rajhshtat, Austro-Hungarija dhe Rusija janë marë vesh për ndamjen e tokave shqiptare, mandej Turku mbas gjashtë muejsh pranon shpalljen e autonomis së Bullgaris, tue përfshi viset shqip-tare — Kaçanikun, Tetovën, Gostivarin dhe Dibrën. Pyteni Sulltanin sa bullgarë ka n'ato vise! Ai ndoshta nuk e din, por né e dijmë — asnji. Njikohësisht na mohoi nevе autonomin simbas kërkesës nga Janina. Na i ndihmuem sulltanit në luftë kundër knjazit e kralit, kurse ai u ndihmoi e gjithënji u ndihmon atyne kundër nesh. Ndërsa krali hap shkolla, ngreh kisha, dërgon mësues e prifta, boton gazeta, dërgon idhtarë e konzuj dhe përgaditet me shkelë Kosovën e Shqipë-tarët, me pëlqimin e sulltanit, hyqymeti turk na ndjek, na shkoklon drû, na vret e na djeg për nji shkrolë shqipe, kurse na hapin sibjan mektebe në vakufe me mësue përmendesh disa dovë arabisht e me thânë: "Turk elhamdylyla". Pra, na hapin shkolla ku nuk mesohet as sa me dhânë imza, ose na hapin iptidaje ku mesohet elifi dhe hesapi deri në nji mijë, mandej kalemxhijtë e këtuhit i çojnë n'Anadolli e nuk i lanë me shërbye në vendet e veta shqipëtare. Këthough selam duhet me ia përciellë sulltanit e me i kërkue vetëm nji gjâ — me na njoftë autonomin si popujve të tjerë se na kemi me qereris vehten madje mâ mirë se kojshitë ».

Kështu mendoi ai me folë para krenëve në Kuvend, por nga për-krahja që krenët i dhanë rezolucionit të bejlerëve, sigurisht hartue në Stamboll, kuptoi se fjalët do ti shkojshin huq, prandaj i ruejti për nji rast mâ të përshtatshëm.

Kur filloi Kuvendi në Pejë ishte pazar i madh, kurse kur mbaroi ishte pazar i vogël, por këte herë kishin ardhë mâ njerëz, jo aq për shitblemje, sa për të marrë vesh se çka kishin vendosë krênët e Koso-vës në këte Kuvend.

Telalli i rá pazarit anembanë dhe bërtiti me zâ mâ të naltë se të hoxhës në minare:

« Ndigjoni, o milet, ndigjoni! Parija e tubueme në Kuvend në Pejë katër ditë ka pleqnue për hallin e miletit e të davletit dhe kërkon n'emën të mbretit:

1. *Të mos njihet kurrfarë sundimi tjetër, pos sundimit të sulltanit.*
2. *Të paguhen taksat e tokës dhe renta.*
3. *Mashkujt prej 18-40 vjet duhet të shkojnë asqer të mbretit.*

4. *Ndalohet hakmarrja deri në Shen Mitër, dmth, deri me 7 nandor 1899.*

5. *Në rast sulmi nga çdo i huej, t'i jipet përgjigje në të njêjtën mënyrë.*

6. *Bashibuzukëve do t'u blehen armë me paret e njerëzve mâ të dalluem, e fyshekët do të mirren nga xhephanet e hyqymetit.*

7. *Nëse ndokush mbrenda tetë muejve vret ndokend, do ti digjet shtëpija.*

8. *Shtëpija digjet edhe për rrahje e plagë mbrenda kësajë kohe.*

9. *Kush tremb miletin pa nevojë tue shprazë pushkë kot, do të nxirret para hyqymetit për denim.*

10. *Hajnat e kaçakët do t'i dorëzohen hyqymetit, e nëse ikin do t'u digjet shtëpija.*

11. *Krejt mileti duhet me marrë vesh se hyqymeti âsht kah mirret me punë të mëshefta.*

Ky vendim, si ferman i padishahut, do të ngjitet në derë të bashkis e nëpër dyer të xhamijave e të dyqaneve me e mësue mileti e me veprue simbas këtyne pikave ».

Mbasi falën drekën, krênët e Kuvendit duelën në qytet dhe biseduen me njerzit e krahinave të veta, të cilët kishin ardhë kush për pazarllëk e kush për takime e bisedime me miq e dashamirë dhe për të ndigjue në vend lajmet nga puna e Kuvendit.

... Ma il rapporto del Koliqi con il mondo dei fratelli *arbreshë* non si limita alla ricerca storica e critica: quel mondo è diventato sorgente viva di poesia per il suo canto.

... Gli studiosi di albanologia vedranno nel sereno e pacato giudizio storico quanto anche in questo settore le lettere albanesi debbono al Koliqi. Oggi noi possiamo affermare senza tema di errare che le sue fervide idee hanno gettato le basi di una prospettiva storica del mondo italo-albanese. Di ciò gli albanesi d'Italia devono essere grati allo studioso, prescindendo da ogni considerazione di natura sentimentale (d'altra parte giustificabilissima).

GIUSEPPE GRADILONE

(*Ernesto Koliqi e gli italo-albanesi* in *Shêjzat*, VII, 1963, nr. 5-8, pp. 226-229).

Gedanken über Nation und Staat der Albaner[1]

Ad memoriam Ernesto Koliqi

von ROBERT SCHWANKE

Stavro Skendi beklagt in seiner Abhandlung über den Zeitraum 1878 bis 1912[2] die Lückenhaftigkeit der bisherigen Historiographie. Da es fürwahr an Quellen nicht fehlt, liegt dies wohl an einer mangelhaften Aufbereitung der letzteren. Selbst Tirana hat bisher mehr Quellen zu sammeln als aufzubereiten versucht.

Das Scheitern der Prizrener Liga bedeutete in der albanischen nationalen Wiedergeburt zwar einen schmerzlichen Rückschlag, die dezentralisierten und von den Auslandsalbanern inspirierten Einigungsversuche der albanischen Nation gingen jedoch weiter. Wir können hiebei sehr enge Verknüpfungen und Wechselbeziehungen zu den vielfältigen auf der Balkanhalbinsel sich geltenden Bestrebungen feststellen. Allen diesen Bewegungen ist jedoch gemeinsam das Ringen um Durchsetzung und Erreichung eines vagen, mittelalterlich geformten und mit neuzeitlichen Methoden zu erreichen versuchten, unklaren nationalen Ideals.[3] Das falsche Verstehen der modernen Nationalidee liess diese Bestrebungen schliesslich zum Ringen um Machtpositionen und zu Rivalitätskämpfen ungleicher Partner degenerieren. Auf der Strecke blieben hiebei die Makedoslawen, die Aromunen und die Albaner. Man betrachtete diese Völker ohne Staat als unterentwickelt, beeinflussbar und als reine Objekte der eigenen Machtausweitung. Alle drei Völker hatten auch gemeinsam, dass sie sich gegen eine sehr zielbewusste Propaganda von Griechen, Serben und Bulgaren zu wehren hatten. In den Zentren akuter Gefährdung, wie z. B. in Korça, regten sich die ersten erstaunlichen Abwehrkräfte. Das zielbewusste Streben nach kirchlicher und schulischer Eigenständigkeit bewirkten dort innerhalb weniger Jahre ein fühlbares Stoppen der Graecisierung bei der Intelligenz[4] und ein

[1] Die folgenden Ausführungen ergaben sich vornehmlich im Zuge meiner letzten Forschungen zur mazedonischen Frage. Die Darstellung beruht vor allem auf Berichten, die von Manastir (Bitolj) an das K.K. Ministerium des Äußeren gerichtet wurden. Diese befinden sich im Hans-, Hof- und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv in der Liasse Konsulate XXXVIII, ebenso wie die aus Wien ergangenen Weisungen.

[2] Stavro Skendi, *The Albanian National Awakening 1878-1912*, Princeton, University Press 1967.

[3] Aus den Denkschriften von J. G. Hahn vom Jahre 1862: « Den Morgenländern, die die Menschen nicht nach ihrer Abstammung oder Nationalität sondern nach ihrem Bekenntnisse gliedern, wurde die Theorie einer neuen politischen Schule des Abendlandes oktroiert ».

[4] « Mit den in der Schule erlernten Kenntnissen im Namen der griechischen Sprache

Erstarken des eigenen Nationalgefühls. Wirksame Hilfe leisteten hiebei neben dem Auslandalbanertum die amerikanische protestantische Mission,[5] wodurch die Albaner in der Lage waren eigene Schule und Kirchenpredigt gegen den anscheinend allmächtigen Einfluss des griechischen Patriarchats einige Zeit behaupten zu können. Wenn trotzdem damals noch die Griechen in ihrem Irrwahne der « Grossen Idee » obsiegten und die Emanzipationsversuche vorerst scheiterten, so lag dies wohl vornehmlich an der Haltung der Pforte, welche es den mohamedanischen Albanern nicht gestattete, an einem nationalalbanischen Unterricht, zusammen mit Christen teilzunehmen.[6] Konzessionen machte man den Albanern kurzfristig nur dann, wenn man ihrer bedurfte - wie z. B. in der Kretakrise.

Bleibende Erfolge konnten die Albanern mit Hilfe Oesterreich-Ungarns, das fälschlich vielfach nur als katholische Schutzmacht angesehen wird, machen, Bereits im Jahre 1886 hatte man von verschiedener albanische Seite — auch der orthodoxen und toskischen Albaner — in Wien die Bitte vorgebracht, die Donaumonarchie möge die albanische Nationalbewegung wirksam schützen.[7] Die Haltungs Wiens war damals, wie auch weiterhin, reichlich unentschlossen.[8] Man wollte wegen des Risikos die albanische Frage nicht in ihrer Gesamtheit aufrollen, wenn man dies auch für möglich hielt, versäumte dadurch die Gelegenheit und musste sich dann, als es für eine eigene Entscheidung zu spät war, sich von anderen das Gesetz des Handelns vorschreiben lassen. Die chauvinistischen Balkanstaaten hatten 1912 das aus eigenem durchzusetzen versucht, was Russland mit San Stefano gegen das übrige Europa nicht vermochte. Der Berliner Vertrag überliess zwar den einzelnen Balkanstaaten Gebietsteile mit starken Minoritäten, die markantesten Mischzonen der europäischen Türkei, vornehmlich die historischen Gebilde Mazedonien, Altserbien und Epirus blieben auf fast ein halbes Jahrhundert ungeteilt, was den Albanern eine Zeitspanne zur inneren

ausgerüstet ... stellen sich viele, nachhause zurückgekehrt, in einem Gefühl der Dankbarkeit gegen ihre Wohltäter, in den Dienst der griechischen, der fremden Sache. Das alles ist deren Stärke ». *Bericht aus Manastir,* Nr. 45, vom 4. Juli 1899.

[5] « So sehr die Ziele gewisser englischer und amerikanischer Missionsgesellschaften, welche Subventionen bewilligten auf die Verbreitung des christlichen Glaubens im protestantischen Sinne gerichtet gewesen sein mögen, so erwies sich die Anstalt (d. h. Schule in Korça) dank der albanischen Unterrichtssprache und der Gesinnung von Kyrias in erster Linie als national und blieb frei von pietistischem Geiste ». *Bericht aus Manastir,* 7.7.1899, Nr. 47.

[6] Infolge des Verbots, dass Mohamedaner die Schule in Korça « besuchen, haben die Anstalten in Korça einigermassen an Bedeutung verloren ». *Weisung nach Manastir,* 26.7.1899, Nr. 376.

[7] Die jüngeren und aufgeklärteren Albanesen rechnen mit der Eventualität des Zerfalles des osmanischen Reiches (und rechnen mit) ... engen Anschluss an eine starke Kontinentalmacht ...

Freundschaftliche, mitunter selbst intime Beziehungen (meldet der Konsul Zagorski) mit den albanesischen Begs ... *Bericht aus Janina,* 16.1.1886, Nr. 2.

[8] Man zweifelte wohl ob die Pforte den Albanesen ehrlich eine Autonomie geben wolle. Aber die « Verhältnisse seien so kompliziert und einer autonomistischen Gestaltung eher abträglich, dass vorderhand die Basis fehle ». *Memorandum des Ballhausplatzes,* vom Jahre 1886.

Festigung gab. Wer könnte heute sagen, was von den Albanern noch übrig geblieben wäre, wenn es zu der Teilung von 1912 bereits 1878 gekommen wäre?

Das bei den oesterreichen Staatsmännern seit Mitte des 19. Jahrhunderts feststellbare wachsende Interesse an Albanien, verbunden mit der Staatsmaxime, die türkische Herrschaft so lange es möglich war, zu erhalten, trug von Anfang an grosse Zwiespältigkeit in sich, was es leicht macht, eine ehrliche Absicht der Donaumonarchie den Albanern gegenüber überhaupt in Frage zu stellen.[9] Die Tatsachen sprechen aber anders. Nicht bloss einige, als besonders albanoman zu bezeichnende Diplomaten, sondern auch das ganze Ministerium in Wien hatte eine besondere Vorliebe für die Albaner, wie sich das bei den Differenzen zwischen Heer und Diplomaten während des ersten Weltkrieges herausstellte.[10] Trotzdem kam es zu verschiedenen halben Massnahmen gerade aus diesem Zwiespalte heraus. Im Interesse des guten Einvernehmens mit der Türkei musste man es vermeiden, mit den albanischen Strömungen, die im Grunde gegen den Bestand des türkischen Staatswesens arbeiteten, offen zusammenzuarbeiten, anderseits aber den Albanern nahelegen, politisch-militärische Aktionen zu vermeiden, sie aber national und kulturell ausgiebig zu unterstützen.[11] Das unmittelbare Staatsinteresse wurde jedoch für Oesterreich auf albanischem Gebiete in Nordalbanien berührt im Hinsicht auf Montenegro. Hier galt das Hauptaugenmerk Katholiken *und* Mohamedanern, wenn auch die Hauptwaffe, welche man der Türkei gegenüber anwandte, das katholische Kultusprotektorat [12] war. Aus einer Betreuung der Bischöfe, einem Einsetzen für die Sonderstellung der Mirdita, war mit der Zeit eine Methode der Beeinflussung der ganzen nordalbanischen Stämme geworden, die man national geeint in einer Phalanx gegen Montenegro sehen wollte. Die dabei angewendete Methode der Subventionierung der Stammesführer, an welcher man im Allgemeinen bis 1918 festhielt, wurzelte wohl vornehmlich in einem sehr geringen Vertrauen in die politische Reife des breiten Volkes. Man hielt auch eine von albanischer Seite vorgeschlagenen Beeinflussung der breiten Massen, wie sie vor allem im bergigen

[9] Politika aresimore kulturale dhe shkencore propagandistike e Austro-Hugarisë në Shqipëri nuk përputhej me lëvizjen kombëtare shqiptare, ishte në kundërshtim me interesat e saj ... Kultusprotektorat .. veproi në dëm të lëvizjes kombëtare shqiptare.

Zef Prela, *Problemi kombëtar shqiptar dhe Kultusprotektorat*, in *Studime historike*, 1965, 3, S. 152.

[10] Besonders Conrad von Hoetzendorf warf dem Aussenministerium ständig weltfremdes Albanienschärmertum vor (Vgl meine Ausführungen in *Dissertationes Albanicae*, München 1971, S. 63).

[11] Folgende Punkte waren für Oesterreich massgebend: « keine Begünstigung agitatorischer Tendenzen zum Nachteile des Sultans und der bestehenden staatlichen Ordnung in der Türkei, ein freundschaftliches und loyales Verhältnis zu der Pfortenregierung, ein Interesse an der Erhaltung der Integrität der Herrschaft des Sultans und der friedlichen Ordnung in den Balkanländern ». Im Sinne der Albaner förderte man anderseits alle Bestrebungen auf die Einigung sämtlicher albanischer Stämme ohne Unterschied der Religion, zu gemeinsamer kultureller Arbeit und Wahrung ihrer nationalen Eigenheit », hegte dafür die wärmste Sympathie und gewährte möglichste Unterstützung.

Weisung nach Manastir, 8-4-1899, nr. 9.

[12] Ueber das Kultusprotektorat vor allen in seinen Anfängen handelt mein Vortrag, der Ende 1973 in Palermo gehalten wurde, (im Druck).

Hinterland wohnte, durch Schule und Bücher zu jener Zeit *kaum* gegeben. Bei all dem hätten nur die reicheren Kreise, die ohnedies bereits national aufgeschlossener waren, ihren Vorteil gehabt, nicht die Analphabeten der Berge.

Im Gebirge hingegen Schulen zu schaffen, wäre ein Beginnen gewesen, welches selbst in bescheidenem Umfange übermässig viel Geld und Zeit gekostet hätte.[13] Immerhin hat man doch in engerem katholischen Gebiete eine Reihe von Protektoratsschulen ins Leben gerufen, welche z. T. auch von Mohamedanern besucht waren. Ueber diese Art der Schulen herrscht noch immer eine vielfach ganz fehlerhafte Anschauung. Sicher unterstanden diese Schulen, den Usancen der Pforte folgend, der Obhut der katholischen Bischöfe. Ansonsten kam es in den Protektoratsschulen ebenso wie in Korça vornehmlich auf die Initiative der in der Regel weltlichen und *albanischen Lehrer*[14] an, man war sogar, wie in Bosnien, bemüht, infolge der konfessionellen Zerissenheit des Landes das Konfessionelle nicht allzusehr hervortreten zu lassen. Was für die pietistischen Tutoren in Korça gilt, wo man neute das Nationale hervorstreicht, muss auch bei einer Würdigung der Protektoratsschule ins Auge gefasst werden.[15] Umstritten ist auch das von Oesterreich geförderte Wirken des Jesuitenordens in Albanien.[16] Ueber die Tatsache, dass ein Grossteil der ghegischen Intelligenz aus dem Saverianum, der einzigen damals bestehenden Mittelschule des Landes hervorgegangen ist, kann man nicht hinweggehen.[17]

Ist also im Norden Albaniens eine stetig einwirkende kulturelle Tätigkeit zu Gunsten der nationalen Bewegung von Seiten Oesterreich-Ungarns festzustellen, so konnte man sich bei den Südalbanern zu keinen kontinuierlichen und programmässig festgelegten Subsidien entschliessen. Doch lässt sich auch hier fast bei jeder Schul- Vereins- und Zeitschriftengründung eine mehr oder

[13] Aus dem *Memorandum* vom Jahre 1886.

[14] Logareci, welcher in Prizren das Schulwesen modernisierte, Schultexte entwarf, und in engem Zusammenhang mit den österreichischen Vertreter Anregungen und Neuerungen in Erwägung zog und teilweise auch durchführte (wie später L. Gurakuqi).

vgl meine Abhandlung in *Dissertationes albanicae* S. 67. In den Protektoratsschulen liess man auch den übrigen Lehrern vollen Spielraum, wie sie ihren Unterricht gestalten wollten.

Dagegen « Të gjithë këto shkolla fetare ishin reaksionare, të ngritura mbi bazat e shkolasticismit mesjetar feudal fetar dhe mbi një platformë me synime antikombëtare » (Prela, a. a. O. S. 148).

[15] Die humanitären Anstalten waren nicht bloss für die Katholiken sondern auch für die moh. Albaner tätig. In Tirana waren es auch die mohamedanischen Begs, welche ihre Kinder in die katholische Schule schickten, Vgl meine Abhandlung « Oesterreich- Ungarn und der albanische Sprachkongress von *Manastir* in Jahre 1908 », in *Gjurmime albanologjike*, I 1969, S. 67.

[16] Ueber die Widerstände gegen die Jesuiten in Skutari vergleiche meinen Vortrag in Palermo 1973. Anm. 12.

[17] In Tirana macht man sich heute über die Mittelschule in Skutari lustig, doch « do të ishte pa vend të mohohet fakti historik se nga shkollat mesjetare fetare dhe shkolastike kanë dalë shkencëtarë të famshëm dhe nga shkollat fetare dhe seminare kanë dalë edhe në kohët e reja billa udhëheqës të njohur të klasës puntore. Por për që këto shkolla nuk pushuan së qeni feudale fetare e reaksionare dhe as ata njerëz së shkencës nuk qenë produktë i tyre » (Prela, a.a. O. S. 149).

minder grössere österreichische Mithilfe feststellen.[18] Interessant ist, dass hiebei mehr noch als bei den Nordalbanern nationale Gesichtspunkte entscheidend waren. Als z. B. die Frage der Möglichkeit der Verwendung eines arabischen Alphabets — nicht im Sinne des Opportunismus der Pforte sondern einer möglichen Nationalliteratur unterentwickelter albanischer Gebiete — auftauchete, hätte man sich ohne weiteres auch zu einer Subventionierung solcher Druckerzeugnisse bereit gefunden, wenn man in ihnen die Möglichkeit nationaler Sammlung unter diesem Aspekt erblickt hätte.[19] Wo immer man daher von toskischer Seite, gleichgültig ob es sich um Mohamedaner oder Orthodoxe handelte, um Hilfe herantrat, war in der Regel eine gewisse Hilfsbereitschaft festzustellen, es sei denn, es handelte sich um eine ausgesprochen politische Aktion.

Nach den vergeblichen Versuchen der albanischen Liga von Peć wandten sich auch namhafte Vertreter derselben an Oesterreich um Unterstützung ihrer Bestrebungen.[20] Zur Pforte hatte man kein Vertrauen mehr, England, Griechenland und Italien hatten enttäuscht, bei letzterem Staate sah man in den engen persönlichen Verbindungen der Dynastien mit Montenegro grosse Gefahr. Bei diesen Verhandlungen kam vor allen die beiden Verhandlungspartnern auferlegte Bedachtnahme, vorsichtig lavieren zu müssen, stark zum Ausdruck. Die als Mohamedaner stark von der Pforte abhängigen albanischen Vertreter suchten einerseits Oesterreich zu beweisen, dass sie, um überhaupt agieren zu können, mehr das mohamedanische Moment hervorgehoben hätten, sie hüteten sich, ihre Beziehungen mit Oesterreich zu offenbaren[21] und fanden dadurch am ehesten bei der Macht Verständnis, welche im Hinblick auf die Pforte ebenso handelte und nach den Verhandlungen ihren Vertreter nochmals einschärfte, Vorsicht walten zu lassen.[22] Ueber den ganzen Verhandlungen schwebte auch die unsichere Lage Mazedoniens, eines von allen Seiten von der Propagandatätigkeit der annexionslüsternen Nachbarn beackerten Landes.

[18] Aus den Akten des Wiener Haus-, Hof-und Staatsarchivs geht hervor, wieviele Vereine Zeitschriften und schöpferische Einzelpersonen in Albanien subventioniert und gefördert wurden.

[19] Oesterreich bewahrte im Alphabetstreit immer Neutralität und konnte daher auch an eine Subventionerung wertvoller Publikationen in arabischer Schrift denken (Vgl. *Weisung nach Konstantinopel*, vom 2-3-1910, *HHStA*, PA XIV, Karton 24).

[20] Oberstleutnant Halil Beg, Shefqet Beg Frasheri und Fehim Beg Zavalani verhandelten mit dem österreichischen Konsul Kral durch Vermittlung von G. Kyrias. *Bericht Manastir* 12-3-99. Wien aeusserte sich dazu: « Es entspricht meinen Intentionen, wenn besagte Notable... die Uebergeugung gewonnen haben dass wir alle Bestrebungen, welche auf die Einigung sämtlicher albanischer Stämme ohne Unterschied der Religion abzielen .. die wärmste Sympathie entgegenbringen und dieselbe auch unterstützen » (*Weisung nach Manastir* von 8-4-99).

[21] « Es sei ganz richtig — erklärten die Albaner — dass die Ipeker Konferenz eine ausschliesslich mohamedanisch gouvernmentalen Charakter trage. Doch wie hätte auf andere Weise eine grössere Zusammenkunft der Albanesen ermöglich werden sollen (Das gilt auch von dem Anfang der Prizrener Liga. Der Autor) ... es war eine Vorversammlung, man arbeite an der Einigung Albaniens ohne Unterschied der Konfession an seiner Befreiung und an seinem Anschluss an die okzidentale Zivilisation » (*Bericht aus Manastir*, 12.3.99).

[22] *Weisung nach Manastir* vom 5. Dezember 1899- alle Schritte direkter Aktion sind sorgfältig zu vermeiden.

Schon bei einer Betrachtung der mazedonischen Verhältnisse wird es schwer, zu entscheiden, wie weit Opportunismus, wirklich ideales nationales Streben oder nationale Gleichgültigkeit bei den einzelnen Handlungen im Spiele waren. Allzu sehr spielten bei den Albanern Antipathie und Sympathie, die Bewertung jeglichen Geschehens nur nach dem eigenen Gesichtspunkt eine Rolle.[23] Noli hat dieses Hin und Her von Verrat und Patriotismus sehr treffend charakterisiert.[24] Bei einem kleinlichen Anlegen genormter Massstäbe könnte wahrscheinlich kein einziger nationaler Albaner als wirklicher Patriot bestehen.

Seit 1945 ist zu diesen Animositäten von Einzelpersonen und Grüppchen noch eine pauschale Wertung durch das nunmehr in Albanien herrschende Regime getreten. Mit sehr wenigen Ausnahmen fallen unter die negative Kritik die katholisch- italianophilen Elemente, ohne Rücksichtnahme auf deren faktische Leistung für das Albanertum selbst. Unter die Verfehmten fällt vor allem Ernesto Koliqi, eine Persönlichkeit auf dem literarischen und kulturellen Sektor.

Wenn man das albanische Volk als Ganzes in seine Untersuchung einschliesst und dabei als Nichtalbaner frei von emotionellen Reaktionen ist, hält man in allgemeinen von den vorerwähnten subjektiven Wertungen herzlich wenig. Eine wie überall mit dem Zeitablauf eintretende Abklärung, wertet nationale Leistungen nach wesentlich anderen Gesichtspunkten und wird daher auch Ernesto Koliqi und vielen anderen den ihnen gebührenden Platz im albanischen Kulturleben einräumen müssen.

[23] So klagt G. Kyriasi in einem Schreiben vom 18-8-1889 « unglückseligerweise ist seit etwa 3 Jahren ein abscheulicher Zwiespalt unter ihnen (in Bukarest) ausgebrochen ... jetzt existieren 2 Vereine ... abscheuliche Worte gegen jedermann der den Slawen wohlgesinnt ist ... die Leute sind nicht sehr gewillt, Opfer für ihr Vaterland zu bringen ».

[24] Këtu brenda në një ditë si me magji trathëtori bëhet patriot dhe patrioti trathëtor. (Fan Noli, *Të pesë anarkitë*, in *Vepra* 2, S. 34).

Letër nji Mikut

nga **KOLEC PIKOLINI**

I dashtuni Mik,

ndoshta njihemi, ndoshta jo, megjithatê me anën e kësaj letre po Të përcjelli ngushullimet e mija mâ të sinqertat për humbjen e *prof. Ernest Koliqit.*

Edhe në rast se nuk e ké njohtë personalisht, zânin, jam i bindun, se ia ké ndigjue, prandej e dij se lajmi i vdekjes së prof. Koliqit kje i papritun për të gjithë ata që deshtne lulzimin e veprimtarís së Tij në lamën letrare në mërgim. Koliqi kje nji pijoner i palodhun i kulturës: kurr nuk e uli pendën e artë të shkrimtarvet lirídashës. E me at pendë t'artë Ai ringjalli veprat e shkrimtarvet të Rilindjes kombtare, sidomos ndër këto kohna që anmiqt e letrarve të lirë po mundohen me xevendësue Rilindasit t'onë me profetë të rrêjshëm letrarë.

Kush e njofti edhe e ndjeku me kujdes veprimtarín e Tij letrare n'Atdhé e në mërgim, u pajis me nji idé: letrari plak âsht tue vazhdue rrugën e letrarve të djeshëm. Koliqi kje nji figurë e naltë dhe i papërkulun në vijën e ndërmarrun. Kje respektue e nderue prej shum intelektualve ndërkombtarë të Botës së Lirë. Nji ndër veprimtarít e Tija të pashlyeshme kje krijimi i rivistës *Shêjzat* (shtyllë kryesore e bazë e themeltë për çdo studim në letërsín shqipe) e bashkëpunimi i pakputun me Arbëreshët si t'Italís ashtu edhe me ata të California-s, ku asnji i mërguem, mbas luftës së dytë botnore, nuk pat kurr nji sukses si Koliqi. Ai, me bashkëpuntorët e Tij, mbajti gjallë shpirtin e Shqiptarit të lodhun, në mërgim, prej tallazeve të pashpresë për të nesërmen. Me pendën e Tij i la me kuptue mërgimtarit se shkrimtarët e Rilindjes kombtare dhe pasardhësat e tyne vijojnë veprimtarín në Botën e Lirë për lulzimin e krenarís të poetve të vërtetë Shqiptarë. Koliqi, tue qenë nji personalitet tepër i naltë për botën e vogël t'onen, si çdo tjetër i këtij nivelit, pati miq e anmiq.

Mik i Koliqit kje *mërgimtari i lirë* që deshti me u lanë trashigim fëmijve dijenín se Shqipnija ka nji të kalueme legjendare që âsht mbajtë gjithmonë gjallë nga Herojt e lirë të Kombit.

Miq kjenë edhe ata që deshtne me ndije përhera mirë për Nânën e përbashkët, Shqipnín; me naltësue heroizmin e Dëshmorve kombë-

tarë të lirë që mohohen e poshtënohen nga letrarët rinegatë që pëson sot Atdheu i robnuem nga bisha e egër komuniste.

Anmiqt e Tij kjenë *kundërshtarët politikë:* kundërshtarë jo me arsyetim, por vetëm të tillë sepse zeliqarë; ata të moshës së Tij mbasi nuk kjenë të zotët me e diftue vedin, kur ishte koha, për atê çka sot predikojnë; kundërshtarë me nji frymë politike të pabashkim, dje, sot e nesër.

Humbja e Koliqit âsht humbje e përbashkët që, tash për tash, duket si humbje e nji personi, por e nji personi të paxevendësueshëm; humbje e madhe për né mërgimtarët bashkimdashës e lirídashës pse anmiku i lirís përgëzohet për disfatat e njimbasnjishme t'emigracjonit në Prendim, e, nji disfatë për Poetin e robnuem n'Atdhé që tash tridhetë e sa vjet shikon e shpreson në përpjekjet letrare të të rijve në mërgim. Me zhdukjen e Koliqit, letrari i rí në mërgim, po deshti me mbajtë emnin Shqiptar, të përqiqet me mbajtë gjallë zânin e Shqiptarit të robnuem në truell të të Parvet; të mbajë gjallë përpjekjet për lirí të Vendit e të Shqiptarit kudo qoftë. Penda e letrarit të lirë, sot për sot, âsht lufta mâ e fortë kundra propagandës së rrêjshme që bân shkrimtari i kuq, komunisti terrorist si n'Atdhé, ashtu edhe jashta.

Koliqi, si letrar, mbet i gjallë në shpirtnat e Shqiptarve largpamës; mbet i gjallë për letrarët e rij të së nesërmes; mbet i gjallë ndër faqet e arta të shkrimtarve për lirí. Shpirti i Tij âsht bashkue me ata të Frashërlijvet, De Radës, Schirò, Çajupit, të Fishtës e tjerve. Shpirti i Tij pastë pagjë me tanë ata që u përpoqën për lulzimin e Kombit Shqiptar.

Ket desha me të thanë, *Mik i dashtun*, e çka shkrova — ndoshta nuk âsht në naltësín letrare që meriton Koliqi — por ka nji vleftë pse e kam shprehë e shkrue me zêmër, dashamirsí e miqsí.

* * *

U.C.I.A.: commemorato Koliqi

Lungro, 17 (*a. f.*) — Si è svolta nel collegio di S. Adriano di San Demetrio Corone l'assemblea generale dei soci dell'unione delle comunità italo-albanesi. I lavori sono stati aperti dal prof. *Emilio Tavolaro*, presidente onorario, il quale ha ricordato la figura dell'insigne prof. *Ernest Koliqi*, recentemente scomparso, mettendo in evidenza l'opera svolta in favore della cultura italo-albanese.

(*Il Giornale di Calabria*, n. 40, 18-I-1975).

Synopsis of the life and works of the Poet professor Ernest Koliqi

by P. V.
Translated by ZEF V. NEKAJ

Ernest Koliqi was born in 1903 in Shkodër, Albania, where he attended the elementary school.

In **1918**, his parents sent him to the college "Cesare Arici" in Brescia, Italy, where he attracted the attention of the poet and classical critic J. Fr. Giovanni Costetti, whose classical literary influence on the talented youngster remained throughout his life.

Later in that year, he enrolled at the Bergamo College and founded the students' weekly magazine *Noi Giovani* (We, the Youngsters), where he published his first poems.

In **1921**, he returned to Albania, where he zealously studied his mother tongue. The great patriot Luigj Gurakuqi encouraged him to pursue a literary career. At the same time, he became a member of the Shkodra literary circle, and associated himself with Kolë Thaçi Shuk and Karl Gurakuqi, Loro Ashiku, Dom Lazër Shantoja, Kolë and Lin Kamsi, and others.

He won first place in the literary contest sponsored by the Ministry of Education, for the composition of the national hymn. The panel was composed of Fr. Gjergj Fishta, Bishop Fan S. Noli, both national poets, Luigj Gurakuqi and Mid-hat Frashëri, patriots and writers.

In **1923**, together with Fr. Anton Harapi and Nush Topalli, he founded the newspaper *Ora e Maleve* (The Muse of the Mountains), which had a great impact on the political and literary field of that time. In this work Koliqi was encouraged by L. Gurakuqi and Fr. Fishta, and later he became secretary of the paper and editor-in-chief.

In **1924**, he became a member of the *Bashkimi* (Literary Union) founded by Avni Rustemi. Because of his sharp criticism against the government, he was forced to leave Albania and immigrate to Yugoslavia for five years. There he learned Serbo-Croatian and read the greatest writers of that country.

Still encouraged by L. Gurakuqi, he wrote and published the dramatic poem *Kushtrimi i Skenderbegut* (Scanderbeg's war cry), evoking the national hero of the 15th century who fought against the Turkish armies. It was precisely this work that caused him to decide to enter permanently the field of Albanian letters.

In **1928**, he published in Zara, a Dalmatian town of 18th century Albanian settlers, his first novel *Hija e Maleve* (The Shadow of Mountains). His narrations reflect not only the traditional impact of the middle-aged law of Lekë Dukagjini as implied by northern Albanian highlanders, but also the social and philosophical life of the city dwellers of Shkodra.

In **1929**, upon his return to Albania, he was assigned to teach Albanian in Shkodër and Vlonë, where he was respected and loved by his students, colleagues, and readers, in whose written comments, Koliqi earns the appellative of *The Creator of the Albanian Novel.*

It was at this time of amnesty that he undertook the translation of the great poets of Italy into Albanian.

In **1932**, he publishes the first volume of *Poetet e Mëdhej t'Italis* (The Great Poets of Italy) including Dante, Petrarca, Ariosto and Tasso. The voluminous work was proceded by an overenthusiastic introduction of Fr. Fishta. The translations were very well received by all readers and critics.

In **1933**, his collection of poems *Gjurmat e Stinve* (The Traces of the Seasons) is completed. It is an interplay of Shkodra's fluorescent scenes and diverse customs and ways of life impermeated into the Albanian mind from pagan to modern times, but always nurtured by doses of hope for a joyous and better future.

In **1934**, he wholeheartedly cooperates with and becomes one of the shining stars of the biweekly cultural, philosophical and literary magazine *Illyria* published by the best Albanian thinkers and writers of that time.

In **1935**, his prosaic poem *Quattuor* and also the second volume of his novel *Tregtar Flamujsh* (Merchant of Flags) was published. The latter was written to expose the unscrupulous commercial practices of pseudo-patriots in his hometown Shkodra. The novel is a great social and psychological critical analysis, sprinkled with satire.

In **1936**, the second volume of *The Great Poets of Italy* including works of Parini, Monti, Foscolo and Manzoni is published with a forward written by his famous Professor, Carlo Tagliavini. A commendatory article was written on this occasion by the technically inclined lyrical poet, Fr. Ndre Mjeda, in *Leka* magazine.

The translated poems of the third volume encompassing Leopardi, Carducci, Pascoli and D'Annunzio appeared in different magazines, and especially in the *Manuale di Lingua Albanese* (A Manual of the Albanian Language) of J. Fr. Fulvio Cordignano. At this time Koliqi translated and published also lyric poems by Diego Valeri, Enrico Grassi, Emil Verhaeren and Charles Baudelaire.

In **1937**, he received his doctoral degree at Padova University, with the thesis *Epica Popolare Albanese* (The Albanian Popular Epic) which was highly praised by German Albanologues, such as Professor Norbert Jokl, Maximillian Lambertz and other scholars.

In **1938**, he becomes Associate Professor of the Albanian language at the Padova University under Professor Tagliavini.

In **1939**, Koliqi is nominated Professor of the Albanian Language and Literature at the University of Rome.

He became Minister of Education and gathered around him the best Albanian scholars and writers.

Under his ministerial sponsorship were printed for the first time a multitude of text-books for elementary and high schools of Albania, and also *Shkrimtarët Shqiptarë* (An Anthology of Albanian Writers) in two volumes, *Bota Shqiptare* (The Albanian World), *Rreze Drite* (Illuminating Rays), *Te Praku i Jetës* (At the Threshold of Life) and 14 volu-

minous editions of *Vrsaret e Kombit* (The Treasures of the Nation), the latter containing a monumental work on the Albanian folklore and traditional law.

Founded the literary magazine *Shkëndija* (The Sparkle), which became the hearth of many talented young writers from the whole country.

In **1940**, he organized in Tirana "The Congress of Albanological Studies" in which participated Professors Carlo Tagliavini, Antonio Baldacci, Francesco Ercole, the lexicographer Angelo Leotti, Prof. Gaetano Petrotta and other scholars. The outcome of this congress was the creation of *Instituti i Studimeve Shqiptare* (The Institute of the Albanian Studies), which became the cornerstone of the present "State University at Tirana". It was at this time that the publication of voluminous works entitled *Studime e Tekste* (Studies and Texts) was accomplished amidst the war and confusion; but, under Koliqi's management, linguists, scholars, and writers such as Zef Valentini, Fr. Bernardin Palaj, Ernesto Cozzi, and others were doing scientific work despite what was happening all around them.

In **1941**, he assigned to the annexed Albanian region of Kosova, part of Montenegro and Macedonia over 20 elementary and high school teachers to open for the first time Albanian schools and awards 100 scholarships to the students of these regions to study at Italian universities so as to further their education and prepared them to teach their previously denied mother tongue. In connection with these undertakings, we will reproduce the words of *Dr. Rexhep Krasniqi,* President of Free Albania Committee in New York: "*... finally, the historical moment of the opening of the first complete high school in Albanian was realized on the 12th of December 1941, and these schools were of great basic importance for the development, for the widening of progress, education and the Albanian cultural background in today's Yugoslavia*". (*Shêjzat* [Le Pleiadi], XVIII, 1974, N. 1-10, pp. 8-11).

In **1942**, he married a young teacher *Vangjelija Vuçani,* with whom he is later to have two children: *Marco* and *Elisabeth*, the fruits of their love. He leaves the Ministry of Education and becomes President of the Institute of Albanian Studies in Tirana to carry on the work proposed by the Congress mentioned above. In this endeavor, he cooperated with Mustafa Merlika Kruja, Professor Alexander Xhuvani, Professor Karl Gurakuqi, Professor Eqrem Çabej, with poets Asdren, Ali Asllani, Lasgush Poradeci, the publicist Ismet Toto, and others.

In **1943**, he returned to the University of Rome as Professor of the Albanian Language and Literature and is also nominated Albanian Ambassador to the Vatican. Professor Koliqi was the last Albanian to serve in that capacity.

The end of the second World War in 1945 found him in Italy, and he was forced to become an emigrant never to return to his native country, about which he wrote all his life.

In **1947**, he founded and edited the newspaper *L'Albanie Libre* (Free Albania), contributing numerous articles and poems, among them *Kanga e Kapidan Markut* (The Canto of the Leader Marku), one about Alush Leshanaku, and another about Ndoc Mirakaj, all epic poems dedicated to nationalist fallen heroes during the postwar struggle with the present Red regime.

In **1953**, a masterful literary analysis entitled *Dý Shkollat Shkodrane* (The Two Shkodra's Schools) appeared in series in the same paper. Here Koliqi's concise comments are an eternal tribute to the Albanian literary legacy of Jesuit and Franciscan fathers.

In **1957**, by decree of the President of the Italian Republic, on September 2nd, the Department of the Albanian Language and Literature at Rome University became *The Institute of the Albanian Studies* and Professor Koliqi was named its President. He

publishes *Poesia Popolare Albanese* (The Albanian popular poetry) in Albanian with its Italian counterpart.

One of Koliqi's greatest achievements in Albanian literature was the founding of the social, cultural and artistic magazine *Shêjzat* (Le Pleiadi). For 18 uninterrupted years Koliqi contributed to each number of this magazine, besides his editorial essays, also other literary, historical, social, artistic, political articles and comments and translating poetry from Albanian into Italian and from Italian into Albanian. Thus he enriched both languages with masterful pieces of work.

Started the publication of the series *Studi Albanesi* (Albanian Studies), and under his supervision, the following publications first saw light: *Tradizioni Popolari degli Albanesi d'Italia* (Popular Traditions of Albanians in Italy) in three volumes, and *Studi e Testi* (Studies and Texts) in six volumes.

In **1959**, he published a poetical volume in Albanian and Italian entitled *Kangjelet e Rilindjes,* it. "I canti della Rinascita" (The Renaissance Cantos), which are a eulogy and encouragement to Albanians (*Arbresh*) still living in Southern Italy and Sicily from the 15th Century, so that they might continue to preserve, as they have done up to the present, their traditions and the Albanian language.

In **1960**, *Shija e bukës së mbrûme* (The Taste of the Unleavened Bread) which appeared in a series in *Shêjzat,* is published as a complete long novel. In it Koliqi treats the love, the hardships, and the nostalgia of the exiled people who were forced to leave their country. The place of settlement is the U.S.A. Besides its direct relation to exiles in the United States, it is amazing to read with what kind of accuracy the author, who up to that time had not visited U.S.A., describes the streets, monuments, theatres and other locations of New York, Boston, and Chicago.

In the magazine "Quaderni Dannunziani", booklet XVIII-XIX, appeared his study *Gabriele D'Annunzio e gli Albanesi* (Gabriele D'Annunzio and the Albanians).

In **1961**, he translated into Italian and publishes in *Shêjzat* the satirical poem by *Ali Asllani: Darsma Shqiptare* (The Albanian Wedding).

During the same year publishes *Rapsodi e rapsodie delle Alpi Albanesi* (The Rhapsodians and Rhapsodies of the Albanian Alps) which dealt with the custom and the ability of highlanders to convert the historical events and warfare into beautiful oral poetry, which was recorded only during this century.

In **1962**, he translated into Italian and published in *Shêjzat* with comments *Koha e Re* (The Modern Time), the XXVIth canto of *Lahuta e Malcis* (The Lute of the Mountains) by Fr Fishta.

Published in Italian *Antologia della lirica albanese* (The Anthology of the Albanian Lyric), which is a careful selection of the best Albanian lyrical poems in and out of Albania, and a brilliant reflection of the Albanian art and contemplation.

With minor touches, he republishes the 1936 edition of *Shtatë Pasqyrat e Narçizit* (The Seven Mirrors of Narcissus). Here, the author in poetical prose described his image mirrored in different waters striving for poetical inspiration.

In **1965**, *the Enciclopedia dei Popoli d'Europa* (The Encyclopedia of the European People), Milan, Italy, included in its publication of that year also Koliqi's Italian monography on *Albania.* It is the first time that an encyclopedia of such a magnitude published a rich summary on geographical, economical, historical, social and literary aspects of Albania. The monography is wonderfully illustrated with color maps, pictures of personalities, and other aspects of the Albanian life.

In **1969**, his beloved wife, the long companion and right arm in every activity, *Vangjelija,* dies of cancer on the 4th of May. She took away with her part of the poet's stimuli, inspiration, joy, and perhaps her death was instrumental in shortening his life.

November 28-30 he participated in the commemorial festivities of the Pan-Albanian Federation of *Vatra,* held in New York, on the occasion of Scanderbeg's death (1468-1968). There he read the theme *Fan Noli, përlavdues epiko-lirik i burrnis shqiptare* (Fan Noli, epico-lyric praiser of the Albanian bravery) on behalf of his Institute of the Albanian Studies in Rome. He displayed there also an Albanian cultural background exhibition for which he was highly praised by the Chancellor of the University of Rome.

In **1970**, he re-edited and republished the poem *Symfonija e Shqipeve* (The Symphony of Eagles). The first edition appeared in *Gazeta Shqiptare* (The Albanian Newspaper) in Bari, Italy, 1936. In this short musical poem, Koliqi recalls the settlement of the Albanian forefathers, the Illyrians, in the Balkan Peninsula; then through tormentuous historical events, arrives to our modern times and step by step concludes his symphony with a chorus "credo" of three divergent-in-thought poets for the perpetuation of the Albanian nation. The poem was masterfully translated and commented upon by the young Albanian writer, *Anesti Andrea,* Ph. D.

In **1971**, he translated into Italian and publishes in *Shêjzat Marash Uci's Episode* by Fr. Fishta: cantos XII, XIII, XIV and XV of "The Lute of the Mountains" with introduction and footnotes.

In **1972**, Koliqi published *Saggi di Letteratura Albanese* (Essays on the Albanian Literature), a refined selection of his essays and conferences which reflect his talented professional thoughts during many years of sustained artistic work.

In **1973**, he continues the translation into Italian of *Lahuta e Malcis: Oso Kuka,* cantos II, III, IV and V with extensive comments and explanations.

He undertook his second trip to the U.S.A., this time in order to trace back the remains of the Albanian language, "the Arbresh dialect" of the Italo Albanians scattered throughout the U.S.A. This was a challenging and painstaking research projet that only a true scholar as Koliqi would undertake.

In **1974**, he transcribed the recorded conversations with American-Italo-Albanians and made the necessary linguistic explanations and comments (yet to be published).

Sketches a project for an Albanian anthology in three big volumes.

January 15, **1975**, died at his residence in Piazza della Balduina, 59, Rome, unexpectedly after a light fever. He was buried side by side with his parents and wife.

At his burial ceremony on the 18th of January 1975, a multitude of personalities, colleagues, Albanians, Italians, and Italo-Albanians from many parts of Italy, and friends from the U.S.A., Turkey, Sweden, West Germany, France, Belgium and other countries were present.

Note:

Part of Koliqi's work has been translated into Italian, German, English, Arabic and Greek. He contributed different articles in Albanian magazines and newspapers such as in *Hylli i Dritës* (The Morning Star), *Leka, Gazeta Shqiptare, Illyria, Përpjekja Shqiptare* (The Albanian Strive), *Minerva, Besa, Koha e Jonë* (Our Time), etc.

The above biography, however, doesn't include all of his publications with or without pen name, or his unpublished work and letters. It remains the duty of scholars and students of Albanology to search for and etablish his monumental work. Such research would, we feel certain, establish this poet, writer, publicist, essayist, and critic true greatness in the field of letters more than we close friends who knew him personally could imagine.

To conclude, we will let another well-known Albanian scholar and grammarian speak, the late Professor *Karl Gurakuqi*. *"There are not many Albanian writers whose names are known as well as Koliqi's in our literary milieu. There are but few writers whose literary legacy has spread as much as Koliqi's, wherever Albanian is spoken and studied. For a period of 40 uninterrupted years, his name has appeared in different papers, magazines, and publications of cultural activities, many of which were sponsored by Koliqi himself. Wanted or not, much of his work is predestined to enter in the history of our letters"* (*Shêjzat*, VII, 1963, N. 5-8, p. 163).

Decorations and Academic Titles

Golden medal of "Dante Alighieri" Society
Golden star for Educational Merit
Ordinary Academician of Tiberine Academy
Honorary Academician of Teatine Academy of Sciences at Chieti
Member of Abruci's Academy for Sciences and Arts
Effective Member of the Mediterranean Academy
Honorary Member of the International Center of Albanian Studies at Palermo, Italy

... Koliqit i shkon lavdija ma e madhe ma në fund në botimin për 18 vjetë pa ndërpremje të revistës Shêjzat *që asht thesar i pafund për histori, letërsi e albanologji nga pendat ma të njohuna shqiptare e të hueja, në gjuhën shqipe, në gjermanishte, frengjishte, italishte dhe anglishte. Qe nji punë e vijueshme që i jep Koliqit kunorën e larit për merita të jashtazakonëshme letrare.*

Dr. Hamdi H. Oruci

(Fjalim i mbajtun në Boston me 12 dhetuer 1976 në mbramjen kushtue 60 vjetorit të ngritjes së Flàmurit, në Korçë, nga patrioti Th. Gërmenji).

Nota bibliografica[1]

Kushtrimi i Skanderbeut (Il bando di Skanderbeg), (poemetto), Nikaj, Tirana, 1924.

Hija e maleve (L'ombra delle montagne), (raccolta di novelle), Zara, 1929.

Poetët e mëdhej t'Italís (I grandi poeti d'Italia), (traduzioni in versi di poeti italiani, da *Dante* al *Tasso*), vol. I, Nikaj, Tirana, 1932.

Marash Uci (studi) in Minerva, 1932, ristampato in *Shêjzat,* 1967, nn. 9, 10, 11, 12.

Gjurmat e stinve (Le orme delle stagioni), (raccolta di liriche), Tirana, 1933.

Tregtár flamujsh (Mercante di bandiere), (raccolta di novelle), Tirana, 1935.

Quattuor (poemetto in prosa), *Illiria,* 1935.

Poetët e mëdhej t'Italís (I grandi poeti d'Italia), (traduzioni in versi di poeti italiani, da *Parini* al *Manzoni*), vol. II, Tirana, 1936.

Pasqyrat e Narçizit (Gli specchi di Narciso), (poemetti in prosa) in *Gazeta Shqipëtare,* Bari, 1936, ristampato in *Shêjzat,* Roma, 1963.

Symfonija e Shqipeve (La sinfonia delle aquile), carme in prosa in vari tempi come le composizioni musicali), in *Gazeta Shqipetare,* 1936, ristampato in *Shêjzat,* 1969.

Epica Popolare Albanese (studio critico con appendice di traduzione di rapsodie), Padova, 1937.

Genesi del poema « Il liuto delle montagne » (Lahuta e Malcís), (Prolusione universitaria inedita), 1939.

Fishta, interpret i shpirtit shqiptár in *Shkendija,* numero unico, 1940.

Le nuove correnti nella letteratura albanese (conferenza tenuta nella *Accademia del Mediterraneo*), inedita, 1953.

Influenze orientali nella letteratura albanese, Istituto per l'Oriente, Roma, 1954.

Studio sul gruppo etnico albanese, (inedito), corso universitario 1954.

Le due scuole scutarine (quella dei francescani e quella dei gesuiti) in *Albanie Libre,* 1954.

La radice etnica nel De Rada, (conferenza tenuta nel Collegio di S. Demetrio Corone per il millenario della Badìa di S. Adriano), 1955.

Poesia popolare albanese, (testi e traduzioni poetiche in italiano), Firenze, 1957.

Kroje të reja në Parnaz shqiptár (Nuove fonti nel Parnaso Albanese), (la prima sistemazione critica della letteratura del Kosmet) in *Shêjzat,* 1957, n. 1, 4-5.

Kangjelet e Rilindjes (I canti della rinascita), (con traduzione in italiano), Roma, 1959.

Come nasce in Albania un canto popolare, in « Studi in onore di Angelo Monteverde », Modena, 1959.

Dhetëvjetori i së përkohëshmes « Jeta e Re » (Decennale della rivista « La vita nuova ») in *Shêjzat,* 1959, n. 11-12.

Il realismo socialista e la sua letteratura, (conferenza tenuta nel collegio greco per l'associazione *Vatra e Arbereshvet*), Roma, 1960.

Shija e bukës së mbrûme, (Il sapore del pane casareccio), romanzo, Roma, 1960.

G. D'Annunzio e gli Albanesi in *Quaderni dannunziani,* fasc. XVIII-XIX, 1960.

Ventesimo anniversario della scomparsa di P. G. Fishta, (con la traduzione in italiano della satira del Fishta: *La medichessa*), Roma, 1960.

[1] Questa nota, alla quale si è creduto opportuno dare un'ordine cronologico, registra le opere più significative del Koliqi e alcuni suoi scritti di capitale importanza, scelti tra i numerosi pubblicati nelle varie riviste a cui egli ha collaborato. (Cfr. GRADILONE G., *Il 30° anno di Ordinariato universitario del prof. Ernesto Koliqi* in *Shêjzat,* XIII, 1969, nn. 10-12).

Rapsodi e Rapsodie delle Alpi albanesi (studio critico con traduzione in italiano di rapsodie), Roma, 1961.

Nozze albanesi, (poemetto di *Ali Asllani,* tradotto in italiano e annotato da E. Koliqi), Roma, 1961.

I tre maggiori poeti d'Albania, Roma, 1961.

Peseëdhetëvjetori i vdekjes së Giovanni Pascolit (con traduzioni in albanese di poesie del Pascoli), Roma, 1962.

Evoluzioni storica della lirica albanese, Roma, 1962.

Tempo nuovo (traduzione del canto XXVI della *Lahuta e Malcís* di P. G. Fishta), Roma, 1962.

Giuseppe Schirò, poeta della fratellanza panalbanese, Roma, 1962.

Antologia della lirica albanese (versioni poetiche in italiano e note), Milano, 1963.

Girolamo De Rada, profilo critico in *Almanacco Calabrese,* Roma, 1963.

Islam e cristianesimo nella letteratura albanese in *Shêjzat,* 1963, n. 1-2.

Spirito autoctono e influssi stranieri nella letteratura albanese in *Shêjzat,* 1963, nn. 9-10 e 11-12.

Considerazione sui canti eroici del popolo albanese, München, 1964.

Fenomeno della diglossia sessuale nella lingua e nella letteratura albanese, Louvain, 1964.

G. De Rada (sulla vita e sull'opera del De Rada), Roma, 1964.

Gli Albanesi in Calabria in *Atti del 57° congresso della Società Dante Alighieri,* Roma, 1964.

Il teatro albanese, (corso universitario inedito), 1965.

Albania, monografia, in *Enciclopedia dei popoli d'Europa,* Milano, 1965

Lo sfondo storico e politico del poema Këthimi (Il ritorno), di *Giuseppe Schirò,* Palermo, 1966.

Faik Konica (*profilo critico*) in *Shêjzat,* 1967, n. 5, 6, 7, 8.

L'umanità di Skanderbeg, Palermo, 1969.[2]

Fan Noli, përlavdues epiko-lyrik i burrnis shqiptare in « Seminari Ndërkombëtar i Federatës Panshqiptare "VATRA" ». Përmbledhë nga Dr. Med. Hamdi H. Oruçi, New York, nanduer 1969.

Kuleta e vjetër me guraleca të ngjyrëshem (Il vecchio Borsellino pieno di sassolini colorati), in *Shêjzat,* 1970.

Gjergj Fishta: Il Liuto delle Montagne (Lahuta e Malcís), traduzione, introduzione e note, *Episodio di Marash Utzi,* Canti XII, XIII, XIV, XV, Roma, 1971.

Bernardin Palaj dhe nji poemth i tij i pakryem (B. Palaj e un suo poema inedito) in *Shêjzat,* 1972, nr. 5-8.

Mustafa Kruja si njeri kulture (M. Kruja nel campo culturale) in *Shêjzat,* 1972, nr. 9-12.

Giorgio Fishta al servizio della politica nazionale (Gjergj Fishta në shërbim të politikës kombtare): conferenza tenuta nell'Aula Magna dell'Università di Palermo il 26-11-1972.

Saggi di letteratura albanese, Firenze, Leo S. Olschki Editore, 1972, pp. 259.

Zef M. Harapi, auktor rromanxash e dramash (Zef M. Harapi, autore di romanzi e drammi), in *Shêjzat,* 1973, nr. 1-4.

Gjergj Fishta: Il Liuto delle Montagne (Lahuta e Malcís), traduzione e note, *Episodio di Oso Kuka,* Canti II, III, IV, V, Roma, 1973.

Mehdi Frashëri si shkrimtar (Mehdi Frashëri come scrittore) in *Shêjzat,* 1973, nr. 5-8.

Migjeni dhe unë (Migjeni ed io), in *Shêjzat,* 1974, nr. 1-10.

The tragic end of one of the most brilliant stylists of Albanian Literature (Reverend Lazer Shantoja, 1892-1945), in *The Fulfilled Promise,* A Documentary Account of Religious Persecution in Albania, by *Gjon Sinishta,* pp. 110-117, Santa Clara, California, USA, 1976.

[2] Fin qui cfr. GRADILONE G., *op. cit.;* l'aggiornamento è stato fatto dalla Redazione della Rivista.

Scritti critici sul Koliqi e la sua opera

Manca uno studio approfondito di tutta l'opera koliqiana. C'è stato un tentativo in questo senso, il quale, per essere il primo, si raccomanda per la ricca informazione e per la varietà, dei problemi affrontati: è la tesi di laurea della signorina *Maria Zuccaro,* discussa nell'anno accademico 1952-53 presso la Facoltà di Lettere e Filosofia dell'Università degli Studi di Palermo: *Ernesto Koliqi e la sua opera,* pp. 214.

Cordignano F., *Epopeja kombtare e popullit shqiptár* (L'Epopea nazionale del popolo albanese), *Scutari, 1925, p. 96.*

Hylli i Dritës, *1930, n. 2, pp. 114-120* (*Vallime Letrare,* « *Hija e maleve* »).

Petrotta G., *Popolo, Lingua e Letteratura Albanese,* Palermo, *1931, p. 401, p. 442.*

Cordignano F., *Lingua Albanese, dialetto ghego, grammatica, saggi di letteratura, fraseologia e proverbi,* U. Hoepli, Milano, *1931, p. 193.*

Fishta G., *Parathânje,* (*p. VII-XIV*) in *Poetet e medhej t'Italís,* vëllim i parë, Tiranë, *1932.*

Valentini G., *Epistull* in *Leka, 1934, pp. 170-171.*

Valentini G., *Kronikë* in *Leka, 1934, pp. 287-299.*

Hylli i Drites, *1935, n. 12, p. 599.*

Tagliavini C., *Parathânje,* (*p. V-IX*) in *Poetet e medhej t'Italís,* vëllim i dytë, Tiranë, *1936.*

Shuteriqi D., in *Perpjekja Shqiptare,* Tirana, *1937, anno I, n. 8, p. 103.*

Leka, *anno X, 1938, n. 4-5, p. 140.*

Albania, *Consociazione Turistica Italiana,* Milano, *1940, pp. 92-93.*

Petrotta G., *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese,* Palermo, *1950, p. 245.*

Mann Stuart E., *Albanian Literature,* London, *1955, pp. 78-81.*

Shuteriqi D., *Histori e letërsisë shqipe,* Tiranë *1955, p. 231.*

Schirò G. jr., *Storia della letteratura albanese,* Nuova Accademia, Milano, *1959, pp. 239-245.*

Gradilone G., *Un poeta albanese: Ernesto Koliqi* in *Il giornale dei poeti, 1956, n. 1, pp. 2-3.*

Tamburi P., *Kangjelet e Rilindjes di E. Koliqi,* in *Shêjzat, 1959, n. 9-10, pp. 335-339.*

Tamburi P., *La vocazione al romanzo di E. Koliqi,* in *Shêjzat, 1960, n. 7-8, pp. 242-248.*

Valentini G., *Scutari e il suo poeta,* Gurakuqi K., *Ernest Koliqi,* Zajmi T., *Kontributi i Koliqit për Kosovën* (*Il Contributo del Koliqi alla cultura kosovara*); Gradilone G., *Koliqi e gli Italo-Albanesi,* Cirrincione A., *I personaggi del romanzo* Shija e bukës së mbrûme in *Shêjzat, 1963, n. 5-6-7-8,* (*numero per il 60° compleanno di Ernesto Koliqi*).

Quasimodo S., in *Le Ore, 1963, 5 settembre, p. 28.*

Paratore E., *Liriche Adriatiche* in *Giornale d'Italia, 1964, 5 febbraio.*

Shënime Bio-Bibliografike të Profesor Ernest Koliqit, in *Diellí,* Boston, Mass., *September, 18, 1968.*

Guzzetta A., *Ernesto Koliqi, un poeta sociale,* Milano, *1968.*[3]

Ressuli N., in « Storia delle letterature del Sud-Est Europeo »: *Storia della Letteratura albanese,* pp. 133-134, Fratelli Fabbri Editori, Milano, 1970.

Lorusso Marcella, *Ernesto Koliqi e la letteratura albanese,* Tesi di Laurea, Anno Accademico 1975-76, Università degli Studi di Bari. Relatore: Ch.mo Prof. Luigi Marlekaj.

[3] Fin qui cfr. GRADILONE G., *op. cit.;* l'aggiornamento è stato fatto dalla Redazione della Rivista.



Koliqi, ndërmjet Malsorvet, ndër Malet e Veriut
Koliqi, tra i Malissori, nelle Alpi Albanesi



Koliqi ndërmjet profugvet shqiptarë
Koliqi tra i profughi albanesi

Vorrimi i prof. Ernest Koliqit

nga **M. C.**

Në mbramjen e 15 të kallnorit 1975 u ndal së rrahuni zemra e profesor Ernest Koliqit, papritmas, në shtëpinë e Tij në Romë. Lajmi i zi u përhap gjat natës në gjak e gjini, në shqiptarët e shpërndamë nëpër botë dhe në të gjitha katundet arbëreshe të Italisë. Ne nesre gazetat dhe radio italiane në gjuhën shqipe dhanë kumtin e vdekjes së Koliqit tue vu në dukje vlerat e Tij letrare e shkencore si dhe damin dhe shprastësinë që shkakton kjo zhdukje për kulturën shqiptare në vete dhe në lidhje me kulturën evropiane.

Familjes të Ndiemit i erdhën telegrame nga të gjitha anat e botës prej miqsh dhe personalitetesh politike të vendit si dhe prej shkencatarësh e njerëzsh të artit tue fillue prej datës 16 kallnor e këndej. Telegrame e letra pikllimi mori dhe Fakulteti i Letrave i Universitetit të Romës.

Si mbas dokes shqiptare trupi i Ernest Koliqit u vizitue dhe u ruejt ditë e natë nga të afërm e miq në banesën e Romës deri të shtunën më 18, kur iu dha lamtumira e fundit prej nji mori gjindje. Në ceremoninë e vorrimit kishin ardhë miq e dashamirë nga Shtetet e Bashkueme të Amerikës, nga Turqija, Suedija, Gjermania, Franca dhe Belgjika si dhe prej shumë vendeve të Italisë, kryesisht arbëreshë.

Nji numër i madh kunorash prej Italisë dhe vendeve të ndryshme si dhe të afërmvet e dashamirëve të Romës zbukuruen rrugën e fundit të Ernest Koliqit tue ia radhitë prej banesës, për të gjat të sheshit përpara shtëpisë, shkallave dhe në hymjen e kishës të Piazza della Balduina dhe deri në lëter, ku *Atë Danjel Gjeçaj*, i asistuem prej papasve arbëreshë, tha meshën përmortore dhe mbajti nji predikim të thekshëm. Nga kjo ceremoni fetare ka për të mbetë përherë në kujtesë tingulli i mallëngjyeshëm i këndimit të korit të Kishës së Shën Athanasit të Romës në gjuhën arbëreshe, ankimet e lutjet plot poezi të liturgjisë lindore dhe ndër to fjalët e pikllimit të *Mons. Fortino-s* « për humbjen e vëllaut Ernest ». Pjesë të kësaj liturgjie këndoi Ai shpesh, nji zani me popullin arbëresh, me za të naltë, ndër kishat arbëreshe në Kalabri dhe në Siqili.

Mbas ceremonisë fetare, para derës së tempullit, i dha lamtumirën e fundit profesori i Universitetit të Romës, *Ettore Paratore*, në emën të Rektorit dhe të kolegëvet të këtij Universiteti. Prof. Paratore tha

ndër të tjera se kultura shqiptare me Koliqin humbte në Itali përfaqësuesin ma të madh të saj. Me gojtari të përmendun vlerësoi Paratore cilësitë e nalta të Ndiemit në lamën e artit dhe të shkencës.

Dr. Ismail Verlaci, kryetar i *Blokut Kombtar Indipendent*, përshëndeti Ernest Koliqin për së fundi, në emën të vet dhe të shokëve, me fjalë thellësisht të ndieme:

Me lot e me zêmër të thyeme nuk kam kurajo me i thanë Ernest Koliqit lamtumirë.

Zhdukja e Tij, për letërsín shqiptare, jashtë e mbrenda Atdheut të robnuem, lên sot nji boshlluk jo kollaj të zavendësueshëm prej breznive t'ardhëshme.

Mjeshtër i ndriçuem nga çdo pikpamje.

Pas 29 vjetve bashkpunimi të ngushtë në fushën politike të mergatës e në luftën e shumëllojshme kundër barbarve qi zotnojnë Shqipnín, Blokut Kombtar Indipendent, *papritmas i mungon nji prej shtyllave themeluese.*

Nuk due me i thanë lamtumirë, sepse tue i thanë lamtumirë nji Mjeshtri, siç ka qenë dhe âsht për né, domethanë me abdikue ndaj atyne parimeve qi Ai vet na ka rranjos.

N'emën të Këshillit Drejtues të Blokut Kombtar Indipendent, *të Degavet të Shteteve të Bashkueme t'Amerikës, Kanadá, Belgjikës e të Francës si edhe un vet, përûlem me respekt para Teje, dhe në heshtje të premtojmë se kena me vazhdue e kurrë mos me të harrue.*

Familjes dhe botës shqiptare ia paraqitën përdhimtimet nëpërmes të *M. Camaj* kolegët e miqt e Universitetit të Münchenit *G. Stadtmüller, H. J. Kissling, G. Grimm* dhe *P. Bartl.*

Familja dhe të pranishmit përcollën mandej trupin e të Ndiemit në banesën e fundit. Ati dhe vëllau i pa shoq, miku dhe mjeshtri i shumëvet prej nesh dhe nji ndër shtyllat e letërsisë shqipe po vorrosej larg Atdheut. Ky mendim peshoi ma randë se kurr në krye dhe në zemrat e të pranishëmvet shí në atë moment kur kufoma e Ernest Koliqit u ul te gryka e vorrit.

Tahir Kolgjini, nji mik i vjetër i të Ndiemit, mbajti fjalimin e fundit. Me fjalë të zgjedhuna në nji shqipe të kthiellтë vlerësoi Kolgjini cilësitë letrare dhe kulturore të Koliqit, dashuninë për vend e gjindjen e vet.

I dashtuni Ernest,

T'a kam pasë çmue vleftën e madhe për s'gjalli. T'a kam pasë çmue dhe e kam pasë dekllarue, herë mbas here, botënisht. Jo veç unë; por, në të vërtetë, vleftën t'ânde e ka pasë çmue e tânë bota shqiptare. Ani, pse ndokush, për shkak zilije e ndonji kategorí, për shkak kundrështimesh parimore, nuk e ka shprehun sheshas.

Unë, nuk e pata mendue se, kam me të vajtue e me të gjëdhokun këtu në krye të vorrit t'ând. Nuk e pata mendue se, do të jem kaq i pá fat. Por, kjo ndodhinë e idhtë, po më shfaqet e pá prapueshëme.

Na shokë, miq e dashamirë, jemi mbledhun këtu pranë Teje, për me të nderue dhe për me të përcjellun në banesën e mbrame; pse na thanë se, ké vdekun. Por, ky lajm i kobshëm, âsht përhapun gabim. Burrat si Ti, kurr nuk vdesin. Ata, ndërrojnë jetë. Prá, edhe Ti, ndërrove jetë dhe shkove atje, ku, dikush mâ heret e dikush mâ vonë, do të shkojmë edhe na tjerët.

I dashtuni Ernest,

Ti, ishe dhe shkove si nji shqiptár sedrar e kryenaltë; sepse, si nji arsimtár me nji vullnet të pa sosshëm, derdhe mundimin t'and për t'arsimue brezin e rí me dhetamija, qi ishte grumbullue në bankat shkollore për t'u pajue me njoftuninat e kohës moderne dhe me ato të traditave të nalta të racës shqiptare.

Nji vetmohim idealist medis idealistave.

I dashtuni Ernest,

Për veç detyrës së shênjtë si mësimdhânës, Ti, me nji talent thuejse të pá shoq dhe me vrullin e natyrës t'ânde, u hodhe në lâmën e gjuhësís, tue i shërbyem popullit t'onë me poema të shkëlqyeshëme, me proza tërhjekëse dhe me nuanca të llojëllojëshëme. Dhe përpunimet t'Ua, kanë fitue admirimin e bashkëkombasëve, të cillët, janë t'interesuem në çashtje kulturore e shoqnore.

I dashtuni Ernest,

Dikuër, në kohën e luftës së dytë botënore, kur digjeshin flakë katër anët e lamshit të këtij dheu, Ti, i përvole krahët si ministër i arsimit dhe n'ato rrethâna krejt të vështira, për të parën herë udhzove krijimin e shkollës shqipe në vendet shqiptare të robnueme, të cillat, mâ përpara e kishin të ndalueme rrebëtësisht me e soditun edhe abetarin e gjuhës së tyne. Përpjekjet t'Ua morale e materiale dhe ndihmat e pá kursyeshëme, qi i bâne çashtjes, me nji herë e dhanë pemën e tyne. Dhe sod, shkolla shqipe n'ato vende, u rrânjue dhe po vazhdon regullisht si nji e drejtë e pá mohueshëme e elementit shqiptár.

Vetëm kënaqsíja e këtij shërbimi, mjafton për me të përgëdhelun ndiesinat dhe për me t'ambëltue plagët.

I dashtuni Ernest,

Ti, edhe në jetën e gjatë të mërgatës shqiptare e në rrethâna mjaft të vështira, u bâne pyrg i kështjellës së virtutevе kombtare. I prine botës s'onë me shtyp e me konferenca. Përpunove revista, gazeta e libra. I ngarkove vetvehtes misionin për me ndërlidhun të gjithë shqiptarët me njâni tjetrin në lâmën e kulturës dhe n'atê, qi përkon të drejtat kombtare. Hape nji rrê moderne. Dhe na shqiptarët, nepërmjet të saj, mësuem mâ mirë gjuhën t'onë. Shijuem mâ bukur letërsín t'onë. Njoftëm mâ gjanas historín t'onë. U zbavitëm me valle të prime prej kulture. Dhe u forcuem moralisht e mate-

rialisht, tue mbërritun në gjendje me iu qendrue besnikë të pá përkulëshëm interesave kombtare.

Mâ në fund, i dashtuni Ernest, more bajrakun në dorë dhe, me kompetencën t'ande kulturore të gjânë, me natyrën t'ande t'ambël dhe me bujarín t'ande të pá shoqe, ngallnove me ndërlidhun me ambiente kulturore shqiptare e, sidomos, me qendrën t'ande, shum universitete, shum institute kulturore e shum profesora të botës moderne. Këta, erdhën në marrëdhânje me Ty dhe me pjesën merituese të botës s'onë. U tërnitën; u frymzuen dhe me njoftuninat e tyne historike, gjuhësore e tjera, i dhanë nji kontribut të madh thesarit të kulturës shqiptare, tue i vûmë në dukje dhe tue i botue në mënyra të ndryshëme kërkimet dhe hulumtimet e tyne. Për nji pjesë të këtyne përpunimeve, qartas na e dëshmojnë Shêjzat *t'Ua. Dhe ky sistem i lavdishëm, ka ngulun rrânjë dhe, për fat të bardhë të shqiptarëve, do të vazhdoje dhe mbas këndej.*

I dashtuni Ernest,

Ké qenë luan me dukje fizike. Jé shfaqun madhështor me punimet t'Ua. Prá, për né, gjithëmonë, jé i gjallë. Prandej, Ti, nuk ké vdekun. As nuk vdes kurr! Tý dhe shërbimet t'Ua kemi për t'i ruejtun në thellësín e zêmrave t'ona. Të kemi pasun lakmí dhe kemi me të lakmue për ç'ké bâmë në dobí të Kombit e t'Atdheut.

Po të siguroj se, pinjojt, të cillëve iu ké ndihmue për të gëzue pozita në fushën e kulturës, kanë me qenë mirënjoftësa për Tý. Këta, të jesh i sigurtë, kanë me vazhdue në rrugën t'ande të lavdishëme pá u lodhun e pa u dropetun. Në rrugën e drejtë të shqiptarís ...

Kjo botë, për asnji njerí, nuk âsht e përherëshëme, i dashtuni Ernest Koliqi. Por, Ti, jé i lumtun qi me plot merita po mundesh me zânun nji vend me shum rândësí prânë shkrimtarëve, prânë poetënve e prânë shërbimtarëve të dalluem shqiptarë në jetën e amshueme. Prânë atyne, qi janë apostujt e rilindjes shqiptare.

Për né këtu, zâni i mirë i yt, ushtima e jote e kândëshëme, qi jehon, do të jetë nji ngushullim dhe nji testament udhzimi në veprimet t'ona.

Të shoqnoftë hiri i të Madhit Zot.

Mandej Koliqi u ul në vorrezën familiare, në gjinin e prindëvet e të bashkëshortes *Vangjeli.*

Në pamundësi me botue krejt telegramet e letrat e ardhuna, *Familja Koliqi*, tue përsëritun falnderimet ma të sinqertat, siguron se do të ruhen n'arkivin e Bibliotekës e, mundësisht, nji ditë edhe me i nxjerrun në nji vëllim të veçantë.

Kronikë Kulturore

Tezë doktorati mbi Koliqin

Zoja *Marcella Lorusso* mbrojti në kohët e fundit në Universitetin e Bari-t (Fakulteti i Magjisterit) tezën e doktoratit me titull *Ernest Koliqi e letërsia shqipe*, tue pasë Relator *Professor Luigj Marlekajn*.

Teza ndahet në gjashtë kapituj: 1. *Jeta e vepra e E. Koliqit;* 2. *Koliqi - poet lirik;* 3. *Koliqi novelist;* 4. *Koliqi romansier;* 5. *Koliqi mjeshtër syzimesh letrare;* 6. *Koliqi përkthyes.* Zoja Lorusso asht mbështetë në shtjellimin e tezës në nji mori burimesh, gati qitë në harresë, nga publikime shqiptare e të hueja e të dhana tjera. Sqarimi i vetjes së Koliqit e i veprës së tij në gjithfarë gjinish, pa lanë kurr mbasdore stilin e zhdërvjellët si rrallë të ndokujt në shqipe po se po, por edhe në italishte, pret të shqyrtohet. As interesi i katedrave albanologjike nuk do të mungojnë. Puna e zojës Lorusso paraqet nji ndihmesë në këtë drejtim, kur dihet se dhe Relatori i tezës, Marlekaj, asht nji ndër dishmitarët ma të hollë të veprimtarisë letrare e shkencore të Koliqit qysh para luftës, pajandá prej Shqipnisë deri në Itali. Teza u çmue me notën ma të naltë prej kolegiumit gjykues.

Teza e parë me këtë përmbajtje në Itali u mbrojt në Universitetin e Palermo-s nga *Maria Zuccaro: Ernest Koliqi dhe vepra e tij.* Vjeti akademik 1952-53. Relator *prof. Zef Valentini.*

V.

Lëvizje kulturale n'USA

Mbrëmjet Shqiptare

Dyke vazhduar traditën e saja shumëvjeçare në fushë të kulturës kombëtare Shqiptare, *Shoqëria Letrare*, nisi një veprimtari të re me anë të *Mbrëmjevet Shqiptare.*

Vargu i *Mbrëmjevet Letrare Shqiptare* u fillua të shtunën mbrëma më 21 të dhjetorit 1974 në sallën e bukur «Jefferson» të hotelit Americana Inn Squire, New York City, me *Mbrëmjen Korçare* e cila

do të vazhdohet, më vonë, me mbrëmjet: Shkodrane - Kosovare - Dibrane - Vlonjate - Elbasanase - Tiranase - Kruetane - Beratase - Gjirokastrite - Arbreshe, e kështu me radhë për të gjitha viset ku banojnë Shqiptarë.

Mbrëmja e parë Shqiptare u nis me *Mbrëmjen Korçare* sepse muaji dhjetor është muaji i Themistokli Gërmënjit në Korçë me ngjarjet historike të motit 1916.

Programi i *Mbrëmjes Korçare* ishte ndarë dysh: muzikë popullore, patriotike dhe folklor korçar; lëçitje copësh të sgjedhura nga folklori i Spiro Dines, Thimi Mitkos edhe këngë të Fushës së Korçës, mbledhur nga Bendo Shapërdani. U lëçit gjith ashtu edhe poemi *Rushi u poq.*

Kjo pjes'e parë e *Mbrëmjes* i qe ngarkuar *profesorit Kostandin Vangjeli*, i cili, me një talent thuajse artistik, lumtëroi gjindjen me interpretimin e bukur si të copëvet të folklorit ashtu edhe të poemit *Rushi u poq.*

Në pjesën e dytë të *Mbrëmjes*, folësi kryesor, *Inxhinjer Vasil Gërmënji*, paraqiti konferencën e tija mbi *Heroin Themistokli Gërmënji* shumë të pasur me fakte dhe dokumenta historike dhe me një kompetencë të dalluar q'impresionoi gjindjen e cila mësoi gjëra që s'i kishte dëgjuar më parë.

Fotografira, gazeta, revista, dokumenta edhe libra, të vjetra edhe më të rea, shqip e në gjuhë të huaja, ishin vendosur mbi tryezën e kryesis për shqyrtimin e të gjithëvet.

Dr. Ligor Buzi kryesoi *Mbrëmjen Korçare* me fisniki.

Një inovacion shumë prekës ishte ky: të gjitha zonjat, zonjushet edhe zotërinjtë që nderuan *Mbrëmjen Korçare* me pranin e tyre, tek hynin në sallën « Jefferson » priteshin edhe me nga një lule bukur paraqitur, një karafile, dhuruar nga *dr. Hamdi H. Oruçi*, njëri nga bashkëpunëtorët që ndihmuan shkëlqimisht në pregatitjen e *Mbrëmjes Korçare* në New York.

Gjatë *Mbrëmjes* dëshiruan të thonë nj'a dy fjalë çmuajteje të thellë ndaj nisjativës « e cila duhet përkrahur pa kursim sepse është një e mir e madhe për çështjen, jo vetëm të kulturës por edhe të vllazërimit të njerzis s'onë n'atmosferën e kulluar që krijojnë kësi mbrëmjesh ». Folën: *dr. Oruçi*, *z. Peter Kolonia* edhe *z. Mernaçaj*, i cili deklamoi një poezi të tijnë.

Ndihmesë fort të çmuar dhanë për pregatitjen e *Mbrëmjes Korçare* *z. Dibra*, *z. Lamaj*, *z. Llambi Pambuku*, etj.

Mbrëmjen Korçare e hapi kryetari i *Shoqëris Letrare z. Vasil D. Alarupi.* Pasi mirsardhi edhe falnderoi gjindjen e çquar, ndër të tjera tha:

« *Mbrëmjet Shqiptare* janë përgjegjësi edhe punë kryesore e *Shoqëris Letrare* por, vullneti i mirë edhe bashkëpunimi i intelektualëvet t'anë për pregatitjen edhe paraqitjen e *Mbrëmjevet Shqiptare* pritet me gëzimin më të madh sepse dëshirojmë t'ia lemë sicilit kënaqësinë të flasë me më tepër njohuri, ndjenja e zotësi mbi kulturën, folklorin



Nga e majta/dalla sinistra: Vasil D. Alarupi, Anesti Andrea, Ligor Buzi e Kostandin Vangjeli



Flet zoja Pauline Loukas

edhe historin e qytetit a të krahinës së prejardhjes. Për këtë, do t'ishte mirë që gjith ata zotërinj a zonja që do të dëshironin të bashkëpunonin për organizimin e mbrëmjevet të ndryshme, të hynin në marrëveshje me drejtonjësit e *Shoqëris Letrare. Mbrëmjet Shqiptare* do të jenë thelbërisht kulturale ».

Kryetari i bëri një nderim të thellë kujtimit edhe kontributës së dhënë nga disa anëtarë që kanë ndruar jetë edhe lavdëroi ndihmesën e shumë të tjerëvet ndaj Shoqërisë në të shkuarën.

Mënëfund zotni kryetari ftoi *dr. Ligor Buzin*, publicist dhe poet i mirënjohur së cilit i qe ngarkuar barra të kryesojë *Mbrëmjen Korçare*. Dhe dr. Buzi ia dolli bukur e bukur me zotësin edhe fisnikin q'e dallojnë për kënaqësi të audiencës së shquar.

Mbrëmja e parë Shqiptare, *Mbrëmja Korçare* qe një sukses i plotë. Një nismë nga më të çkëlqyerat në të mirë të kulturës s'onë.

DM-Ko.

MBRAMJE LETRARE SHQIPTARE NE NEW YORK

Me 21 qershuer 1975 në Sallat e bukura të *Hotel Commodore* të Manhattan, New York, *Shoqnia Letrare Shqiptaro-Amerikane*, paraqiti nji mbramje letrare artistike shqiptare. Tema e kësaj mbramjeje ishte *Mbramja Shkodrane*. Salla e madhe e hotelit të famshëm të New York-ut ishte e mbushun me mâ tepër se 350 vetë, shumë me kostume krahinore kombëtare.

Mbramja ndahesh në dy pjesë : *Pjesa e parë historike letrare* dhe *pjesa e dytë fotografike-folkloristike.*

Mbramja kryesohesh nga *dr. Hamdi H. Oruçi.*

Pjesën historike e mbajti *dr. Fejzi I. Domni. Pjesën letrare* e mbajti *z. Zef Mirakaj.* Të dy këto qenë studime t'imta që do të botohen sa mâ shpejt nga *Shoqnia Letrare Shqiptaro-Amerikane.*

Pjesa fotografike qe e pasun me historí visive tue paraqitë monumentet historike të Shkodrës, si Kalan e Shkodrës, të Lezhës, të Drishtit, të Shurdhakut, Urën e Mesit, Xhamín e Plumbit, Lek Dukagjinin me Stemën e Flamurin e Tij, Dedë Gjo' Lulin dhe Flamurin e Deçiqit 1911. U paraqitën edhe kostumet e bukura e tërheqëse të Shkodrës me rrethe. Në *pjesën letrare* u paraqitën fotografít e poetve e të shkrimtarve shkodran : Pashko Vashës, Luigj Gurakuqit, D. Ndre Mjedës, Hilë Mosit, Migjenit, Fishtës, Koliqit etj.

U banë recitime nga vepra të ndryshme të autorve të shkollës shkodrane, si të Mjedës, Fishtës, Volaj, Migjenit, M. Camaj, Arshi Pipës e të Ernest Koliqit.

Recitues ishin dr. Gjon Buçaj, prof. Lume Juka, dr. Fejzi Domni, Zef Mirakaj, Marie Rakaj e dr. Hamdi Oruçi.

Dr. Oruçi e përkujtoj shkurtaz Ernest Koliqin dhe e quejti *Rilindasin e fundit* të letërsís shqipe.

E drejtueme nga artisti shqiptar *z. Bahri Drishti* me nji grup të gjanë kangëtarësh e strumentash, dhe nga *prof. Lume Juka* u paraqit *Dasma Shkodrane* e u kënduen kangë shkodrane.

Si rapsodë me lahutë e çiftelí ishin i biri i të mirënjoftunit Gjergj Pllumbit, *z. Nika* dhe kushrini i rapsodit të famshëm, *z. Shpend Gjelaj* që kënduen kangët e maleve, kangët e Malsis trime, të *Lahutës së Malcís.*

Të pranishmit u gostitën me nga nji kafe e nji ambëlsín.

Përhirimet t'ona drejtuesave të këtyne mbramjeve shqiptare, dhe për mbramjen shkodrane mikut tonë *dr. Hamdi Oruçi-t.*

Urojmë të shohim mbramje letrare shqiptare folkloristike të tjera.

T. H.

Monsinjor Fortino çon nji meshë për Koliqin

Me 15 kallënduer 1975, siç dihet, u ndá këso jete Poeti e Shkrimtari zâmadh, *prof. Ernest Koliqi.* Me 15 fruer 1975, tridhetë ditë mbas vdekjes (*Trigesimo*) u çue nji meshë drite në Kishën italo-shqiptare të *S. Atanasio* në Romë.

Lajmi i kobshëm i zhdukjes së Koliqit u përhap si rrufé në pêsë kontinentet. Nuk âsht vendi këtu me folun mbi veprimtarinë kulturore e politike të Profesorit t'onë pse për këtê kanë shkrue e do të shkruejnë kompetentat. Na këtu dishrojmë vetëm me shtue se mërgata dashamirse e bashkimdashëse ka mbetun jetime e zhprazëtija e Tij ndihet qysh tash.

Në meshë morën pjesë, përveç Familjarvet e Kushrijvet, gadi e krejt kolonija shqiptare e ajo italo-shqiptare e Romës, si edhe shumë Personalitete e Koleg. Nuk mungojshin nxânësit e Tij, të cilët kujtojshin me admirim e dashuní Arsimtarin e paharrueshëm.

Meshën e çoi i përnderti *Monsinjor Eleuterio Fortino* i përsjellun nga kori arbresh. Emnat e të pranishëmvet nuk po mundemi me i shênjue të gjithë e po përmendim Senatorin *Gennaro Cassiani* me Zojën, *prof. Ettore Paratore, comm. Giovanni Lala Comneno* me Zojën, *prof. Mircea Popescu,* Zoja *Silvia Zorzoli,* Gjeneral *Zef Serregji* me Zojën, *Át Danjel Gjeçaj, Dom Gjeto Radi, dr. Ismail Verlaci, rag. Lin Shkreli* me Zojën, *z. Ekrem Telhaj, dr. Ragip Frasheri, prof. Giuseppe Gradilone* me Zojën, e shum e shum të tjerë.

Në fjalimin që Monsinjor Fortino mbajti, përmendi, jo vetëm veprimtarín e Koliqit, por edhe bashkëpunimin e miqsín që e lidhte me Të. «*Jemi mbledhun sot këtu me përkujtue nji Vllaun t'onë, nji Mikun t'onë të dashtun,* Ernest Koliqin, *i Cili për né Arbreshët âsht nji De Rada, nji Schirò, nji Naim, nji Fishtë pse qe Ai që na zgjoi përsëri nga gjumi i randë ku kishim mbetun. Na mësoi e na tregoi udhën se si duhen ruejtë gjuha, zakonet e kostumet dhe randësín e tyne*». Tue vijue shtoi: «*Koliqi na mësoi me dashtë Atdheun e të parvet, Shqipnín, me qenë përhera Vëllezën me Shqiptarët pse ndër të gjithë né rrjedh nji gjak,* gjaku i ynë i shprishun».

Mbas meshës Monsinjor Fortino, mik e përkrahës i Shqiptarvet, ftoi të pranishmit në selín e vet.

Meshë përshpirtje për Koliqin

Në Kishën *Sant'Eustacchio,* në Romë, me 1 fruer 1975, i përnderti *Don Gjeto Radi* kujtoi me nji meshë drite prof. Ernest Koliqin. Morën pjesë në kët ceremoní familjarët e disa miq e dashamirë.

Don Gjeto me pak fjalë të thekëshme shenjoi veprimtarinë kulturore të Koliqit, bujarin e mikpritjen e Tij. «*Vdekja e Ernestit* — tha oratori — *âsht nji humbje e pazavendësueshme për krejt mërgatën shqiptare e diasporen. Kam vuejte edhe këtë rradhë sikur ne kohën kur më vdiq Baba i êm pse Babë e Mik ishte Koliqi për të gjithë né*».

Fjalimi preku thellësisht të pranishmit.

Përkujtohet Prof. Koliqi

Në Kolegjin italo-shqiptar «S. Adriano» të Shën Mitrit (San Demetrio Corone - Cosenza) me datën 15 fruer 1975 u bâ mbledhja e përgjithshme e Antarvet të *Bashkimit të Komunitetve Italo-Shqiptare* (U.C.I.A.). Punimet i hapi Kryetar' i Nderit *prof. Emilio Tavolaro* i cili përkujtoi prof. Ernest Koliqin që u zhduk papritmas para pak kohe.

Prof. Tavolaro vûni në dukje veprimtarinë e zhvillueme nga Koliqi në përkrahje të kulturës italo-shqiptare dhe meritat për rilindjen e krejt diasporës përsëri mbas sa e sa vjetve e për ruejtjen e traditave e të zakoneve t'ona.

Këshilli i Fakultetit përkujton Koliqin

Prof. Zef Schirò jr., me 27 fruer 1975, në nji mbledhje të Këshillit të Fakultetit të Letërsís e Filozofís t'Universitetit të Romës, përkujtoi *prof. Koliqin*. Oratori vûni në dukje krejt veprimtarinë kulturore e arsimore të të Ndiemit tue shenjue veçanisht veprat mâ kryesore, sidomos naltësimin e Institutit të Studimeve Shqiptare që Ai vet krijoi e drejtoi.

Të pranishmit mbajtën nji minut heshtje në shêj zije e nderimi për Koliqin.

Nji vizuer: Ernest Koliqi

Ernest Koliqi u brumue dhe u burrënue me të gjitha dallimet e të ditunit qytetar katolikë Shkodranë, dhe me ato dallime spikateshin në Te: bujaria, mirprumja, thumbat, zgjutësia dhe miqësia.

Aji kishte diçka edhe ma shumë se të tjerët; kishte dituní të thellueme, talent të lindun dhe të përpunuem, zgjutësí dhe vullnet të veçantë me vue në dritë ditunín dhe talentin.

Por Aji kishte edhe ma: kishte cilësín e rrallë, biles shumë të rrallë ndër të gjithë né; kishte uzdajën me përvehtësue njoftuní dhe po ashtu uzdajë me i a mësue edhe të tjerëve.

Ernest Koliqin e respektuen shumë, por edhe e kritikuen shumë.

E respektuen ata që e lexuen, pse ndër shkrimet e Tija gjetën njeriun e nji shtrese shumë ma të naltësueme se do ku dohi; n'ato gjetën brum me brumue vehten dhe nëpërmjet t'ati brumimi me e shkoqitun, me e gjykue dhe me e naltësue Ate mbi kathedrën e ditunís.

E respektuen dhe e deshtën, si shok dhe si mik, të gjithë ata që e ndëgjuen tue folë, pse qoftë rreth nji sofre buke shtëpie ose rreth

tryezës të nji restoranti, Aji, tue naltësue vlerat e pijeve dhe të gjellëve, i afronte atyne që i ishin pranë edhe shijen me e ndëgjue dhe me e çmue, kur kalonte nga sheshet e ditunive ndër sheshet e halleve të përditëshme, nga përshkrimi epik i nji gjesti burrnuer në qesëndisjen dhe thumbat qe i a drejtonte shokut dhe mikut aty rrotull.

E kritikuen dy llojë njerëzish, ata që nuk e kuptuen, pse nuk i a lexuen shkrimet dhe nuk i a shijuen shoqënín dhe muhabetin; e kritikuen edhe ata që kritikën e mbështesin dhe e përforcojnë nëpërmjet të sentimenteve që i krijohen nga gabimet dhe që aq shumë i a prekin sensibilitetin.

Asht nji fatkeqsí e madhe që shumica dërmuese e të mësuemëve Shqiptarë, civilizimi nuk i ka lymosun mirë; kanë mësue për me e pasë mjet jetese dhe me u ngritun ndër shtresa ma të nalta shoqënore, por nuk e kanë përvehtësue civilizimin dhe me e bamë jetesën në harmoní me shoqënín; janë akoma në fazën kur versnikët dhe pjestarët e grupeve të shtresave të të dituave vazhdojnë me i peshue po me kandarin e vjetër.

Jo, kandari nuk asht ma me peshue njerëz; kandari asht me peshue sende; njerëzit studjohen dhe shtjellohen si mbas pregatitjeve mendore dhe si mbas prodhimeve mendore.

Nji mbramje, shumë vonë, ndër rrugët e Romës, miku që m'ishte pranë më pyeti:

« E takove Koliqin? »

« Po », i u përgjigja un.

« Më mungon shumë — shtoi miku — më mungon shumë dhe e ndjejë vehten të vobegësuem nashti që nuk po i a shijoj ma shoqënín dhe nuk po i a ndëgjoj ma muhabetin ».

« Po pse nuk pajton? » e pyeta un.

« Ti e di — më tha miku — ti e di se po të mos ishte nashti tre mbas mezit të natës, dhe po të mos ishje ti nga ata që nuk i a thue kërkuejt, un nuk do t'a kishje thanë kurrë ate që të thash ».

Miku t'em i asaj mbramje Romane bante pjesë në grupin e atyne që e kritikojshin, por duket se po në të njejtën kohë, në thellësín e mbrendís së tij, po vazhdonte me i a ndie mungesën e shoqënís dhe të muhabetit të Tij.

Kjo asht shoqënia t'onë; ne mësojmë me e lexue librin, qëndrojmë dhe vështrojmë harmonín e ngjyrave dhe përdredhjet e vijave të nji vizatimi, rrijmë dhe i ndëgjojmë tingujt e muzikës të nji orkestre; por akoma nuk kemi mbërrimë me u thellue në mbrendín e përmbajtjes së librit, me shkoqitë dhe me gjykue shprehjet e vizatuesit, me e kuptue se tingujt e muzikës, përveç gëzimit që i ndëgjojmë, na hapin edhe dyerët e nji bote që na krijon ndjesina dhe na bie rrëqethje.

Ernest Koliqi leu i talentuem dhe i gatshëm me u strehue ndër shtresa artistash; nëpërmjet të punës e ngriti vehten mbi nji kathedër dimnie dhe mbi ate qëndron; vështron përmbi neve, vështron drejtë

brezënive të reja dhe t'atyne që do të vijnë; vështron ata, që nëpërmjet të ditunive dhe të civilizimit do t'i hapen horizonte të tjera mendimesh, dhe emocionet nuk do të jenë të njillojta me ata që po jetojnë.

Mue më vjen mirë, shumë mirë, që e njofta, që i a shijova shoqënín, që i a ndëgjova muhabetet; me Ate shkëmbeva edhe letra, jo letra formale, por fjalë prej zembre në zembër, letra miqësh; Aji tue u mundue me më llastue dhe me më mësue per me më ngritun ndër shtresa ma të naltësueme, un tue u mundue me i a mbajtë të gjallë zellin dhe me e bindun se si un janë plot ata që i a vleftësojnë ditunín dhe prodhimet mendore.

Ernest, në mbramjen e mbramjeve, paç mbramjen e mirë.

SHEFKI MIRAKU

[« DIELLI » (*The Sun*), Vol. n. 67, n. 1, Worcester, Mass., Thursday, February 28, 1975; 65th Year].

Përkujtimi i Ernest Koliqi-t në New York në përvjetorin e parë të vdekjes

Me 25 Kallnuer 1976, në *Hotel Commodore* të New York-ut, u ba përkujtimi njivjetor i vdekjes së *prof. Ernest Koliqi-t*, poet e shkrimtar i njoftun shqiptar, drejtor i Institutit për Studime Shqipe, dhe Titullar i Kathedrës së gjuhës shqipe pranë Universitetit të Romës në Itali.

Salla e mbledhjes së hotelit të bukur newyorkez, ishte zbukurue me nji mbishkrim me shkronja të florinjta « In memoriam Ernest Koliqi » dhe mbas kryetryezës e afër podit të folësve ishte vendosë edhe nji fotografí e zmadhueme e të ndjerit prof. Koliqi.

Mbledhja u kryesue me zotësí të veçantë nga *Ing. Ago Agaj*, antarë i Këshillit qëndror të *Blokut Kombëtar Independent*. Folësi kryesor ishte *dr. Rexhep Krasniqi*, Kryetar i Komitetit « Shqipëria e Lirë », i cili shquajti fëtyrën poliedrike të Koliqit, tue folë edhe mbi Shkodrën, vendlindjen e Koliqit.

Në Shkodër, dr. Krasniqi ka kalue vjetët ma të bukura të rinís së vet, e bile afer shtëpisë së Koliqve. Ai kallëzoi mbi relacjonet familjare që Koliqi kishte me Luigj Gurakuqin, i cili qe mentori dhe frymzuesi kryesor i interesimit të Koliqit për Kosovë. Krasniqi paraqiti kontributin e Koliqit për arësimin kombëtar në Kosovë, kur në vjeshtën e 1941 u hapën për të parën herë shkollat shqipe dhe i pari gjimnaz i plotë në Prishtinë. Drejtor i këti gjimnazi u emnue nga Koliqi dr. Krasniqi me titullin Komisar, por me funksionin e drejtorit. Kjo veprimtarí vendimtare e Koliqit ka qenë fatlume për Shqipninë e për Kosovën se, sot shohim nji përtrimje të shumëngjyrshme të kulturës në Kosovë. E kjo ndodhi sepse që në riní Koliqi u influencue për Kosovën nga Gurakuqi që kishte si miq Bajram Currin, e kryetarë tjerë revolucjonarë e politikë të Kosovës, që Koliqi i njofti që në hapat e para të veprimtarisë së tij letrare e politike.

Mandej e përkujtuen me radhë Koliqin: zz. *Vasil Alarupi*, Kryetar i *Shoqerisë Letrare Shqiptare-Amerikane*, që foli mbi randësinë e shkrimeve të Koliqit dhe mbi kujtime personale; *Ing. Mahmud Tsungu* që foli mbi ndihmën e madhe që i dha Koliqi arësimit kombëtar në kondita të vështira se punoj atëherë kur në Shqipni ndodhesh i hueji; z. *Adem Hodo*, Nënkryetar i *Bashkimit Demokrat Shqiptar*, që foli mbi kujtime personale e citoi disa pjesë të letërshkëmbimit që ai kishte me Koliqin.

Dr. Hamdi Oruçi lexoi letrën e familjes Koliqi të nënshkrueme nga i biri i të ndjerit Profesor, *dr. Marku*, që falënderonte pjesëmarrësit në atë kujtim të Atit të tij.

Qe teksti i letrës:

Roma, 15 gennaio 1976

Caro Dottore,

in questo giorno, anniversario della scomparsa di mio Padre, Le scrivo anzitutto per ringraziarLa delle gentili e buone parole che ha voluto scrivere alla mia Famiglia ed a me.

So che, in concomitanza con le commemorazioni che hanno luogo qui a Roma, gli amici Albanesi negli Stati Uniti hanno organizzato analoghe occasioni di ricordo. In particolare, sono stato informato che a New York, il 25 gennaio 1976, si svolgerà un Seminario.

La prego, in quella circostanza, di volersi fare cortesemente interprete presso coloro che l'hanno promosso e presso coloro che vi interverranno, dei sentimenti più vivi di riconoscenza e di ringraziamento miei e della mia Famiglia per aver voluto onorare la memoria di mio Padre: un Uomo. Le dimensioni del vuoto che Egli ha lasciato si vanno allargando sempre più via-via che il tempo trascorre, e sapere che qualcuno condivide i nostri sentimenti ed il senso di incolmabilità che proviamo ci conforta e ci onora.

A tutti, il nostro grazie.

La ringrazio, caro Dottore, e la saluto cordialmente.

Marco Koliqi

Dr. Oruçi fjalimin që kishte mbajtë në Boston, në Pier Four kur Organizata Panshqiptare «*Vatra*» shtroi një drekë për nderë të prof. Koliqit në vjeshtën e vitit 1968: *z. Ndue Gjomarkaj*, Nënkryetar i *Blokut Kombëtar Independent*, paraqiti Koliqin familjar dhe aktivitetin e tij letrar e politik. Folën gjithashtu shkurtazi edhe i riu kosovar *z. Skender Kodra* si «nxanës i Koliqit e i shkollës së Tij», dhe *z. Ymer Doda* mbi disa kujtime personale.

Mbas konferencave u shtrue në një sallë po aqë të bukur të *Hotel Commodore*, një darkë me gjellna të shijëshme. Darka u kryesue nga *Dr. Gjon Buçaj*, Sek. i Përgjithshëm i *Blokut Kombëtar Independent*, me zotësí e urtí. Darka u bekue nga ish nxanësi i Koliqit *Monsinjor dr. Zef Oroshi*, i cili lexoi edhe një vjershë të Koliqit që ishte botue në Buletinin e *Jeta Katholike Shqiptare*. Foli gjithashtu *dr. Luat Myftija*, Sek. i Përgjithshëm i *Levizjes Kombëtare te Legalitetit*, tue naltësue veprën letrare të Koliqit dhe tue vue në dukje sidomos miqësinë që kishin dy familjet e njoftuna shkodrane. Foli gjithashtu *Zonja Nexhmie Zajmi*, Kryetare e Degës së *Vatres* së Manhattan-it. U banë mjaft recitime të poezive të Poetit shkodran, por po kujtojmë këtu recitimin e bukur që bani *Zoja Maria Tereza Gjomarkaj*, të një poezie që Poeti vet e kishte përkëthye në gjuhën italisht.

Merrshin pjesë në Përkujtim e në darkën e shtrueme ma tepër se dyqindepesëdhjetë bashkatdhetarë, në mes të cilëve shquheshe juristi i shquem shqiptar *dr. Hasan Dosti*.

Reporteri

«Shqiptari i Lirë»
Vj. XX, New York, Dhjetor 1976

Përkujtimi i BKI

Bloku Kombtar Indipendent organizoi në Janar, përkujtimin e *Profesor E. Koliqit* në New York, në rasën e përvjetorit të parë të vdekjes së tij.

Qyshë disa muej ma parë interesoheshin, jo vetëm blokistat, por, edhe shqiptarët tjerë të komunitetit të New York-ut me rrethe, me dijtëse kur e si do të bahet komemorimi i Koliqit, prandej nisma e *Blokut* u prit me pëlqim nga shumica e bashkëatdhetarvet, gja që e dëshmon edhe pjesëmarrja e gjanë qoftë në numër, qoftë në përfaqsim të Klerit, të intelektualve dhe të partive politike e shoqatave të ndryshme.

Programi u zhvillue ditën e dielë me 25 janar, 1976.

N'orën 12 mesditë, në Kishën Katholike Shqiptare, *Msgr. Zef Oroshi* tha meshën e porositun nga *Bloku* dhe foli përmbledhtas mbi figurën e Koliqit e veprimtarin e tij në dobi të kombit, dhe theksoi se e ka pasë Profesor të vetin në letrësi në Universitetin e Romës.

Kisha ishte e mbushun plot edhe deri jashtë në rrugë. Përveç Katholikve shqiptarë, kishin ardhun edhe shumë bashkë-

vëllazën Muslliman e Orthodoks, ndër të cilët na ranë në sy, *Ing. Ago Agaj*, *dr. Rexhep Krasniqi*, *Adv. Hasan Dosti*, *dr. Odhise Dhima*, *dr. Constantine Spata* me zojën (Arbreshe) *prof. Theodor Papalilo*, *dr. Selahedin Velaj*, *Dervish Halil Dushaj*, *z. Ymer Doda*, *z. Pavlo Nikolla*, *zoja Nexhmije Zajmi* e shumë të tjerë.

Para se me lexue ligjeratën e vet, *Ing. Cungu* ftoi vëllaznit muslliman të pranishëm me i këndue Koliqit nji lutje përshpirtje në gjuhën Arabishte (*El Satiha*), pse ai i konsideronte njisoj si të Krishtenët si Muslimanët Shqiptarë, vëllazën të nji gjaku. Ky gjest vëllaznimi u pelqye nga të gjithë të pranishmit, të cilët qendruen në kambë derisa — *El Satiha* — u krye.

Mbas fjalimit të dr. Oruçit, të pranishmit ndëgjuen me vemendje e përmallim zanin e Koliqit tue folë mbi Nolin në Seminarin e *Vatrës*.

Në fund dr. Oruçi lexoi edhe poezin nostalgjike *Bijës s'ime*, ku shifet paramendienja e Koliqit se nuk ka me u këthye ma në vendlindjen e vet, dhe porositë të Bijën (porosi që i asht drejtue brezit të ri të rritun në mërgim), me u këthye në truell ku tharmi ethnik pret me u ringjallë në trashigim stërgjyshuer në stinët që vijnë.

Të gjithë folësat u duetrokiten me përzemërsi.

Darka

Programi përkujtimuer u përfundue me nji darkë që antarët e *Blokut* shtruen për nderë të miqvet të cilët muerën pjesë në kët përkujtim.

Dr. Gjon Buçaj që drejtoi mbramjen, përshëndeti me pak fjalë mysafirët dhe i falnderoji për pjesmarrjen «*në kët përkujtim të njanit nga shqiptarët ma të mëdhej të kohës, që na la me 15 kallnuer të vitit që shkoi*».

Miqsija e vërtetë, tha ai, asht nji veti fisnike që nuk vdes kurrë. Me i nderue emnin dhe me i shprehë mirënjohjen njij njeriu që të tanë jetën ka veprue frytshëm e pa kursim në shërbim t'atdheut e të kombit, asht detyrë që e bajnë ata të cilët kanë burrni e ndërgjegje. Prandej, falnderoj edhe përgëzohem me të gjithë sa janë ose kanë dashtë, por, për rrethana të ndryshme nuk kanë mujt të jenë këtu me ne, me dëshmue nderimin e miqsinë ndaj Ernest Koliqit e veprës së tij edhe tash kur fizikisht nuk asht ma në mes nesh.

Prej mysafirëvet ishin pranë, përveç Zotnijvet që folën mbasdite, — *dr. Rexhep Krasniqi*, Kryetar'i Komitetit *Shqipnija e Lirë*, *prof. Vasil Alarupi*, Kryetar'i shoqnis *Letrare Shqiptare-Amerikane*, megjithëse kishte angazhime familjare atë ditë, *Ing. Mahmud Cungu* me *Zojën*, *dr. Hamdi Oruçi* me *Zojën* e të bijt *Shpresën* e *Eduardin*, N/Kryetari i *Bashkimit Demokrat Shqiptarë Adem Hodo* me *Zojën*, *Ymer Doda*, i riu kosovar *Skender Kodra* —, edhe *Mons. Zef Oroshi*, *Dom Rrok Mirdita*, *Dervish Ha'il Dushaj*, *Adv. Hasan Dosti*, Kryetar'i *Ballit Kombtar të Bashkuem dhe ish* Kryetar'i Komitetit *Shqipnija e Lirë*, n'emën të *Vatrës* Zoja *Nexhmije Zajmi* Kryetare e degës New York-New Jersey, *dr. Fuad Myftija*, Sekretarë i Përgjithëshëm i O.K.L.I., *dr. Odhise Dhima* funkcionarë i Departëmentit të Drejtësis (*Immigration & Naturalization Service*), *Petraq Ktona*, *dr. Selahedin Velaj*, Zotnijt *Petrit Kupi*, *Nerim Kupi* e *Ramiz Dani*, i biri dhe të nipat e të ndiemit Abaz Kupi, *Asllan Cenaj*, *Reiz Agaj*, *Hajdar Tonuzi*, *Qazim e dr. Xhelal Lusha*, *Jonuz Ndreu* me *Zojën*, *dr. Guri Durollari*, *dr. Nexhat Kaliqi*, *Zef Pashko Deda*, *Abaz Lita*, *Mark Koliq Shkreli*, *Hysen Byberaj* e shumë të tjerë, të cilëvet u kërkojmë falje që na kanë shpëtue emnat pa i shenue.

Dr. Buçaj, mbasi lexoi disa letra, ftoi *Mons. Oroshin* i cili bani lutjen fetare të darkës. Mandej paraqiti recituesat e disa poezive të Koliqit.

Së pari *Zoja Maria Teresa Gjomarkaj* recitoi poezinë italisht *Il suo profumo e i suoi volti* mbasi tha këto fjalë:

Asht nji nder i madh për mue me lexue këtu, në rasën e përkujtimit të vdekjes së prof. Ernest Koliqit, nji nder poezitë e tij në gjuhë italishte, dhe e konsideroj të nevojshme mbasi ai, përveç se Poet i madh Shqiptar, asht edhe poet i gjuhës italishte. Jam e sigurtë se shumë prej të pranishëmvet do të mund t'a kuptojnë e çmojnë kët lirikë që kumbon si nji kujtim nostalgjik i Atdheut të mbetun gjithmonë në zemër të tij.

I riu *Zef Mirakaj* recitoi dy poezi me tematikë shoqnore: *Malsores me djep* dhe *Ballada Shkodrane*, që pohojnë ndiesitë e Koliqit për vuejtjet e vogjëlisë, sido-

mos të malsorve — kala e gjallë e kombit kundra sulmeve të hueja —, të lanun mbas dore e të harruem në kasolla ndërtue si çerdhe shqipesh mbi maje të thepisuna si e thotë vetë Poeti.

Zoja *Lula Daragjati* që lexoi poezinë *Shqipnin e mora me vehte*, tha: *Koliqi e ndiente thellë mallin e Atdheut, të cilin e kishte në zemër. Ai me veprën e tij dijti me e përcjellë edhe në zemrat t'ona, sidomos të të rijve të rritun në mërgim, gja për të cilën i jemi mirënjohtës.*

Ish nxansi i Koliqit, *Mons. Zef Oroshi*, i përcjellun me duertrokitje, lexoi poezin *Lutja e dëshprueme*, të cilën vetë Autori ia pat dhanë me e botue për të parën herë në *Jeta Katholike Shqiptare*.

Të gjitha recitimet u ndëgjuen me vemendje e kënaqsi nga pjesëmarrsit.

Foli mbi Koliqin edhe *dr. Fuad Myftija* i cili theksoi miqsinë që ka pasë sidomos i Ati me të ndiemin Koliqi, dhe çmimin e naltë që ka ndaj veprave të tij *te cilat duhet t'i ndjekin si shembull pendat e reja.*

Organizimi i Programit përkujtimuer u ba prej nji komisioni pregaditës, drejtue nga *dr. Gjon Buçaj* e përba prej disa të rijsh të *Blokut*, të cilëvet u shkon merita e pregaditjes: duhen përmendë sidomos *Prel Perpepaj, Viktor Daragjati, Gjeto Rukaj, Mark Millaj*, dhe bashkpunimi e përkrahja e vlefshëme e *Këshillit Krahinuer*, sidomos e Kryetarit *z. Arif Nezaj.*

Fjala përshëndetëse e Ing. Ago Agaj

Të nderuar Zonja e Zotërinj,

Qënka thënë prej Perendisë që na mërgimtarët, duke ndjekur tradicionin e filluar prej gjakut të shprishur 500 vjet më parë, t'i lëmë eshtrat t'ona nëpër vënde të huaja e jo në Atdheun e dashur i cili na ka rritur, dhe të mblidhemi herë pas here për të përcjellur e përkujtuar ndonjë shok të vlefshëm.

Numrin e madh të këtyre shokëve nuk e përcaktoj dot se e konsideroj, dhe ashtu është më të vërtetë, se çdo mërgimtarë është për t'u futur në radhën e të vlefshëmve sado i vogël që të duket.

Nuk di vlerë më të madhe për njerinë se sa atë që i del zot burrërisht ides së tij kombëtare, lufton për të, rrezikon jetën, familjen e pasurinë.

Dhe këte burrëri e ka treguar çdo mërgimtarë, pra është i vlefshëm.

Sot jemi mbledhur të kujtojmë një nga shokët e mëdhenj, bile atë më të madhin në rrugën e tij të literaturës shqiptare për të cilën ai kishte lerë, *prof. Ernest Koliqin*, të cilit trupi i vdiq para një viti, por emëri i tij nuk vdes kurrë.

Mbi këte burrë të madh do të flasin këtu para juve burra më të cilësuar edhe mua nuk më mbetet veçse t'u them se më bëhet zemra mal kur shoh këtu se tregoni me fakt dashurinë për shokun e mikun, jo vetëm në të mirë e për së gjalli, por, edhe pas vdekjes së tij.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen t'uaj në këte ceremoni përkujtimi u hap shtekun folësve të shquar dhe ftoj së pari *dr. Rexhep Krasniqin* t'urdhërojë këtu pranë meje.

Në nji pjesë tjetër të këtij numëri, mund të lexohet fjala e *dr. Krasniqit*, që kështu përfundoi:

«Tue përfundue kët ligjeratë, mund të thuhet pa eksagjerim se Ernest Koliqi si profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, si shkrimtarë dhe poet prolifik, si gazetar dhe polemist, si konferencier dhe orator, dhe po ashtu si përfaqsues i përsosun i qytetënimit përendimor, ka qenë ndër personalitetet ma të shqueme që ka prodhue kombi shqiptar në këtë shekull të njizet».

Fjalimi i Vasil D. Alarupit

Zotni Kryetar,

Të nderuara Zonja, Zonjushe dhe Zotëri,

Të hënën e shkuar, kur dr. Buçaj më thirri në telefon edhe më ftoi që të them edhe unë dyzë fjalë sonte për të nderuar kujtimin e të ndjerit prof. Ernest Koliqi në mot-mot të vdekjes së tija, më zu, mund të them, pakëz si ngushtë edhe më befasoi. Po s'mund t'ia prishnja e as t'i shmangësha asaj ftese.

Shoqëria letrare xheç kishte ndërmënd dhe në program domethënë, nja dy *Mbrëmje Shqiptare*, kushtuar burravet të racës s'onë që kanë qenë çquar në diasporën duke dhënë një kontributë të vlertë për lartësimin e kulturës Shqiptare.

Po ç'ka!

Kjo e sotmja nderon më të çquarin dhe *Letrarja* me të pregatitur *Mbrëmjet e posaçme Kulturale* do t'i bëjë të ditura me kohë.

Shpirtndrituri prof. Ernest Koliqi e bashkova për herë të parë në Romë se, rasti s'na kishte vënë përballë njëri-jatrit në Shqipëri, ku, mund të them se pata njohur burrat më në zë të kohës, me disa përjashtime.

Miqësija jonë filloi që nga koha e themelimit të *Blokut* dhe q'aso here vashdoi e përzemërt. Kur ika për n'Amerikë të Jugës edhe pasi erdha n'USA, atë miqësi e mbajtmë gjith aqë të gjallë me anë letrë-këmbimit të paprerë, më të dëndur gjatë kohës që ay botoi *Shêjzat;* bile letrën e tij të fundme ma shkrojti dy dit përpara se të ndronte jetë në të cilën lajmëronte se do të vinte për së shpejti në Amerikë edhe premtonte një vizitë më të gjatë nga herët e tjera që na kishte nderuar konakun.

Nga disa takime pra, kohë pas kohe, kur sbrisnja prej Torino në Romë e pastaj në Palermo kur u themelua *Qendra Nderkombetare per Studimet Shqiptare,* kemi kaluar orë kuvëndimi, rahje problemesh edhe disa mbrëmje defrimi të dlirtë se njeriu ishte edhe i qejfit si jo kush.

Ne sikur s'na besohej çdukja e tij e cila na shkundi rëndë por ay e rrojti jetën në një mënyrë të çkëlqyer edhe njësoj e gëzoi. Andaj i falemi Perëndisë që na e bëri kësmet të njohim këte burrë të rrallë të kohës s'onë, të shijojmë frutin e punës së tija kulturale dhe sa privilegj i madh për ne që kemi gëzuar miqësin e tija.

Po Ernest Koliqin, gazetar, poet, përkthenjës i zotë poetësh të mbëdhenj Shqiptarë e të huaj, autor novelash e kisha njohur fort mirë që shumë kohë më parë nëpërmjet të punimevet të tija letrare të cilat më patnë ngjallur, mua Korçarit, një ndjenjë admirate sepse kisha vënë re se te ky burrë Shkodret, jo vetëm Shqiptar, të prikosur bujarisht me kulturë të gjërë evropjane, por edhe shkrimtarin Shqiptar me vlerë të jashtzakonshëm, dinamik e të sgjuar që pat ditur t'i mbleksë të dyja kulturat duke trajtuar subjekte shqiptare me një fuqi shprehëse e përshkronjëse si ay. Këtu qëndronte edhe një ndryshim me të tjerë shkrimtarë. Koliqi e kishte njohur thellërisht popullin e tij, popullin e Malësisë e të Shkodrës në të tëra shfaqjet e jetës. Andaj, për



(*Nga e majta në kambë*): *zz.* Zef Pashko Deda, Gjoke Dragusha, Xhevdet Blloshmi, S. Kodra, dr. Selahedin Velaj, dr. Odhise Dhima, dr. Rexhep Krasniqi, Kap. Ndue Gjomarkaj, dr. Gjon Buçaj, Pullumb Babameto, Petraq Ktona. (*Ulun, po nga e majta*): Msgr. dr. Joseph J. Oroshi, Adv. Hasan Dosti, Vasil D. Alarupi, Anton Froku, dr. Hamdi H. Oruçi e inxh. Ago Agaj

mua, e tërë fuqia e veprës së tij aty e gjen madhështin e saja.

Fletorizma i tregojti udhën e bukur dhe në fletorizmë të çkëlqyer e mbylli jetën. Sikur të mos na kishte lënë kurgjë tjetër, po vetëm *Shêjzat*, kjo tribunë e kulturës Shqiptare në mërgim do t'ishte më se e mjaftë që t'ia pavdekësonte emrin. Në 'të ay na le një trashëgim nga më të pasurit për brezat e ra të cilët do të gjejnë këshillat e Mësuesit të madh edhe një udhë për të ndjekur me nder e krenari.

Ernest Koliqi për 50 vjet ka qënë përhera mëngë-përveshur posi një artist i talentuar duke prodhuar e prodhuar vepra për të mirë të njerzis së gjakut të tij.

Për Mëmën Shqipëri pregatiti me zemër kurorën më të bukur të lavdisë të cilën ia vu mbi krye me dashurin e një biri të besës.

Nga letra e një mikut t'im të çquar, një tjatër burrë me kulturë të gjerë, po nxjer këto fjalë që shkruan mbi humbjen e mikut të përbashkët:

... Po sa keq më ka ardhur për zhdukjen e Ernestit. Vdekja e tij më ka tronditur rëndë; pa dyshim ka qenë një nga humbjet më të hidhura të kulturës s'onë te mërgimit. Vështir se del një tjetër si Ernesti në këtë cerekun e fundit të katij shekulli.

I ndrittë shpirti Ernestit.

Fjalimi i Ing. Mahmud Cungu

Ernest Koliqi:

Njeriu lindet në këtë botë pa atdhe dhe kur vdes varroset në dheun e vet. Atdhenë ai e njef tue u rrit; tue kuptue dhe përdorë gjuhën e nanës; tue ndëgjue mbi veprat e heroizmat e prindve, gjyshërve dhe stërgjyshërve të tij e tue u frymzue nga këto heroizma; tue mësue veçoritë dhe përpjekjet e kombit të tij për t'u njoftë nga kombet tjerë e tue u pajis me këto veçori.

Dashurinë, me të cilën cilsi natyra e ka pajis që në lindje, ai ia kushton ma s'pari nanës e atit pastaj fisit e mandej kombit e vendit të lindjes së parardhsve të tij të cilin vend ai e quen Atdhe.

Ndër raste kur Atdheu dhe lirija kombëtare kërcnohen, qoftë nga fuqi të jashtme qoftë dhe nga tiranija e mbrendëshme, patriotizmi i takon *pjesërisht* nji pjese që braktisin laçk'e plaçkë, far' e fis, dhe marrin udhën e mërgimit, pa marrë parasyshë mundimet e vuejtjet, pa dijt se ç'fat i pret, me qëllim që t'i vazhdojnë përpjekjet e tyne për liri, dhe tanësisht atyne që qëndrojnë në vend dhe përballin gjithë stuhitë tue sakrifikue vehten, tue përlye emnin e pastër të tyne vetëm e vetëm të pengojnë tentativat çkombëtarizuese t'okupatorëve ose veprimet çnjerzore të tiranve.

Si në kategorinë e dytë ashtu edhe në të parën emni i Ernest Koliqit figuron me shkronja të dukshme.

Koliqi akuzohej se bashkpunoi me okupatorin Italian. Por, po t'a mendojmë se si kur nji miljon shqiptarë — e tanë popullsija e Shqipnis — të kishin marrë udhën e mërgimit kur Italija pushtoi Shqipnin, a thue do të kishim Shqipni sot? Ose, sikur të gjithë intelektualët shqiptarë t'a kishin lanë vendin a do të kish njeri që, tue veprue si Ministër i Arsimit, të kundërshtonte tentativat Italjane me fut në shkollat fillore gjuhën italishte e me e lanë gjuhën amtare mbas dore? A do të gjendej ndonji Italjan të shtrinte arsimin kombëtar në Kosovë si e shtrini Ernest Koliqi nepërmjet të Rexhep Krasniqit, Vasil Andonit, Ahmet Gashit dhe shumë intelektualve të tjerë që s'i u-shmangën stuhisë s'okupacjonit?

Koliqi akuzohej se me 12 prill 1939 u-ndodh në grupin që i dorzuen Kunorën Viktor Emmanuelit. Por, sikurse më tha nji Elbasanas me 1943 kur e pyta pikërisht për veprimin e Koliqit: «Kur i hueji të zapton shtëpinë, syrgjynos kryetarin e familjes, të len lakuriq tue të xhvesh nga të gjitha teshat, a do të vij keq se të merr edhe qeleshen — sado e vlefshme të jetë ajo për ty?»

Koliqi bashkë me shokët e tij do të quheshin *trathtarë* vetëm atëherë kur këta vetë t'a kishin dëbue Mbretin Zog e të kishin thirrë Italjanin Emmanuel në vend të tij. Por, *Italinë nuk e thirri as populli Shqiptar as Koliqi, Át Anton Harapi e Dhimiter Berati me shokë*. Mussolini u-vërsul me luftanije, aeroplana e bajoneta mbi nji Shqipni të çarmatosun dhe përgjigjen që muer — të cilën e ndëgjoi gjithë bota — qenë fyshekët e Mujo Ulqinakut.

Patriotizmi tregohet në shumë mënyra dhe provohet ma së miri nën rethanat ma të vështira. Ernest Koliqi, nji nga

shkrimtarët e nderuem të Kombit, tue e dijt se do t'urrehej prej shumëve, tue dijt ndoshta se po i vinte nji njollë emnit të pastër të tij, pranoi të kompromethet vetëm për t'i shërbye kombit e atdheut në kohën ma të vështirë. Si i tillë ai qëndron në nji shkallë me patriotët tjerë që i kanë shërbye kombit në faza dhe epoka të ndryshme.

Prandaj, sikurse e ka thanë anglezi Rudyard Kipling për vendin e vet, mund të themi edhe neve se, si Mbretin Zog në tokën Franceze, për Midhat Frashërin, Abaz Kupin e të tjerë në truellin Amerikan, për Alfred Andonin me shokë në tokën Angleze e shumë të tjerë në vise të ndryshme të botës, ashtu edhe për Ernest Koliqin në dheun Italjan, se aty dy pëllambë vend, ato dy metra tokë, ku prehen eshtrat e tij dhe të secilit patriot Shqiptar janë dhe mbeten gjithmonë *copa toke Shqiptare*.

Edhe fjalimi i dr. Oruçit: *Dy fjalë per Ernest Koliqin* âsht i shtypun tanësisht po në këtë numër të *Shêjzavet*, e po ashtu edhe ai i z. *Adem Hodos*.

Fjalimi i Ing. Skender Kodra

I ndershmi Charmain,

Te ndershëm Klerik, udhehegës dhe anetarë te B.K.I.,

Përfaqsues t'organizatave te Mergates.

Ju falënderoj që më dhatë rastin, unë si pjesë e Kosovës t'i ç'faqi ngushllimet e mija për humbjen e madhe që psoj Kombi, Atdheu, Gjuha për humbjen e mësuesit, Ministrit t'Arsimit, themeluesit të Universitetit dhe intelektualit *me pendë ari* që e quejmë na Kosovarët dhe mbarë bota e qytetnueme.

Për ne Kosovarët do të jetë i pa vdekshëm, e këte e justifikon fakti i vjetit 1941-42 ku si Ministër i Arsimit i dërgoi dyqind mësues Kosovës dhe për herë të parë në historín e Kombit ndezi kandilin e ditunís dhe të librit, dhe, gjatë jetës së vet Kosovën e çmojke si pjesë të pandame prej trupit të vërtetë.

Pra unë jam ai i verbti që i ndjeri Profesor Koliqi i shoqnuem prej Profesor Rexhep Krasniqi-t me shokë më edukoi dhe më përgaditi për nji Shqipní Ethnike të pamvarun.

Me shkrime të veta dhe stilin e naltë e të pa shoq, Koliqi la në zemrat t'ona mbresa të pa shlyeshme, dhe na nuk do të kursejmë asgja, për amanetin që na la *Shqipnín* që e çmonte ma tepër se asgja.

I pa vdekshëm dhe i pa harrueshëm do të jenë veprat e Profesor Koliqit e për né të rijt do të jenë brilante të çmueshëm.

Ju falem nderit.

Fjalimi i z. Ymer Doda

Të dashtun bashkatdhetar,

Humbja e Koliqit ka qenë nji zbraztësi në lamën kulturore. Vlerat e Tij letrare, janë të njoftuna ndër Universitete e ndër persona qi merren me studimet e letërsisë t'onë.

Un personalisht, kam pasë raste me e njoftë Koliqin shum vjet përpara. Ashtu më ra rasti në këto vjetët e fundit me e pa në New York. Këtu sidomos e njofta ma mirë, mbassi për arsyena të ndryshëme, qe prezent në Kongresin e parë të *Blokut*, në manifestimet e 60 vjetorit të Fletores *Dielli* ashtu edhe ma vonë si turist me nga pak ditë

Bisedimet ma të kandëshme qi kam shtrue me Te, janë qenë në sofër, tue hangër e tue pi, si e kishte qejf edhe Aj. Miqsija, thjeshtsija dhe gjykimet e mprehta mbi çashtjet t'ona, me shije pranë miqve, i çfaqte në këso rastesh pa kryenaltësi, pa superioritet, tue i dhanë gjithkuej të drejtë me folë haptazi e tue pranue opinione të ndryshme. Çdo gjykim e përcjellte mandej me ndonji proverb, ose, me ndonji shembull tipik të jetës shqiptare, me na lanë të kënaqun me humore e qeshje. Këtë cilsí pak kush e ka pasë ndër persona të kualifikuem të jetës politike e kulturore shqiptare, qi un kam pasë rast m'e njoftë.

Koliqi i rritun e i shkolluem në botën Oksidentale, kishte thithë kulturën dhe vetinat e njij personi me ndjenja e veprimtarí Europjane të Botës së Lirë. Orientalizmin me mbrapambetunitë i urrente dhe Atdheun donte qi t'a ngrente sa mâ nalt në lamën e përparimit e të kulturës. Por, n'anën tjetër, bazën e çdo veprimi e frymzonte ndër traditat e mira

stërgjyshore të racës t'onë për t'ardhëshmen e Kombit.

Në mërgim vazhdoj të punojë randë për kulturën Shqiptare, për të ia bâ sa mâ të njoftun Botës së Lirë edhe atyne të Tiranës, historinë, letërsinë e çka mâ mirë e ma bukur, raca jonë kishte ruejtë gjatë shekujve. Si titullarë i Kathedrës Shqipe n'Universitetin e Romës, botoj libra dhe ajo, mâ me randësí, qe e përkohëshmja letrare e kulturore *Shêjzat*, qi për 18 vjet vazhdoj me dalë rregullisht, ku muerën pjesë me shkrime ajka e Kulturës Shqiptare, si edhe studjuesa të huej.

Qe i vetmi nxitës qi u interesue e bashkëpunoj me Arbreshët, tue marrë pjesë me punë e shkrime ndër seminare pranë *Qendrës Ndërkombtare të Studimeve Shqiptare* në Palermë të Sicilisë, ashtu edhe ndër çfaqje folkloristike t'arbreshve të Kalabris.

Gjatë kohës kam shkëmbye edhe letra. Mendimet qi Aj çfaqë, janë dhe mbeten testamente. Në kujtim, këtu dishroj me cekë tekstualisht vetëm dy thanje të Tija :

1. Për *Vatrën*, letra *Romë 9 shtatuer, 1971.*

Vatra *duhet të mbetet sipër partive dhe rrymbave të çdo lloji. Ajo duhet të veproje si Shoqatë Patriotike-Kulturore, qi mbledh në gji të vet çdo shqiptar, qi ka për zemër vlerat Kombtare.*

2. Letra *Romë 31-8-1973.*

Pashë me sy dhe preka me dorë, qi mërgata kotet në shpresa utopike, brehet nga ndasina të pa kuptueshme, shpërndahet në veprimtarina, të cilat asgjasojnë kryekput fuqinë qi i duhet kushtue çlirimit të Shqipnis.

Këto dy thanje, mue më mjaftojnë me dhanë gjykimin tem të thjeshtë, se Koliqi qe mbi të gjith e për të gjith. Aj shkroj nji dunja libra e rivista. Gjithçka dijti, me të folme e të shkrueme, i qiti në fushë në peshoren e arsyes. Kur u zhduk, kurrgja nuk muer me vedi të ndryme. Le t'i përngjajmë e mos të ngurremi, po të duem me pasë për zemër vlerat kombtare, siç e ka thanë vetë.

Meritojnë falnderime organizuesit e kësaj përkujtimorje dhe blokistët përgjithsisht me nderim e pa harrim të Këtij Personi, me gjithse nji përkujtimore për të ndjerin Profesor, do t'ishte ideale sikur të bahej me nji seminar të plotë n'emën të bashkësisë, mbassi Aj ia kushtoj të tanë jetën Kulturës Shqiptare.

Fjalimi i zojës Nexhmije Zajmi

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Duke menduar se gjatë këtij programi komemorativ për Ernest Koliqin, folsit do të ishin vetëm ata zotërinj që janë familjarë me shkrimet dhe me veprat e tjera të këtij Shqiptari të shquar, nuk kujtova se dhe unë do të kisha rastin dhe nderin të shtoj nja dy fjalë. Për këtë arsye jo vetëm që nuk jam e pregatitur të flas po gjithashtu kam pirë një scotch-whisky gjatë darkës kështu që nuk kam as një idé se çfarë do t'më prodhojë koka.

Si kryetare e degës së *Vatres*, më lejoni t'i paraqes komplimentat t'ona *Blokut Kombtar Indipendent* që pati zotësin dhe vullnetin të pregatiti një program të lavdueshëm që nuk do t'a harrojmë kurrë. Po ashtu ju falënderojmë nga zemra që patët bujarin të ftoni mjaft *vatranë* si mysafirët tuaj të marin pjesë në këtë mbledhje. Një gjest vëllazërimi i tillë, pa fjalë na ka bërë përshtypje të madhe. Po n'at kohë na kënaq sepse pasqyron dhe qellimin kryesuer që ka patur dhe ka Federata *Vatra*. Pra dhe një herë falënderojmë *Blokun* që sot dhe sonde na ka bërë të ndiejmë se Shqiptarët e Amerikës i ka prurë një çap më afër gardhit të bashkimit.

E tani më lejoni të shtoj dhe nja dy fjalë duke ju treguar se si unë pata rastin dhe nderin të njoh Ernest Koliqin për herën e parë.

Gjatë motit të parë që vazhdonja studimet n'Amerikë, një kondítë shëndetsore më detyroj të marr një pushim të gjatë. Po në vend që të hyja në sanatorium siç u këshillova, vendosa se do të shërohesha më shpejt sikur të veja në Shqipri. Ishte vendimi më i logjikshëm që kam bërë në jetën time se kjo ishte hera e fundit që pashë familjen dhe mëmëdheun ... ku më ka rrojtur shpyrti gjith jetën time.

Duke mos patur aspak dijeni se Shqipërija të nesërmen do të fillonte festimet e 25 vjetorit të pamvarësis, kur arriva në Bari më njoftuan se nuk kishte më vënd në vaporin që atë mbrëmje nisesh për Durrës. Me gjithate vajta në mol dhe më së fundi më lanë dhe mua të hy në vapor.

Me qenë se nuk kisha kabinë, udhtimin e kalova në sallonin e vaporit. Po zhurma dhe kallaballëku i math që ishte tre fish më sa duhesh të mirte vapori, si dhe frika që ndieshin pasagjerët se mos do të përmbysemi, detyroj gjith delegatët e shteteve të ndryshme që po shkojin në Shqipri për festimet, si dhe të tjerët, të kalojnë natën në sallon ose duke bredhur rreth e përqark vaporit. Për këto arsye mu dha rasti të njoh delegatët si dhe bashkatdhetarë të shquar që ndodheshin në atë udhëtim. Midis tyre takova gjithashtu edhe Profesor Ernest Koliqin.

E para pyetje që më bëri ishte, se ç'far po studjoja n'Amerikë. Kur i thashë se kisha në mëndje të specializohem në degën e pedagogjisë, «shumë, shumë mirë po ban moj bijë», m'u përgjegj. «Shqiprija jonë ka nevojë për arsimtarë të stërvitur n'Amerikë». Dhe më vonë vazhdoj të thotë: «Kur të plotsosh studimet dhe të kthehesh në Shqipri, e para punë që do të japim është të bahesh inspektore e shkollave fillore në rrethet e Tiranës».

Kur u ktheva prap n'Amerikë, të Shtunat i kalonja në *Fourth Avenue* ku bleja libra të lira dhe pak nga pak i postoja në Tiranë. Kam çue katër syndiqe me libra përpara se lufta e dytë filloj dhe rrugët u mbyllën.

Po shpresa dhe illuzionet e mija nuk u realizuen ashtu siç nuk janë realizuar dhe shpresat e shumicës që ndodhen sonde në këtë sallë. Po kjo ju ban të kuptoni që dhe unë, siç jeni shumica e zotëris s'uaj, jam gjithashtu refugjate në këtë vënd.

Po ashtu ishte Ernest Koliqi që më influencoj të bahem *Vatrane*. Se kur ju përgjegja se nuk isha antare e *Vatrës*, më tha: «*Vatrane* duhet të jesh moj bijë, se në këtë mënyrë, jo vetëm që e mer Shqiprin me vehte, por, bashkimi i Shqiptarve n'Amerikë mund t'i bajë dobí të madhe mëmëdheut një ditë».

Bashkimi midis nesh është për të mirën t'onë, është ëndrra që ka lulëzuar në shpyrtin tem që atë mbrëmje në vapor që më çoj në Shqipri për herën e fundit.

Fjalimi i z. Ndue Gjomarkaj
Nënkryetar'i B.K.I.

Zoja e Zotnije te ndershem,

Do të kishte qenë një mungesë e madhe sikur *Bloku Kombtar Indipendent* t'a kishte lanë me kalue në heshtje përvjetorin e dekës së Profesor Ernest Koliqit. Do të kishte qenë një dhunim i kujtimit të Tij.

Ernest Koliqi qe një themelues i *Blokut*, një eksponent i rradhës së parë, por, një herit një figurë e ndritun e letravet shqipe, qi me shkrimet e veta pasunoi aq fort literaturën kombtare. Këto arsyetë qi na kan shty me u tubue në kët mbledhje përkujtimore.

Fati ka dashtë qi Ernest Koliqi të tepronte prej asaj radhe shkrimtarësh shqiptarë me vleftë, që me shkrimet e veta i vuni themelet letërsis s'onë. Mjerisht kolegët e ti, *Dom Lazer Shantoja, Vincenc Prennushi, Dom Ndré Zadeja, Pater Bernardin Palaj, Át Anton Harapi* kalben në dhé e, jo vetëm nuk u ndigjohet zâni, por, nuk u dihen as vorret. Emni i tyne âsht fshi prej vargut të shkrimtarvet shqiptarë e kujtimi i tyne âsht shlye nga kujtesa e gjeneracionit të ri. Vetëm Koliqi pshtoi dhe kje ai qi i përfaqsoi.

Letërsija shqipe qi pat marrë aq hov në kohët e fundit dhe epte shpresa për një lulzim edhe mâ të madh, u shtyp, u rrendue. Prej Shqipnís ndigjohet vetëm një zâ i marrun i disa njerzve qi kanë trathtue zakonet e pastra arbnore, tue i thurë levdata e tue i qitë kem një idhulli të huej. Rraca e jonë e cila ka qitë shkrimtarë të rrallë, edhe në kohën e robnís së kalueme, ka ngelë më rrugë: âsht ndry në një heshtim vorri. Prandej, ka qenë një fat i madh qi Koliqi i lirë, në Botën e Lirë, të mujte lirisht me i falë Kombit vepra të tjera me vleftë të pakontestueshme. Dhe premtimin e mbajti tue pasunue letërsín me shkrimet e veta të cilat e naltojnë n'epërsín e letravet shqipe.

Në hapat e parë të karrjerës së vet, Koliqi kje udhëzue prej *Emzot Luigj Bumcit* e, mâ vonë, prej diplomatit të njoftun, shkrimtarit në zâ, patriotit të kulluet *Luigj Gurakuqit*. Por, Koliqi nuk u ndal me aq. Ai lidhi miqsí e përpjekje me pendat e reja shkodrane: me Kolë Thaçin, Shuk Gurakuqin, Dom Lazer Shantoja, Kolë Kamsin, Karl Gurakuqin e tjerë letrarë të njoftun. Por, dishiri i flakët qi ushqente për t'i dhanë zhvillim një shtypi me drejtime moderne e shtyni, në vjetin 1923, me marrë kontakt me Pater Anton Harapin e Nush Topallin

të cilët qitën mendimin me themelue fletoren *Ora e Maleve* qi xên nji vend të meritueshëm në analet e fletorizmës shqiptare.

Ernest Koliqi nuk ngurroi kurr t'api kontributin e vet të çmueshëm në të gjitha rivistat mâ të njoftuna: në të përkohëshmen e Jezuitvet *Leka* drejtue mjeshtrisht prej *Át Zef Valentinit;* në *Hylli i Drites* i fretënve françeskan drejtue prej *Át Fishtes;* në fletoren e Barit *Gazeta Shqiptare* ku publikoi, ndër të tjera, nji krijesë poetike me nji frymzim të naltë lirik me titull *Shtatë pasqyrat e Narçizit;* në *Illyria*, drejtue prej *Asim Jakova* e ku muerën pjesë pendat e reja mâ të shëndoshta të vendit t'onë, si: Branko Merxhani, Vangjel Koça, Karl Gurakuqi, Anton Logoreci, Odhise Paskal, dhe Ernest Koliqi i cili ishte nji ndër redaktorët mâ të shquem. *Illyria* la gjurmë të thella në zhvillimin kulturuer të Shqipnís. Në këtë rivistë publikoi për të parën herë poezín plot njomsí *Symfonia e Shqipevet* ku naltësohet vëllaznija e dashunija ndërmjet shqiptarvet, bashkëpunoi në *Minerva* dhe *Besa*.

Por, do të qindrojshim tepër larg prej analizimit të veprimtarís letrare të Koliqit sikur të kapërcejshim pa prekë nji cilsí qi e dallon prej të tjervet, d.m.th. njohjen e mendësís së Malsorëvet, të zakonevet e të dokevet të botës shqiptare si të malevet ashtu të qytetevet.

Në dhetorin e vjetit 1924 shtërngohet të bragtisi Shqipnin dhe të strehohet në Jugosllaví si emigrant politik. Në Tuzla të Bosnjes pati si shokë të fatit disa ndër mâ të përmendunit krenë të malevet të Veriut si Lush Prelen e Mark Sadikun e Shalës, Dodë Prelen e Merturit e tjerë malsorë. Aty Koliqi nuk e humbi kohën në defrime të kota, por, përfitoi prej rasës dhe prej gojës së këtyne burrave të shquem njofti shpirtin arkaik të *Kanûnit* të cilin mandej e përshkroi me bukurín e stilit të vet të pa kund shoq në novelat *Hija e Malevet*, publikue në vjetin 1928 në Zara. Këto njoftime i thelloi edhe mâ tepër ndërmjet vjetve 1934 e 1938 tue vizitue disa herë Dukagjinin, ku përmblodhi kangë popullore dhe nji materjal të çmueshëm folkloristik, nji pjesë të cilit e publikoi në *Epica Popolare Albanese*, Padovë 1937, e qi kje lavdue prej albanologut të përmendun Norbert Jokl.

Në vjetin 1935 i dhuroi publikut librin e dytë të novelavet *Tregtar Flàmujsh*, thesar bukurije stili e gjuhe i letravet shqipe, e në vjetin 1960 *Shija e bukës se mbrûme*.

Koliqi radhitet ndër mâ të mirët poetën të shqipes. Zotsín e tij në poezí e vulosi Komisjoni i përbamë prej Fishtës, Nolit, Midhat Frashërit dhe Luigj Gurakuqit i cili, në vjetin 1921, i akordoi *çmimin e parë* në nji konkurs poezije të shpallun prej Ministrís s'Arsimit t'asaj kohe.

Në vjetin 1924, i shtym dhe i këshilluem prej Luigj Gurakuqit botoi poemin dramatik *Kushtrimi i Skenderbegut*. Me këtë lotim u pa kjartë se Koliqi ndrynte aftësí të rralla poetike.

Si pinjuell i nji familje së njoftun shkodrane, në vjetin 1933, Koliqi i dhuroi publikut librin e vjerrshavet *Gjurmat e Stinvet*, me të cilin i u kushtue, fund e maje, bukuris së qytetit të vet. Gjithashtu, në vjetin 1959, botoi poemthin *Kangjelet e Rilindjes*, me përkëthim italisht.

Por, Koliqi na paraqitet me veti të rralla edhe si përkëthyesë i dorës së parë qoftë prej italishtes në shqip, ashtu prej shqipes n'italisht. Këto veti i diftoi në vjetin 1932 kur botoi vëllimin e parë *Poetet e Medhej t'Italís:* Dante, Petrarca, Ariosto e Tasso; dhe në vjetin 1936 vëllimin e dytë: Parini, Monti, Foscolo e Manzoni. Prej shqipes n'italisht përkëthei kangë popullore të zgjedhuna ashtu pjesë të *Lahutës se Malcis* e *Satira* të Fishtës. Përkëthei vjerrsha mistike të Naim Frashërit si edhe pjesë të bukura poezinash e rapsodinash të Asllanit, Çajupit, Palaj, Mjeda, Noli, Shantoja e tjerë poetën të përmendun të letërsís shqiptare, të cillat i përmblodhi në *Antologia della Lirica Albanese* publikue në vjetin 1963 në Milano. Në vjetin 1939 themeloi dhe drejtoi rivistën *Shkendija* rreth së cilës u mblodhën fuqít krijuese ma të mira të letravet shqipe.

Por, Koliqi nuk pushoi së punuemi. Ai edhe në mërgim, ndonse i kapërthyem me detyra të ndryshme, nuk u lodh së punuemi rreth idealit të jetës së tij për nji ardhmëni të lulzueme t'Atdheut qi e kishte ndry thellë në zêmër.

Me gjithse i inkuadruem në *Blokun Kombtar Indipendent*, Ai merrej vazhdi-

misht me problemet kulturore. Gjithmonë i gatshëm e i pa pritueshëm me thanë fjalën e vet të çmueshme për të ndriçue opinionin botnuer mbi gjendjen e mjerueshme të popullit shqiptar, merr pjesë ndër Kongrese të ndryshme dhe aty mban konferenca tue shque interesin kombtar. Shkruen vazhdimisht artikuj shqip e italisht në çdo numër të fletores së Blokut *L'Albanie Libre* e mandej në revistën *Lajmtari i të Merguemit*. Në *L'Albanie Libre* botoi rapsodin *Kanga e Kapidan Markut* qi, mbas mendimit të shumicës së shkrimtarëvet, âsht ndër mâ të mirat krijesa të daluna prej pendës së tij. Gjithnji në *L'Albanie Libre* publikoi nji serí artikujsh mbi shkollat shkodrane me titull *Shkolla e Jezuitve dhe Shkolla e Françeskajvet*.

Do të shkojshem tepër gjatë sikur të vijojshem n'analizimin e veprimtarís letrare të Koliqit, por, koha nuk më lejon. Këtu dishroj të përmendi vetëm revistën *Shêjzat*, qi u bâ votër e ngrohët e zêmravet të mërgimtarvet shqiptarë dhe qendër lulzimi kulture shqiptare në prendim.

Ernest Koliqi, si Profesor Ordinarë i Fakultetit të Letravet n'Universitetin e Romës, i u kushtue me mish e me shpirt zhvillimit dhe përhapjes së kulturës shqipe tue tërhjekë nji shumicë të madhe studentash arbresh e italjan. E aq kje e dendun veprimtarija e tij në lamën akademike sa shpesh herë ankohej se nuk i delte koha me shqvrtue thezat e studentavet. Por, nuk u lodh, nuk ngurroi, vazhdoi pa pushim derisa Kathedra e Letravet u naltue në Institut me dekret të Presidentit të Republikës ita-



(*Nga e majta*): dr. Rexhep Krasniqi, prof. Vasil D. Alarupi, inxh. Ago Agaj, z. Adem Hodo e dr. Hamdi H. Oruçi

ljane me 2-9-1957. Këjo âsht lumnija e krenarija e mendes së rracës s'onë.

Zoja e Zotnij, n'emën të *Blokut Kombëtar Indipendent* dhe t'emin personal, ju falnderoj për nderimin qi na batë tue urdhënue në këtë ditë përkujtimore të bashkëpuntorit t'onë e të nji shkrimtari të përmendun i cili shkrini tanë jetën e vet për lumnín e Atdheut dhe koltivimin e gjuhës shqipe.

Ju falem nderës

Miratime

Blokut Kombtar Indipendent, New York

Më vjen keq qi në përkujtimin përvjetuer të të ndjerit prof. Ernest Koliqi, për të cilin kam ruejtë e ruej nderimin dhe respektin mâ të madh qi aq shum e ka meritue, nuk kam mundësí me marrë pjesë sepse tash tre muej ndodhem i shtruem në spital.

Ju falemnderit nga zêmra për nderimin e madh qi më bâni dhe të gjithve Ju përshëndes miqësisht.

Belle River Ont. 22-1-1976 SABRI DOMI

Komisjonit të Blokut Kombtar Indipendent

Të nderuar Zotërinj.

Këte minutë mora letrën tuaj. U falem nderit për ftesën që më bëni që të marr pjesë në përvjetorin e vdekjes të Patriotit Ernest Koliqi.

Më vjen shumë keq që s'marrë dot pjesë se ndodhem në Florida. Po marr pjesë në këtë hidhërim dhe të interesuarve u dërgoj ngushëllimet më të përzëmërta dhe shpirtin e të ndjerit Perendia e vendostë pranë Patriotëve që ranë dëshmorë për Atdhe.

Me të fala dhe nderime

Florida, Jan 24 1976 CHRISTO THANAS

Dr. Gjon L. Buçaj
Sekretar i Përgjithshëm i *Blokut Kombëtar Indipendent*

I ndershëm z. Doktor

Në pamundësí me marrë pjesë në Përvjetorin e Përkujtimit të parë të vdekjes së prof. Ernest Koliqit, me anë të kësaj shkrese dëshiroj me falënderue *Blokun Kombtar Indipendent* dhe Ju personalisht për mirësín që keni pasë me më ftue si mysafir në darkën përkujtimore.

Tue pasë para syshë vleftën dhe kontributin e shkëlqyeshëm të Profesor Koliqit që i ka dhanë letrësís t'onë kombëtare, më vjen shum keq që nuk ndodhem bashkë me ju në përkujtimin e Tij të merituem.

I juej vëllaznisht

Washington D.C. IDRIZ LAMAJ
25 Janar, 1975

Blokut Kombtar Indipendent
Sekretaris se Pergjithëshme
Zotnís së Tij dr. Gjon L. Buçaj

I ndershmi Zotni,

para së gjithash Ju falnderoj qi keni pasë mirësinë me më bâ me dijtë për rasën e Përvjetorit të I-rë të vdekjes s'Ernest Koliqit. Së dytit ju shprehi keqardhjen teme, se lajmi juej, po me datën e orën e letrës qi po ju këthej, më mërrijti në shtëpí, e këta jo për mungesën Tuej, por, për fatin e keq temin qi gjindem shum larg Jush. Kështu qi, me të gjitha përpjekjet qi u mundova të bâj, s'mund gjeta mjet qi të më binte në kohën e duhun atje.

Së fundit, U shprehi ndjenjat mâ të ndijshme të gjith familjarëvet të Tij, miqvet e dashamirëvet të Tij, Kryesís e të gjith antarëvet të B.K.I. për humbjen e njenit ndër shokët e tyne mâ të çmueshmin. Humbja e Ernest Koliqit jo vetëm se ka lanë nji boshllëk të paxevendsueshëm n'Organizatën t'uej e na ka bâ nji dam të gjith né të tjerëvet në mërgim, por, ka shkaktue nji shkurtim të pambatun energjije drite për mbarë Atdhén e mjerë tonin.

Zotni Sekretar, pranoni ju lutem, ndjenjat e mija si të njenit ndër mâ admiruesët e të ndiemit Ernest Koliqit.

Mbetem mik e falnderuesë ndaj Ju gjithmonë.

NDOC VULAJ

Teqe, me 22-1-1976

I ndershëm Z. Buçaj,

Në pa mundësí të marrë pjesë n'atë mbledhje me rëndësi, për shkak të kohës së keqe dhe moshës së kaluar, uroj sukses

dhe lus për të ndjerin Koliqi, njerín e madh të racës shqiptare, prëhje në Parajsë dhe jetë të gjatë për të gjithë ju të tjerët.

I jueji
Baba Rexhep

Në këtë përvjetor të trishtueshëm të zhdukjes së të paharrueshmit Profesor Koliqit, shpirtnisht jemi aty me krejt Blokun e Blokistat.

Verlaci, Kolgjini, Shkreli, Vuçani

(Lajmtari i të Mërguemit, Organ i *Blokut Kombtar Indipendent*, Vjeti VII, 1976, nr. 12).

Ekspozita e pikturave të Lin Delisë në Gjermani

Me 80 piktura në voj dhe me nji përmbledhje vizatimesh iu paraqit publikut gjerman *Lin Delija* në nji sallë të bukur të Pacelli-Haus pranë Universitetit Erlangen-Nürnberg. Titulli i ekspozitës: *Ars sacra et profana*. Kjo ekspozitë u realizue nën kujdesin e posaçëm dhe organizimin e *prof. dr. Joseph Schutz* po i këtij universiteti. Televizioni paraqiti tri herë (në ngjyra) pikturat e Lin Delisë.

Artistët tanë na i kuptojmë në shumë pika ndryshe nga të huejt. Këta gjejnë ndër këto krijime elementa që ne si shqiptarë, nuk na bien në sy, apo vlerësojnë cilësi që ne na duken të natyrshme sadopak në strukturën e shijeve e dijenisë sonë.

Në këtë shkrim nuk po ndalem në citate nga kritika e shtypit gjerman mbi ekspozitën; po kufizohem në ndoj shprehje tipike të vizituesve në hapjen e ekspozitës që zgjati prej 16 deri në 31 marc 1976. Nji vizitues i moshës së pjekun tha: «Kontrastet mes mistikës dhe tipareve humane shkrihen në nji... Mbi të gjitha humane asht kjo pikturë dhe për këtë shumë e afërt». Nji tjetër: «S'kam pa tash sa kohë nji pikturë kaq burrnore!» Nji artist i ri tha se i ati kishte qenë nji piktor shumë i përmendun. «Ka vdekë para disa vjetsh. Kjo asht nji pikturë komplekse që don pregatitje për t'u kuptue si duhet: sa entuzjast do të ishte im atë për pikturën e Delisë!». Nji specialist i historisë së artit: «Ky kombinim motivesh të shpie lehtas në përmasa të artit universal, të kuptueshme prej të gjithëve». Shiques tjerë ma të rij kërkoshin elementa analogë nga piktorët e njoftun bashkëkohorë, nacionalë, sikur, për shembull, ngjan dhe në Itali ku kritika mbi Delinë sheh në pikturat e tij nji mbasardhës të shkollave romake të drejtimeve të Mafai-t dhe të Bartoli-t që ishin mjeshtër të Linit në Akademinë e Romës.

Çka na thotë ne Lin Delija? Na të moshës së tij dhe bashkëvendas e njohim Linin prej Shkodrës deri në Antrodoco, gjithmonë me ngjyra ndër duer e ndër tesha, me këto danga — sheje të besnikisë së Lin Delisë ndaj këtij arti. Objekti i tij asht njeriu, permanent i rikrijuem nëpër ambjente të ndryshme ku Lini kaloi, si thotë ai vetë «tue hjekë keq». Në këto dhetë vjett e fundit ai nxierr motivet nga ambjenti i Antrodoco-s ku jeton: njerëz në autobus, natën, prej Romës deri në këtë qytetëz abruceze, tratoritë popullore dhe rrugat. Me njerëzit «e rritun» Lini gjindet në luftë të pandërprerne, por jo me të vorfën e fëmijë që në veprat e veta i trajton me lirizëm. Me të rritunit idhnohet e pajtohet. Shej pajtimi asht shpesh karikatura apo vumja në «bisht të lahutës»; ai thotë «shkodrançe», por ma e drejtë asht të thuhet «në mënyrën e Lin Delisë».

Subjektivisht mue kjo pikturë më lidh me ata çka quhet folklor shqiptar, me përftyrimin e ngjyrave të veshjes së përditshme, si xhamadani e tirqit e ngjyem në langun e verrit që në popull quhen *ngjyra të mbyllta*, me ngjyra ma *të hapta* të kostumeve festore popullore dhe të tokës në blerim dhe të gardhiqeve me manaferra në Bardhanjorë, afër Shkodrës. Kombinimi i tyne asht harmonik si vlerat e ngjyrave të tokës dhe të bimësisë në te prej kah erdhëm.

Asht dhe afër mendsh se ata çka quhet «folklorizëm» shqiptar nuk mund të mbesë «fotografi» e objektit, por vetëm mbresë avullore e ngjeshun në bukën e përditshme ngjat udhëtimit njizetepesëvjeçar të Lin Delisë nëpër botë.

Martin Camaj

Dr. Rexhep Krasniqi nderohet nga Bashkësia e New York-ut

Si çdo vjetë, edhe me 28 nanduer 1975, Komiteti *Shqipëria e Lirë* përkujtonte Ditën e Pamvarësisë bashkarisht me bashkësín shqiptare të të tre shteteve fqinjë, New York, New Jersey e Connecticut.

Mbas mbarimit të përkujtimit, *dr. Hamdi Oruçi*, që ishte Kryetar i saj mbramjeje, i befasoi të gjithë të pranueshmit dhe miqët e huejë si edhe disa gazetar amerikan që merrshin pjesë, kur thirri z. *Idriz Lamaj*, poet i rí i diasporës sonë, të lexoi në gjuhën shqipe, përmbajtjen e nji *Pllake të përartë* e të vueme në nji kornizë të bukur, dhe *prof. Kostandin Vangjelin* t'a lexoj përkëthimin në gjuhën anglishte. Të gjithë të pranishmit u ngritën në kambë dhe e themi me sinqeritetin ma të madh se nuk kemi pa ndonjiherë nji ovacjon aqë spontan e që zgjati afër 4-5 minutash. Ndërkohë *dr. Krasniqi* ishte ai ma i habituni se nuk e priste nji gja të tillë.

Pllaka e përartë i u dorëzue dr. Krasniqit nga kryetari i mbramjes në mes të duerëtrokitjeve të fuqishme. *Dr. Oruçi* mbajti dy fjalë tue urue që ky gjest i komunitetit të New York-ut të përsëritet edhe për patriot të tjerë që e meritojnë e të merret ky shembull i kësaj nate që të nderohen ata që punuen për atdheun tonë në fushën e kulturës e në fushën e mbrojtjes të së drejtave shoqnore të popullit shqiptar, të drejtave demokratike e politike.

I prekun qe edhe folësi i asaj mbramjeje, miku i popullit shqiptar, sekretar i përgjithshëm i A.C.E.N.-it (*Asamblesë së Kombeve të Robnueme të Evropës*) i cili kërkoi të flasi n'emën të Asamblesë e në emën të tij personal e të përhiroi dr. Krasniqin, mikun e të gjithë kombeve të robnueme dhe Kryetarin e Komitetit *Shqipëria e Lirë*.

Dr. Rexhep Krasniqi, i prekun, falenderoi inisjatorët dhe krejt bashkësín shqiptare dhe pranoi Pllakën që i jepesh atij, por edhe për shokët e bashkëpuntorët e tij në Komitet se pa ndihmën e tyne sigurisht se nuk do të mund të baheshe ndonji punë aqë e dukshme sa që asht ba.

Këtu paraqesim përmbajtjen e Pllakës në gjuhën shqipe e në përkëthimin anglishte:

PËR PUNËN E TIJ TË VAZHDUESHME
NË SHQIPNI DHE JASHT ATDHEUT
ME VENDOSMËNI DHE NDERSHMËNI KOMBËTARE
ME DEDIKIM TË PAPËRKULUN
NË LAMËN E PËRPARIMIT KULTUROR DHE POLITIK
TË POPULLIT SHQIPTAR DHE SHQIPNIS
KU NË NJI DITË JO TË LARGËT
DO TË VENDOSEN
LIRIA E FJALËS DHE AJO E MENDIMIT
LIRIA E BESIMIT DHE LIRIA E MBLEDHJES

SI EDHE TE GJITHA LIRITE E TJERA DEMOKRATIKE
SI KUJTIM
I PARAQITET KJO PLLAKE

REXHEP KRASNIQI-t

PER SHENJE NDERIMI DHE FALENDERIMI
SOT ME 28 NANDUER 1975
NE QYTETIN E NEW YORK-ut TE SHTETEVE TE BASHKUEME.

BASHKESIA SHQIPTARE E NEW YORK-ut

* * *

Perkthimi anglisht:

FOR HIS CONTITINUOUS EFFORTS
IN ALBANIA AND IN EXILE
AND WITH UNINTERRUPTED DEDICATION
IN THE FIELD OF CULTURAL AND POLITICAL ADVANCEMENT
OF THE ALBANIAN PEOPLE AND OF THE ALBANIAN NATION
WHERE IN A NON DISTANT DAY
WILL BE RESTORED
THE FREEDOM OF SPEECH AS WELL AS THE FREEDOM OF THOUGHT
THE FREEDOM OF RELIGION AS WELL AS THE FREEDOM OF ASSEMBLY
AND ALL THE OTHER DEMOCRATIC LIBERTIES
AS A SOUVENIR

to
REXHEP KRASNIQI

AS A TOKEN OF RESPECT AND APPRECIATION
TODAY THE 28 NOVEMBER 1975
IN THE CITY OF NEW YORK, USA.

THE ALBANIAN COMMUNITY OF NEW YORK

Dr. Rexhep Krasniqi

Lindi në Gjakovë të Kosovës në vjetin 1906 ku edhe mbaroi shkollën fillore në gjuhën shqipe gjatë vjetëve 1916-18. Shkollën e mesme e mbaroi në *Theresianum*, Vjenë, që ishte shkolla ma aristokratike e ma e famëshme në Evropën Qendrore përpara Luftës së dytë botnore. Më 1934 mori titullin akademik të *Doktorit në filozofí*, nga Universiteti i Vjenës. Teza e doktoratës kishte subjektin historik: *Kongresi i Berlinit dhe Shqipnia verilindore*. Si relator i tezës ishte *prof. Karl Patsch*, Kryetar'i Institutit Balkanologjik pranë Universitetit të Vjenës, albanolog i njohun, historian e arkeolog i përmendun.



Dr. Oruçi i dorzon dr. Krasniqit pllakën e përartë *të Bashkësís shqiptare të New York-ut*

Mbas mbarimit të Universitetit dr. Krasniqi këthehet n'Atdhé dhe emnohet menjiherë profesor i historisë e i gjeografisë në gjimnazin e Gjinokastrës, ku ma vonë u gradue edhe si zavendës-drejtori, e qëndroi deri më 1938. N'atë vjet emnohet si *Drejtor i Arsimit të Mesëm* pranë Ministrisë s'Arsimit dhe ma vonë si *Inspektor Epruer* pranë po asaj Ministrie. Më 1941 emnohet *Komisar'i Naltë i Shkollave Shqipe* në Kosovë dhe *Drejtor'i Gjimnazit* të parë, të plotë tetë vjeçar, në gjuhën shqipe në Prishtinë. Dr. Krasniqi e përshkruen ketë episod në revistën *Shêjzat* të vjetit 1974, nr. 1-10; ff. 7-11: *Për organizimin e Internatit — ku do të banojshin 200 studenta, shumica e të cilëve do të studjojshin me bursa qeveritare —, Ministri Koliqi, emnoi* prof. Vasil Andonin *me titull si Rektor dhe si ndihmës mësuesin* Lirak Dobdiba, *të cilët qenë dërgue në Tetor 1941 në krye të detyrës së re. Për drejtimin e Gjimnazit të Prishtinës, me kohë ishte caktue nji arsimtar i merituem kosovar që ishte në Tiranë. Por, ky për arsye personale në çastin e fundit u tërhoq. Ministri Koliqi, që i kishte dhanë nji randësí të jashtëzakonshme zhvillimit të arsimit kombëtar në krahinat kosovare, u gjind në nji pozitë të vështirë për zavendësimin e tij. Ma në fund, me pëlqimin e plotë të tij, ai i a ofroi* prof. Rexhep Krasniqit, *drejtimin e shkollës në fjalë si Komiser i Ministrís, i cili njikohësisht, do të ruente pozitën që kishte në atë kohë si Inspektuer Epror në Ministrinë e Arsimit bashkë me arsimtarët e njohun* Karl Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Anton Deda, Kolë Kamsi *e* Kostaq Cipo». Dr. Krasniqi kallzon edhe udhëzimet që i

jepen nga ministria përpara se të niseshe në krye të detyrës, pika e tretë ishte: *Studentët e kësaj shkolle nuk do të kishin nevojë të marrin pjesë në organizimin e rinisë fashiste, siç ishte gjendja në Shqipnín e vjetër.*

Në pranverë të vjetit 1943 Krasniqi emnohet *Ministër i Arsimit* në Qeverín e *Maliq Bushatit*, n'atë kohë kur në Shqipní e në Kosovë ishte suprimue fashizmi.

Në vjeshtën e vjetit 1943 zgjidhet si *Nënkryetar i Kuvendit Kombëtar* që u mbajtë në Tiranë, e ku për të parën herë merrshin pjesë edhe përfaqësuesa të zgjedhun lirisht e demokratikisht në të gjitha viset shqiptare që sot gjinden nën sundimin e Jugosllavisë së sotme dhe ku u shpallë bashkimi i këtyne tokave me Shtetin Shqiptar e pamvarësia e neutraliteti i Shtetit Shqiptar. Ma vonë Krasniqi u emnue si *Nënkryetar i Parlamentit* nën Regjencën e *Mehdi Frashërit, Idhomene Kosturit, P. Anton Harapit* e *Fuad Dibrës.*

Mbas luftës së dytë botnore ai emigroi për nji kohë të shkurtë së pari në Sirí dhe prej andej në Australí ku punoi për shtat vjetë në fabrikat e *General Motors* dhe të *Dunlop Tire Co.* t'Australisë.

Më 1957 thirret n'Amerikë me marrë pjesë në formimin e Komitetit *Shqipëria e Lirë* me qendër në New York, dhe u zgjodh si *Kryetar i Komitetit*, detyrë që e mban edhe sot e kësaj dite.

Gjatë kohës kur ishte profesor i historisë në Gjinokastër ai përpiloi historinë e popullit shqiptar dhe për ma tepër se nji duzinë vjetë fletët e poligrafueme të kësaj historie u banë tekste në disa shkolla të mesme në Shqipní prej shumë profesorave të historisë.

Në mërgim dr. R. Krasniqi, në bashkëpunim me *dr. Xhelal Mitrovicën*, boton të parën fletore në gjuhën shqipe në Australí me emnin *Vatra Shqiptare* që zgjati botimin për ma tepër se dy vjetë, në format të madh.

Dr. Krasniqi asht autor i këtyne librave: *Kontributi i Popullit Shqiptar në mprojtje të Evropës - Skenderbeu; Nji vështrim historik i robnimit të Evropës Lindore, Albania*, në bashkëpunim me *dr. A. Gegaj.* Përveç këtyne ai ka botue në shtypin e A.C.E.N.-it (*Asamblesë së Kombeve të Robnueme të Evropës*), çdo gjashtë muej, në gjuhën anglishte, broshura shumë faqesh, mbi gjendjen politike, ekonomike, kulturore të Shqipnisë për pesëmbdhjetë vjetë rresht. Ka botue në shtypin e mërgimit, artikuj-studimi historik, ka qenë bashkëpuntor i revistës *Shêjzat*, asht bashkëpuntor i *Koha e Jonë* etj. Për çdo muej, për njizet vjetë, në çdo numër të fletores së Komitetit *Shqiptari i Lirë* ka kontribue me artikuj studimi pa i nënshkrue ose shpesh tue përdorë pseudonimin *Balcanicus*, etj. Nji pjesë e madhe e kryeartikujve të kësaj gazete janë prodhime të tija. Gazeta *Shqiptari i Lirë* vazhdon botimin edhe sot e kësaj dite.

Dr. Krasniqi ka mbajtë shumë konferenca akademike në shumë universitete të ndryshme t'Amerikës mbi historinë e popullit shqiptar, mbi kulturën e mbi ekonomín e mbi gjendjen politike të atdheut tonë.

Dr. Krasniqi ka vizitue disa herë gadi të gjitha bashkësitë shqip-

tare në Evropë dhe në Amerikë dhe asht takue, në nivel të naltë, me personalitetet ma të shqueme-të Evropës qendrore e të Amerikës.


Asht për t'u shenue se Rexhep Krasniqi ka qenë zgjedhë si *Bir në shpírt* nga vet Heroi i Dragobisë *Bajram Curri*, i Cili e ka shoqnue për të parën herë në Vjenë kur shkoi të vazhdoi mësimet në Austrí. Krasniqi kishte mbetë jetim nga të dy prindët që në vegjëli, dhe shtëpia e tij ishte aty ku jetonte Bajram Curri ose pasardhësit e Tij, si në malet e Shqipnisë, në Gjakovë, në Shkodër, në Sarajevë, etj.

Duhet të vehet në dukje dhe aktiviteti sportiv i dr. Krasniqit si futbollist i njohun në Shqipní. Ai ishte pjestar i skuadrës së futballit të Shoqnisë *Vëllaznia* e Shkodrës, dhe kapiten'i skuadrës, në kampionatin e parë të futballit në Shqipní më 1930. Luejti për disa vjetë dhe sporti i ka dhanë nji fizikë atleti dhe e ka pajisë me nji karakter të ngulun e burrnor.

Dr. Krasniqi ka vetëm disa nipa e mbesa që jetojnë në Shqipní, dhe ai vetë jeton që më 1957 në New York.

HHO

Veprimtarija patriotike e heshtun e Adem Dushit



Adem Dushi

Me mbarimin e Luftës së Dytë Botnore, shum Shqiptarë (natyrisht këtu përmbledhim edhe vllezit e Kosovës dhe të Çamërís) u detyruem, — nga gjendja e ré politike që u krijue — me braktisun vendlindjen e, nji shumicë, edhe familjet. U shpërndam, andej e këndej, ndër vende të ndryshme t'Europës, në fillim, e pastaj ndër krejt kontinentet e tjerë.

Ka qëllue rasti me vû në dukje ndonjenin prej këtyne e sot po dishrojmë me paraqitun edhe nji tjetër kosovár që, në heshtje e përvujtuní, kurdoherë âsht mundue për çashtjen kombtare, në përgjithsí, e ate kosovaren, veçanërisht. E kemi fjalën tek *Adem Dushi*.

Lindi në Dush (Pejë) me 28 gusht 1904. Kreu studimet e para në nji shkollë turqishte sepse, n'at kohë, studimet në gjuhën shqipe ishin të ndalueme. Qysh në riní filloi me u përpjekun për Kosovën. Dishiri ishte t'a shifte të bashkueme me Nânën Shqipní. E kur kjo ngjarje historike ndodhi, Adem Dushi, në vjetët 1941-1943 qe zgjedhun si përfaqësues i Kosovës në Parlamentin Shqiptár. Veçse, edhe mâ përpara (në vjetët 1935-1940) e kishte përfaqësue minoritetin shqiptár në Parlamentin e Belgradit. Sa herë që Ademi paraqitesh ndër zgjedhjet, auktoritetet jugosllave mundoheshin me i nxierrun

ngatrresa e bâjshin edhe propagandë që të mos votohesh emni i tij. Mirpo, kurr Adem Dushi nuk iu përul këtyne kërcnimevet e vijonte me punue e u zgjidhëte sepse Shqiptarët e atyne rrethinave dhe parija e vendit kishin dhanë besën se do t'a votojnë : e ashtu ndodhi.

Nuk u kursye për bashkatdhetarët ; e përballoi anmikun me ball të hapët. Nuk i trembesh askujt. Kur ishte nevoja, paraqiste ankesa e protesta për mprojtjen e të drejtave të popullit të Kosovës tue qenë se donte që edhe ky të gëzonte po të njejtat të drejta, si krejt të tjerët.

Me 1945 qe arrestue në Pejë nga partizanët, por mujti, në vjetin 1946, mâ në fund e mbas shum peripecinash, me dalun n'Italí. Këtu kaloi disa kohë në kampin e profugvet të Reggio Emilia. Prej këndej emigroi në Sirí, ku gjindet edhe sot.

Gjatë krejt këtyne vjetve emigrimi, ka vijue, gjithmonë, me u interesue e me u kujdesue për çashtjen kombtare. Ka bâ hapat e duhuna, me sa ka muejtë, që mos të harrohet Kosova e të mprohen të drejtat e atij populli. Në Damask, punon e bân çdo sakrificë për me i ardhun në ndihmë Shqiptarvet të tjerë. Prá, nuk na mbetet tjetër veçse me i urue jetë të gjatë e plotsimin e dëshirit që Adem Dushi ka, si çdo Shqiptar tjetër i vërtetë : me u kthye n'Atdhé të lirë e në paqë!

T.

Anesti Andrea

Anesti Andrea lindi në Korçë më 1940. Mbassi mbaroi gjimnazin shtetnor në vendlindje, si bursist i shtetit u dërgue në Gjermanín e Lindjes për të ndjekë studimet universitare në Leipzig. Në prag të mbarimit të semestrit të dytë (maj 1957) arratiset në Berlinin Perendimor dhe kërkoi strehim politik.



Prof. Dr. Anesti Andrea

Mbassi kaloi disa kohë në kampin e refugjatve në Nüremberg dhe në Köln, emigroi në USA më 1961. Mbas kryemjes së shërbimit ushtarak në ushtrinë amerikane, ai i rifilloi studimet universitare në Universitetin e Shtetit të New York-ut dhe më 1968 mori titullin akademik të *B. A.* Prej 1969 deri më 1974 studjoi në *Boston College* (Universitetin Jezuit të

Boston-it) dhe në mars të vjetit 1974 mbaroi studimet universitare tue mbrojtë me sukses thezën e doktoratës me titull *The Aesthetics of the Early Nitzche* (Estetika e Nietzches). Në maj t'atij viti fitoi titullin akademik *Ph. D.*, doktoratën amerikane, në *Studimet Gjermanike*.

Interesimi për problemet e kthjellësisë në shprehje dhe ato të drejtësisë dhe thellësisë së mendimit, e tërhoqi prof. Anestin ndaj studimeve filozofike dhe prej verës 1977 ai po ndjekë studimet në filozofí si student i jashtëm në *Columbia University*, New York.



LASGUSH PORADECI ERNEST KOLIQI

P. GJERGJ FISHTA, O. F. M. ALEKSANDËR S. DRENOVA (Asdren)

DY BREZA LETRARË...

Nxierrë nga revista « Përpjekja Shqiptare », nr. 14-15, 1938

Ai shërbei si *docent* i gjuhës e i letërsisë gjermane në *Northeastern University*, Boston, mandej në *Eastern Kentucky University* dhe që nga viti 1976 âsht si *profesor kathedre* në *Eisenhower College*, në Seneca Falls, New York.

Prof. dr. Anesti njihet si përkëthyes i përsosun e poet i përhjellët si në gjuhën anglishte e në gjuhën e ambël shqipe. Ka përkëthye n'anglishten artistike veprën *Symfonia e Shqipere* të Koliqit dhe *Martesa e Mujit* e qerthullit të Mujit e Halilit të Visarit tonë kombëtar. Përkëthimet e tija në të dyja gjuhët janë të përsosuna dhe kanë tërhjekë vemendjen e diasporës shqiptare.

Ai ka qenë bashkëpuntor i rregulltë e shumë i vlefshëm në vjetët e fundit të revistës *Shêjzat* dhe bashkëpunon me revistat e shtypin e mërgimit shqiptar herë me emën e herë tue përdorë inicjalet e tija ose ndonji pseudonim.

Hylli i *prof. dr. Anesti Andrea* në fushën e letërsisë posa ka fillue të duket në horizontin shqiptar dhe jemi të sigurtë së do të japi nji kontribut jashtzakonisht të fortë e të dukshëm.

Të rij Shqiptarë Universitarë n'Amerikë

Mbas luftës së dytë botnore erdhën me mija refugjatë në Shtetet e Bashkueme të Amerikës, të ikun nga Shqipnia. Shumica dërmuese ishin njerëz të thjeshtë, nji numër i madh me familje e me fëmijë të vegjël e disa edhe me profesione të ndryshme e disa edhe akademik.

Numri i shqiptarve në Amerikë, ato që erdhën para luftës së parë bashkë me këto të luftës së dytë botnore janë afër 100.000, shumica e të cilëve i kanë mbajtë lidhjet shpirtnore me Shqipnín të freskëta se atdheu ka jetue nepër familjet e tyne. dhe shumica dërmuese e fëmijëve e flasin edhe sot shqipen.

Sot në Amerikë kemi ma tepër se katër duzina mjekë shqiptarë të gjeneracjonit të parë e të dytë, kemi disa duzina inxhinjera e kryeinxhinjera me detyra të nalta në qeverí në amerikane, kemi duzina profesora universitetesh — *Colleges e Universities* — e duzina të shumta mësuesish shkollash të mesme e shkollash fillore; kemi mjaft profesionist të tregtisë industriale në vende kyçe, e me qindra tregtarë që dallohen dita ditës në fushën kompetitive të sistemit kapitalist të Amerikës.

Por aty ku na bahet zemra mal, asht kur shohim brezin e rí, të bijët e atyne refugjatve që erdhën pa asgja, përveç «shpresës së Kepit të mirë» ose që lindën ma vonë në Amerikë e po kryejnë *College* e *Universitete* dhe marrin tituj akademik. E ajo që na gëzon ma tepër asht se edhe këta pinjuj të rí e mbajnë naltë krenarín e familjes shqiptare, të shqiptarizmit dhe të vendlindjes së prindëve.

Këtu po shenojmë vetëm disa që na njohim personalisht, e që i kemi mbledhë edhe nga shtypi i mërgimit. Nuk pretendojmë se paraqesim nji pasqyrë të plotë, gja krejt e pamundun për ne, por që u sugjerojmë gazetave që botohen në Amerikë në gjuhën shqipe që në fund të vjetit së paku të bajnë nji bilanç vjetor e të vejnë në dukje përparimin intelektual, industrial të bijëve të «*gjakut të shprishur*».

Kristina Fekeçi, e bija e *prof. Adalbert Fekecit*, mbaroi *University of California, Berkley*, dhe mori titullin e *B.A.* në *Histori te Artit*. Ajo asht tue studjue tashti në Evropë për të perfeksionue gjuhët e hueja dhe do të këthehet që të vazhdoi për doktoratë në Shkollën e Artit, në California ose në New York.

Lumo Cungu (Tsungu) mbaroi Universitetin e New York-ut, *Hofstra College* tue u gradue në *Tregtin Nderkombtare* dhe në *Administratë të Përgjithëshme*.

Arbënor Cungu, edhe ky i biri i *Inxhinjer Mahmut Cungut*, mbaroi shkollën aeronautike dhe tashti punon si pilot æroplanash të mbëdhej *Jet*, me nji kompani amerikane.

Ilir Cungu, edhe ky i biri i Inxh. Cungut, vazhdon mësimet e nalta për inxhinjeri, në *Nassau Community College*, të Universitetit të New York-ut.

Urime të veçanta *Familjes Cungu* që bani gjithë ata sakrifica për shkollimin e të tre djemëve. Të tre janë edhe veteranë të ushtrisë amerikane, dhe *Lumo* e *Iliri* kanë shërbye edhe në Vietnam dhe *Arbenor* në Amerikë.

Ali L. Begeja, i biri i të ndjerit *dr. Halim* e i zonjës *Sulltana*, mbassi mbaroi shkollën e mesme me nderime të veçanta, qe *Folesi Valedictorian* i shkollës e i klasës e fitoi edhe bursë shtetnore të plotë për nji çfardo Universiteti në Amerikë. Ai zgjodhi Universitetin *Brown* të Rhode Island, universitet i famshëm e tepër selektiv në pranime studentash ku prap e kreu në krye të klasës *summa cum laudae* tue marrë diplomën në *Mathematike* dhe në *Computers*, në qershor të 1977. Do të vazhdoi në *Columbia University*, New York, për doktoratë amerikane Ph. D.

Fillor Çaushaj, djali i zotit e zonjës *Sami Çaushaj*, mbassi mbaroi Collegin me nota të shkëlqyeshme, fitoi jo vetëm bursën e plotë, por edhe të drejtën e hymjes në shkollën mjeksore amerikane. Tashti ai vazhdon mësimet e mjeksisë në Universitetin e famshën *John Hopkins, Medical School* dhe për nja dy vjetë do të marri doktoratën në mjekësi. Ai u martue para dy vjetësh me nji vajzë shqiptare, me të bijën *e Imam Hysen Hoxhes*.

Joanne Prifti, e bija e *z. Louis* dhe *Vangjeli Prifti*, mbaroi shkollën e *Hygjenes Dentiste* në Universitetin e Pennsylvanís më 1966 me *summa cum laudae*, dhe tashti vazhdon mësimet e nalta për doktoratë. Z. Luigj Prifti ka qenë për afër tridhjetvjetë *speaker* në gjuhën shqipe në *Voice of America*, tashti në pension, dhe marrim vesht se asht tue punue në kërkime historike shqiptare.

Kujtim Beqaj, i biri i të ndiemit *Muhedin* dhe i zonjës *Emilika Beqaj* mbaroi *Queens University* në Kingston, Ontario, Kanada, në shkencat ekonomike, *summa cum laudae*. Do të vazhdoi mësimet për Ph. D.

Mirvet Muca, që hiku nga atdheu në moshën 17 vjeçare në Jugosllaví dhe vazhdoi mësimet universitare për tre vjetë e gjysëm në Universitetin e Shkupit, ku për arësyena të padituna u akuzue dhe u shtie në burg. Më 1960 erdhi në Amerikë dhe tashti vazhdon mësimet për doktoratë *Ph. D.* për *International Relation* (Marrëdhanje Ndërkombëtare) në *New School for Social Research*, në New York dhe asht aktiv në qarqet intelektuale shqiptare amerikane.

Hasan Biberaj, lindun në Kosovë, nga prindë të hikun nga Shqipnia më 1952, mori këto kohët e fundit «*Master's Degree*» në Historí, dhe tashti vazhdon po në *Columbia University*, New York, për Ph. D.

Elez Biberaj, edhe ky i lindun në Kosovë, nga prind të hikun nga Shqipnia më 1952, u gradue nga *Columbia University*, New York, në *Shkencat Politike* dhe *Journalisem*. Tashti vazhdon mësimet e nalta, po n'atë Universitet për Ph. D. Familja Biberaj erdhi n'Amerikë më 1968 dhe vëllaznit Biberaj po shquhen për aktivitetin e tyne intelektual e akademik në fushë ndërkombëtare.

Roberta Chicos, e bija e të ndjemit *Peter Chicos*, Kryetar' i *Vatrës* 1968-1970, dhe i zonjës *Nikolinë*, u gradue nga *Universiteti Swarthmore* të Pennsylvania, në *Ekonomí*. Ajo studjoi edhe Filozofí dhe asht e interesueme mjaft në art. Jetoi për nji vjetë në *Evropë* për të përfeksionue gjuhët e hueja. E na që e njohim familjen Chicos, nji fis i gjanë në Boston, mund të dëshmojmë se Roberta ishte *bebja e synit* e Peter Gencit të mjer. Po nga familja e Peter Chicos u graduen edhe vajza e madhe *Marilyn* dhe djali *Paul*, të dy me grada akademike, të martuem dhe me punë të mira.

Lek A. Velaj, i biri i *dr. Selahedinit* e i zonjës *Rina*, mbaroi Pace University, New York, dhe mori diplomën në *Shkencat Politike* dhe do të vazhdoi mësimet për Drejtësí që të dali advokat, karjerë që e siguronë të marri pjesë në politikën e vendit ose në pozita private të mira.

Drini R. Velaj, edhe ky i biri i *dr. Selahedinit* e i *Rines*, asht në *Universitetin Welseyan*, Connecticut, dhe i asht vue studimeve shkencore e me qëllim daljeje mjek.

Xhemil Çakërri, i biri i zotit *Qazim* dhe i zonjës *Gabriella*, vazhdon mësimet në *Universitetin e Texas*, për Mjeksi, n'Ushtrín Amerikane. Xhemili asht djalë inteligjent dhe me vullnetin e tij të çelnikët, patjetër do t'i dali në krye dëshirës.

Genci Babameto, i biri i *Pullumb* dhe i zonjës *Sabet*, mbaroi *Fairleigh Dichinson University*, New Jersey dhe mori diplomën në *Biologji* dhe tashti shkon në *Graduate School of New York* për *Fiziologji* dhe i a ka vue synin degës mjeksore. Jemi të sigurt se me vullnetin dhe me inteligjencën që ka pa tjetër do të dalë mjek i mirë.

Besa Luti-Babameto, e bija e martueme e zotit *Pullumb* dhe zonjës *Sabet* mbaroi *Fairleigh Dichinson University*, New Jersey dhe u gradue në shkenca ekonomike dhe do të vazhdoi për Ph. D. Zonja *Besa* asht e martueme me z. *Gregory Luti*.

Rasim Babameto, i biri i z. *Isak* dhe i zonjës *Miminet*, asht në mbarim të Universitetit të Shtetit, *New York City College* në degën e Arteve të bukura.

Judy Perkins, e bija e z. *John* dhe e zonjës *Drita* në *Kokalari*, mbaroi *Master Degree* në *Tregeti Bankare* dhe tashti drejton nji bankë të madhe tregëtare në Bakersfield, California. *Judy*, të cilës e ama i a ka mësue shqipen, ka fitue shumë nderime në shkollën e mesme dhe në Universitet dhe asht tash pesë vjetë në *Who's Who* amerikane.

Gary Perkins, edhe ky i biri i *John* dhe i zonjës *Drita* në *Kokalari*, vazhdon *University of California*, në San Diego, California, dhe i asht nisë degës mjeksore.

Lekë Domni, i biri i *dr. Fejziut* dhe i zonjës *Mini*, mbassi mbaroi shkollën e mesme me nderime të veçanta, po vazhdon mësimet universitare në *Boston College*, universitet i përmendun, dhe siç duket edhe ky do të ndjeki karjerën e dr. Fejziut, e do të bahet mjek. Edhe dr. Fejziu asht në *Who's Who* amerikane: urime e naltë e ma naltë!

Dervish Mitrovica, i biri i të ndjemit *dr. Xhelal* dhe i zonjës *Feruze*, vazhdon studimet në *Universitetin e Torontos*, Canada, në degën *Elektroteknike*. Ai ka fitue për merita të veçanta bursë qeveritare të plotë.

Darlene Mitrovica, edhe kjo e bija e të ndjerit *dr. Xhelal* dhe e zonjës *Feruze* vazhdon mësimet n'Universitetin e Toronto-s, Canada, në degën e *Historisë së Artit te Renaisances*.

Ronald Chika, i biri i zotit *Vahit* dhe i zonjës *Tefta*, asht tue e mbarue *Pennsylvania State University*, në *Biologji* e i a ka vue edhe ky synin studimeve mjeksore. Z. Vahit asht i njohun në qarqet vatrane të New York-ut.

Brian Dervishi, i biri i *inxh. Ahmetit* dhe i zonjës *Shpresa*, asht tue e mbarue universitetin e famshëm *Ann Arbor* në Michigan. Z. Ahmeti asht Kryetar i sotëm i Federatës Panshqiptare *Vatra*.

Loraine Prifti e bija e z. *Vangjel*, që shërbei n'Ushtrinë Amerikane gjatë luftës së dytë botnore, dhe qe ndërlidhës i shërbimeve me Shqipnín në Bari, asht në mbarim e sipër të *Pennsylvania State University* në *Kimi*, dhe do të vazhdoi po aty për Ph. D.

Robert Licho, i biri i *dr. Edvardit* dhe i *Doktoreshes Silena*, shkon në *New York University* dhe, si duket, i a ka nisë udhës së nanës që asht primare në nji nga spitalet ma prestigjioze të New York-ut, asht drejtoreshë e nji reparti të madh dhe asht edhe në librin *Who's Who* tash sa vjet.

Wilfred Fekeçi, djali i *prof. Adalbertit* asht edhe ky tue vazhdue në vjetin e dytë *Universitetin e California* në Berkeley. Endè nuk e ka caktue degën e specializimit por, me sa dijmë, ndoshta edhe ky do të sulmoi degën e mjeksisë.

Asht për t'u përgëzue edhe *prof. Adalberti* për sakrificat e tij të shumta për shkollimin e të dy fëmijëve në universitete të mbëdha.

Zyhdi Karagjozi, djali i *inxh. Agim* dhe i zonjës *Rose* në *Peshkopia*, asht regjistrue në *Cobbleskill College*, në New York. Endè nuk e ka caktue degën e specializimit.

Donna Del Prete, lindun nga familja shqiptare *Mirakaj*, mbaroi në *Buffa'o Universitetin* e New York-ut dhe mori diplomën e specializimit për ata që kanë vështërsi në të folme. Do të vazhdoi mësimet për doktoratë.

Luigj Mirakaj, asht tue e mbarue *St. John University* dhe i asht nisë degës mjeksore që na jemi të sigurtë se do t'i a dali në krye se me vullnetin e zgjuetsín e tij nuk ka gja që t'a ndali.

Hajdin Alijaj, nga Malësia e Gjakovës, vazhdon studimet në *New York City College*, asht bile edhe themeluesi edhe drejtuesi i nji të përkohëshme studenteske me emnin *Zëri i studentave shqiptarë*. Urime.



Judith Theodore edhe kjo e bija e të ndjerit *Paul Rako Theodore* dhe e zonjës *Flora Chicos Theodore*, e mbesa e të ndjerit *Peter Chicos*, Kryetar i *Vatrës* (1968-1970), mbassi mbaroi shkollën e mesme me nderime, dhe *Vernon Court Junior College* në Newport, Rhode Island, dhe Universitetin Stonybrook të Long Island mori titullin akademik *B. A.* Më 1975 mbaroi *Boston State College* dhe mori *Master's Degree*.

Zonjusha Judy ka qenë përherë e shqueme dhe përherë ka qenë në listën e nderit të Dekanatit.

Tashti ajo punon në ndërmarrje private në fushën e Sigurimeve ashtu siç punonte daja i sajë.



John C. Chani, i biri i zotit e zonjës *Peter J. Çani*, nga rrethet e Boston-it, mbassi mbaroi shkollën e mesme me nderime tue fitue edhe çmimin e revistës *Time* magazine të famëshme, mori *B.A.* në *Shkenca Politike* nga Universiteti i famshëm Amherst, Mass.; ma vonë vazhdoi *Massachusettes College of Pharmacy*, ku mori edhe aty *B. S.* Tashti punon bashkë me babën në farmacín e Familjes Chani.



Karen L. Chani, e bija zotit e zonjës *Peter J. Çani*, mbaroi *Colby Sawyer College* në New London, New Hampshire, tue marrë diplomën për *Artet e Bukura, B. A.* me nderime të veçanta nga dekanati i Kolexhit. Ajo tashti vazhdon mësimet e nalta në Universitetin e New Hampshire, në Durham, N.H.


Abdullah Nezaj, nga rrethet e Kuksit, po vazhdon mësimet në Universitetin me famë të *Cornell University* në *Business Administration.*

Nicol Alempievíç, bir i familjes së madhe të *Mirakajve*, âsht tue vazhdue mësimet universitare në *Brooklyn College* në *Psikologji.*

Bessa Tonuzi, e bija e z. e zonjës *Gani Tonuzi*, vazhdon mësimet universitare në *Pratt University*, New York, në *Artistic Design.*

Drita Tonuzi, edhe kjo e bija e familjes së madhe të *Tonuzve* të Dibrës, vazhdon *Brooklyn College* në *Sociology.*

Nderim i veçantë



Thomas R. Theodore

Thomas Ronald Theodore, i biri i të ndjerit *Paul Rako Theodorit* dhe i zonjës *Flora Chicos-Theodore*, nip'i të ndjerit *Peter Chicos*, mbassi mbaroi *Massachusettes Institute of Technology* (M.I.T.) më 1968, vazhdoi mësimet në *Boston University* tue u gradue në *biologji.*

Në punë private ai punoi në fushën e kërkimeve elektromekanike të fuqisë së fuzionit të hydrogjenit. U bâ konsulent firmash klinike private si edhe klinikash universitare si të famshmes *Klinike Joslin Diabetes Foundation*, për përdorimin e fuqís bashkuese të çelulës së sheqerit në të sëmundët me diabet.

Si konsulent i *Theta Technology* ai shkruejti në revista shkencore mbi *Historin e aparateve të presionit të gjakut.* Ky studim âsht bâ nji klasik në qarqet shkencore. Zbuloi edhe nji stetoskop të veçantë që ndihmon në zbulimin e toneve e të veseve të zêmrës. Ky zbulim bashkë me atë të fundit që mban datën «1978» mbi *L71 Komputeri Kalorik* janë në proces administrativ që të marrin patente të veçanta.

Tashti punon si *Kërkues indipendent* në *Shkollën e Medicines* së Harvard dhe të M.I.T. mbi shumë aspekte elektrofiziologjike. Zbulimet e tija në fushën mjeksore janë të shumta.

Âsht antar i *American College of Sports Medicine, American Institute of Aeronautics and Astronautics, Boston Athletic Association - Medical Unit, The Inter-*

national Supreme Council, Order of DeMolay; The Institute for American Strategy, The National Advisory Board of the American Security Council dhe të *Pan Albanian Federation of* «Vatra». Pra âsht edhe në veprimtarí shqiptarizmi.

Në edicionin e 16-të të *Who's Who* âsht i cituem me dukmení të veçantë. Rolandi âsht i martuem, babë i nji vajze dhe jeton në Arlington, Massachusettes. Shqipja e tij âsht e bukur e mjaft e kuptueshme.

Urime familjes *Theodore* dhe fisit të *Chicos*, ose si e njohim *Çikozëve*.

Viktor Daragjati, i nipi i *Mirakajve* e djali i zonjës *Lule*, asht në mbarim të diplomimit në shkencat e inxhinjerís.

Lina Marashi, lindun *Mirakaj*, vazhdon mësimet universitare në *Hunter College*, New York.

Ali Ramaliu, i biri i zotni *Hysen* e i zonjës *Assunta*, mbassi mbaroi shkollën e mesme me nderime të veçanta, sidomos në fushën e fotografisë dhe të gazetarisë, tashti vazhdon studimet universitare në vjetin e dytë në *New York University*, Stony Brook, L. I., N. Y.



Diana Dhuratë Oruçi, e bija e *dr. Hamdiut* dhe e zonjës *Lumto*, mbassi mbaroi shkollën e mesme me nderime të veçanta, në krye të *High Honors Society* dhe mbas nji aktiviteti të gjanë në krye të redaksisë së *Librit vjetor* të klasës e të shkollës së sajë, asht në mbarim të *New York State University*, Albany, N.Y., tue u diplomue në *gjuhësin anglishte*. Ka ndër mend të vazhdoi mësimet e nalta për *Masters Degree* në nji universitet tjetër e të kaloi nji semestër në Evropë, për specializim të gjuhëve të tjera.

Shpresa Jeanette Oruçi, edhe kjo e bija e *dr. Hamdiut* dhe e zonjës *Lumto*, asht në mbarim të shkollës së mesme dhe asht pranue në nji universitet të New York-ut, por nuk e ka caktue endè degën e studimit.

Për mungesë informatash, nuk asht e mundun, dhe nuk e kemi ndër mend, që të paraqesim nji listë të plotë të studentave universitarë shqiptarë në Amerikë. Kjo gja asht e pamundun të bahet kambë e dorë: don punë të madhe e nji shtyp të rregullt. Na deshtëm të vejmë në dukje gjallnín e bashkësisë shqiptare në USA, dhe të vejmë sidomos në krahasim mërgimtarët e ardhun para luftës së dytë botnore dhe atyne që erdhën gjatë e mbas luftës së dytë botnore. Shqiptarët e ardhun mbrenda këtyne tridhjet vjetëve kanë përparue në çdo pikpamje që të merret: shoqnore, ekonomike e sidomos kulturore. Sot kemi me mija djelm e vajza që shkojnë në shkollat fillore, mija që shkojnë në shkolla të mesme, me qinda që shkojnë në College e në universitete, me qinda që marrin tituj akademik e me shumë duzina që marrin edhe Ph. D. që, për lexuesit evropjan vejmë në dukje se *Ph. D.* amerikane, nuk asht njilloj me doktoratën e universitetit evropjan ndoshta mund të krahasohet me profesoratën e universitetit.

Këtu nuk kemi çekë pjesën tjetër të *gjakut të shprishur, arbëreshët* që, ndoshta, në numër janë ma me shumicë këtu se në Italí.


Shêjzat përshëndesin të gjithë studentat, ata që përmendëm e ata që janë studenta, si edhe prindët e tyne, dhe u urojmë punë të mbarë dhe suksese në fushën e gjanë të kulturës. *E kultura shqiptare po hecë me hapa të mbedhaja kudo në botë.*

HHO

Kisha e ré Katholike Shqiptare "Zoja e Papërlyeme" - Pajtore e Shqiptarvet -

Mbas shum përpjekjesh, edhe nji qendër tjetër fetare shqiptare, muejtë me u krijue: gëzim i madh për të gjithë, pa dallim feje e krahine, por veçanërisht mâ i madh e i papërshkrueshëm për bashkësín e vendit ku u krijue e për krejt ata që nuk u kursyen me dhanë ndihmën e tyne. Vendi ku gjindet Kisha âsht nji ndër mâ të bukurit e Detroit-it. Kje nji fat e nji ndihmesë e Zojës gjetja e kësaj ndërtese e u vendos me ia kushtue Kishën *Zojes Pajtore te Shqiptarvet* e për të parën herë u çue Mesha në Votrën Shqiptare, e u plotsue ajo suazë e hijshme me atê shka mungonte: *Kisha Katholike Shqiptare.*

Populli i kësaj Qendre së ré, i mveshun me kostumet kombtare e me krenarí, këndoi valle, në Michigan, në sheshin e Shêjtnores së vet. Ndërtesa âsht shum e bukur e pamja e madhnueshme tërhjek, pa tjetër, vemendjen e çdo udhtarit që kalon andej pari.



« Zoja Pajtore e Shqiptarvet » - *Our Lady of Albanians:* 20855 W. 13 Mile, Beverly Hills - Birmingham, Michigan 48010 - Phone: 642-0816

Famullitari, sëbashkut me Këshillin e Qendrës, vendosën me e bâ inaugurimin me 25 qershor 1977. Sejcili mori përsipër nga nji detyrë e të gjithë e kryen, mâ së mirit, por barrën mâ të randë e ka pasun e ka e do t'a ketë Famullitari vet. Kush e njef Dom Ndrevashaj, e din se âsht i palodhshëm e i pakursyeshëm. Âsht nji

Meshtár që meriton çdo levdatë për meritat e tija fetare dhe atdhetare. Ka pasun. fatkeqsisht, edhe prej atyne që e kanë luftue «jo si burrat», por me shpifje e çdo lloj kërcënimesh.

Mbrrijti dita e inaugurimit. Ishte nji ditë e Shtunde. Dielli kishte fillue me ngrohun me rrezet e veta të shkëlqyeshme. Dalë nga dalë po fillon me ardhun nji mori gjindësh: ishin jo vetëm ata të Michigan-it, por edhe të tjerë që, posaçërisht, kishin ardhun nga New York-u, nga Kanadaja, nga Ohio e tjera vende. Vetëm nga New York-u ishin rreth njiqind e ndër to. *Mons. Dr. Joseph J. Oroshi, Dom Rrok Mirdita, zz. Gjon Gjinaj* e *Hysen Biberaj* e sa e sa të tjerë që, fatkeqsisht, nuk i njof. Por qe se po mbrrijnë edhe shum meshtarë e zyrtarë të naltë t'Arkidioçezit të Detroit-it, me në krye *Ipeshkvin Krawcak*, i cili përfaqësonte edhe *Kardinalin Dearden*, që ishte i sëmundë e dërgonte nji letër plot dashtní, përgëzime e bekime.

Në rrugën kryesore, para Kishës, dallohet nji tabelë me shkrojat kuq-e-zí: OUR LADY OF ALBANIANS. Mbi Shêjtnoren nji kryq i bardhë e në të dy ballnat e Kishës dy kryqa të stolisun e me sherita arit shenjojshin edhe vjetin: 1977!

Kisha mbrenda ishte e shtrueme me pëlhurna të bardha e me shkrime shqip: *Mirse keni ardhë te Zoja Pajtore e Shqiptarvet. Papa Pauli Gjashte* ishte denjue me i çue Kishës bekimin e Vet anglisht e shqip. Era e kandëshme e trandofileve, karajfilavet e lilavet përciellte popullin qysh nga rruginat e Kishës deri tek lteri i stolisun. Tre flàmuj të mëdhej: ai i Vatikanit, i Shqipnís e i Shteteve të Bashkueme t'Amerikës valvitshin porsa u hynte në Shêjtnore.

Pikrisht n'orën njimbëdhjetë filloi ceremonija. Në vendet e para ishin Delegatët e besimeve të ndryshëm. Nji korté i gëzueshëm, i primun nga dymbëdhjetë xhakoj, tetë meshtarë, nga *Dom Prenk Ndrevashaj* sëbashkut me *Monsinjor Dr. Joseph J. Oroshin, Dom Rrok Mirditen* e me *Ipeshkvin Krawcak*, iu ngjiten lterit. Këtu filluen me bâ bekimin e Shêjtnores dhe ceremonín e liturgjís së Kishës.

Nuk âsht e mundëshme me përshkrue përmallimin e asaj dite së paharrueshme dhe asaj date historike. Dom Ndrevashaj, me urtín që e dallon, u drejtohej Përfaqësuesvet të besimeve të ndryshme e krejt pjesmarrsve me buzëqeshje e lot ndër sy: *Mirë se keni ardhë te Shpija e Zotit! Mirë se keni ardhë te Shpija e Juej!* Ipeshkvi Krawcak foli tue u përgëzue me né e tue na dhanë guxim me vijue n'udhën e ndërmarrun e mos me iu trembun përgjegjsinave e vishtirsinave që do të na paraqiten. Hymnet fetare, në gjuhën shqipe, përcuellen krejt ceremonín. Lutjet fetare u thanë nga mbarë Përfaqësuesit e fenave të ndryshme: kjo tregoi se Shqiptari, kur don, âsht i njij zêmre e i njij fuqije së vetme që askushi kurr nuk mundet me e damtue. Jashtë, të gjithë, pa dallim, përshëndetshin Dom Ndrevashaj, me kënaqsí: *Dhashtë Perendija e Zotrija e Jote na e ngrehë edhe në Shqipëri nji Kishë kështu!... Kjofshë bekue e i Lumi të ndihmofte!*

Ishin Shqiptarë e vetëm Shqiptarë: toskë e gegë, mysliman e orthodoks e katholik: të gjithë të bashkuem e të lumtun.

Mbas ceremonís fetare, Dom Prenka ftoi të pranueshmit për nji kafe e prej andej, mâ se treqind automobila, u drejtuen kah *Holiday Inn Power* i Southfield-it ku, për ndér të mysafirvet, bashkësija e Kishës kishte pregatitun sofrën. Në krye të vendit *Ipeshkvi Krawcak*, pastaj Kleri Katholik Amerikan e Shqiptar, Hirsija e Tij *Baba Rexhepi*, i Ndritshmi *Imam Vehbi Smajli*, Kryetari i *Vatrës, Inxh. Ahmet Dervishi* e shum të tjerë.

U lexuen letra e telegrame t'ardhuna nga pesë kontinentet, u mbajtën fjalime tue vû në dukje veprimtarín e heshtun të Dom Prenk Ndrevashaj. Fjalimet e *Mons. Oroshit*, të *Dom Rrok Mirditës*, të *Dr. Gjon Buçaj* prekën krejt të pranishmit, veçanërisht Famullitarin sepse kujtuen edhe Nânën e Motrën e Dom Prenkës, *Miria Elena Ndrevashaj* dhe *Suor Alberta*. Këta dy kreatyra të Zotit i lejuen Djalit dhe Vllaut me krye misjonin që Perendija i kishte caktuem. U theksue kjo edhe nga fjalim-mbajtsit për t'u tregue, në këtë mënyrë, të gjithvet se sa i dashtun ishte Dom Prenka nga të vetët. Përhera ka thanë Dom Prenka: *S'ka nevojë me mprojtë kush drejtësin t'eme para Zotit as para njerzvet të Kombit t'em, por bânju Ju vet njerz të dashtun dhe të dijshëm me ndihmen e Fés.*

Fjalimet e *Baba Rexhepit*, t'*Imam Vehbi Smajlit*, të z. *Zef Mirakaj*, z. *Tahir Markaj*, z. *Bajram Qunmulaj*, z. *Preng Grudës* e të shum të tjervet na gëzuen, por nuk mund të harrojmë fjalën dashunore të Kryetarit të *Vatrës*, Inxh. *Ahmet Dervishit* dhe të mjekut *dr. Ton Shllakut* që kishte ardhun bashkë me Zojën e vet. Dr. Shllaku, të gjithë e dijnë, se âsht nji mjek i çmueshëm, jo vetëm ndër né Shqiptarët, por edhe në krejt rrethin ku ushtron profesjonin. Megjithse i xânun me detyrime të tjera, iu ka shmangun atyne për me qenë pranë at ditë të shênjueshme.

Shqiptarët, banuesa në Michigan, si të tjerët, treguen se Shqiptari nuk âsht i pafé, siç po duen me e paraqitun qeveritarët e sotshëm, por, përkundrazi, beson në nji Perendí. Faktet e tregojnë se të gjithë kanë ndihmue e ndihmojnë për ndërtime Xhamijash, Teqesh e Kishash d.m.th. për Institute fetare.

Mysafirët mbetën të kënaqun edhe nga sofra e shtrueme e nga ushqimet e pregatituna. Orkestra *Shqipet* na argtoi me muzikë e kângë kombtare. E, aty-për-aty, vullndetarisht, u mblodhën edhe dhjetëmijë dollarë të tjerë për Kishën. Kështu Qendrat fetare n'Amerikë shtohen e duhen mbajtun me çdo sakrificë sepse Xhamijat, Teqet, Kishat Orthodokse e Katholike, kudo që kanë qenë ndërtue e do të ndërtohen, janë të vetmet selí që mbajnë përhera gjallë ndiesín, jo vetëm fetare, por edhe atê kombtare e janë këto Qendra që ruejnë gjuhë e zakone. Shembullin e kemi tek Vlleznit *Arbreshë* n'Italí e Amerikë e me Orthodoksit e Shteteve të Bashkueme. Na të gjithë, sidomos të rijt, urojmë që shpejt Perendija të na dhuroi Ditën fatlume me u kthye në Shqipnín e lirë që dishrojmë e atje të rishofim përsërí Vendet e shêjta të mbushuna me besnik tue iu drejtue Perendís që Lirija e Paqëja të mbretnojnë kudo në Botë.

LULA LUCAJ

Aperte le attività annuali del Circolo " Besa-Fede "

Con una dotta e documentata conferenza del direttore dell'Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma, prof. *Ernest Koliqi*, sul tema *Classicismo e romanticismo nella letteratura albanese*, sabato 23 novembre 1974, ha aperto le sue attività annuali (1974-75) il circolo italo-albanese di cultura *Besa-Fede* di Roma.

In particolare l'oratore, scrittore e saggista di primo piano della letteratura contemporanea albanese, ha messo in rilievo come gli influssi del romanticismo europeo nella letteratura albanese siano limitati, mentre quelle forme e quegli spiriti della letteratura riflessa albanese, molto simili a quelli romantici, provengono dalla stessa letteratura orale albanese, una delle più suggestive del mondo.

Non si può quindi asserire, come talvolta avviene, che l'Albania si sia costituita a nazione sotto il diretto influsso del romanticismo. I letterati albanesi tuttavia trassero i più opportuni insegnamenti dalle correnti letterarie occidentali (classicismo, romanticismo, verismo, ecc.) per risvegliare le più segrete virtù della stirpe, rimaste sopite a causa dell'ingiusto destino storico di cinque secoli di dominazione turca.

L'oratore è stato presentato da Mons. *Eleuterio F. Fortino* che ha ricordato il contributo dato dal Koliqi alla letteratura albanese, tanto nella creazione quanto negli studi critici.

La conferenza è stata seguita da un qualificato uditorio, composto da albanesi di Albania e albanesi d'Italia residenti a Roma che costituiscono la base del circolo *Besa*. Infatti questo circolo è stato costituito nel 1967 proprio per rispondere alle esigenze culturali di questo gruppo etnico che per ragioni di lavoro risiede a Roma. In maggioranza esso è composto da albanesi d'Italia, provenienti dalla Calabria, dalla Sicilia, dalla Lucania e dal Molise. In Italia vivono ancora almeno duecento mila albanesi, residuo della grande immigrazione avvenuta nel sec. XV allorché i turchi occuparono l'Albania. Questi mantengono ancora viva la lingua e le tradizioni familiari albanesi assieme a una propria cultura. A Roma vi si trovano almeno 4.000 italo-albanesi

Il Circolo *Besa*, costituito su iniziativa di un gruppo di studenti universitari, nel 1968 ha organizzato una imponente celebrazione del V centenario della morte dell'eroe nazionale Giorgio Castriota Skanderbeg, definito dal Papa del tempo *atleta di Cristo*.

In questa occasione si sono incontrati a Roma migliaia di albanesi provenienti non soltanto dall'Italia, e dall'Europa, ma anche dalle Americhe e dall'Australia. In seguito, oltre alle attività culturali normali, ha organizzato vari convegni di studenti universitari, affrontando la seguente problematica: *Il ruolo dell'intellettuale cristiano italo-albanese nel contesto della situazione politico-religiosa delle nostre regioni.*

Le stirpi degli Albanesi d'Italia nella cronaca di Tocco 1385-1422

« *L'Arbri* (Albania) è un fenomeno non esclusivamente legato a un territorio. Dovunque un albanese accende un focolare e costituisce una famiglia, un gruppo, una comunità albanese, l'*arbri* si manifesta. Questa sera noi qui costituiamo un *Arbër* ».

Con questa considerazione ha aperto la sua conversazione il prof. *Giuseppe Schirò*, direttore dell'Istituto di studi bizantini dell'Università di Roma, conversazione che egli ha tenuto al circolo di cultura « *Besa*-Fede » degli Italo-Albanesi di Roma, il 6 dicembre 1975.

Questa concezione dell'*arbri* ha fornito lo sfondo della conferenza e il tessuto connettivo che ha collegato in un'unica realtà culturale e spirituale, anche se diversificata per vicende storiche e politiche, gli albanesi d'Albania, quelli dell'Epiro e gli *Arbreshë* di Calabria e Sicilia.

Il prof. Schirò ha riferito sulle stirpi degli Albanesi d'Italia presenti nella *Cronaca dei Tocco*. Questa « Cronaca » di anonimo viene alla luce dopo 5 secoli dalla sua composizione. Il manoscritto scoperto da *Silvio Giuseppe Mercati* è stato oggetto di studio per ben 15 anni da parte del prof. *Giuseppe Schirò*, il quale finalmente quest'anno ne ha pubblicato l'Editio princeps - 3.975 versi (*Cronaca di Tocco dei Cefalonia di Anonimo* - Prolegomeni - Testo critico, traduzione di Giuseppe Schirò - Accademia Nazionale dei Lincei - Roma, 1975, pp. XXI - 610).

L'autore anonimo della cronaca è un contemporaneo e testimone di alcuni degli avvenimenti narrati. Egli racconta, in versi demotici greci, le vicende che costituiscono le trame della storia dell'Epiro fra il 1375 e il 1422. Ma già si avverte l'avanzata dell'esercito ottomano. Nel 1453 cadrà Costantinopoli, nel 1468 morrà Giorgio Castriota Scanderbeg e l'emigrazione in Italia degli Albanesi è imminente.

Il prof. Schirò si è soffermato su 4 casati presenti nella « Cronaca » e che attualmente si ritrovano negli Albanesi d'Italia:

— gli *Spata*, signori del despotado di Arta;

— i *Bua*, stradioti di mestiere, ora al servizio degli Spata, ora dei Tocco;

— i *Masarachei* (Mazzaracchio), albanesi che hanno partecipato ad azioni militari promosse dagli Spata;

— i *Tocco* (i Tocci) famiglia italiana che il Re di Napoli conferma come Duchi di Cefalonia, e che conquistano il despotado di Giannina e poi quello di Arta facendo guerra agli Spata. Sotto i Tocco si ricongiungono i due despotati dell'Epiro (Arta e Giannina), ma che tuttavia non si fondono completamente in un'unica entità.

La conferenza è stata seguita da un folto e scelto pubblico che ne ha apprezzato la chiarezza, il rigoroso fondamento storico e l'accuratezza metodologica.

L'oratore è stato presentato da Mons. *Eleuterio F. Fortino* che ne ha messo in rilievo l'opera come studioso e maestro, ricordandone alcune delle maggiori pubblicazioni, come quelle su *Barlaam Calabro* (1938 e 1959), gli *Analecta Hymnica Graeca* (12 volumi dal 1966 in poi), l'unica *Storia della Letteratura Albanese* (1959), esistente in Italia e l'Edizione Critica del *Këthimi* (1965), opera postuma dell'omonimo Giuseppe Schirò.

Sono state quindi presentate le felicitazioni della comunità Italo-albanese di Roma al prof. Schirò per la sua recente nomina a *membro dell'Accademia di Atene*, riconoscimento prestigioso per i suoi alti meriti scientifici, di ricerca e di insegnamento.

Nel corso della riunione *Domenico Morelli* ha presentato il programma delle attività del Circolo *Besa* per il 1976 che prevede: un corso settimanale di lingua albanese, una serie di conferenze su « l'Uomo e la sua Terra » e una ricerca di gruppo su « La Comunità Italo-albanese oggi ».

In apertura Mons. *Fortino* aveva fatto una breve commemorazione del prof. *Ernest Koliqi,* che esattamente un anno fa tenne proprio al circolo *Besa* l'ultima sua conferenza pubblica. Lo ha ricordato come studioso, poeta, e amico degli Albanesi d'Italia.

* * *

Il Circolo italo-albanese di cultura *Besa* di Via dei Greci 46 di Roma sta promuovendo da anni una intensa attività culturale.

Il 26 novembre c.a. ha organizzato una tavola rotonda sul tema: *Gli albanesi di Jugoslavia: rinascita di un popolo,* cui hanno partecipato tre *arbëreshë* di Calabria che nel mese di agosto hanno preso parte al quarto Seminario di cultura albanese, organizzato a Prishtina (Kosova-Jugoslavia) dalla locale università albanese. Moderatore del dibattito è stato il *dr. Lillo Fedele,* italo-greco di Reggio Calabria, che l'anno scorso ha visitato gli albanesi di Jugoslavia. Il *prof. Domenico Morelli* ha parlato del risveglio degli albanesi di Jugoslavia negli ultimi trenta anni, mettendo in evidenza i risultati culturali ed il ruolo storico sociale che ha svolto e che svolge di continuo questo popolo in tutta l'area albanese. La *sig.na Kate Zuccaro,* che da anni si interessa di folklore, dopo avere riferito sulla attività scientifica dell'Università di Prishtina nel campo del folklore, ha messo in rilievo gli aspetti caratteristici del folklore albanese di Kosova in confronto con il folklore degli albanesi di Calabria.

Il *prof. Italo C. Fortino,* dopo avere presentato gli elementi di fondo della poesia degli ultimi trenta anni, ha tratteggiato i lineamenti critici di tre poeti: *Esad Mekuli, Enver Gjerqeku* e *Ali Podrimja,* che rappresentano tre periodi nell'evoluzione delle tematiche poetiche, quello sociale, quello lirico e il periodo del simbolismo.

Viaggio tra gli albanesi della Jugoslavia

Il Circolo italo-albanese di cultura di Roma (Via dei Greci 46) *Besa/Fede* è ritornato ad interessarsi degli Albanesi di Jugoslavia.

L'antropologo, *dr. Guido Cafiero,* il 25 febbraio 1978 vi ha tenuto una conferenza ampiamente illustrata da una proiezione di diapositive a colori sulla vita, la cultura, l'arte e i mestieri degli albanesi di Jugoslavia, frutto di una indagine fatta sul luogo.

Il *prof. Domenico Morelli,* ha presentato l'oratore segnalando le sue pubblicazioni di carattere antropologico e etnografico sugli albanesi d'Italia e di Jugoslavia, apparsi su *Atlante* (Istituto Geografico De Agostini), sulla *Rivista di Etnografia* (Napoli), e su *Risveglio-Zgjimi* (rivista italo-albanese di cultura). Egli ha anche ricordato che il Circolo *Besa/Fede* ha già aperto il discorso sugli albanesi di Jugoslavia con la *Tavola Rotonda* del 26 novembre scorso sul tema: *Gli albanesi di Jugoslavia. rinascita di un popolo.*

Il *dr. Guido Cafiero,* ha inquadrato la sua esposizione nel contesto più ampio della sua ricerca, effettuata in Jugoslavia, che aveva per scopo il rilevamento antropologico delle componenti etniche di quella Federazione di Repubbliche. In particolare, specialmente nel commento delle diapositive, egli ha messo in evidenza l'etnografia e l'antropologia della Kossova (la Provincia Autonoma albanese nella Repubblica Serba) e della Macedonia. Ha presentato queste zone: Rugovo, Peć, Dećani, Dakovica, Prizren, Uroscevać, Tetovo, Gostivar, Ocrida, Bitola, Skopje. Della vita degli albanesi in queste regioni, ha fatto emergere le caratteristiche del lavoro, della scuola, della fede religiosa (cristiana — di espressione ortodossa e cattolica — e musulmana), in una dialettica fra conservazione della cultura tradizionale e rinnovamento, nel contesto delle profonde trasformazioni sociali e politiche in corso, in cui non è assente il contrasto talvolta stridente.

Scopo della ricerca è stata quella di un confronto con la « realtà albanese » degli *Arbëreshë* d'Italia.

L'oratore ha affermato: « In questo vasto comprensorio abbiamo cercato le dominanti antropologiche e, in queste, i temi strutturali non ancora intaccati dai mutamenti politici e dai sovvertimenti tecnologici dell'evoluzione moderna, per poterli confrontare con quelle degli albanesi d'Italia e rilevarne le eventuali caratteristiche e valori comuni ».

Questo parallelo ha portato all'« evidenziamento delle origini meridionali e addirittura *arvanite* (cioè degli albanesi di Grecia) della maggior parte delle popolazioni italiane di ceppo albanese, la cui evoluzione tuttavia ha seguito matrici decisamente locali e tipiche delle regioni ospiti. L'eventuale recupero delle peculiarità etniche, dovrebbero, per le comunità italiane, dirigersi più verso l'area tosca e arvanita, che non verso le popolazioni gheghe pure ».

Ne è seguita una conversazione-dialogo con i presenti, in cui l'oratore ha potuto approfondire alcuni aspetti della proiezione.

Mons. *Eleuterio F. Fortino,* a conclusione, ha ringraziato l'oratore e i presenti, albanesi, *arbëreshë,* italiani per la loro partecipazione e ha messo in rilievo la rinascita culturale e sociale degli albanesi di Jugoslavia nonché i buoni rapporti instaurati da alcuni anni con gli albanesi d'Italia.

Una raccolta di saggi del poeta Ernesto Koliqi

Albania - Nascita di una cultura nazionale

di Mircea Popeścu

Nessuno certamente meglio di *Ernesto Koliqi* ci poteva dare un panorama così ampio e brioso della letteratura e della stessa storia del popolo albanese come quella che vien fuori dai suoi *Saggi di letteratura albanese*, pubblicati di recente dall'editore Olschki di Firenze (pp. IV-260, lire 5.500).

Poeta tra i maggiori del suo Paese, critico e storico letterario, filologo, attualmente professore di lingua e letteratura albanese nell'Università di Roma, ministro della Pubblica Istruzione prima della guerra a Tirana, lo scutarino Koliqi ha preso parte attiva alla vita culturale e politica dell'Albania. Non solo, ma per una decina d'anni, fra il 1930 e il 1940, ha soggiornato a lungo nelle montagne settentrionali del Paese, immedesimandosi con le antichissime tradizioni e con le consuetudini delle popolazioni del luogo, mentre dopo l'ultima guerra ha spesso frequentato gran parte delle circa ottanta comunità italo-albanesi degli Abruzzi, del Molise, della Lucania, delle Puglie, della Calabria e della Sicilia: eredi miracolosamente conservatisi delle centinaia di migliaia di profughi che, dopo la conquista dell'Albania da parte dei turchi, nel 1479, trovarono scampo in Italia, specialmente nel regno degli amici aragonesi. E per gli italo-albanesi, ma non solo per loro, il professor Koliqi pubblica a Roma la rivista *Shêjzat* (Le Pleiadi).

La caratteristica saliente di questo massiccio e denso volume, che raccoglie articoli, saggi, conferenze che coprono l'arco di una ventina d'anni, è che l'autore parte il più delle volte da impressioni, rievocazioni, ricordi occasionali, che mirabilmente intreccia, ma sempre al modo conviviale e direi cordiale, con dati precisi di storia e di critica letteraria. Il libro, pur nutrito di vasta e puntuale erudizione, risulta perciò di gradevole lettura e offre un'immagine dell'Albania, nella sua travagliata storia e nella sua spezzettata evoluzione culturale, assai vivace e colorita. Non si dimentichi che per quattro secoli e mezzo, e cioè dalle eroiche e sfortunate imprese di Giorgio Castriota, detto Skanderbeg, al 1912, quando a Valona fu proclamata l'indipendenza dell'Albania, gli schipetari, di ceppo illirico e stanziati da più di tremila anni nella regione adriatica, hanno subìto un duro e soffocante dominio turco, e in precedenza avevano conosciuto il dominio di Roma e di Bisanzio. L'ultimo periodo bizantino, che consentì la formazione di prospere signorie locali, nei secoli XIV e XV, e cioè alla vigilia dell'invasione ottomana, fu il periodo più fiorente della storia albanese, idealizzato nei canti eroici e leggendari che le masse di fuggiaschi

porteranno di lì a poco nell'ospitale Italia, conservando così per quasi mezzo millennio il ricordo e la nostalgia della patria abbandonata al di là del mare.

A queste belle rapsodie, che narrano l'epopea di Skanderbeg, le gesta degli eroi noti come « Agà di Judbina », le aspre lotte contro i confinanti slavi e greci, e il cui recitativo veniva accompagnato dal suono della *lahuta*, Koliqi, che fin dal 1937 ci aveva dato preziosi ragguagli sull'« *Epica popolare albanese* », ancora produttiva ai tempi dell'ultima guerra, dedica alcuni capitoli, veramente esemplari e utili a qualsiasi cultore di tradizioni popolari, del suo libro. Con lo stesso amore e con un senso di malcelata nostalgia egli parla anche dell'antichissimo *Kanûn di Lek Dukagjini:* il codice delle montagne albanesi, che ha regolato, con le sue aspre eppur giuste norme consuetudinarie, la vita di una società eroico-patriarcale, come quella dei monti del nord, fino alla nascita dello Stato albanese, e che ha lasciato tracce manifeste nel carattere, non certo banale o sbiadito, degli schipetari: gheghi, toschi, *arbreshë*, divisi ancora in tre confessioni religiose: musulmana, la più numerosa, ortodossa e cattolica.

Malgrado questi profondi motivi di diversità, che sono etnici, religiosi, politici — i lunghi dominii stranieri —, e malgrado i tanti influssi subiti lungo i secoli, più orientali che occidentali, salvo che nell'ultimo periodo, il popolo albanese si è mantenuto sostanzialmente unitario. Oltre che da « un profondo identico substrato illirico », « questa unità, nell'apparente mosaico di elementi disparati, fu ed è tenuta viva dall'*humus* autoctono della collettività albanese, da una identica fondamentale concezione della vita, ad un complesso di virtù e di difetti comuni e dalla cosiddetta letteratura orale del popolo, tuttora in continuo germoglio e sempre fiorente ». Si ritrova questo carattere unitario non solo fra gli albanesi dell'Albania, ma anche fra quelli che vivono nei Paesi finitimi, soprattutto nella Kosova jugoslava, e fra gli italo-albanesi, nel cui ambito ha preso l'avvio, insieme alla lotta risorgimentale, la stessa letteratura colta nazionale.

Ne è stato iniziatore, nel 1836, con la prima edizione del poema *Milosao*, uscita a Napoli, il calabrese *Girolamo De Rada* (1814-1903), che nella sua lunga vita non ha mai avuto modo di conoscere la patria d'origine dei suoi avi, e che tuttavia, insieme a *Naim Frashëri*, musulmano della setta misterica dei *Bektashi*, e al padre francescano *Giorgio Fishta*, costituisce la grande triade di poeti-vati della nazione albanese. Alla loro opera, come a quella di altri scrittori colti e in particolare alla lirica di un altro italo-albanese, il siciliano *Giuseppe Schirò*, Ernesto Koliqi consacra molte pagine, accompagnando opportunamente le notizie, i commenti e i ricordi con belle traduzioni in italiano, parte delle quali avevamo già avuto modo di leggere ed ammirare nell'*Antologia della lirica albanese*, pubblicata a Milano, nel 1963.

Raccogliendo in volume questi *Saggi di letteratura albanese*, altrimenti per la maggior parte poco accessibili, Ernesto Koliqi ha recato un buon servizio non solo alla sua patria d'origine, che porta sempre nel cuore, specie in frangenti tragici come quelli odierni, ma anche alla patria di adozione, così legata, per i motivi che il libro adduce, e non foss'altro che per le fiorenti comunità italo-albanesi, che hanno dato all'Italia, fra gli altri, *Agesilao Milano* e *Francesco Crispi*, ai fieri schipetari d'oltre Adriatico.

(« Il Giornale d'Italia », Roma, 20-II-1974)

DR. ERNEST KOLIQI

Dr. Ernest Koliqi, Albanian poet and author and professor of Albanian language and literature at the University of Rome, died Wednesday in Rome at the age of 71, according to word received here.

Dr. Koliqi was Minister of Public Education of Albania from 1939 to 1941 and president of the Institute of Albanian Studies from 1941 to 1944. He was the author of epic and lyric verse and short stories.

(« The New York Times », Friday, January 17, 1975).

Un'altra perdita della nostra cultura

LA SCOMPARSA DI ERNESTO KOLIQI

Sono giorni particolarmente dolorosi, che hanno visto scomparire più di un luminare della nostra alta cultura: oggi dobbiamo piangere — oltre alla morte di Ranuccio Bianchi Bandinelli, perdita gravissima per la scienza dell'antichità classica — anche quella di Ernesto Koliqi.

Për autoren *Nermin Falaschi-Vlora* âsht shkrue shpesh në faqet e kësaj reviste ku theksohej se në vargjet e saja gjindet nji notë e re edhe për poezín bashkëkohore në Italí.

Falaschi botoi tash së fundi edhe nji roman *La Gru coronata*, fryt i përshtypjeve nga Uganda ku zoja Nermin jetoi për do kohë me të shoqin, zotin *Renzo Falaschi*, ambasador i Italisë në këtë vend të Afrikës.

Nëpërmjet të përkthimit apo shqipërimit, krye nga prof. Fekeçi me zotnim të sigurtë i të dy gjuhëve, italisht e shqip, kjo notë karakteristike e zojës Falaschi-Vlora përçohet edhe në gjuhën amtare të poeteshës. Për nji punë kaq të mundshme dhe të kryeme mirë përgëzojmë prof. Fekeçin dhe shkrimtares Falaschi i dëshirojmë suksese tjera në këtë lamë artistik.

V.

Omar Mali, *Pesëdhetëvjetori i vdekjes s'Elez Isuf Ndreut (1925-1975)*. Numër i veçantë i *Koha e Jonë*, 1975, faqe 20.

Ngjarjet historike gjithmonë paraqesin vishtirsina për me u përshkrue, prandej cilidò ia kushton këtyne mundimin âsht për t'u përlavdue. E këtë rradhë e kemi fjalën tu *z. Omar Mali* që na paraqet me kët vepërz jetën dhe veprimtarín e Elez Isuf Ndreut, në rastin e pesëdhetëvjetorit të vdekjes. Fillon me tregue jetën e këtij Atdhetari e, pastaj, dokumenton edhe veprimtarín e zhvillueme ndër luftat e betejat e ndryshme, shpesh në bashkëpunim me patriotët e mirënjoftun si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, etj.

Vepërza lexohet me andje se âsht e shkrueme me nji gjuhë të kuptueshme e të kjartë.

Z. Omar Mali, gjithmonë, po në *Koha e Jone* ka botue edhe poemthin dramatik të *Dom Lazer Shantojes* me titull *Kuvendi i Deshmorvet* që përshkruen nji kuvend ku «Dëshmorët betohen me vijue luftën për Lirí!». Shantoja âsht nji ndër ata shkrimtarë shqiptarë, fatkeqsisht, pak i njoftun e do të kishte qenë mirë, mendojmë, me e pasë botue këtë poemth, edhe në format vepërze.

V.

«Dielli» (*The Sun*) - *Fletorja mâ e vjetër shqiptare.*

Fuqizimi i fletores mâ të vjetër shqiptare *Dielli*, organ i *Vatres* dhe përmirësimi i saj cilësor paraqesin nji ngjarje të kënaqshme në konstelacionin e shtypit shqiptar të kohëve tona. Vjetin e ardhshëm «Dielli» mbush shtatëdhetvjetorin (1909-1979). Kjo ngjarje âsht nji ndër datat mâ të shënueshme të shtypit tonë, shkak edhe për mburrje jo vetëm për editorët e «Diellit», por edhe për krejt shqiptarët e Amerikës, qofshin këta «të vjetër» apo «të rij». Në faqet e revistës *Shêjzat* le të vehet përsërí në dukje sa vijon: nji ndër kushte kryesore që ndija nacionale të mbetet gjallë në diasporën shqiptare edhe këtu e tutje âsht fjala e shkrueme në gjuhën shqipe: pra, shtypi ynë. Për mbajtjen gjallë të kësaj flake — nëse eksiston nji shtytje e tillë ndër ne — nuk âsht barrë e detyrë e nji kategorie njerëzish, por e të gjithë shqiptarëve jashtë, qofshin ata në Amerikën Veriore apo në Zelandën e Ré. Si njerí me përvojë të madhe në këtë lamë veprimi këtë e ka vû shpesh herë në dukje edhe i ndiemi Ernest Koliqi.

P.

Nijazi Sulçoglu, *Rënkimet e burgut*. Vjersha. Ankara 1977. Faqe 64.

Autori âsht nji i rí kosovar, por në të vërtetë nji ndër shkrimtarët mâ produktivë që shkruejnë jashta bashkësive shqiptare ndër dhena të ndryshme. Sulçoglu ka qitë në dritë këto vepra: *Kitarra e të merguemit* (vjersha) në vjetin 1969; *Antologjija bashkohore e poezis turke* (1970); dhe prap nji përkthim tjetër: *Neper Shqiperi e Kosove; Nga mergimi ne Kosove* (1975); *Kthimi në vendlindje* (1976).

Vepra e fundit gjithnji në vargje ka bâ kohët e fundit mjaft bujë ndër lexuesit shqiptarë. Kjo përshkruen nji ngjarje të përjetueme nga autori. Sulçoglu arrestohet (shih *Introdukte*) në nji udhtim «transit» nepër Jugosllaví dhe mbahet në burg 255 dit!

Si në të tjerat vepra edhe këtu Sulçoglu shfren dalldishëm dashunín për popullin e vet e Kosovën. Autori lexohet me andje dhe len tek të gjithë përshtypjen e njeriut të shumvuejtun dhe të kërkesës, si mbas mendimit tonë ligjitim, të jetojë i lirë mes njerzvet të vet. Bien në sy edhe shqetsimi i vazhdueshëm, notë e thellë njerzore e burimi poetik.

P.

Idriz Lamaj, *Marrëdhëniet partiake shtetërore Shqipëri-Jugosllaví*, Nënfletë e «*Shqiptarit të Lirë*», New York, 1977, faqe 20.

Për këtë të rí të Kosovës e për veprën e parë *Rruge te mergimit*, pat shkrue gjatë i ndiemi prof. Koliqi (shif *Shêjzat*, XVII, 1973, nr. 9-12, faqe 395-397). Sot paraqitet me nji studim mbi *Marredheniet partiake shtetenore Shqiperi-Jugosllavi* e fillon me përmbledhjen anglisht; pastaj pjesa e tjetër âsht në gjuhën shqipe. Âsht nji studim, me të vërtetë, shum interesant e që duhesh bâ. Botohen dokumenta të Tiranës me Belgradin e studiohen të 24 volumet që deri më sot, «shoku» Enver ka botue për të tregue — thotë ai — «patriotizmin», kurse faktet tregojnë se janë «12.000 faqe falsikim historije». Mjafton me lexue «thëniet e Enverit për Tito-n» për t'u bindun se ka plotsisht të drejtë Idriz Lamaj e se «shoku» Enver ka kërkue me «e mbyllun djellin me shosh» por rrêna, lum «shoku» Enver, «i ka kambët e shkurtna!»

Të lumtë Idriz, e, edhe nji herë, siç shkruente Koliqi «urojmë qi ky letrar i rí t'a vazhdojë për s'mbari ecjen në shoqní të Zânës... Zoti e premtoftë!»

P.

Tahir Kolgjini, *Esat Pashë Toptani dhe akuzat qi bahen.* Istanbul 1977. Faqe 240.

Shpesh herë ngjarjet historike nuk janë të lehta për t'u zgjidhë mbrenda nji kohe të caktueme e të kufizueme. E vërteta mundet me dalë në dritë edhe mbas dhjeta e qinda vjetësh. Ai që don me ndreqë nji botëkuptim të afirmuem mbi nji kohë apo vetje, kërkon andej e këndej dokumenta me ndriçue lexuesin dhe për me pasë kënaqësín se i ka dhanë nji kontribut historís. Këtë ka ndërmmarrë edhe bashkëpuntori i ynë i vlefshëm *Tahir Kolgjini* me botimin e veprës në fjalë. Autori bien dokumenta e shpjegime tue dashtë me përcaktue çashtjen nëse Esad Pashë Toptani «ka qenë apo jo trathtar».

Nuk jemi kompetenta të materjes, prandej nuk jemi në gjendje me shprehë nji mendim të kjartë e urojmë që kjo të bâhet nga ana e historjanvet. Na gëzohemi që Tahiri, si përhera, e mori guximin dhe e shprehu lirisht mendimin e tij e për këte meriton çdo lëvdatë.

Gjuha e Autorit të *Shpalime rreth Lahutes, Te vërtetat shqiptare-greke* (turqisht) e të tjera veprave, âsht e kuptueshme nga të gjithë e ndër shkrimet e tija gjindet nji pasuní shprehjesh popullore e fjalësh të panjoftuna.

Tahir Kolgjinit i urojmë jetë të gjatë e presim përsërí vepra të tjera të çmueshme në dobí të çashtjes kombtare.

P.

Koha e Jonë. *E përkohëshme Politike - Kulturore - Shoqnore. Nr. 10-11-12. Vjeti XVI, tetuer-dhetuer 1977. - Në* Opinioni Ynë *Petrit Qerreti prek në këtë numër temën e komunikimit (tejtimit) mes shqiptarëve me anën e shtypit dhe mjeteve tjera përçuese të mendimit. Shfaqen edhe qëllimet të cilat prej vetje në vetje — si zadhanës apo shkrimtar dhe prannues apo lexues — mund të ndërrojnë në ndoj pikë Kjo e përkohshme dallohet, sadopak edhe për daljen pa u ndërpre për gjashtëmbëdhetë vjet me radhë, për plotësimin e detyrës dhe qëllimit që ajo i ka vu vetes në lamën e komunikimit, sidomos për rrahjen e atyne temave që interesojnë botën shqiptare.*

Koha e Jonë *si dhe të gjitha publikimet e diasporës do të mbesin si dokument për ata të breznive të ardhshme që donë të dijnë se çka iau vriste menden e zemrën shqiptarëve në këtë periudhë. Edhe ky asht nji komunikim tepër me randësi.*

Botuesve z. Isa E. Ndreu *e të palodhshmit* Lec Shllaku *ju urojmë punë të mbarë dhe vazhdimësi.*

P.

Rita Tocci. *Terenzio Tocci mio Padre* (Ricordi e pensieri). Mezzo secolo di vita balcanica (*Albania 1911-1945*), Arti Grafiche Joniche, Corigliano Calabro (CS), 1977, pp. 185 con alcuni clichés. L. 4.000.

Para pak kohe asht vu në qarkullim vëllimi i sipërshenjuem shkrue, italisht, nga zoja *Rita Tocci*, e bija e *Terenc Toçit*.

Vëllimi asht i ndamun në XXXIV kapituj. Ndër të parët gjindet jetëshkrimi i Terenc Toçit dhe studimet e veprimtarija djaloshare.

Terenc Toçi lindi në San Cosmo Albanese (Cosenza) me 9 mars 1880. Mësimet e para i kreu në Kolegjin italo-shqiptar të Shën Dhimitër Korones. Qysh në moshën ma të ré filloi me i u kushtue çashtjes shqiptare. Për këte u largue nga vendlindja e shkoi n'Urbino ku kreu edhe studimet universitare duke u doktorue në Drejtësí.

Këtu zoja Rita na ep dokumentimin e vepravet të shkrueme nga Baba. Me 1901 boton librezën *La questione albanese;* vijon pastaj me shkrue artikuj ndër shum fletore e mban fjalime gjithmonë për të mprojtun qenëjen e nji Shqipnije si *komb* që u dallonte nga vendet e tjerë fqinjë për gjuhë, tradita e kostume. Bashkëpunoi me fletoren italo-shqiptare *La Nazione Albanese* t'Anselmo Lorecchio-s e me *Gazzetta Albanese* derisa me 1912, sëbashkut me F. Argondizza, botoi, në Romë, *Rivista dei Balcani.* Me 1913 vjen në Shkodër e përnjiherit boton fletoren *Taraboshi* deri me 1 príll 1914 e pastaj, përsëri, me 1921 për disa muej të tjerë.

Gjithashtu ka botue, ndër të tjerat, edhe *Shpresa e Shqypnís* (1908), *L'Albania e gli Albanesi* (1911), *Krimet e politikës* (1922), *E drejta ndeshkimore* (1926) e *Fashizmi* (1928). Për këtë veprën e fundit, Rita Tocci shenjon recensimin e bam nga *Lumo Skendo* (Mid-hat Frashëri) në revistën e vet *Diturija* (Korrik-Shtator 1928, faqe 352) e ku thotë: «Shkrimet që përkthen Terene Toçi janë fjalët e Mussolini-t, me të cilat u dëfton Italjanvet udhën që duhet të ndjekin për nderin, zhvillimin e fuqinë e atdheut të tyre.

Këndonjësi shqipëtar po të lexojë *shqipëtar* atje ku thuhet *italjan* e *Shqipëri* ku thuhet *Itali*, ky libër mund të mbahet për cilindo prej nesh si një udhëheqës që meriton të ndiqet e t'i vihet veshi».

Zoja Tocci vazhdon, pastaj, ndër kapitujt e tjerë me vu në dukje edhe detyrat e nalta që ka patun i Ati: Deputet, Prefekt i Shkodrës, Konsull e, shpesh herë, edhe Ministër i Ekonomis dhe Sekretar i Përgjithshëm i Republikës Shqiptare në kohën e Zogut, etj. Nuk mungon veç me përshkrue edhe veprimtarin që Terenc Toçi ka zhvillue në favor të çashtjes kombtare derisa mbërrin në ditën e mjerueshme të 17 nandorit 1944 kur i Ati arrestohet nga komunistat që e akuzojnë si *kriminel lufte!*

Këto kapituj janë ma të përmallueshmit, sidomos leximi i letravet që i Ati i shkruente familjarvet nga burgu e ku kjartas shifet e tregohet karakteri i Tij i fortë e besimi se kishte punue përhera me ndërgjegje të pastër e për të mirën e Vendit. Dënohet me vdekje e n'orën 19 të datës 14 príll 1945 pushkatohet sëbashkut me 16 patriot të tjerë Shqiptarë «të dënuem vetëm pse kishin dashunue Shqipnin jo komuniste».

Libri paraqitet mirë e meriton me u lexue, sidomos nga ata që përpiqen me shkrue historin e vërtetë me dokumenta, paanësisht e me tregue të drejtën e ngjarjevet. Terenc Toçi punoi për Atdheun e të Parvet, shkrîu jetën, prandej duhet që edhe kujtimi i Tij të mbetet i paharrueshëm.

P.

Frangjisk Andon Santori, *Brisandi Lleticja e Ulladheni,* Romanci i tretë. Trascrizione del testo originale inedito, varianti della prima redazione, introduzione e glossario a cura di *Ital Konstant Fortino,* Stabilimento Tipografico Editoriale «C. Biondi», Cosenza 1977, pp. 227, L. 5.000.

Nel mese di maggio 1977 è stata pubblicata a Cosenza — Stabilimento Tipografico Editoriale C. Biondi — un'opera albanese di *Frangjisk Andon Santori* (1819-1894), finora inedita e giacente nella Biblioteca Civica di Cosenza.

Si tratta del III Romanzetto in versi dal titolo *Brisandi, Lleticja e Ulladheni,* che descrive una vicenda del secolo scorso di oppressione e sfruttamento dei poveri da parte di signorotti e feudatari locali. L'autore segna il passaggio dal romanticismo al realismo nella letteratura *arbreshe.*

Il manoscritto trovato alla Civica di Cosenza contiene sei romanzetti. Quello scelto per la stampa, il terzo, è compreso nelle pp. 111-164, in ff. 31/20,5, in due colonne: testo albanese e traduzione italiana a fronte, in alfabeto proprio all'autore.

L'edizione critica è stata curata dal prof. *Ital Konstant Fortino,* del Dipartimento di linguistica dell'Università delle Calabrie.

Viene presentato il testo originale trascritto nell'alfabeto moderno, le varianti della prima redazione — il romanzetto ha subito due redazioni —, e una ampia presentazione storica e letteraria tanto dell'autore quanto della sua opera. Particolare importanza hanno le osservazioni linguistiche e il rilevamento della struttura della lingua usata dal Santori e del suo lessico. La lingua parlata e scritta degli albanesi d'Italia, data la situazione di branca staccata dalla madrepatria e con uno sviluppo autonomo di cinque secoli, presenta particolarità interessanti per la stessa lingua di Albania, tanto a livello strutturale quanto semplicemente lessicale.

A fronte del testo albanese del romanzetto si pubblica anche la traduzione italiana che era stata fatta dallo stesso autore e si trova nello stesso manoscritto.

Una caratteristica di questa edizione critica, oltre a riportare alla luce un'opera inedita che collocherà meglio l'autore nel quadro della letteratura albanese, è costituita dal fatto che l'intero apparato critico è redatto in lingua albanese. Lo stesso glossario che conclude la pubblicazione è composto dai termini della parlata degli albanesi d'Italia, contenuti nell'opera, tradotti nell'albanese comune odierno. È la prima volta che ciò avviene in Italia.

In genere le opere albanesi vengono presentate in italiano al lettore italiano. La presente pubblicazione si rivolge quindi direttamente agli albanesi e ai cultori della lingua albanese. Essa è indicativa del movimento di risveglio culturale in Calabria che vede nell'uso della lingua albanese, non limitatamente alla conversazione familiare, ma esteso anche negli scritti e negli scritti di carattere scientifico, il vero strumento della salvaguardia del proprio patrimonio culturale nonché della stessa propria sopravvivenza come minoranza etnico-culturale. La lingua usata dal curatore è quella letteraria comune albanese.

La presente pubblicazione quindi oltre al suo valore scientifico quale contributo agli studi albanologici in Italia, ha anche un chiaro significato politico in favore della vita delle Comunità albanesi in Italia.

E.

Shkrimi Shêjt - Katër Ungjijt dhe Punët e Apostujvet - Përkthye shqip prej teksteve origjinale nga *Msgr. Dr. Joseph J. Oroshi.* Romë-New York 1978.

Botimi përmban nji *Hymje* të Msgr. Oroshit, *Paraqitjen* e At prof. Valentinit i cili njikohësisht asht edhe «Censor Deputatus», dhe ngjit mbas *Parathanjen* e Përkthyesit. Kemi përduersh, pra, për të parën herë në botim katolik librat e *Dhiatës së Ré* të plotë në gjuhën shqipe: *Ungjillin* si mbas *Matheut, Markut, Lukes e Gjonit,* si edhe *Punët e Apostujvet.* Në fund vjen *Bibliografija* e përdorun prej Përkthyesit si edhe ajo e papërdorun nga e cila shihet filli i pandamë i traditës së përkthimit të Shkrimit Shejtë ndër shqiptarë. Së fundi gjindet nji *Fjalorth* i skajeve jo fort të njoftuna prej lexuesvet.

Çdo përkthim i këtij lloji shënon — pamëvarsisht nga besojmat — nji ngjarje kulturore. Prej kohësh, tue fillue nga Noli, rolin kryesor në këtë mes e kanë marrë dhe e marrin klerikët shqiptarë në Shtetet e Bashkueme të Amerikës.[1] Tipar i përgjithshëm i këtyne përkthimeve asht kujdesi dhe lavrimi i vetëdishëm i gjuhës shqipe. Asnji — tue mos përjashtue as Nolin që mbështetet mjaft në Kristoforidhin — nuk asht përpjekë të jetë novator në pikëpamje gjuhësore. Këtij parimi i mbahet edhe Msgr. Oroshi: ky ndjek me zell e akribi mjeshtrin e vet, Dom Ndre Mjedjen të cilit i ka kushtue edhe veprën. Ndre Mjedja asht njohësi ma i mirë i traditës letrare veriore të kësaj lande; filli kapet te Buzuku i cili nga ana tjetër edhe ky

[1] Ban përjashtim *Meshari i të Kremtëve,* përkthye dhe zhvillue prej *At Danjel Gjeçaj o.f.m.,* Romë 1966.

ndjek nji traditë ma të vjetër. Duhet vu qartë në dukje se Përkthyesi, Msgr. Oroshi, po i përmbahet rregullave e formave të Mjedjes, por bie njikohësisht edhe risime tue anue me qëllim kah zhvillimi i mavonshëm i variantes liturgjike gege. Pranon atykëtu edhe trajta leksikale të traditës jugore kështu që përkthimi ka dalë i kuptueshëm për të gjithë shqiptarët që kanë sadopak dijeni pasive të fjalorit themelor të shqipes. Dhe s'mund të jetë ndryshe sepse çdo përkthyes i materies fetare e ka këtë pikësynim.

Gjuhëtarët tanë i ka kapë vala e njejsimit të gjuhës shqipe dhe me dashje apo padashje ndjekin hullinë e tyne pjesa ma e madhe e shkrimtarëve. Këtë proces po e ndjekin edhe studjuesit e huej, lingvistët kryesisht, sepse standardizimi i nji gjuhe sot asht degë e posaçme e kësaj dije. Gjuhëtarëve që merren me këtë punë dhe mbahen si ligjabamës në këtë lamí u vëhet shpesh faji se janë të papërkulshëm. Harrohet edhe sa vijon prej anës së kritikuesvet: maparë e ma dalë këta dijetarë e dinë zanatin e vet, dmth në përgjithësi e njohin strukturën e gjuhës shqipe tue u nisë prej autorëvet të vjetër. Por nëse këta vënë kambë e thonë se standardizimi i gjuhës shqipe fillon tek ata, kurrkush nuk jau zen besë. Gjuhëtarët e sodit mund të mburren se kanë përpunue shumë pjesë të gramatikës e se kanë dhanë nji ndihmesë të madhe për njejsimin e gjuhës. Edhe tërthorazi u janë imponue shkrimtarëve e përkthyesve të cilët, të gjithë, pa përjashtim, p.sh., zgjedhin ato variante të caktueme prej tyne, të përgjithsueme në shtypin e përditshëm. Kjo tendencë diktohet edhe në përkthimin e Msgr. Oroshit i cili nuk i largohet aspak strukturës së traditës katolike të Veriut. Këto risime apo inovacione shumë të matuna nuk stojnë si ngjan tek disa tjerë përkthyes. Gjuha shqipe e Oroshit që mbështet në nji variante gjuhësore të përpunueme me shekuj shijohet prej çdo shqiptari nëse ai niset pa paragjykime. Kam përshtypjen (e kjo s'ka për t'u pëlqye gjuhëtarëve standardizues!) se pëlqehen ma së forti prej lexuesvet ata shkrimtarë të cilët shkruen dhe shkruejnë tue u mbështetë në nji traditë të gjatë, si Noli, Konica e tash së fundi Kadaré (në tosknishte) dhe Fishta, Mjedja e Koliqi (në gegënishte). Shumkush asht sot i këtij mendimi: në flakën e normalizimit tepër të zellshëm po zhduken apo mënjanohen disa cilësi të randësishme, si koloriti gjuhësor i shprehun edhe nëpërmjet të thanjeve idiomatike, muzikaliteti, shkaktue prej ndrydhjes e lanjes mbasdore të shumë tingujve e kombinimit të tyne si dhe të përmasave semantike (kuptimore).

Msgr. Oroshin e përgëzojmë për këtë punë kaq të mundshme dhe të dalun gjuhësisht mirë. Bie në sy edhe botimi tejet i kujdesshëm tipografikisht.

MARTIN CAMAJ

Në përkujtim të Dr. Nos Qirjakut

Dr. medicine *Nos Qirjaku*, lindë në Elbasan më 13 kallnor 1925, vdiq nga nji sëmundje e randë më 3 korrik 1976 në Demonte, qytetëz malore e provincës së Kuneo (Italí) ku punonte si mjek zyrtar i kësaj komune. Me vend e të drejtë po e përkujtojmë Nosin në faqet e kësaj reviste në të cilën Ai shkroi disa artikuj dhe e përkrahu gjithësesi, tue derdhë mund e kohë në pregatitjen e shtypit të saj e mâ vonë edhe si pajtimtar ndihmues me të holla. Dhe jo vetëm për këtë sjellim në kujtesën e zemrës Nos Qirjakun, mikun shumë të dashun tonin

dhe besoj i të gjithë shqiptarëve që e njoftën si dhe të huejve që patën rastin të punojnë e të shoqnohen me të Ndiemin.

Nosi u largue heret nga familja dhe erdhi në Italí për të ndjekë mësimet bashkë me trí motra. Si student pësoi edhe i Ndiemi vorfninë e mbasluftës. Në Romë u njoft me shumë shqiptarë dhe nuk u nda kurr nesh për t'u njisue me vendësit, gjâ që do të kishte sjellë lehtësí në përballimin e vështirësive të jetës, meqenëse Nosi u rrit e u burrnue në Italí.

Më mbetet në kujtesë të dhanunit e të Ndiemit mbas librit shqip e vullneti i fortë për ta thellue sa ma tepër njohjen e gjuhës e të letërsisë shqipe: Nosi fliste nji gjuhë shqipe, tosknishte të ambël, dhe shkruente si ta kish sosë edhe shkollën e mesme në gjuhën shqipe. Ai më rrëfeu njiherë se kishte jetue me vjet në ankth e frikë se, tue jetue me mote i shkëputun nga rrethi shqiptar, po harron edhe gjuhën e etënve.

Dr. Nos Qirjaku qe besimtar i bindun dhe meqenëse besimin e ushtronte intensivisht bamirësishëm, nuk i praponte as nuk i tëhuejeshin ata të cilët nuk ishin i mendimit të tij. Me nji idealizëm të tillë përballoi edhe zejen e mjekut, tue i lanë ndér emnit të shqiptarit edhe në atë kand të dheut të Piemontit ku vdiq.

Kur ndahet prej të gjallëve nji njerí kaq zemër-mirë si Nosi, jo vetëm familja në atdhé e Italí, posaçe e shoqja *Leonilde* dhe vajza *Cristina*, por të gjithë miqtë e Nosit jetojnë pajandá me ndjenjen e nji humbje.

M. Camaj

P. Dr. Paulin Margjokaj ndrroi jetë

Mbas nji sëmundje të shkurtën, ndrroi jetë në Vjenë, *P. dr. Paulin Margjokaj*. Studimet e para i kreu në Shqipní ku u dallue për prirjen kah ata teologjike, të cilat i kreu n'Antonianum të Romës. Por nuk u ndalë me kaq. Vijoi studimet universitare e u doktorue në Degën e Historís.

Si krejt Fretnit shqiptarë, edhe P. Margjokaj nuk iu shmangë kurr detyrave që iu ngarkuen, por përkundrazi i përballoi përhera me krejt fuqít e veta dhe me shum kujdes. Në Shkodër, përveç mësimeve që ipte në Liceun e Françeskajve, bashkëpunoi edhe në rivistën *Hylli i Drites* e pastaj mësoi edhe në Bolzano (Italí).

Nga Italija u trasferue në Vjenë aty kah vjeti 1950. Përsëri filloi kërkimet e dokumentavet që mund të kishin vleftë për historín e Shqipnís. Pa tjetër do të ketë lanë ndonji dorëshkrim tue qenë se nuk muejti, fatkeqsisht, me botue asnji vepër. Edhe në *Shêjzat* ka shkrue studime historike t'interesantshme.

Ishte i gatshëm me u ardhë në ndihmë emigrantavet shqiptarë që kalojshin kah Austrija o u ndalshin për pak kohë për të bâ praktikat e nevojshme për emigrim. U siellte, andej e këndej, ndër zyrat përkatse për t'ua lehtësue bashkatdhetarvet çashtjen e mërgimit.

Me zhdukjen e *P. Margjokaj*, jo vetëm Fretnit, por mbarë mërgata pëson nji humbje të randë. Familjarvet e far'e fisit kudo që ndodhen, u paraqesim përdhimbtimet mâ të ndieshmet.

V.

Vdiq Kapiten Xhevdet Skënderaj

Vdiq në Romë, me 6 maj 1976, *Kapiten Xhevdet Skenderaj*. Vuente nga nji sëmundje e pashërueshme që Ai përballoi me guxim deri në çastin e fundit.

Xhevdeti lindi në Mallakastër me 21 mars 1917. Studimet e para i kreu në vendlindje. N'Italí e, pikrisht, n'Akademín Ushtarake të Modena-s, vijoi studimet e nalta. Doli nga Akademija me gradën «Nëntoger» e pastaj, dalë nga dalë, me zotsín që e dallonte, mbrrijti në gradën «Kapiten» e me këte gradë mori pjesë në Luftën e Dytë Botnore.

Ishte i dashtun nga të gjithë. Lexonte veprat klasike të hueja e shqipe. *Komedin Hyjnore* e njifte mâ së mirit, po ashtu edhe shum poet shqiptar, ndër të cilët Fishtën, Naimin e Koliqin.

Zojës *Laura* e krejt far'e fisit në Shqipní i paraqesim ngushullimet mâ të gjalla.

P.

Vdekja e Gjok Dragushës

Nga nji dorë mizore, me 21 korrik 1976, në New York, tragjikisht u zhdukë miku e përkrahsi i ynë, *Gjok Dragusha*.

Njerí i thjeshtë, puntor i palodhshëm, i dashtun nga të gjithë, Gjoka muejti me krijue nji farë pozite me shum sakrifica. Shtëpija e Tij ishte gjithmonë e hapun e nuk kursehesh sa herë që ftohesh me dhanë ndonji kontribut për çashtjet e dobishme.

Në vorrimin e Gjokës morën pjesë nji shumicë e madhe Shqiptarësh banuesa në New York e arkivoli ishte rrethuem me shum kunora.

Zojës *Geraldine* e dy Vajzavet, si edhe vllaut *Nikoll*, i dërgojmë ngushullimet mâ të ndieshmet.

V.

Zhdukja e Sabri Domit

Lajmi i zhdukjes së këtij mikut të dashtun, na ka tronditun për së tepërmi. Sabri Domi ishte dashamír e përkrahës i *Shêjzavet* e i lëvizjeve kulturore.

Sabriu lindi n'Ujmisht (Bicaj) me 22 príll 1917. Mbassi bâni studimet e para n'Atdhé, pastaj shkoi në Firenze. Dallohesh për sjelljet burrnore dhe patriotike. Të gjithë e çmojshin e kjo u pá në vorrimin që iu bâ me 20 shtatuer 1976 në Belle River (Kanada) ku morën pjesë nji numër i madh miqsh e dashamirësh dhe të njoftunish. Të shumtat ishin edhe tubat e lulevet dhe kunorat.

Të Vejës, Fëmijvet, vllaut *Islam* u paraqesim ngushullimet t'ona mâ të dhimbëshme.

Zoja Lucia Shkreli ndrroi jetë

Me 1 dhetuer 1976, ndorri jetë, në Romë, zoja *Lucia Shkreli del Monaco*, bashkëshorte e dashamirit t'onë të dashtun, *Lin Shkreli*.

Ceremonija e vorrimit u zhvillue me 3 dhetuer. Muerën pjesë gadi krejt kolonija shqiptare e Romës e nji shumicë e madhe miqsh e dashamirësh të Familjes del Monaco. Gjithashtu i shenjueshëm ka qenë edhe numri i kunoravet e i tubavet të lulevet që rrethojshin arkivolin.

Mikut *Lin* i paraqesim, vllaznisht, ngushullimet t'ona mâ të thella.

P.

Halim Begeja (1916-1977)



Dr. Halim Begeja

Mbas nji sëmundjeje të gjatë e të dhimbshme me guxim, me vullnet të papërkulshëm por sidomos me nji shpresë të madhe, i mirënjohuni patriot *dr. Halim Begeja*, me banim në New York që më 1950, vdiq me 17 janar 1977, tue lanë mbas zonjën fisnike *Sulltana* lindun *Çakërri*, dy djelmët, *Aliun* dhe *Gjergjin*, vëllan *Jusuf* që banon në Francë, katër vëllazën e nji varg të gjatë kushrijsh sa në Amerikë e në Evropë e në Shqipní, e nji grumbull të gjanë miqësh e shokësh.

I shkreti Halim hyni në historinë mjeksore shqiptare: Ai qe i pari shqiptar, me sa dijmë, që i u ba nji transplant veshke, që i u dha vullnetarisht nga i vëllai Jusufi dhe që i a zgjati jetën për disa vjetë.

Halimi vjen nga nji familje e njohun tiranase, prej *Begejve* të Mbëdhej, i biri i *Ali Begejes*, advokat i njohun e patriot tiranas. Mësimet e patriotizmit Halimi i mori në shtëpí nga familjarët e tij. Ai mbaroi shkollën fillore në Tiranë dhe shkollën e mesme, liceun, në Shkodër më 1938. U regjistrue menjiherë në Universitetin e Parisit, në Sorbonne, në degën e Drejtësís. Për arsyena të luftës së dytë botnore, mbas dy vjetëve i u desht të mbaroi Drejtësinë në Universitetin e Sienës, Itali, tue marrë titullin e advokatit. Ushtrimi i advokaturës qe i shkurtë për Halim Begejen.

Ai merret me çeshtje kombëtare të kohës dhe merrë pjesë aktive në kristalizimin e *Ballit Kombëtar*, tue kapë pushkën kundër të huejit të ardhun përtej Adriatikut. Qe edhe kryetar çetash e kryetar i Batalionit *Besnik Çano* që luftoi edhe në tokat e lira të Kosovës me qeleshe të bardha që mbajshin emblemen e flamurit me shqiponjë, tue u përleshë me anmiqët e huejë e të vendit.

Edhe këtij patrioti i u desht të kapi udhët e mërgimit: kaloi në kambë nepër krejt Jugosllavín, me pushkë në dorë, deri sa erdhi në Italí, ku u bashkue me shokët e tij. Në fillim u muer edhe me sport, se sportist i njohun qe Halim Begeja që në kohën e studimeve të shkollës së mesme me *Sport Klubin* e Tiranës, dhe në kampet e aleatve formoi skuadra futballi e luejti me profugët e tjerë e disa herë edhe me skuadra t'Italís, shpesh tue fitue. Ishte mësues i mirë, trainer i zoti e mbi të gjitha ishte shok i mirë.

Në Kampet e Italís ndodhi mosmarrëveshtja në mes të disa leaderve të *Ballit Kombëtar*. Halim Begeja mbështeti Ali Këlcyrën, Koço Mukën, Nuredin Vlorën, Kadri Cakranin, Hysni Jenisherin, etj. Ai u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i kësaj pjese të *Ballit*.

Në vjetët e para të 1950 emigroi në Shtetet e Bashkueme dhe qe edhe sekretar i Komitetit Kombëtar *Shqipëria e Lirë* që u krijue nga Mit-hat Frashëri, dhe mbas vdekjes së tij më 1949, u kryesue nga adv. Hasan Dosti deri më 1956. Halimi merrë pjesë në shumë mbledhje ndërkombëtare të përkrahuna nga politika e Amerikës në atë kohë.

Halim Begeja asht autor i shumë studimeve politike të botueme fatkeqësisht në forma broshurash të poligrafueme. Ai qe orator i fuqishëm. Qe shqiptar i mirë, i sinqertë dhe i vendosun.

Bashkëpunoi me të gjithë mërgimin shqiptar, e bashkëpunoi me cilindo që kishte si program *Shqipnin e Lirë, Demokratike* dhe me cilindo leader që besonte

në zgjedhje demokratike: *I shtrohemi vullnetit të popullit në Shqipni*, thonte Halimi. *Na në mërgim jemi nji pjesë e vogël. Vullnetit të popullit sovran shqiptar, të lirë duhet t'i shtrohemi për formën e rregjimit per trajtën e qeverisë dhe për mënyr'n e zgjedhjeve.*

Vorrimi i *dr. Halim Begejes* u ba me nderime të mbëdha në New York, në Queens, mëhallën e qytetit të New York-ut ku Halimi bashkë me familje banonte. Merrshin pjesë nji shumicë e madhe shqiptarësh të ardhun nga rrethet e New York-ut, të shteteve fqinjë e bile edhe nga vende të largëta. Në Shtëpín Mortuore (*Funeral Home*) ishin vue shumë kunora lulesh të dërgueme nga personalitetet shqiptare në mërgim, nga miqët e familjes, e nga shokët e tij.

Fjalën kryesore e mbajti *Adv. Hasan Dosti*, që kishte ardhë apostafat ata ditë, dhe tregoi heroizmën e Halim Begejes dhe vetmohimin e tij në fushë të betejes kundra anmiqëve. Mandej foli *dr. Rexhep Krasniqi*, Kryetar i Komitetit *Shqipëria e Lirë*, z. *Hodo Metaj*, dhe përfaqësues të partive politike në mërgim. Si shok e mik i Halim Begejes e i familjes foli *dr. Hamdi Oruçi*.

Ceremonia fetare u ba nga *Imam Isa Hoxha* i New York-ut, por banë lutje, në spiritë ekumenike edhe *Monsinjor Zef Oroshi* i Kishës Katholike dhe *Rev. Costa* i Kishës Orthodokse shqiptare.

Dr. Halim Begeja lenë, me të vërtetë, nji zbrastí të pazavendësueshme në gjinin e familjes së Tij fisnike dhe në gjinin e bashkësisë shqiptare.

Na të revistës *Shêjzat* përkulim kryet me nderim përpara këtij patrioti të ndershëm, dhe marrim pjesë në dhimbjen e *Familjes Begeja* duke u paraqitun përdhimtimet tona ma të ndieshme.

HHO

Zí në Familjen e Kap. Ndue Gjomarkaj

Me 14 maj 1977, në New York, e rrethueme nga Bashkëshorti e nga Fëmijt që e adhurojshin, mbas nji sëmundje të shkurtën, ndrroi jetë *Maria Teresa Gjomarkaj*.

Posa u përhap kumti i zí, përnjiherit miq e dashamirë të Kap. Ndue Gjomarkaj e të Familjes së tij, vrapuen për me iu gjetun pranë.

Maria Teresa nuk kishte vetëm se 45 vjeç: ishte e ré e në moshën mâ të bukur. Lindi në Romë, ku kreu studimet e para e ata universitaret.

Edhe përpara martesës, Ajo përhera i priti Shqiptarët me përzêmërsí të veçantë. E konsideronte vehten krejt «shqiptare» e mburresh për këtê. Pat mësue për bukurí gjuhën shqipe. Interesohesh për çashtjet t'ona e ndiqte me dashuní çdo veprimtarí. Kujdesesh për rritjen e fëmijvet e ishte e lumtun duke shikue përparimin që ata bâjshin: *Cristina, Bianca, Alessandra* e, veçanërisht, *Gjoni* i vogël ishin gëzimi i Maria Terezës dhe i Ndues.

Mbas emigrimit në Shtetet e Bashkueme, prap nuk u kursye për asgjâ. Bujare, e sjellshme, mikpritse: plotsisht si ka qenë gjithmonë Shtëpija Gjomarkaj. Ndjekte zakonet shqiptare e kishte dishír me i njoftun sa mâ mirë.

Tashti, pak nga pak, po fillonte me gëzue sakrificat e bâmuna me Bashkëshortin, por qe, se sëmundja mizore e rrëmbeu, pa mëshirë, nga gjini i Familjarvet e i krejt atyne që e admirojshin. Gjatë sëmundjes, nuk u kujdesue kaq për vehte, sa për Burr e Fëmij: ky mendim e ndoqi deri në minutin e fundit.

Vorrimi u bâ në New York e meshën e çuen, anglisht, *Át Cogo* dhe, shqip, *Dom Rrok Mirdita*. Përveç Shqiptarve të New York-ut, kishin ardhë me i dhanë përshëndetjen e fundit edhe miq e dashamir nga vende të ndryshëm.

Të gjithë na, thellësisht të prekun nga kjo humbje, vllaznisht i paraqesim mikut të dashtun, *Kap. Ndue Gjomarkaj*, *Fëmijvet*, *Familjarvet* e mbarë far'e fisit kudo që ndodhen, ndjenjat mâ të gjalla të përdhimbtimit t'onë tue lutë Perendín që t'u fali forcë e durim.

P.

Vasil D. Alarupi (1908-1977)

Me 6 gusht, mbas nji sëmundjeje të shkurtë, vdiq në Boston, n'Amerikë, novelisti i mirënjohun shqiptar *Vasil D. Alarupi*, tue lanë mbas zonjën e Tij të dashun *Almerinen*, e cila megjithse e lindun franceze ka zemër shqiptare, dhe nji vajzë, *Yolanden* e nji djalë *Johnin*, të dy të martuem, dhe nipa e mbesa dhe nji varg kushrijshë në rrethet e Boston-it e në mërgim dhe në vendlindje, në Shqipní.

Vorrimi u zhvillue në Kishën Shqiptare Orthodokse dhe Mesha u çue nga *Át Arthur Liolin*, Kancellar i Peshkopatës Orthodokse Shqiptare, me nji pjesëmarrje të gjanë të kolonisë shqiptare dhe nga shumë miqë të Tij e të familjes të ardhun nga New York-u, New Jersey e Connecticut e deri edhe nga Florida. Ishin vue shumë kunora lulesh për shenjë nderimi.

Në Shtëpín Mortuore (*Funeral Home*) i Përndershmi *Át Liolin* mbajti nji fjalim të prekshëm për autorin shqiptar tue kallzue në vija të përgjithëshme jetën e veprat e Vasil Alarupit.

Mbas vorrimit *Familja Alarupi* shtroi nji darkë përkujtimore në Restaurantin e njohun *Pier Four* të Anthony Athanasit. Aty, mbas darkës përshpirtnore foli shoku i vogjëlisë dhe moshatari i Tij, *ing. Vasil Germenji*, antar'i Komitetit *Shqiperia e Lirë* dhe përfaqësues i *A.C.E.N.*-it tue paraqitë kujtime personale e familjare dhe tue i parashtrue ngushllimet Familjes Alarupi që humbi burrin dhe baban, por edhe ai humbi nji shok, nji mik dhe mërgata shqiptare nji nacjonalist të dedikuem, dhe letërsia shqiptare nji novelist të shquem. Miku i shtëpisë *dr. Ligor Buzi* foli edhe ai për kujtime personale e familjare dhe paraqiti gjinden e shumët që kishin ardhë për këtë darkë përkujtimore.

Vasil Alarupi lindi në Korçë më 1908 ku mbassi mbaroi shkollën fillore e Lyceun e Korçës tue u shque, shkoi në Paris ku mbaroi më 1933 Universitetin e Sorbonne-s në *Shkencat Politike* dhe në *Zhurnalisëm*. Aty ai themeloi shoqnín shqiptare studenteske, simbas modelit të *Shoqnisë Studenteske* të Vjenës së Austrisë, dhe e zgjanoi qarkun kulturor akademik me mbledhje të shpeshta në sallat e universitetit të Sorbonne-s tue tërhjekë folësa të njohun, gazetarë, shkrimtarë e miqë francez të njohun.

Mbas mbarimit të mësimeve universitare këthehet në Shqipní dhe fillon punën si gazetar në shtypin e asaj kohe. Kur në Korçë u themelue revista *Rilindja* nga *dr. Pandi M. Frasheri*, me 28 nanduer 1934, aty filloi të bashkëpunoi edhe Vasil Alarupi në shtyllën *Na duhet kulturë dhe karakter* ku bashkëpunojshin *prof. Kostandin Cipo, Sterjo Spasse, Tajar Zavalani, Ramiz Harxhi, Ilo Mitke Qafzezi, Bardhi Shtylla, Andon Mazrreku, Vedad Kokona* etj. Revista zgjati deri më 1936, e pastaj u mbyll nga auktoritetet qeveritare të asaj kohe.

Prej 1944 deri më 1948 Vasil Alarupi jeton në Italí dhe më 1948 emigron në Brazil dhe vendoset në Sao Paolo ku punon në nji kompaní kemikale si përkëthyes dhe asht aktiv në shtypin e vendit ku shpesh shkruen artikuj mbi Shqipnin.

Më 1950 emigron n'Amerikë dhe mbas pak kohe themeloi gazetën *Skënderbeu* që filloi botimin më 1951 e vazhdon disa numra dhe mandej mbas themelimit të *Albanian American Litterary Society*, boton gazetën e përmuejshme *Albanian American*, që shpesh asht tetë ose ma tepër faqesh të mbëdha dhe që vazhdon botimin deri më 1958, dhe ku bashkëpunojnë shumë pena artistike e letrare të kohës. Vasili aty derdhi krejt mallin e atdheut e të vendlindjes së tij, tue botue pshertimet e tija dhe bile edhe vizatimet e tija, se Vasili ishte edhe piktor me lapës, bile mjaft prolifik.

Nga Amerika ai bashkëpunoi me të gjithë shtypin e mërgimit sidomos me *Shêjzat* ku botoi mjaft novela e bile edhe tre broshura më vehte: *Çupat e Vançit; Këthimi në Krujë* dhe *Skënderbeu*. Si kryetar efektiv i *Shoqëris Letrare Shqiptare* n'Amerikë, ai organizoi mjaft mbramje shqiptare e shfaqje teatrale në shumë qytete të ndryshme të rretheve të Boston-it. Në kohët e fundit ai qe inspiruesi e organizuesi i *Mbramjeve Shqiptare* në New York, në Worcester, dhe Mbramja Shqiptare e fundit qe përkujtimi i *60-vjetorit* të ngritjes së Flàmurit në Korçë nga

Themistokli Gërmenji, që u mbajtë në Restaurantin *Pier Four* në Boston në praní të ma tepër se 400 shqiptarve.

Mbas vdekjes Familja botoi novelën *Gjënthi dhe Agimtha* shtyp në shtypshkronjën e Peter Kolonjës, dhe dedikue para vdekjes *Almerinës, bashkeshortes time*. Si kjo novelë presin botimin edhe dy tre novela të tjera që janë pjesë e nji vargu të gjatë punimesh që Vasili punoi papushue gjatë shumë vjetëve e të qortueme me dorën e Tij.

Vasil Alarupi njihet si nji nga novelistat e mirë të gjuhës shqipe, sidomos të së folmes korçare, tue paraqit zakonet e bukura shqiptare me nji gjallní të mahnitshme e me nji gjuhë të pasun.

Vdekja e Vasil Alarupit e vorfënon letërsín shqipe të diasporës sonë, dhe lenë nji zbrastí të madhe në rrethin e miqëve të shumët dhe nji plagë të pazavendë sueshme për Familjen e Tij.

Na të revistës *Shêjzat* që e kemi pasë bashkëpuntor që në fillim, u paraqesim ngushllimet tona familjarve dhe ulim kryet me respekt Përpara kujtimit të Tij.

HHO

Ida Koka ndrroi jetë

Nga Shqipnija ka mbrrijtun lajmi i vdekjes së *Ida Koka*, motër e mikut dhe përkrahsit të *Shêjzavet*, dr. Ton. Jetonte bashkë me nânën e vuente nga nji sëmundje pashërueshme.

Dr. Ton Kokës dhe mbarë Familjarvet kudo që gjinden, tue marrë pjesë në këtkumt të tyne, U paraqesim ngushullimet mâ të thella.

P.

Ndrroi jetë Gjeneral Zef Serreqi

Mbas nji sëmundje të shkurtën, ndrroi jetë në Romë, me 8 príll 1977, *Gjeneral Zef Serreqi*.

Lindi në Shkodër me 20 príll 1895 e këtu kreu edhe studimet e para. Pastaj n'Italí ndejti për nji kohë të gjatë për të krye studimet n'Akademín ushtarake. Me vullnet e zotsí që e dallojshin, muejti me mbrrijtun, shkallë-shkallë, deri në gradën mâ të naltë t'ushtrís shqiptare e kje edhe Adjudant i Mbretit Zog.

Ishte mikpritës e i njoftun si ndër rrethet t'ona, po ashtu edhe ndër qarqet e hueja. Ceremonija e mbrame fetare u bâ në Romë, ku morën pjesë nji numër i madh bashkatdhetarësh e të huej. Trupi i Tij, mbas do kohe, u dërgue n'Austrí, ku edhe u vorrosë.

Të vejës *Zojes Maria*, të *Bijes me Burr*, nipit *Hil Topallit* e mbarë far'e fisit, i paraqesim përdhimbtimet mâ të thella.

P.

Ndrroi jetë Miria Elena Vuksanaj Ndrevashaj

Mbas nji sëmundje të gjatë të bartun me besim e durim, ndrroi jetë, në Romë, me 19 gusht 1977 zoja *Miria Elena Vuksanaj Ndrevashaj*. Nâna e bashkëpuntorit dhe mikut të dashtun *Dom Prenk* e *Suor Alberta*.

Lindi në Theth me 15 mâj 1909. Grue Shqiptare e vërtetë e pajisun me zakonet e virtytet e malit, por edhe besimtare e kurr nuk u dishprue edhe mbas vdekjes së Bashkshortit që e la me dy fëmij të vogjël: *Prenken* e *Alberten*. N'at kohë ishte në moshën mâ të bukur: 24 vjeçare. Iu kushtue, atëherë, me krejt fuqít, rritjes së fëmijvet e ishte e lumtun kur i shikjoi që të dy tue ndjekun rrugën e Zotit.

Vorrimi u bâ në Romë e Meshën e çoi vet i Biri.

Dom Prenkës e *Motres Alberta* të dashtun, u dërgojmë ngushullimet mâ të sinqertat.

P.

Zhdukja tragjike e Luftarit të Lirís, Gjon Gjinaj

Nji dorë e poshtën dhe mizore, nji dorë trathtare dhe e shitun, nji dorë e mallkueme dhe e ndytë, bâni që të largohesh nga kjo botë Luftari i Lirís, *Gjon Gjinaj*. Të pandërgjegjshmit dhe frigacakët shprazën pushkën, jo si Burrat e vërtetë Shqiptarë, jo si ndjeksit e *Kanûnit të Lek Dukagjinit*, jo si ata që braktisën Atdheun e Familjen për të mbajtun nalt, edhe në mërgim, frymën e shëndoshtë të traditave shqiptare mâ të çmueshme.

Gjon Gjinaj ishte njerí i thjeshtë, por i dashtun e i nderuem nga të gjithë. Përhera buzëqeshës, bujár e mprojtës i të dobvet. Cilidò iu drejtonte për ndonji çashtje, ishte i bindun se tek Gjoni gjente përkrahjen e përpjekjen e pakursyeshme. Nuk urrente as anmikun, krejt përkundrazi kërkonte me bisedue e me u skjarue me tê; urrente vetëm komunizmin. Shkoi ndër Malet e Shqipnís për me u bashkue me Kap. Mark Gjomarkaj, prof. Alush Leshanakun, Ndoc Mirakaj, Sandër Gjomarkaj, Sefedin Biçakun e me nji numër të papërshkrueshëm Dëshmorësh të tjerë të Qindresës së vërtetë antikomuniste shqiptare që flîjuen edhe jetën për nji Shqipní të lirë në luftën kundra bishës s'egër komuniste e për të mbajtun gjallë përhera flakën e Lirís.

Edhe në mërgim vijonte me punue, në heshtje, e u mundonte me qênë i dobishëm, me krejt fuqít e veta, për çashtjet që interesojshin bashkësín mërgimtare.

Në vorrim kanë marrun pjesë qindra e qindra bashkatdhetarë e nji numër tepër i madh kunorash mbulonte arkivolin. *Të gjithë* deshtën, kështu, me i tregue Gjonit *dashunín* që ushqejshin për Tê e *të gjithë* ishin të bindun se ky gjak ishte derdhun për me kënaqun anmiqt e me shkaktue lëndime e varrë të reja në zêmrat e farefisit e të dashamirvet.

Me dashamirsí e mall vllaznuer do t'a kujtojmë, e zhpraztín e Tij, pa tjetër, do t'a ndiejmë : Perendija dhashtë që Gjon Gjinaj të pushoi në paqë e « dora trathtare dhe e shitun » mos të ketë aspak qetsí në ndërgjegje deri në çastin që do të paraqitet tek Drejtësija Hyjnore.

Z.

Pal Bib Mirakaj ndrroi jetë

Ndërsa revista ishte në shtyp e sipër, na erdhë lajmi i trishtueshëm së vdekjes, nga nji sëmundje e pashërueshme, të nji tjetrit Luftar të Lirís : *Pal Bib Mirakaj*.

Pjestarve të *Familjes Mirakaj* e *Nipave*, si edhe mbarë far'e fisit kudo që ndodhen, tue marrë pjesë në pikllim të tyne, u paraqesim përdhimbtimet mâ të ndieme.

V.

Collana di "Shêjzat"

MARTIN CAMAJ, *Djella,* tregim në prozë e në vjerrshë, 1-2, Romë 1958, faqe 142. L. 2.000

ERNEST KOLIQI, *Kangjelet e Rilindjes,* Poemth me përkthim italisht, 3, Romë, faqe 85. » 3.500

MARTIN CAMAJ, *Legjenda,* vjerrsha, 4, Romë 1964, faqe 74. » 2.500

ETËHEM HAXHIADEMI, *Skënderbeu,* vjerrsha, 5-6, Romë 1968, faqe 104. » 2.500

* * *

Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia, Roma 1959, 141+80 pp. » 10.000

MARTIN CAMAJ, « *Il Messale* » *di Gjon Buzuku.* Contributi linguistici allo studio della genesi, Roma 1960, 90 pp. » 3.000

HILUSH VILZA (ERNEST KOLIQI), *Shija e bukës së mbrûme,* rromanx, Romë 1960, faqe 173. » 20.000

ERNEST KOLIQI, *Pasqyrat e Narçizit,* Romë 1963, faqe 32. » 2.500

KARL GURAKUQI, *Nepër vullâjt e « Shêjzavet ».* Veprimtarija e Revistës *Shêjzat* në dhetëvjetorin e parë 1957-1966, Romë 1966, faqe 115. » 3.000

ANGELA CIRRINCIONE, *Sintassi albanese degli antichi scrittori,* Roma 1968, 120 pp. » 2.000

BERNARDIN PALAJ, *Opere.* Volume I: *Poesie,* a cura di ANGELA CIRRINCIONE, Roma 1968, 311 pp. » 5.000

TAHIR KOLGJINI, *Shpalime rreth « Lahutës ».* Shpalon disa fjalë shqip të përdoruna në *Lahuta e Malcís,* Istanbul 1969, faqe XIII-300. » 7.000

ERNEST KOLIQI, *Symfonija e Shqipevet,* Romë 1970, faqe 42. » 3.000

ERNEST KOLIQI, *The Symphony of Eagles.* Translated and with an introduction by ANESTI ANDREA, Roma 1972, pp. 21. » 3.000

TAHIR KOLGJINI, *Esat Pashë Toptani dhe akuzat, qi bahen,* Istanbul 1977, faqe 240. » 7.000

TYPIS POLYGLOTTIS VATICANIS

Studi Albanesi

pubblicati dall'Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma sotto la direzione del Prof. Ernesto Koliqi

(cm. 18 × 25)

TRADIZIONI POPOLARI DEGLI ALBANESI D'ITALIA

1. *Novellistica italo-albanese.* Testi originali raccolti dal prof. Luca Perrone. 1967, XXVI-602 pp., con 77 tavv. f.t. e 1 cartina. L. 9.000

2. *Racconti popolari di S. Sofia d'Epiro, S. Demetrio Corone, Macchia Albanese, S. Cosmo Alb., Vaccarizzo Alb., S. Giorgio Alb.,* 1970, XXXII-448 pp., con 6 tavv. f.t. e 1 cartina. » 7.500

3. *Racconti popolari di Greci* (Katundi) *in Provincia di Avellino e di Barile* (Barili) *in Provincia di Potenza,* a cura di Martin Camaj, 1972, XXI-190 pp., con 3 tavv. f.t. e 1 cartina, Tipografia Dario Detti, Roma. » 5.500

STUDI E TESTI

1. De Rada G., *I Canti di Milosao. Traslitterazione, varianti delle edizioni a stampa e traduzione,* a cura di Giuseppe Gradilone, 1965, VIII-136 pp., con 7 tavv. f.t. » 3.000

2. Schirò G., *Këthimi. Il ritorno.* Poema postumo con introduzione a cura di Giuseppe Schirò jr., 1965, XXIV-262 pp., con 5 tavv. f.t. » 5.500

3. *La legge delle montagne albanesi nelle Relazioni della Missione Volante 1880-1932,* a cura di G. Valentini, 1968, XVI-288 pp. » 4.500

4. Camaj M., *La parlata albanese di Greci, in provincia di Avellino,* IV-120 pp. » 3.500

5. Koliqi E., *Saggi di letteratura albanese,* 1972, IV-260 pp. » 5.500

6. Gradilone G., *Altri studi di letteratura albanese,* 1974, 303 pp. con 12 tavv. f.t. Editrice Bulzoni, Roma. » 8.000

CASA EDITRICE LEO S. OLSCHKI - CAS. POST. 295 - 50100 FIRENZE

Çmimi: Lit. 20.000 - $ USA 25